

DORACAK BIBLIK

dr Stephen Etches

Rruga e Paqes 2020

e përktheu: Rifat Buzuku dhe Stephen Etches
korrektura: Rifat Buzuku, Gani Smolica

PËRMBAJTJA E LËNDËS

DORACAK

Perëndia	7
Bibla	8
Kanuni	9
Apokrifa	10
Krijimi	10
Zanafilla	11
Hipoteza e gojëdhënave	15
Zhvillimi i kombeve të lashtësisë	16
Kombet e lashtësisë	20
Dalja	25
Moisiu	32
Ligji (tora)	34
Dhjetë urdhërimet	41
Sistemi i flijimit	43
Festat e izraelit	46
Besëlidhjat	50
Endja në shkretëtirë	53
Pushtimi i tokës së premtuar	58
Joshua	62
Gjyqtarët dhe çlirimtarët	64
Monarkia	69
Davidi	72
Solomoni	74
Mbretëria e ndarë	77
Mërgimi	83
Kthimi nga mërgimi	86
Estera	92
Fenomena e profecisë	93
Profetët e besëlidhjes së vjetër	95
Isaia	97
Jeremia	102
Vajtimet	105
Ezekieli	108
Amosi	116
Hosheja	118

Hagai	120
Mikeja	122
Cefanja (Sofonia)	124
Nahumi	122
Jona	127
Obadja	129
Joeli	133
Habakuku	134
Zakaria	135
Malaki	139
Letërsia e urtësisë	137
Fjalët e urta	139
Kënga e këngëve	140
Koheleti	141
Jobi	142
Psalmet	143
Letërsia apokaliptike	146
Problemi i numrave të mëdhenj në DhV	147
Periudha ndërdhiatore	150
Sfondi historik i DhR	153
Katër ungjijtë	155
Jezusi – një figurë historike	166
Misioni i Jezusit	168
Java e fundit e shërbimit të Jezusit	172
Vdekja e Jezusit	173
Ringjallja e Jezusit	174
Shkrimet e apostujve	178
Kisha e parë	182
Zhvillimi i Kishës së parë	186
Letra e palit drejtuar romakëve	189
1 + 2 letrat drejtuar korintasve	185
Letra e dytë drejtuar korintasve	186
Letra drejtuar galatasve	187
Letra drejtuar efesianëve	189
Letra e palit drejtuar filipianeve	190
Letra drejtuar kolosianëve	191
Letra e parë drejtuar selanikasve	192
Letra e dytë drejtuar selanikasve	193

Letrat baritore	199
Letra drejtuar filemonit	200
Letra drejtuar hebrenjve	200
Letra e Jakobit	202
Letra e parë e Pjetrit	203
Letra e dytë e Pjetrit	204
Letra e Judës	206
Letra e parë e Gjonit	206
Letra e dytë e Gjonit	208
Letra e tretë e Gjonit	208
Libri i apokalipsit	209
Tabelat e ndryshme	228
Kritika tekstuale	229
Gjenealogjia e Jezusit	246
Fjalor biblik etnografik	248

PERËNDIA

Bibla është një libër, ose më mirë të themi, një përmbledhje librash, ku flitet për Perëndinë dhe për marrëdhëniet e tij me botën, veçanërisht me njerëzimin. Në këtë kuadër Perëndia shfaqet me anë të veprave dhe fjalëve.

Sipas Biblës, Perëndia jo vetëm që ekziston, por edhe mund të njihet. Në dritën e vetëshfaqjes së Perëndisë në Shkrimet e shenjta, mund të japim pohimet që vijnë:

1) Perëndia është një Person, një qenie shpirtërore krejtësisht e pavarur nga krijimi i tij. Ai është krijuesi i të gjithave, i vetmi burim jete, dhe kështu të gjitha qeniet e gjalla për ekzistencën e tyre varen nga Ai.

2) Perëndia, për nga natyra, është shpirt i pakufizuar. Ai nuk është një përmbledhje konceptesh, por një Person. Nga njëra anë, Ai është mbi të gjitha dhe banon në amshim, por nga ana tjetër është afër atyre që janë të përulur dhe që i nënshtrohen Atij.

3) Perëndia është burimi i arsyes dhe i moralit të shëndoshë. Ai është i shenjtë, i ndryshëm nga ne; prandaj ka dashuri të shenjtë, mëshirë dhe urtësi të shenjtë.

4) Perëndia është i plotpushtetshëm. Bën planet e tij dhe i zbaton ato në kohën e tij dhe në mënyrën e tij. Kjo është, thjesht, shprehja e inteligjencës së tij, fuqisë së tij dhe urtësisë (d.m.th. shkathtësisë) së tij. Kjo do të thotë se vullneti i Perëndisë nuk është aspak arbitrar, sepse vepron në përputhje të plotë me karakterin e vet.

5) Perëndia, në mënyrë thelbësore, është një bashkësi e përbërë nga tre personat, nga natyra trepersonash, një Trini. Vetëm njeriu është në gjendje të ketë bashkësi me Perëndinë nëpërmjet shpirtit të tij. Përveç kësaj, Perëndia dëshiron të ketë bashkësi me njeriun. Për këtë, Ai ka bërë udhën e kthimit për te Vetja, duke dërguar personin e dytë të Trinisë, Jezusin, Mesinë, për të zgjidhur problemin themelor të njeriut; largimin e tij nga Perëndia për shkak të rebelimit të tij.

Në Bibël, gjithashtu, flitet rreth përgatitjes së shpëtimit, si edhe për vetë shpëtimin; se si mund të shpëtojmë, për të gëzuar bashkësinë e përjetshme me Të.

BIBLA

Sipas Dhiatës së Re, *I tërë Shkrimi i shenjtë është frymëzuar nga Perëndia dhe mund të përdoret me dobi për mësim, për korrigjimin e gabimeve dhe të mësimëve të rreme, që të bëjmë një jetë që i pëlqen Atij.* (2 Tim 3,16). Por, a ekziston ndonjë dëshmi për këtë pohim? Po! Dhe për këtë mund të përmendim të paktën tri arsye:

1) Plotësimi i profecive të dhëna, disa qindra vjet para realizimit të ngjarjeve të përmendura. Kjo tregon se Perëndia është autori i fundit i Biblës, sepse Ai është i vetmi që jo vetëm i di të gjitha para se të ndodhin, por edhe mund t'i shkaktojnë. Siç shkruan apostull Pjetri: *Por kini parasysh se asnjë profeci e Shkrimit të shenjtë nuk e ka burimin në mendjen e njerëzve; sepse lajmi i profetëve nuk u hartua nga njerëzit. Profetët i zuri Shpirti i shenjtë dhe ata thanë atë që ua futi në mendje Perëndia.* (2.E Pjetrit 1,20-21).

Ata që mohojnë mundësinë e profecisë parashikuese datojnë librin e Danielit në periudhën makabe, kurse pjesën e dytë (disa madje edhe librin e tretë) të Isaisë në periudhën pas mërgimit.

2) Njëlloshmëria e Shkrimit të shenjtë. Megjithëse kishte shumë autorë, të cilët shkruan në kohë të ndryshme, mësimet në librat e tyre përputhen në mes tyre. Të gjithë kishin dhuntinë e profecisë, d.m.th. shkruanin nën frymëzimin e Shpirtit të Perëndisë, por ishin të profesioneve të ndryshme; për shembull, disa ishin mbretër, njëri ishte bujk, tjetri bari etj.

3) Mënyra e veçantë se si u shkrua Shkrimi, bie në sy. Të gjitha ngjarjet e përpiluara në Dhiatën e Vjetër përmbajnë parime shpirtërore, të cilat na mësojnë (në Dhiatën e Re) për karakterin e Perëndisë. Kjo mënyrë e shkrimit quhet tipologji. Në dy rrethe të Dhiatës së Re flitet për këtë parim. *Të gjitha këto u ndodhën atyre, që ne të nxjerrim mësim prej tyre. Kjo është shkruar për paralajmërimin tonë, sepse jetojmë në kohën e fundit.* (I Korintasve 10,11), dhe në një vend tjetër: *Ajo që është shkruar në Shkrimin e shenjtë, u shkrua që të mësojmë prej saj, me qëllim që të na japë zemër që të qëndrojmë të patundur dhe t'ia arrijmë qëllimit që po presim* (Romakëve 15,4). Është e qartë se Perëndia i drejtonte autorët e Biblës, në mënyrë që më vonë teksti biblik t'u shërbente qëllimeve të Tij si burim i mësimit praktik dhe autoritetshëm për besimtarët. Në Bibël tregohet se si plani i Zotit për shpëtimin e njeriut që zhvillohet nëpër historinë ka një unitet të paracaktuar nga Ai qysh në fillim dhe që kulminohet në personin e Mesisë.

Kjo do të thotë se Bibla është shkruar në një mënyrë përzgjedhëse,

që të dallohen marrëdhëniet ndërmjet Perëndisë dhe njerëzimit si edhe plani i shpëtimit të Tij.

KANUNI

1). **Përkufizim:** kanun do të thotë një përmbledhje librash që janë nor-mative për të gjitha çështjet e fesë dhe sjelljes.

Në Shkrimin e shenjtë kanuni lidhet gjithnjë me konceptin e besëlidhjes. Teksti i dokumentit përcakton kushtet e besëlidhjes. Në kohën e DhV ideja e kanunit ishte e njohur për çdokënd.

2). **Kanuni i Dhiatës së vjetër:** Shkrimet e DhV i zgjodhën njerëzit e autorizuar nga Zoti, nën frymëzimin e Shpirtit të shenjtë. Njerëz të tillë ishin Moisiu (hebr. Mosheu), Davidi (nën drejtimin e Samuelit), Salomoni (hebr. Sholomo), Hizkija (gr. Ezekia), Joshija dhe Ezra. Kanuni u përfundua nga Ezra (400 vjet para Krishtit). Tekstet u redaktuan në kohën e Sa-muelit, Davidit, Hizkijës dhe Ezrës. Ky kanun u ratifikua në kuvendin e Javneut më 73 e.r. Në çdo fazë të kanunizimit, kriteret vendimtare ishin:

a) Personat e kualifikuar për të vendosur kanunin (d.m.th. profetët).

b) Përdorimi i lëndës në liturgjinë e Tempullit. Futja në kanun do të thoshte konkretisht autorizim për përdorimin në liturgjinë e Tempullit.

Autorët e DhV ishin Moisiu (pjesës së parë që quhet Tora = mësimi themelor i fesë), profetët (zbatimi i mësimin), dhe të urtët (asimilimi i më-simit, në formë fjalësh të urta dhe adhurimi), e kjo pajtohet me tri ndarjet e DhV (Ligji, Profetët dhe Shkrimet e tjera). Autori i librave të Joshuas dhe Gjyqtarëve ishte profeti Samuel. Librat e Samuelit dhe Mbretërve (hebr. libri i Mbretërive) i shkroi profeti Isaia, por profeti Jeremi i redaktoi më vonë. Kështu, libri hebraik i Mbretërive është një hyrje në librin e Isaisë. Danieli ka luajtur një rol të rëndësishëm, sepse ai ishte lidhja (në kohën e mërgimit) midis Jeremisë (i cili shkoi në Babilon pas kohës së tij në Egjipt) dhe Ezrës. Danieli ia dorëzoi librat e kanunit Ezrës në fund të mërgimit. Librat e Ezrës dhe Nehemisë, si dhe librat e Kronikave i shkroi Ezra. Ai, gjithashtu, futi në kanun librat e tjerë të pjesës së tretë të kanunit (Kënga e këngëve, Ruta, Vajtimet, Koheleti dhe Estera).

Kanuni hebre është ndarë në tri pjesë:

LIGJI (5 libra); Zanafilla, Dalja, Levitiku (d.m.th. Kodi priftëror), Numrat dhe Ligji i përtërirë (d.m.th, Besëlidhja e ripërtërirë.

PROFETËT (21 libra); Joshua, Gjyqtarët, 1 + 2 i Samuelit, 1 + 2 i Mbre-

tërve, Isaia, Jeremia, Ezekieli, Hoshea, Joeli, Amosi, Obadia, Jona, Mihaja, Nahumi, Habakuku, Cefania, Hagai, Zakaria, Malahi.

SHKRIMET E TJERA (13 libra); Psalmet, Fjalët e urta, Jobi, Kënga e Këngëve, Ruta, Vajtimet, Koheleti, Estera, Danieli, Ezra, Nehemia, 1 + 2 Kronikave.

APOKRIFA: Në disa botime të Biblës paraqiten edhe 7 libra të tjerë (Tobia, Judita, Libri i Dijes, Libri i Sirakut, Baruku, 1 + 2 mbi Makabentë, si dhe disa shtesa në librat e Esterës dhe të Danielit) që nuk i përkasin ka-nunit të Jerusalemit, por që pranohen nga kisha katolike, sepse bënë pjesë në botimin e Septuagintës (përkthimi grek). Në të vërtetë mendimet rreth Apokrifës në Kishën ortodokse janë të ndara. Këto libra ekzistojnë në Izraelin e lashtë, por nuk u pranuan për leximin publik: ato mund të konsultoheshin për përmirësim shpirtëror personal.

Është kuptimplotë që asnjë botim çifut i Septuagintës (LXX) nuk u gjet deri më sot. Çdo botim i krishterë i Septuagintës ka një përmbledhje të ndryshme të librave apokrife. Kur çifutët nga Aleksandria përvetësuan përkthimin grek të Akuilës, për të zëvendësuar Septuagintën, u përjashtuan të gjithë librat e Apokrifës.

Filo, i cili jetonte në Egjipt më 20 p.e.r deri te 50 e.r. nuk citon kurrë nga ndonjë libër apokrifik, por shpesh nga librat kanonikë.

S'ka dëshmi historike për ekzistencën e ndonjë kanuni të dytë aleksandrin, i cili do të justifikonte përfshirjen e librave apokrifë në ndonjë botim të Biblës.

KRIJIMI

Bota është krijimi i Zotit. Materialistët tradicionalistë mendojnë se bota është një proces i pa fund i gjeneratës. Panteistët besojnë se bota është një emanacion i përjetshëm. Megjithatë, teistët janë i mendimit se bota është krijuar brenda dimensionit të kohës. Gjithësia kishte një fillim. "Në fillim Perëndia krijoi qiejtë dhe tokën." (Gen. 1,1). Materialistët janë i mendimit se bota doli *ex materia* (nga materia). Panteistët mendojnë se bota lindi *ex deo* (nga Perëndia). Në kundërshtim, të krishterët besojnë se Perëndia e krijoi *ex nihilo* (nga asgjë).

Doktrina e krijimit ka disa implikime të rëndësishme për ekologjinë. Ndërsa bota nuk është perëndi (kundër panteistëve), ajo nuk na takojnë neve, siç pohojnë materialistët. Nga këto konstatime dalin dy aspekte

të ekologjisë së krishterë: toka i takon Perëndisë (e jo njeriut), ndërsa njeriu duhet ta administrojë (Geisler: *Etika e krishterë*)

ZANAFILLA

Libri i Zanafillës ndahet në dy pjesë të pabarabarta: historia e lashtë (1-11) paraqitet si prologu i historisë së shpëtimit, me të cilën merret mbarë Bibla. Libri fillon që nga prejardhja e botës dhe zgjeron perspektivën e saj për të përfshirë edhe tërë njerëzimin. Tregon për krijimin e botës dhe të njeriut, për rënien e njeriut në mëkat, për pasojat e saj, dhe për shtimin e së keqes që dënohet me përmbytjen e madhe. Duke filluar me Noahun dhe familjen e tij, bota popullohet përsëri, por, me anë të tabelave gjenealogjike që shkojnë duke u kufizuar, në fund, i kushtohet vëmendje Avrahamit, atit të popullit të zgjedhur.

Me anë të tregimeve të ndryshme, si p.sh. të tabelave gjenealogjike, theksohen disa të vërteta teologjike që janë për pjesën e shfaqjes si vijon:

1) Perëndia është krijuesi i gjithësisë dhe i tërë njerëzimit; prandaj njeriu i përgjigjet Atij për sjelljen e tij.

2) Njerëzit nuk iu bindën urdhrit të krijuesit të tij, dhe tani, për shkak të mendjemadhësisë, provojnë jetën me vuajtje, mundime, hutim dhe ndarje mes tyre.

3) Përballë mëkatit të tyre, Perëndia reagon duke i dënuar njerëzit, por krijon një njerëzim të ri, të lindur nga njeriu (Noahu), për të cilin pati mëshirë.

4) Por për shkak të shtimit të prishjes së njerëzimit, Perëndia, që i kishte premtuar Noahun që të mos dërgojë më përmbytjen, tani ndërmerr një detyrë me afat të gjatë, në të cilën do të shprehet pa masë durimi dhe mëshira e tij; ai do të formojë një popull, të lindur nga njeriu i zgjedhur (Avrahami). Këtë popull e përcakton për t'u bërë dëshmitari i tij mes popujve të tjerë, që edhe ata të njohin një ditë Ligjin e tij – udhëzimet për jetesën sipas vullnetit të tij – dhe ta zbatojnë në jetë.

5) Në këtë popull, shpesh të pabesë dhe zemërgur, me gjitha paralajmërimet e profetëve, në fund Perëndia do ta dërgojë Birin e tij, Fjalën e tij të gjallë, për t'ia shpallur Izraelit dhe kombeve të tjera shpëtimin e tij. Vetëm me flijimin pajtues të Jezusit, Mesisë, për mëkatet tona (shprehja supreme e mëkatit njerëzor si dhe e dashurisë hyjnore), do të realizohet plotësisht qëllimi i Perëndisë për shpëtimin e botës.

Për shkak të mosbindjes së Adamit ndaj urdhrit të Perëndisë, i gjithë njerëzimi u dënua me vdekje, por për shkak të vdekjes pajtuese dhe

ringjalljes së Jezusit, Mesisë, Adamit të dytë, udha e shpëtimit u hap për të gjithë njerëzit.

Në historinë e patriarkëve (Zanafilla kap. 12-50), tregohet për stërgjyshërit e mëdhenj të Izraelit;

Avrahami (gr. Abrahami) është njeriu i besimit, bindja e të cilit shpërblehet nga Perëndia, që i premtun një trashëgimtar si edhe tokën e premtuar që do t'u takojë pasardhësve të tij (kap 12,1 – 25,18). Përveç kësaj, Avrahamit i premtohet se një nga pasardhësit e tij do të jetë Mesia.

Zoti është perëndi i individëve, Avrahamit dhe pasardhësve të tij, e jo e vendeve, siç e kishte zakon nën banorët e Kanaanit

Jakovi (hebr. Jaakovi) është njeri dinak që ia zë këmbën të vëllait, merr me mashtrim bekimin e të atit, Izakut (hebr. Jichakut), dhe ia kalon në dinakëri xhaxhait të tij, Lavanit. Por, të gjitha këto dinakëri nuk do t'i vlenin asgjë, në qoftë se Perëndia nuk do ta kishte zgjedhur atë (e jo Esavin) që para lindjes së tij dhe nuk do t'ia kishte ripërtëritur premtimet e besëlidhjes që i ishin dhënë Avrahamit (25,19-36).

Midis Avrahamit dhe Jakovit, Izaku është një figurë mjaft e dobët, jeta e të cilit tregohet në lidhje me të atin dhe birin e tij.

Dymbëdhjetë bijtë e Jakovit janë stërgjyshërit e dymbëdhjetë fiseve të Izraelit. Njërit prej tyre i kushtohet e tërë pjesa e fundit e Zanafillës. Kapitujt 37-49 (pa 38 dhe 49) përmbajnë biografinë e Josefit, njeriut të urtë. Njeriu i urtë është ai që ia ka frikën Zotit, e kjo do të thotë respekti i duhur për të dhe nënshtrimi i jetës ndaj autoritetit të tij. Ky tregim, i cili ndryshon nga tregimet e mëparshme, kalon pa ndërhyrje të dukshme të Perëndisë dhe pa shfaqje të re, megjithatë është një mësim i plotë; virtyti i të urtit shpërblehet dhe Zoti i kthen poshtërsitë e njerëzve në të mirë.

Libri i Zanafillës është një njësi e mbaruar; historia e stërgjyshërve. Kjo histori e patriarkëve është një histori familjeje dhe përmbledh kujtimet që mbaheshin për stërgjyshërit: Avrahamin, Izakun dhe Jakovin. Ajo është një histori popullore; ajo zgjatet me anekdotat personale dhe tiparet piktoreske, pa kujdes për t'i lidhur me historinë e përgjithshme. Në fund është një histori fetare; të gjitha kthesat vendimtare karakterizohen nga një ndërhyrje hyjnore dhe gjithçka, siç duket, drejtohet nga vetë Perëndia. Kjo është një pikëpamje e vërtetë në nivelin më të lartë fetar, por nuk e merr parasysh veprimin e shkaqeve të dorës së dytë; përveç kësaj, faktet paraqiten, shpjegohen dhe mblidhen për të treguar një tezë fetare;

1) ka Perëndi që formoi një popull dhe i dha një vend;

2) ky Perëndi është Zoti, ky popull është Izraeli, dhe ky vend quhet

Vendi i Premtuar (ose: Toka e shenjtë – d.m.th. Toka që i takon Perëndisë).

Është me rëndësi të kuptohet se këto premtime asnjëherë nuk u anuluan ose u zëvendësuan, megjithëse kanë qenë pezull, në kohën e epokës së kishës. Gjithashtu shpallet se kush e bekon Avrahamin (dhe pasardhësit e tij) do të bekohet, por kush e mallkon do të mallkohet: ky parim u vërtetua që athëherë dhe sot e kësaj dite, në lidhje me kombin e Izraelit.

STRUKTURA DHE PREJARDHJA E ZANAFILLËS

Lënda në librin e Zanafillës është shumë e lashtë. Siç duket, libri kombinon lëndën e shkruar mbi 10 pllaka prej deltime me prejardhje mesopotamiane (kap. 1-36) me një tregim me prejardhje egjiptiane (kap. 37-50). Prof Uajzman e ndan lëndën e Zanafillës në pjesët që fillojnë me shprehjen: *Ky është libri i breznive të...*(Zan 2,4; 5,1; 6,9; 10,1; 11,10; 11,27; 25,12.9; 36,1.9; 37,2).

Sipas teorisë së prof. Uajzmanit Zanafilla u përkthye nga pllakat individuale që do të mbanin lëndën e asaj që vijon. Kështu tregimet për krijimin e planetit tonë si dhe të kopshtit të Edenit do të jenë shkruar në një pllakë të vetme prej Moisiut, kur këto ngjarjet iu zbuluan nga i vetmi dëshmitar okular, vetë Zoti. Tregimet për rënien e njeriut në mëkat dhe ngjarjet të mëpasshme do të jenë shkruar në një pllakë tjetër prej Adamit si dëshmitar okular i këtyre ngjarjeve. Pastaj Adami do t'ia ketë kaluar këto pllaka pasardhësit të tij, Shemit, dhe kështu me radhë deri në Josefin. Pastaj Josefi do t'ia ketë shënuar kapitujt e fundit dhe do t'ia ketë vënë të gjitha këto pllaka në bibliotekën e faraonit. Atëherë Moisiu, kur ishte në oborrin e faraonit do të ketë pasur mundësi t'i lexojë këto pllaka. Pastaj do t'ia ketë përkthyer ato në hebraisht.

Teoria e traditës së gjatë kinse gojore është i çalë, sepse bazohet në parimin që vlen për fiset nordike: popujt e Lindjes së Mesme dinin shkrim i këndim që në lashtësi.

TREGIMI I KRIJIMIT NË LIBRIN E ZANAFILLËS

Historia e krijimit në librin e Zanafillës është unike ndër tregime të ngjashme të lashtësisë. Në shumicën e filozofive të lashta dhe të feve pagane, njerëzit besonin në një lloj metamorfoze gjinësh, në një gjenezë spontane, madje edhe në atë se gjithësia lindi nga marrëdhëniet seksuale

ndërmjet perëndive! Tregimi i Zanafillës nuk është të këtij lloji. Përkundrazi, tregimi është shkruar me qëllim që ta kundërshtojë pikëpamjen idhujtare të kombeve pagane të lashtësisë, të cilat e adhuronin diellin, hënën dhe yjet. Për këtë arsye është theksuar roli i vërtetë i trupave të tillë qiellore.

Nga ana tjetër, tregimi i Zanafillës nuk është shkruar në terminologjinë e shkencës bashkëkohore, por në një stil të thjeshtë që mund të kuptohet në çdo kulturë dhe në çdo kohë. Është e qartë se Perëndia dëshiron që krijesat e tij, sidomos fëmijët e tij, ta shohin kozmosin nga pikëpamja e tij. Kozmosi nuk është një vend i ftohtë pavetor dhe pa kuptim: nuk evoluoi nga vetvetja. Tregimi është shkruar në një terminologji personale të përzemërt. Toka jonë shumë e bukur u krijua nga Perëndia i dashur, por i gjithëpushtetshëm, si vendbanim për njerëzit. Për t'u bindur, mjafton ta krahasojmë planetin tonë me planetët e tjerë të sistemit tonë diellor.

Sidoqoftë, ka disa vështirësi që paraqiten për mentalitetin shkencor të shekullit tonë, të cilat do të t'i shqyrtojmë si më poshtë.

1) Tregimi përshkruan krijimin e jetës në planetin tonë e jo krijimin e kozmosit, megjithëse përmendet kalimthi se Perëndia krijoi edhe kozmosin. Me dukjen e diellit dhe hënës vetëm në ditën e katërt, theksohet se Perëndia është krijuesi i dritës, e jo këta trupa qiellore të hyjniuar nga paganët.

2) A janë «ditët» ditë të vërteta? Siç duket, theksi i tregimit është krijimi i menjëhershëm i çdo faze me urdhrin e Perëndisë. Perëndia i gjithëpushtetshëm dha urdhër dhe gjithçka u bë. Atje ku Perëndia vepron kështu, nuk ka nevojë për periudhat e gjata të kohës. Edhe në qoftë se ditët i interpretojmë si faza të veprimtarisë, pikëpamja e autorit përjashton mundësinë e ekzistencës së periudhave prej miliona vjetësh. Ajo s'është aspak e shkruar nga pikëpamja evolucioniste.

Disa mendojnë se «ditët» janë mënyrë didaktike ose liturgjike e paraqitjes së lëndës, por na vjen vështirë ta pranojmë se skema 6-ditorshe e punës dhe 1-ditorshe të pushtimit të themelohet vetëm mbi një figurë letrare: ajo duhet të themelohet mbi një realitet (si p.sh. Pasha themelohet mbi ngjarjet reale të çlirimit dhe Daljes nga Egjipti).

3) Rendi i krijimit, në kapitullin e parë, siç duket, nuk pajtohet me rendin në kapitullin e dytë. Por, nuk është ashtu. Kapitulli i dytë nuk na paraqit një tregim paralel, por merret me marrëdhëniet: marrëdhënia ndërmjet Perëndisë dhe njeriut, njeriut dhe punës, njeriut dhe kafshëve, dhe ndërmjet burrit dhe gruas. Kapitulli i dytë, gjithashtu, na përgatit skenën e veprimit të kapitujve të mëtejshëm: tundimi, rënia në mëkat

dhe dëbimi nga kopshti etj. Me fjalë të tjera, rendi në kapitullin e dytë nuk është kronologjik, por tematik.

Mjerisht, sot, shumë njerëz nuk e marrin seriozisht tregimin biblik të krijimit. E kjo është për dy arsye:

A) Libri nuk është shkruar në terminologjinë shkencore të shekullit XXI.

B) Mendohet se libri është në kundërshtim me zbulimet e shkencës, por duhet vërejtur se:

1) Tregimi i krijimit është shkruar me një terminologji që mund të kuptohet nga njeriu i rëndomtë në çdo shekull.

2) Tregimi i krijimit është në kundërshtim me njëfarë filozofie materialiste, por jo me shkencën e vërtetë, e cila përcaktohet si neutrale.

HIPOTEZA E GOJËDHËNAVE

Hipoteza e gojëdhënave paraqit argumente për një kompozim të mëvonshëm të Pesëlibërshit (ose Pesë librave të Torës) që përbëhet nga katër burime (J, E, D, and P). Kjo hipotezë është themeluar me presupozimet e filozofit Hegel të cilat janë evolucioniste dhe kundërmbinatyrore. Presupozohet që mbarë historia ka evoluar nga faza primitive (d.m.th. nga politeizmi) deri në fazën më komplekse (d.m.th. në monoteizam). Ithtarët e kësaj hipoteze mendojnë se sa e hershme të jetë lënda, aq më e mosbesueshme dhe legjendare duhet të jetë ajo. Për të vërtetuar këtë evoluim, lënda biblike do të jetë kompozuar ose në kohën e monarkisë (Davidi etj) ose pas mërgimit të popullit në Babilon. Megjithatë shkenca arkeologjike moderne ka treguar se kjo hipotezë nuk qëndron: analiza e besimeve të shumicës së fiseve primitive ka treguar se në fillim ishte monoteizmi dhe se politeizmi ishte zhvillim i mëvonshëm, falë hyjnizimit të fenomeneve natyrore dhe të adhurimit të të parëve të fisit.

Përveç kësaj mendohet se shkrimi u shpik vetëm pas kohës së Moisiut. Arkeologia ka treguar se kjo është gabim. Për shembull, besëlidhja që u ratifikua në kohën e Moisiut ishte modeluar sipas origjinalit hitas, i cili nuk përjetoi shkatërrimin e perandorisë hitase rreth 1178 para Kr.

Pesëlibërshi nuk përmend as Jeruzalemin, as tempullin e as shenjtëroren e Shilos, të cilat i përkasin kohës së mbretit Joash, kur gjoja u përpilua pesëlibërshi. Disa pohojnë se kushtet e Ligjit janë tepër komplekse për epokën gjoja primitive të Daljes. Komplexiteti i pllakave të Marit (afro 1750 para Kr.), pllakave të Nuzit (afro 1500 para Kr.) si dhe pllakave

të Eblës (afro 2250) dhe një bollëk lëndash nga Egipeti i lashtë tregojnë se qytetërimet e lashta dinin shkrim e këndim dhe ishin në gjendje të përpilonin kodet ligjore shumë të ndërlikuara.

Për gojëdhënien priftërore – kryesisht Levitiku (kodi profëror), Numërimet (Numrat) dhe pjesat e Ligjit lidhur me ritualeve priftërore – pohohet se është pjesa më e mëvonshme e Ligjit të përpiluar rreth 450 para Kr. Kështu pohohet se Ligji ritual pasqyron epokën pas mërgimit, et jo shek. XV. Po të jetë kjo e vërtetë, e kemi të vështirë ta kuptojmë përse bëhet fjalë në tekstet priftërore për urimin dhe tumimin, nazireatin, tendën e shenjtë, arkën e besëlidhjes, qytetet e strehimit, kushtin për mendjen e zezë, ritin e lartësimit dhe shumë gjëra të tjera që ishin krejt anakronizmet nga koha pas mërgimit.

ZHVILLIMI I KOMBEVE TË LASHTËSISË

Në Bibël pohohet se të gjitha racat rrjedhin nga Adami, dhe kështu, të gjithë njerëzit kanë trashëguar qëndrimin e tij mëkatar dhe kanë solidarësi me të. Por a është kjo e mundur nga pikëpamja gjenetike dhe shkencore? Në Bibël jepet historia e zhvillimit të individëve deri te familjet, dhe nga familjet deri te popujt, dhe nga popujt deri te kombet. Për këtë mund të lexohet në kapitujt e parë të Zanafillës, dhe veçanërisht në të ashtuquajturën tabelë të kombeve në kap. 10. Historia e rritjes së vrullshme të popullsisë botërore në librin e Zanafillës është përzgjedhëse: autori interesohet vetëm për gjenealogjinë e njerëzve besimtarë midis rritjes së prishjes morale. Lexojmë p. sh. se kishte njerëz të tjerë në kohën e Kainit dhe Hevelit, të cilët ishin në gjendje të hakmerreshin me Kainin. U kalkulua se nga vdekja e Adamit (jetoj 930 vjet) mund të ketë pasur një popullsi prej 20 miliona njerëzish, në qoftë se rritja e riprodhimit ishte e njëjta si e jona sot. Ka mundësi që gjenealogjitë në Zan 1-12 (10 emra nga Adami deri te Noahu, dhe 10 emra nga Noahu deri te Avrahami) të jenë përzgjedhëse. Por, pasi përmytja i shkatërroi të gjithë (përveç Noahut me familjen e tij), çështja që na intereson është zhvillimi i popullsisë duke filluar nga përmytja e madhe.

a) Nga familjet deri te kombet: lënda rregullohet në mënyrë të atillë që nënkuptohet se ndarja gjuhësore e Babelit u përgjigjej familjeve dhe se çdo ndarje e tillë presupozon se do të kishte një tokë (vend), ku çdo familje mund të banonte dhe të punonte, dhe se grupet e tilla familjare do të zhvilloheshin në kombe. Veprat 17,26 i përgjigjet kësaj ideje. *Prej një njeriu krijoi të gjithë popujt e njerëzimit, që të banojnë në tërë sipërfaqen e tokës; (me mirësinë e tij) u jep stinë e vendbanime.*

b) Ka mundësi që Shemi të jetë autori i listës, sepse ai i vë në listë pasardhësit e tij deri te brezi i pestë në disa raste, kurse gjenealogjia e Hamit zgjerohet vetëm deri te brezi i tretë, dhe ajo e Jafetit vetëm deri te brezi i dytë. Kjo do të shënojë se Shemi e humbi kontaktin me shumicën e të afërmeve të tij pas ngatërimit të gjuhëve dhe shpërndarjes së madhe.

c) Shemi e dinte nga profecia e Noahut se ai ishte njeriu i zgjedhur për të transmetuar dijeninë e Perëndisë së vërtetë si dhe premtimeve të tij ndaj brezit të mëparshme.

d) Ndarja e tokës së populluar, për të cilën bëhet fjalë kur thuhet se ajo ndodhi në ditët e Pelegut, do t'i referohet ndarjes gjuhësore dhe geografike që identifikohet me ngjarjet që pasonin ato të Kullës së Babelit. Në qoftë se Pelegu lindi pak pas shpërndarjes, s'është çudi që Everi të përkujtojë një ndodhi aq të rëndësishme në emërimin e birit të tij (i cili do të thotë «ndarje»). S'ka të ngjarë se bëhet fjalë për largimin e ngadalshëm të kontinenteve nga njëri-tjetri.

e) Sigurisht u bënë shtegtime nëpër urat tokësore te ngushtica e Beringut dhe tek ajo e Malajzisë, kur niveli i detit ishte më i ulët se sa është tani, gjatë shekujve pas përmytjes, kur shumica e ujërave të tokës ishte e ngrirë në sheshinat e mëdha kontinentale të kohës së akullnajave. Përdorimi i anijeve as nuk mund të përjashtohet në jug, kurse krahinat që janë tani shkretëtira (Sahara, Arabia e t.j.) gëzonin një periudhë shiu, ku ujërat e bollshme ishin në gjendje të mbanin zhvillimin e qytetërimeve nëpër botë.

f) Këtij procesi shtegtimi dhe zhvillimi kulturor nuk i nevojitej epoka të gjata, siç e parafytyrojnë ithtarët e evolucionit. Përkundrazi, mbarë bota u popullua brenda disa brezash. Ky proces zhvillimi do të ketë zgjatur rreth dy shekujve, ose më gjatë, në qoftë se ka intervale në gjenealogjitë. Arkeologët e kohës së fundit kanë konstatuar se qytetërimi u duk pothuajse bashkëkohësisht në të gjitha pjesët a botës, vetëm para disa mijë vitesh. Gërmadhat e vendeve të ngulura, kur erdhi një grup i ri në një krahinë gjatë dyndjes, natyrisht japin të kuptojnë për evolucionistin se ka të bëjë me një qytetërim të kohës së gurit, por ka të ngjarë se ato pasqyrojnë një situatë shumë përkohëse. Porsa të gjendeshin lënda për fabrikimin e keramikës dhe metaleve, kohën e gurit e zëvendësoi koha e bronzit ose koha e hekurit. Ekonominë fshatare e zëvendësoi pas pak urbanizimi, ndërsa shtojte popullsinë dhe zhvilloheshin lënda të përshtatshme për ndërtim. Siç duket, ky model u përsërit herë pas here.

Ndërsa fisi shpërngulej në një krahinë të pazbuluar, do të gjente vend të përshtatshëm në malësi për mbrojtje, (por pranë burimit ose lumit dhe pranë rrafshinave lymishtë për furnizimin e ujit dhe ushqimit) dhe

pastaj do të përpiquej të vendoste një fshat. Megjithëse anëtarët e fisit sigurisht e dinin zanate të dobishme si bujqësi, ekonomi kafshore, keramikë, metalurgji e tj., ata nuk mund t'i përdornin menjëherë. Duheshin zbuluar, minuar dhe shkrirë shtresa metalesh: argjilë e përshtatshme duhej gjetur për fabrikimin e tullave dhe pocërisë, kafshët duheshin rritur dhe të lashtat duheshin mbjellë. Të gjitha këto mund të kenë zgjatur disa vjet. Ndërkohë, fisi duhej të mbijetonte duke gjuajtur, zënë peshk dhe mbledhur fruta dhe arra. Shtëpi të përkohshme duhej ndërtuar prej guri, në qoftë se ishin në dispozicion, ose prej lëndësh druri ose madje edhe në shpella.

Sigurisht shumica e dëshmimeve për kulturën paleolitike dhe neolitike të njeriut të hershëm, kur interpretohen siç duhet, s'janë veçse dëshmi për luftën e vështirë për mbijetim nga ana e fiseve të vogla njerëzish gjatë shekujve të hershme pas përmbytjes së madhe.

Në qoftë vendi i ngulur nga fisi ishte i dëshirueshme, një fis tjetër e më i fortë do të vinte për ta dëbuar dhe kulturën e parë do ta zëvendësonte një kulturë e ndryshme. Disa fise rriteshin me shpejtësi dhe zhvilloheshin në kombe të forta, kurse disa të tjerë rriteshin vetëm ngadalë, pastaj amulloheshin, prisheshin dhe në fund shuheshin.

g) Ndërsa çdo njësi familjare dhe fisnore u largua nga Babeli, çdo grup zhvilloi jo vetëm kulturën e tij të veçantë, por edhe trajtat e tij fizike dhe biologjike të veçanta. Pasi ata mund të komunikonin vetëm me njësinë e tyre, s'kishte më mundësi të martoheshin jashtë grupit. Prandaj u desh të krijonte familje të reja të përbera nga të afërmit e ngushtë, të paktën gjatë shumë brezave. Pranohet gjenetiksht se variacione dalin shumë shpejt brenda një popullsie të vogël që shumëzohet, por vetëm shumë ngadalë brenda popullsisë së madhe që ndërzihet. Në rastin e dytë, vetëm gjenat dominuese do të dalin si trajta fizike brenda popullsisë, duke pasqyruar shumë a pak trajta mesatare, edhe në qoftë se trajta të veçanta rrijnë të fshehur në magazinën gjenetike të popullsisë. Përkundrazi, në një popullsi të vogël, gjenat, të cilat janë zakonisht recesive (të fshehura) në popullsi të mëdha, mund të dalin në shesh madje edhe të dominojnë në këta kushte. Kështu, pas disa brezash ndërzimi, mund të dalin trajta të veçanta të ngjyrës së lëkurës, lartësisë, përbërjes së flokave, trajtave të fytyrës, temperamentit, rregullimit ndaj mjedisit dhe të tjerat, dhe të lidhen me fise dhe kombe të veçanta.

Pasi popullsia e botës ishte ende relativisht e re, dhe pasi, para përmbytjes, kishte qenë minimumi i rrezatimit nga mjedisi (në saje të baldakinit uJOR që rrethonte atmosferën e tokës dhe që largonte me filtrim një rrezatim të tillë) që mund të shkaktonte mutacione gjenetike, s'kishte

ende asnjë rrezik gjenetik nga ndërzimi. Por pas kalimit të shumë shekujve, akumulimi i mutacioneve dhe rreziku i cenave gjenetike ishte bërë aq serioze, saqë Zoti e shpalli të paligjshme çdo martesë gjaktrazuese (Kodi priftëror 18,6-14).

Natyrisht, me kalimin e kohës, ndërsa njerëzit mësonin gjuhët e njëri-tjetrit, ndodhi krushqi, dhe kështu, procesi lëvizi në drejtim të kundërt, siç e shohim sot. Por është me interes të konstatohet se, në të dy rastet, faktori vendimtar është bariera gjuhësore. Por, në përgjithësi, fenomeni i kombeve të dalluara u bë i përhershëm.

h) Zhvillimi i religjionit: të gjitha kombet, ndërsa ato po shpërnda-heshin, mbanin disa njohuri për Perëndinë e vërtetë të qiellit, megjithëse kjo njohuri u bë gjithnjë e më shumë e dobët me kalimin e kohës. Kombet mbanin traditat e ngatërruara për përmytjen e madhe, si dhe për shpërndarjen nga Babeli. Përkujtimet e tyre të pasakta për Shpëtimtarin e premtuar ishin të ngatërruara në sisteme të ndryshme flijimesh kafshore (madje edhe flijimesh njerëzore), për të fituar favorin e shpirtrave të këqij që qeverisnin, siç duket, jetën e tyre të përditshme. Me kalimin e kohës, këta shpirtra u identifikuan me forcat e natyrës në një gjithësi të mbyllur. Këtij fenomeni duhet shtuar hyjnizimi i heronjve të lashtë si dhe zhvillimi i sistemit babilonas të paganizmit të organizuar që u shpërnda nga ithtarët e tij deri në skaj të botës.

Në të vërtetë libri i Zanafillës i afrohet Dhiatës së Re më tepër se sa Dhiatës së Vjetër, dhe për disa nga temat e saj nuk dëgjohet derisa ndërlikimet e saj dalin në dritë në kuadër të ungjive. Futja e martesës, rënia e njeriut në mëkat, xhelosia e Kainit, ndëshkimi i përmytjes së madhe, shfajësimi i besimtarit, bijtë rivalë sipas premtimit dhe sipas trupit, blasfemia e Esavit, gjendje udhëtare e popullit të Perëndisë, të gjithë janë tema të Dhiatës së Re. Në fund ka simetri sipas së cilës duken përsëri në librin e Apokalipsit skenarët dhe figurat e pjesës së parë të librit të Zanafillës, ku shkatërrohen Babeli dhe gjarpri i lashtë, mashtrues i tërë botës, kurse të shpëtuarit, megjithëse tani veteranë e jo më naivë, shëtiten përsëri në parajsë pranë pemës së jetës. (Kidner: *Zanafilla*).

Shumë tiparet e Vreshtit të Edenit duken përsëri në Tendën e shenjtë dhe, më vonë, në Tempull. Hyrjet e të dyve rrinë përballë lindjes, dhe të dy i mbrojnë keruvimet, të cilët gjithashtu përfaqësohen në muret e Tempullit bashkë me lulet dhe palmat. Menora ose shandani të sjell ndërmend pemën e jetës të parajsës. Tempulli është vendi ku rikthehet bashkësi ndërmjet Perëndisë dhe njeriut.

Libri i Zanafillës është një burim me rëndësi të veçantë për mësimin

e etikës së gjithmbarshme, për të cilën aludohet te DhR. Lënda nga Moisiu ishte e vlefshme për shtetin teokratik të Izraelit, i cili nuk ekziston më, prandaj ne duhet t'u kthehemi Zan kapitujve 1-11 për të na drejtuar sot. Atje gjejmë, për shembull, parimin e drejtësisë i cili është ndëshkimor e jo ndreqës, në kundërshtim me parimet tona të drejtësisë.

KOMBET E LASHTËSISË

Në kapitullin e dhjetë të Zanafillës gjendet një listë emrash, e cila shpjegon prejardhjen e kombeve. Sipas tregimit biblik, të gjitha kombet e botës rrjedhin nga tre bijtë e Noahut. Meqë është vështirë ta kuptojmë këtë, duhet t'i shqyrtojmë me vëmendje këta emra.

Ky shqyrtim biblik i kombeve u bë disa kohë pas ngatërimit të gjuhëve dhe pas shpërndarjes së popujve. Sot pasardhësit e këtyre popujve gjenden në krahina të ndryshme. Ata u shpërndanë edhe më tutje, por lanë prapa gjurmët e tyre ose në emrat e krahinave, nëpër të cilat kaluan, ose në emrat e vendeve, ku më në fund, u vendosën. Me kalimin e kohës, këta emra u deformuan pjesërisht, por sot mund të njihen pas një analizimi të stërholluar.

Pasardhësit e Jafetit

Bijtë ose pasardhësit e Jafetit janë thelbësisht popujt e vendosur në veri dhe në veriperëndim të Mesopotamisë, të shpërndarë nga Deti Egje deri në Detin Kaspik.

Jafeti Emrin Jafet e hasim në letërsi si Japetos, ati legjendar i grekëve, dhe si Ijapeti, i cili njihet si stërgjyshi i arianëve në Indi.

Në kohën e shkrimit të tregimit biblik, Gomeri dhe bijtë e tij ishin popujt e veriut të vendosur në Azinë e Vogël ose në Kaukaz (d.m.th. kimeriasit, frigitët dhe sitët).

Gomeri identifikohet (sipas Herodotit, Plutarkut dhe shkrimtarëve të tjerë nga lashtësia) me krahinën e Kimerisë, në veri të Detit të Zi, e që sot njihet me emrin Krime. Një degë e pasardhësve të Gomerit, më në fund, u shpërngul në perëndim ku emrin e tyre e lanë në Gjermani dhe në Kambri (Kimri ose Velsi). Nga kjo mund të supozojmë se ata ishin keltët. Emri «Kadmon» a «Kedmon» haset, gjithashtu, në Anglinë Veriore. Kjo do të thotë se kadmonasit ishin ose një degë e kimeriasve ose u vendosën në atë vend. Në shekullin VII para erës sonë, kimeriasit e pushtuan Lidinë në Azinë e Vogël, kurse një degë tjetër u vendos në Evropën lindore.

Magogu është një emër që do të thotë vendi i Gogut dhe ka të bëjë me një fis kimerias që u vendos në Lidi dhe në Frigji, kurse një degë tjetër banonte në veri të Kaukazit, në Rusinë e sotme. Fjala «Gog» ndoshta gjendet edhe sot në emrin Gruzi.

Madai ishte stërgjysh i medasve. Ata u vendosën në Persinë e sotme dhe ishin pjesërisht (së bashku me elamasit semitë) edhe stërgjyshërit e persëve. Më në fund me anën e këtij grupi të jafetasve, u zhvilluan arianët që më vonë u shpërngulën në Indi. Pasardhësit e Javanit janë jonët ose grekët.

Tuvali Pasardhësit e Tuvalit në atë kohë ishin një popull që banonte gjatë bregut të Detit të Zi, në perëndim të një populli me emrin Mushekë ose Mesheh. Në librin e profetit Jëhezkel (Ezekiel), ata janë të lidhur ngushtë me Magogun dhe Meshehun. Tuvali njihet nga përmendoret asiriane si tibarenët. Sipas këtij emri edhe qyteti rus mori emrin Tobolsk. Në librin e Ezekielit ata janë të lidhur me emrin Rosh, emër nga i cili rrjedh emri Rusi.

Meshehu ose Moisiq janë mushekët, një popull nga stepa veriore, i cili u vendos në kodrat e Moskës e prej të cilave rrjedh edhe emri i tyre. Moskovia më parë ishte njëri nga emrat e Ruisë.

Tirasi u bë stërgjyshi i trakëve, sipas historianit hebre Josefit. Ky emër është, gjithashtu, i lidhur me etruskët.

Pasardhësit e Gomerit

Ashkenazi ishte një fis sit. Hebrenjtë e identifikuan me Gjermaninë. Disa etnografë mendojnë se ky emër ka të bëjë me emrat Skandia dhe Saksonia, sepse kolonizatorët nga Gjermania sulmuan deri në Danimarkë dhe në brigjet perëndimore të Evropës. Pasardhësit e tjerë të Ashkenazit mbetën në krahinën e Armenisë, e cila, sipas historianit Strabo, quhej Sakasene

Sitia, sipas fjalorit, shënonte një vend në krahinën verilindore të Evropës, e që shtrihej midis Danubit dhe Donit. Ata ishin një popull me prejardhje iraniane, që formoi në Siti një shtet që u prish gjatë shekujve I dhe II para erës sonë.

Rifati ishte, sipas Josefit, stërgjyshi i paflagonianve. Ka të ngjarë se emri Karpatet të jetë një emër i afërt me të. Gjithashtu, është e mundur që edhe emri Evropa të ketë rrjedhur nga fjala Rifa.

Togarma është stërgjyshi i armenëve. Kjo shprehje përfshin edhe fiset e turkmenëve dhe kozakëve të vendosur në stepat e Ruisë qendrore në shekullin XV. Disa mendojnë se kjo fjalë ka të bëjë me Turqinë.

Pasardhësit e Javanit

Elisha ka lidhje me fjalën Alashia, një popull në Qipro, kryeqyteti i të cilit ishte En-Komi në bregun lindor, nga i cili eksportuan bakrin. Disa e lidhin emrin me Hellas (greqisht Greqi); shih edhe Helespont, helenas etj.

Tarshish është e mundur të shënonte Tarsin (kryeqytetin e Cilicisë), krahinën e rendësishme, më vonë nën sundimin e hitasve. Disa e lidhin këtë emër me një vend në Sardini, kurse disa të tjerë edhe me Tartesin, një vend në Spanjë.

Kitim (në tekst; Qipro) shënon një popull, i cili banonte në Qipro, kryeqyteti i të cilit ishte Kitioni (Lanarka e sotme). Ka të ngjarë që shprehja Ma-Kittim (vendi i Kitimit) të jetë shkruarë në fjalën Makedoni (Maqedoni). Qiproja u bë trampolinë për filistenjtë nga Kreta, Greqia dhe Anadollia për invadime detare të bregdetit egjiptian.

Rodanim (në tekst; Rodi) ishte një popull që banonte në ishullin e Rodit.

Pasardhësit e Hamit

Bijtë e Hamit janë kryesisht popujt e jugut; Arabia dhe Afrika.

Kushi shënon kasitët që në fillim banonin në verilindje të Asirisë (në Azerbajxhaninë e sotme). Nga shekulli XVI deri në 1150 para erës sonë, ata ishin sundimtarët e Mesopotamisë së poshtëreme, por në fund asirët i dëbuan ata. Një degë e atij populli u shpërngul në jug dhe u vendos në Etiopi.

Micraimi (në tekst; Egjipti) ose shënon një popull ose faktin që Egjipti përbëhet nga dy pjesë: Egjipti i sipërm dhe Egjipti i ulët. Menesi ishte, sipas traditës, themeluesi i asaj kulture.

Puti është Libia, d.m.th. krahina e Afrikës Veriore në perëndim të Egjiptit.

Kënaani është stërgjyshi i kenanasve.

Pasardhësit e Kushit

Seba ishte një popull që u shpërngul në jug dhe u vendos në Sudan. Gjithashtu, lanë gjurmë të emrit në provincën e Shabës në Somali.

Havila shënon një krahinë në Arabinë qendrore, por në fillim, ky emër ishte i lidhur me krahinën e Gruzisë së sotme.

Savta është e lidhur me qytetin e lashtë Sabatah në Arabi.

Raama, gjithashtu, u vendos në Arabi.

Pasardhësit e Raamës

Sheba ose Saba ishte një shtet tregtar në Jemenin e jugut që lulëzonte në periudhën 1000-500 para erës sonë.

Dedani shënon Arabinë veriore.

Nimrodi Kushi kishte një djalë me emrin Nimrod, i cili u bë themeluesi i qyteteve të mëdha të Babilonisë dhe të Asirisë e që më vonë u zhvilluan në perandori të fuqishme babilonase dhe asiriane. Ndër këto qytete ishte edhe qyteti Erek ose Uruk, i vendosur 130 km në juglindje të Babilonit (Bavelit), qytetit të parë. Ky ishte atdheu i Gilgameshit, heroit në tregimin babilonas mbi përmbytjen e madhe. Akadi ishte drejtpërdrejt në veri të Babilonit dhe i dha emrin perandorisë akadiane, thelbësisht sinonimik me perandorinë sumeriane. Në Asiri Nimrodi themeloi, gjithashtu, disa qytete; Ninave, Rehovot-Ir, Resen dhe Kalah. Këto qytete së bashku formuan një konglomerat urban me emrin Ninavë e Madhe. Ninava, e vendosur 300 km në veri të Babilonit, u bë më vonë kryeqyteti i perandorisë asiriane. Kalahu ndodhet afërsisht 30 km në jug të Ninavës, dhe mban emrin Nimrud, sipas themeluesit të tij, Nimrodit.

Pasardhësit e Micraimit (Egjyptit)

Ludim do të thotë banorët e Lidisë.

Anamim shënon popullin e Cirenesë

Lehvim shënon Libinë

Naftuhim shënon Egjiptin e ulët

Patrusim do të thotë Patros, një emër tjetër për Egjiptin e sipërm.

Kasluhim janë popull i Egjiptit veriperëndimor

Kaftor (në tekst; Kreta) u bë më vonë qendra e një qytetërimi të shkëlqyeshëm që mori fund nga një shpërthim i tmerrshëm vullkanik më 1470 para erës sonë. Ata që mbetën gjallë ose u shpërngulën në kontinentin grek, ku e themeluan qytetërimin miken të shkëlqyeshëm ose u shpërngulën drejt jugut dhe u vendosën në bregdetin e Kënaanit. Ata e themeluan qytetërimin pëlishtas. Sidoqoftë qytetërimi në Kretë edhe më parë kishte marrëdhënie tregtare me vendin e Kënaanit.

Pasardhësit e Kënaanit

Cidoni ishte stërgjyshi i fenikasve.

Heti ishte stërgjyshi i hitasve, të cilët më vonë u shpërngulën në Azinë e vogël dhe themeluan një perandori të madhe, ku sunduan për 800 vjet. Siç duket, pas shkatërrimit të perandorisë hitase, të mbeturit e popullit ikën drejt lindjes. Sipas përmendoreve, hitasit quheshin Kittai,

emër i cili më vonë ndoshta u kthye në Katai, kur ata u vendosën në Lindjen e Largme. Arkeologët hetuan disa ngjashmëri ndërmjet hitasve dhe mongolëve. Të dy popujt janë të njohur për rritjen e kuajve dhe shkrirjen e hekurit.

Nëntë bijtë e tjerë të Kënaanit ishin stërgjyshët e fiseve kënanas që banonin në Kënaan kur mbërritën izraelitët nën komandën e Joshuas më 1406.

Jevusait rridhnin nga një njeri me emrin Jevus. Ata ishin banorët e mëparshëm të Jerusalemit.

Amorasit ishin një popull kënanas nga Lindja me prejardhje hametike. Ata kishin një degë në Mesopotami, e cila u zhduk për shkak të pushtimeve aramase, por më vonë shfaqen përsëri duke folur një gjuhë semite (aramaie) dhe themeluan disa dinasti amorase në Babeloni. Dinastia më e njohur ishte ajo e Hamurabit, që i shtoi mbretërisë së tij edhe dy shtete amorase me emrin Mari dhe Ashur. Sidoqoftë, ka mundësi që banorët e parë të Mesopotamisë e quatin «amoras» çdo pushtues perëndimor, sepse fjala «amuru» do të thotë pushtues.

Girgashait ishin një popull, emrin e të cilit e mban krahina në bregdetin lindor të liqenit të Galilesë. Në tregimet e ungjijve kjo krahinë quhet krahina e gergezenëve ose Gezara.

Horasit ose hurianët ishin një popull, i cili e themeloi mbretërinë e Mitanit me kryeqytet Nuzi. Kjo perandori shtrihej nga Mesopotamia veriore deri në Azinë e vogël. Një degë e gjuhës së tyre flitej, gjithashtu, nga një popull i vendosur në krahinën e Urartut (Araratit) që më vonë në Mesopotami shfaqet me emrin Kaldai.

Arkasit kishin qendrën e tyre në Tell Arka në Siri.

Arvadasit banonin në Arvad, qytet-port i fenikasve.

Zemarasit banonin rreth 9 km në jug të Arvadit në një qytet me emrin Sumur, sot quhet Sumra.

Hamatasit janë të lidhur me qytetin e njohur të Hamatit në Siri.

Sinasit lanë gjurmët e tyre në Sinai, errësirën e Sinit ose Cinit. Në librin e profetit Isaia është përmendur një popull i Lindjes së Largët me emrin Sinim. Gjithashtu, në librat historike të lashtësisë përmendet një popull i Lindjes me emrin *Sinae*. Kjo tregon që disa nga pasardhësit e Sinit u shpërngulën drejt lindjes, kurse të tjerët drejt jugut në vendin e Kënaanit. Është e kuptueshme se populli kinez identifikohet gjithnjë me parashtesë Sino-. Përveç kësaj, ky kombinim gjendet shpesh në emrat kinezë (p.sh. Siang).

Siç duket, Heti dhe Sini ishin stërgjyshët e popujve të Lindjes që më

vonë u shpërndanë më tej me anën e Ngushticës së Beringut deri në kontinentin e Amerikës. U provua gjenetikisht se fiset e Sibirisë janë paraardhësit e indianëve të Amerikës

Pasardhësit e Shemit

Shemi ishte stërgjyshi i të gjithë hebrenjve. Shprehja ‚hebre‘ (hebr. *Ivrit*) rrjedh nga emri Eber. Në fillim kjo shprehje kishte të bënte me një grup më të madh (me emrin habiru?). Avrahami ishte një degë e këtij grupi. Nga i njëjti grup, rridhte edhe dinastia egjiptiane me emrin Hiksos (1710-1570 para erës sonë) që ishin pushtues semitë nga Mesopotamia.

Elamasit u vendosën në krahinën juglindore të rrafshinës së Mesopotamisë, rreth gjirit të Persisë dhe në veri. Kryeqyteti i tyre i lashtë quhej Susa ose Shushan. Më vonë ata u bashkuan me medët për të formuar perandorinë persiane.

Ashuri ka të bëjë me banorët e parë të Asirisë para pushtimit të Nimrodit. Prandaj perandoria asiriane ishte një përzjerje nga popujt semitë dhe hamitë.

Arpakshadi i dha emrin e tij krahinës së Arapakitisit në Asiri.

Ludi Ka të ngjarë që edhe Ludi të jetë stërgjysh i lidasve në Azinë e vogël.

Arami u dha emrin e tij aramasve, të cilët ishin sirianë. Gjuha e tyre u bë gjuha e përgjithshme e Asirisë dhe Babilonisë.

Pelegu u dha emrin e tij pellazgëve.

Siç duket, të gjithë bijtë e Joktanit u vendosën në Arabi.

Kështu mund të vërehet, se megjithëse autori i tregimit interesohet para së gjithash për prejardhjen e kombeve që më vonë kishin të bënin me Izraelin, në këtë tregim gjendet edhe prejardhja e disa degëve të të gjitha kombeve të botës. Ky tregim na jep lidhjen e domosdoshme ndërmjet fillimit të qytetërimeve më të lashta dhe erës sonë.

DALJA

Libri i dytë i Biblës quhet Dalja, sepse thirret për nder të ngjarjes kryesore të librit. Kjo shënon plotësimin e premtimit që Zoti ia dha Avrahamit, 430 vjet më parë; lindjen e kombit izraelit dhe pranimin e kartës kombëtare – Ligjin. Këto tema lidhen me një ngjarje tjetër: endjen në shkretëtirë që zgjati 40 vjet. Për shkak të mosbindjes së kombit, duhej të kalonte 40 vjet në vend të dyve, para se kombi ta arrinte vendin, të cilin u premtua Avrahamit dhe pasardhësve të tij. Përmbajtja e librit

mund të ndahet si vijon:

kap. 1-12 Izraeli në Egjipt

kap. 13-18 Dalja e Izraelit nga Egjipti

kap. 19-34 Dhënia e Ligjit në malin Sinai

kap. 35-40 Ndërtimi dhe shugurimi i Tendës së shenjtë

Moisiu është njeriu që Perëndia e formoi për të vepruar si përfaqësues i tij: ai duhet ta çlirojë popullin duke e nxjerrë nga robëria e Egjiptit për ta sjellë në tokën e premtuar të Izraelit. Në malin e Perëndisë, Perëndia e ngarkoi Moisiun (Moisiun) me këtë detyrë, kur Ai i shfaqet atij me anë të kaçubës, e cila megjithëse ishte e ndezur flakë, nuk digjej! Pas çlirimit, Moisiu e sjell popullin drejt këtij mali. Atje, Perëndia i shfaqet popullit në një mënyrë shumë madhështore, e lidh besëldhjen e tij me kombin dhe ia jep kartën e tij kombëtare, d.m.th. ligjet e tij. Mjerisht, pak më vonë, populli e shkel besëldhjen duke adhuruar demin prej ari – një formë idhujtarie, me të cilën u njohën në Egjipt. Por, Perëndia ia fal mëkatën dhe e përtërin besëldhjen. Pastaj Perëndia i jep kombit një varg udhëzimesh për mënyrën se si duhet të adhurohet në shkretëtirë. Ndoshta na habit rreptësia e këtyre udhëzimeve, por duhet marrë parasysh se Perëndia është i shenjtë (parimisht i ndryshëm nga ne), dhe se nuk mund të lejojë që shenjtëria e tij të komprometohet nga një qëndrim kryengritës ndër popuj të pa rilindur. Edhe një faktor që duhet marrë parasysh ishte ky: kombi izraelit ishte ende shumë i ri dhe në qoftë se Perëndia nuk e trajtonte rreptësisht duke zhdukur shfaqjet e së keqes, populli nuk do të shpëtohej gjallë! Besëldhja është mjet për të lidhur një marrëdhëni të re që nuk ekzistonte më parë: Izraeli është prona e veçantë e Zotit. Mbretëria e priftërve, dhe komb i shenjtë. Izrael është mënjanuar nga kombet e tjera për shërbimin e Zotit, sikurse edhe priftërinjtë ishin mënjanuar nga njerëzit e tjerë.

Cilat ishin, pra, ngjarjet e Daljes? Pas një periudhe të gjatë të banimit në Egjipt, izraelitët papritur gjenden në skllavëri, për shkak të ndryshimit të regjimit egjiptian. Ky regjim i ri refuzon t'u jetë i favorshëm dhe i mban për rrezik potencial. Mbreti egjiptian (faraoni) filloi një politikë të gjenocidit për të penguar shtimin e racës. Pastaj, mbreti i skllavëroi izraelitët. Por, po afrohej koha kur Perëndia ia kishte premtuar izraelitëve t'i çlironte, sepse ishin pasardhësit e Avrahamit dhe kështu trashëgimtarët e premtimeve hyjnore. Së pari Perëndia vendosi njeriun e tij, Moisiun, që bëhet përfaqësuesi i tij para mbretit egjiptian. Faraoni refuzon

t'i çlirojë izraelitët dhe për këtë Perëndia dërgon në Egjipt një varg fatkeqësish, dhjetë gjithsej. Asnjëra nga këto fatkeqësi nuk bie në izraelitët që banojnë në krahinën e deltës së Nilit, e cila quhej Goshen. Por, mbreti refuzon të mëshirojë dhe bëhet gjithnjë e më shumë zemërgur deri në ardhjen e fatkeqësisë së fundit: vrasjen e bijve të parëlindur. Gjatë kësaj fatkeqësie të fundit, Perëndia urdhëron që çdo familje izraelite të vrasë një qengj e t'i futë gjakun në ballësore dhe në dy shtalkat e derës. Kur bie fatkeqësia, engjëlli vrasës kalon pranë dyerve të familjeve izraelite, por hyn në ato egjiptiane. Kështu shpëtohen gjallë të parëlindurit izraelitë kurse vriten të parëlindurit egjiptianë. Më në fund, mbreti egjiptian bindet dhe i lejon izraelitët të shkojnë. Pas nisjes së tyre, ndërron mendje dhe dërgon pas tyre forcat e tij elite me koçi luftime. Ata i zënë izraelitët në grackë me detin në shpinë. Por, Perëndia bën që deti të tërhiqet me anë të një erë të fortë dhe izraelitët kalojnë në terik nëpër terr. Në të gdhirë ushtarakët egjiptianë marrin vesh se ç'ndodhi dhe përpiqen t'i ndjekin. Por në këtë çast, Perëndia bën që të kthehet një baticë shumë e madhe. Kjo baticë e mbulon terikun dhe të gjitha forcat egjiptiane mbyten. Në këtë mënyrë, Perëndia e çliroi popullin e tij dhe ia shkatërroi armiqtë.

Si mund t'i shpjegojmë fatkeqësitë që ranë mbi egjiptianët? Në librin e Daljes vërehet se si lufta shpallet në sferën mbinatyrore. Lumi Nil mbahej si fuqi hyjnore dhe faraoni mbahej pothuaj si trupëzim i një perëndie. Ka lidhje të qartë ndërmjet fatkeqësive dhe perëndive egjiptiane. Në fatkeqësinë e parë Nili u shndërrua në gjak – ky është një konstatim dukjeje e jo biologjik. Uji, siç duket, u skuq dhe u bë i neveritshëm. Në rastin e fatkeqësisë së parë, Moisiu i bëri sfidë faraonit në kohën e ceremonisë fetare të pranverës, kur i lutej perëndisë së Nilit për fryrjen e lumit, i cili do të plehëronte tokën për të siguruar një pjellori të mjaftueshme. Pas lutjes, dy elemente u çrregulluan: Nili solli me vete sasi të mëdha të baltës së kuqe që vinin nga Etiopia me anë të Nilit të kuq e jo si zakonisht me anë të Nilit të bardhë. Bakteret dhe planktoni e helmuan ujin duke i dhënë pamje të kuq, erë të neveritshme dhe shije të hidhur. Në Daljen 7,24 mësojmë se si disa egjiptianë mund ta filtronin nëpër rërë dhe ta pinin. Një gjë e tillë s'do të ishte e mundur të bëhet, në qoftë se ishte fjala për gjak të vërtetë. Pas kësaj kuptohet vetvetiu që bretkosat do të luzmonin duke u larguar nga ujërat e helmua. Këto ujëra do t'i shtinin bretkosat në thellësinë e vendit ku do të vdisnin. Pastaj insektet do të luzmonin në trupat e kalbëzuara të bretkosave. Me rastin e fatkeqësisë së katërt, lexojmë se si faraoni i lutej përsëri perën-

disë së Nilit në breg të lumit; kësaj here sigurisht me rastin e ceremonisë së fundit të stinës së fryrjes së lumit (shih Dalja 8,20). Me rastin e kësaj fatkeqësie, mizat e reja vijnë nga çelja e vezëve të pjella në kërmat e bretkosave. Ato janë ndoshta zektha me një thimth të fortë. Këto insekte do të përhapnin antraksin (fshikëzezën). Si shumica e mrekullive biblike, fatkeqësitë na tregojnë se si Perëndia e ka natyrën nën kontrollin e tij të plotë, e jo se vepron kundër natyrës.

Për këtë ngjarje lexojmë në librin e dytë të Biblës, por a ka bazë historike në të? A është ky një mit si historitë e lindjes së kombeve të tjera? Së pari duhet të konstatohet që stili i librit nuk tregon asnjë aspekt mitik. Kombi izraelit nuk dallohet nga kjo histori në dritë të mirë; në fakt dallohet si një komb rebel. Libri i Daljes qëndron si dëshmi kundër tyre. Kur Shtjefni, martiri i parë i krishter, mban fjalimin e tij të fundit para këshillit izraelit 1500 vjet më vonë, i kujton anëtarët për faktet e historisë së kombit, siç janë të shkruara në librin e Daljes. Ata nuk duruan t'i dëgjonin këto, dhe *griheshin në zemrat e tyre dhe kërcëllonin me dhembë kundër tij... ata lëshuan një britmë të madhe, mbyllën veshët dhe u versulën të gjithë së bashku kundër tij. E nxorën jashtë qytetit dhe e vranë me gurë....* Në qoftë se e gjithë kjo punë ishte vetëm mitike, përse reagueshan me kaq forcë ndaj fjalimit të tij? E vërteta është gjithnjë e pavolitshme, por miti kurrë.

Tregimi i dytë për të vërtetën historike të këtyre ngjarjeve është që gjasat janë të mira që një popull i shtypur të largohet nga një shtet despotik i asaj kohe. Siç duket, në shekullin XIV para erës sonë, popujt nga 14 rrethe, krahina malore dhe qytete dolën nga kampet e tij në mbretërinë hitase dhe u shpërngulën në tokën e Isuvës. Mbreti i fuqishëm i hitaseve i ndoqi dhe i kapi përsëri.

Pergameni i Ipuwerit që datohet rreth vitit 1400 përshkruan trazirat të dhunshme në Egjipt: vdekjen nga uria, thatësi, ikjen e skllevërve (duke marrë me vete pasurinë e egiptianëve), dhe vdekjen nëpër mbarë vendin. Pergamenën e shkroi një egiptian me emër Ipuwer dhe do të jetë një tregim i pasojave të fatkeqësive të Daljes të shkruar nga perspektiva e një egiptiani mesatar.

Shenja e tretë për të vërtetën e historisë së Daljes njihet duke shqyrtuar sfondin e saj historik. Në dokumentet historike egjiptiane gjenden shumë shembuj të semitëve si Josefi dhe Moisiu me pozita kyç në shoqërinë egjiptiane. Sidoqoftë, në këto dokumente janë vetëm aluzionet e zhdrejta për daljen e izraelitëve. Në Bibël thuhet se Moisiun e rriti një princeshë egjiptiane, e cila ishte në gjendje të mos i bindej urdhrin të

faraonit për të vrarë të gjitha foshnjat (meshkujt) izraelite pa problem.

I vetmi individ që i përshtatet kësaj figure është mbretëresha Hapshesut, e cila pastaj u emërua bashkësundimtare me Tutmosisin III, nga 1505 gjer më vitin 1483. Thuhet se Moisiu, kur ishte i rritur, vrau një kujdestar egjiptian (i cili, siç duket, po përdhunonte një grua izraelite) dhe iku në shkretëtirë, ku duhej të kalonte 40 vjet deri në vdekjen e atij mbreti egjiptian. I vetmi mbret, që sundonte kaq gjatë (përveç Raamsesit II shumë më vonë) ishte Tutmosisi III. Thuhet se ndërmori 14 fushata kundër Sirisë dhe Palestinës. Për këtë i duheshin baza të para për të mbajtur në depo pajimet e tij. Ato ishin depot që egjiptianët i detyruan izraelitët t'i ndërtonin, në deltën e Nilit. Pas Tutmosisit erdhi në pushtet Amenopisi II (1450-1445), i cili ishte sigurisht mbreti egjiptian i kohës së Daljes. Është kuptimplotë që ai s'ishte në gjendje të bënte një fushatë ndërmjet vitit të pestë (datimit të Daljes, d.m.th. 1445) dhe vitit të nëntë (1441). Sigurisht sepse e kishte humbur forcën e tij elite me koçi lufte në Detin e kuq kur po ndiqte izraelitët. Është, gjithashtu, kuptimplotë se biri i parë dhe më i vjetër nuk trashëgoi fronin. Biri i tij i dytë, Tutmosisi IV, tregon se si pa një ëndërr, në të cilën sfinksi egjiptian e urdhëroi t'ua pastronte rërën këmbëve të tij, atëherë do ta shpërblente me trashëgimin e fronit, edhe pse nuk ishte biri i parë. E në Bibël thuhet se ky bir i parë u vra në fatkeqësinë e dhjetë, kur u vranë të parëlindurit e tërë tokës së Egjiptit. Prandaj, mund të vërejmë se ka disa shenja në dokumentet egjiptiane që pajtohen me historinë biblike. Sidoqoftë, në këto dokumente nuk janë përmendur ngjarjet e Daljes, ndoshta meqë egjiptianët nuk iu dhanë rëndësi. Përveç kësaj, shtetit nuk i pëlqen t'i regjistrojë disfatat e tij.

Në tregimin e Daljes është fjala për Detin e kuq. Duhet vërejtur se fjala origjinale është «deti i xunkthave». Kjo shprehje shënonte sipërfaqen e ujërave që gjeroheshin nga fillimi i kanalit të sotëm të Suezit – liqeni Menzale – (duke kaluar nëpër liqenjtë më të thellë të asaj kohe) deri në fundin e kanalit në jug. Edhe gjiri i Suezit zgjerohej sigurisht më në veri në atë kohë. Nuk dihet me saktësi ku kaluan izraelitët. Sidoqoftë aluzioni për baticën na bind që është fjalë ose për zgjerimin e gjirit të Suezit ose të liqenit Menzale në veri.

Fatkeqësite (ose katastrofat) ndjekin një rend logjik dhe natyror (shkaku dhe pasoja), përveç në rastin e breshrit dhe vdekjes së të parëlindurve. Parimi i mrekullueshëm është intensiteti i ngjarjeve dhe sinkronizimi i tyre: Zoti e përdor krijesën e tij për qëllimet e veta. Kjo tipologji e librit të Daljes duket përsëri në librin e Apokalipsit, ku i njëjti

shkak dhe e njëjta pasojë përcakton katastrofat që do të vijnë pas një lufte bërthamore.

Ngjarjet e Daljes, të cilat shkaktuan formimin e kombit izraelit, parashikojnë një dalje shumë më të madhe. Kjo dalje duhej të ndodhte rreth 1500 vjet më vonë, kur Jezusi, Mesia, derdhi gjakun e tij si qengji i Pashkëve për të çliruar ata që ishin skllëvër të mëkatit dhe Satanit. Kështu, Jezusi i formoi ata që besojnë në të në një popull të ri – popullin e Perëndisë, i cili do të trashëgojë tokën e premtuar, qytetin qiellor.

Kulmi i librit arrihet me ndërtimit të Tendës së shenjtë dhe shugurimin e saj. Tani e tutje Perëndia banon me njerëzimin dhe futet sistemi i flijimeve, i cili është mjet i vazhdimit të besëlidhjes në sajë të ndjesës së mëkatëve.

SHTESA 1. **ITINERARI I DALJES**

Na duket më mirë të pranojmë itinerarin tradicional. Siç duket, izraelitët, pas një kthimi drejt veriut, e kaluan detin në jug të lagunës së Menzaleut ku pajtohen emrat e përmendur (Sukoti, Pi-Hahiroti dhe Baal Cafoni). Në kohën e Daljes ky vend do të ishte një grykëderdhje e gjerë. Është plotësisht e mundur që ekziston një korrespondencë midis shpërthimit të vullkanit Santorini dhe ngjarjeve të Daljes nga Egjipti, për shembull tërheqja e frikshme e ujit dhe kthimi i saj i papritur në formën e një tsunami.

Megjithatë kohët e fundit disa arkeologë kanë pohuar se itinerari ishte ai që ndan me dysh gadishullin e Sinait, se kalimi ishte ai i Gjirit të Akabës dhe se mali i Sinait gjendej në Arabinë veriore.

Kundërshtimet janë si vijon :

1. Elementi i kohës nuk pajtohet me përshkrimin e ngjarjeve. Është pak e besueshme se forcat e faraonit u deshën të kalonin mbarë gadishullin e Sinait para se t'u arrinin izraelitëve.
2. Emrat e fushimeve (tëbanishtimeve) pajtohen me një itinerar në jug që kalonte gjatë bregdetit të gadishullit të Sinait. Itinerari alternativ nuk ka asnjë oaze të njohura.
3. Me gjithë pohime të kenë zbuluar rrotat e karrocave nën ujërat e Gjirit të Akabës, këto fenomene mund të kenë një shpjegim tjetër. Në qoftë se fundi e vendkalimit të detit ishte një kreshtë e ngurtë, ka pak të ngjarë se egiptianët

ranë në batak atje.

4. Midjanasit nuk ishin popull sedentar, por endeshin në një sipërfaqe të gjerë duke përfshirë edhe gadishullin e Sinait. Prandaj nuk është e mundur t'i lokalizonte ata përgjithmonë në Arabinë veriore.

SHTESA 2. DATIMI I DALJES

Disa faktore siç duket fiksojnë datimin e Daljes rreth vitit 1450 (shih kronologjinë në fund të tekstit). Ka dy referime biblike që na mundësojnë të gjejmë datimin e saktë: 1 Mbr 6,1 dhe Gjy 11,26. Në 1 Mbr 6,1, është shkruar se Solomoni filloi ndërtimin e Tempullit në vitin e katërt të mbretërimit të tij, d.m.th. 480 vjet pas Daljes nga Egjipti. Mbretërimi i Solomonit mund të datohet në rreth 971–931 para Kr., kështu që viti i katërt i mbretërimit të tij do të jetë 967 para Kr. Sipas kronologjisë biblike kjo do ta caktojë Daljen 460 vitet më parë—rreth 1447 para Kr., ose të themi përafërsisht 1450 para Kr. Në qoftë se llogaritim 40 vitet për endjen nëpër shkretëtirë, para pushtimit izraelit të Kanaanit, arrijmë në datën rreth 1410–1400 para Kr. për hyrjen e izraelitëve në Kanaan. Një tekst biblik tjetër — Gjyqtarët 11,26—na thotë se izraelitët ishin tashmë ngulur në Transjordani 300 vjet aty nga koha e Jiftahut, një prej gjyqtarëve. Jiftahu, sipas specialistëve, mund të datohet në rreth 1100 para Kr. Kjo do ta caktojë kolonizimin izraelit në lindje të Jordanit 300 vjet më parë —rreth 1400 para Kr.

Aludimi gjeografik në qytetin e Raamsesit mund të ketë qenë azhu-rim i mëvonshëm nga ana e skribit hebre. Dëshmitë arkeologjike në lidhje me qytetet e Raamsesit dhe Pitomit pajtohen me shpjegimet biblike në qoftë se Dalja 1,11 bën aludim në fillimin e robërisë të izraelitëve (me rreth shek. XVIII para Kr.), e jo në kohën e Daljes. Letrat e Tell El Amarnës (korespondencë mes vasalëve kananas dhe feudalëve të tyre egjiptianë) siç duket, pajtohen me kohën e Pushimit të Palestinës nga ana e izraelitëve më 1400. Ky datim pajtohet gjith-ashtu me dëshmitë arkeologjike dhe shpjegimet biblike. Siç duket, shumë rilevime arkeologjike të mëparshme të terrenit dolën të siper-faqshme, kurse identifikime të gërmadhave arkeologjike ishin shpesh të gabuara. Përveç kësaj, arkeologët e parë u kishin dhënë periudha-ve arkeologjike datime arbitrare dhe të gabuara.

MOISIU

Moisiu (hebr. Mosheu) ishte udhëheqës dhe profet i madh, me anën e të cilit Perëndia i nxori izraelitët nga robëria e Egjiptit, dhe formoi një komb për shërbimin e tij dhe e shpuri deri në kufijtë e tokës që Perëndia ua kishte premtuar të parëve. Ka shumë të ngjarë që Moisiu lindi më 1526 dhe vdiq më 1406.

Që ta çlironte popullin e tij nga robëria në Egjipt, Perëndia formoi një njeri, një çlirimtar. Në librin e Daljes del se Perëndia ishte me Moisiun që nga lindja e tij. Në kohën e lindjes së tij, doli një urdhëresë nga mbreti egjiptian (faraoni) që të vritet çdo fëmijë hebre mashkull. Nëna e tij, Mirjama, e fshehu dhe pastaj e futi në një shportë prej kallamit të papirusit dhe e la në xunkthore, në bregun e lumit. Një nga bijat e faraonit, ndoshta e njohura Hatshepsutë, e gjeti foshnjen dhe filloi ta dashuronte. Moisiu u adoptua dhe ndoshta u rrit në haremin mbretëror. Atje pranoi një edukim princor. Por, kur u rrit, zbuloi identitetin e tij të vërtetë që ishte hebre, jo egjiptian. Ai i takonte popullit të skllavëruar që bënte punë të detyruar. Që nga ky çast filloi të identifikohet me popullin e tij dhe nisi të hidhte poshtë edukimin e tij egjiptian, e kjo e shqetësonte princshën që e kishte adoptuar, e ndoshta edhe vetë mbretin egjiptian. Pak më vonë ndërhyri për një bashkizraelit që e trajtonin keq. Sipas traditës izraelite, mbikëqyrësi egjiptian kishte bërë tradhti bashkëshortore me gruan e këtij izraeliti. Moisiu e vrau dhe duhej të ikte menjëherë nga vendi, sepse e kërkonte policia. Ai iku në shkretëtirën e gadishullit të Sinait. Atje u njoh me një blegtor-prift të Madianit që quhej Rëuel ose Jitro, u martua me një nga bijat e tij, Ciporën, dhe i lindi një djalë, të cilin e quajti Gershom. Gjatë kësaj kohe u njoh shumë mirë me gadishullin e Sinait, sepse atje kulloste kopetë e Jitros. Pak më vonë, kur iu afrua malit të Sinait, Perëndia iu paraqit në flakën e zjarrit buçitës në një kaçubë: kaçuba ishte ndezur flakë por nuk digjej. Perëndia e thirri të kthehet prapa në Egjipt për ta çliruar popullin izraelit nga robëria e për ta çuar në gadishullin e Sinait ku Perëndia do ta bënte një komb të madh. Në fillim Moisiu refuzoi, por në fund pranoi me kusht që Perëndia t'i jepte Aharonin për ndihmës. Moisiu u kthye përsëri në Egjipt. Nga kjo kohë kishin kaluar dyzet vjet dhe mbreti egjiptian i mëparshëm kishte vdekur. Kështu, pra, mund të kuptojmë që Moisiu ishte veçanërisht i kualifikuar për të udhëhequr popullin izraelit. Kishte marrë edukimin më të mirë të asaj kohe, jo teorik por edhe praktik. Ishte i njohur me oborrin e mbretit. Më tej njihte shumë mirë gadishullin e Sinait, sepse kishte kaluar shumë kohë atje. Kështu, pra, Moisiu e njihte krahinën ku duhej më vonë t'i

çonte izraelitët. Por, me më rëndësi se çdo gjë tjetër, Perëndia i kishte premtuar se do ta shoqëronte me të kthyer në Egjipt. Meqë po nisej për një detyrë të rrezikshme, e braktisi familjen e tij.

Pas takimit me të vëllanë dhe me kryetarët izraelitë, Moisiu dhe Aharoni dolën para mbretit egjiptian që të kërkonin lejën për izraelitët, që të dilnin në shkretëtirë që të bënin një festë për nder të Zotit. Por, mbreti i refuzoi me përbuzje – tashmë kishte mjaft festa fetare, në të cilat nuk punohej, dhe kjo kërkesë ishte krejt justifikim për papunësi. Pas refuzimit nga ana e mbretit, Perëndia e siguroi Moisiun se do të plotësonte premtimet e dhëna në besëlidhjen që e kishte lidhur me Avrahamin që t'i nxirrte pasardhësit e tij nga Egjipti për t'i çuar në tokën e premtuar, në Izrael. Kur në Egjipt ranë fatkeqësitë të mëtejshme, Perëndia ia zbuloi mbretit egjiptian fuqinë dhe pushtetin e tij. Në fatkeqësinë e fundit vdiqën të gjithë bijtë e parëlindur të egjiptianëve. Në fund mbreti ndërroi mendje dhe lejoi që izraelitët të shkonin lirisht. Izraelitët, nën udhëheqjen e Moisiut, kaluan në terik nëpër detin e kuq (që Perëndia mrekullisht e kishte tharë), panë disfatën e ushtrisë elitë egjiptiane, dhe u nisën në shkretëtirën e gadishullit të Sinait. Moisiu i udhëhoqi deri në pikëpjekjen me Perëndinë në malin e Sinait. Pak më parë, u takua përsëri me familjen e tij që po e priste me vjehrrin e tij, Jitron, i cili i dha një këshillë të mirë. Izraelitët kaluan rreth një vit në krahinën e malit. Pak para nisjes së tyre, u bë regjistrimi i popullit, i cili organizohej në një ushtri me disiplinë të ashpër. Së shpejti arritën në Kadesh-Barnea ku u përgatitën për pushtimin e Palestinës, tokës së premtuar. Sidoqoftë, populli u frikësua dhe refuzoi t'u besonte premtimeve të Perëndisë duke ngritur kundër Tij. Për pasojë, si dënim, populli duhej të priste edhe 38 vjet që ta pushtonin tokën e premtuar.

Moisiu ishte udhëheqës i shquar. Thuhet se ishte njeri shumë i ulët, i cili kishte një marrëdhënie shumë të ngushtë me Perëndinë. Ndryshe nga kushdo pas tij, me shumë raste bisedonte ballë për ballë me Perëndinë, dhe ishte i vetmi që dëgjonte zërin e tij. Sidoqoftë, durimi i tij u provua shumë nga sjellja e turpshme e izraelitëve rebelë nën udhëheqjen e tij. Jo vetëm se ankoheshin kundër Perëndisë por edhe disa here e kundërshtonin hapur udhëheqjen e Moisiut. Në disa raste Moisiu i lutej shumë Perëndisë me lot të hidhur që të mos e shkatërronte popullin po aty për rebelimin e hapur; propozonte që të shkatërrohej ai në vend të tyre. Kjo tregon se si e donte popullin që ishte nën udhëheqjen e tij; dhe ndërhyri për të. Meqë Moisiu kishte një marrëdhënie aq të ngushtë me Perëndinë dhe ishte aq i privilegjuar shpirtërisht, kjo do të thotë se përgjegjësia e tij ishte shumë e madhe. Mirjama, motra e tij,

vdiq, sepse ngriti krye kundër tij duke kundërshtuar zgjedhjen e Perëndisë. Por, edhe Moisiu edhe Aharoni bënë sharje kundër Zotit kur guxuan ta zëvendësonin. Në Kadesh-Barnea, Zoti i dha urdhër Moisiut që ta godiste shkëmbin për t'i furnizuar izraelitët me ujë, por ai së bashku me Aharonin tha: *„Dëgjoni, o rebelë, a do të nxjerrim ne (e jo Perëndia) ujë nga ky shkëmb?“* U dënuan me përjashtimin nga toka e premtuar – kurrë nuk hynë në të. Pak më vonë Aharoni vdiq dhe u varros në malin e Horit. Moisiu kishte të drejtën që vetëm ta shihte tokën e premtuar nga mali i Pisgahut që ndodhet sot në Jordan. Ai vdiq dhe u varros atje pak kohë para pushtimit. Joshua, e jo ai, e udhëhoqi kombin izraelit në tokën e premtuar.

Moisiu ishte profeti më i madh i Dhiatës së vjetër. Asnjë tjetër, pas tij, nuk ka folur ballë për ballë me Perëndinë. Ai ishte mësuesi i madh i popullit të Perëndisë, autori dhe redaktori i të pesë librave të Biblës (Tora). Ai profetizoi që një ditë Perëndia do të nxirrte nga gjiri i popullit izraelit një profet si ai, dhe fati i përjetshëm i atij populli do të varej nga qëndrimi i tij ndaj këtij profeti. Kjo profeci u plotësua kur erdhi Jezusi, që ishte më i madh se Moisiu; ai i dha popullit ligjin e ri, mësimin e ri nga Perëndia, dhe që plotëson mësimin e Moisiut dhe mbaron zbulimin e Perëndisë.

Moisiu në Dhiatën e vjetër, gjithashtu, ishte udhëheqësi më i madh i popullit të Perëndisë. Ai udhëhoqi popullin për çlirim nga robëria e Egjiptit, nëpër shkretëtirë deri në kufirin e tokës së premtuar. Kjo parashikon atë që do të bënte Jezusi, Mesia, në një nivel më të thellë. Jezusi e nxjerr popullin e tij nga robëria e Satanit, nëpër shkretëtirën e kësaj jete tokësore ku janë shtegtarë, dhe e shpien në tokën e premtuar, në qytetin qiellor. Një herë Jezusi e quajti vdekjen e tij në kryq „daljen e tij“, sepse me anë të vdekjes së tij pajtuese, mundi fuqitë djallëzore që mbajnë rob njerëzit dhe çliroi ata që besojnë në të. Është kuptimplotë që me këtë rast (me shpërftyrimin e Jezusit në mal), dëshmitarët e kësaj ngjarjeje ishin Moisiu dhe Elija që u paraqitën së bashku me të në madhështinë qiellore.

LIGJI (TORA)

Perëndia e çliroi popullin izraelit për ta plotësuar premtimet e tij që ia kishte dhënë Avrahamit rreth 625 vjet më parë. Nën udhëheqjen e Moisiut, Perëndia e çoi popullin në vendtakimin e përcaktuar në shkretëtirë, në malin e Sinait, ku i ishte paraqitur Moisiut 40 vjet më parë. Aty, në këtë mal, Perëndia e lidhi besëlidhjen me popullin e vet,

Izraelin. Kjo besëlidhje u ngjan besëlidhjeve që mbretërit hitas i lidhnin me shtetet e tyre vasale. Për këtë mund të lexojmë në kapitujt e 19 dhe 20 të librit të Daljes. Perëndia thotë se e ka liruar popullin nga robëria dhe kështu ai tani i takon Atij. Izraelitët e pranojnë këtë dhe janë dakord që të bëhen populli i tij. Pas kësaj Perëndia e lidh formalisht besëlidhjen me ta. Që atëherë Ai është Zoti i tyre feudal dhe ata janë vasalët e Tij. Për të përjetuar lulëzimin, si dhe mbrojtjen dhe hirin e tij, ata duhet ta dëgjojnë dhe të largohen nga çdo lloj idhujtarie (d.m.th. besnikërinë ndaj perëndive të tjera). Në qoftë se e shkelin besëlidhjen, d.m.th. kartën e tyre kombetare, atëherë në fund do të dënohen me mërgim në tokë të huaj. Për këtë Perëndia do të përdorë kombet e tjera.

Perëndia ua dha ligjin, ose kartën kombëtare që të bëhet kushtetuta dhe kodi i kombit të ri. Ky «ligj» e pasqyron karakterin e Perëndisë, autorit të tij. Për këtë quhet «ligji i përsosur». Izraelitët besnikë kërkonin të mësonin edhe më shumë për ligjet e Perëndisë, për udhëzimet e tij për shpëtim dhe lulëzim, sepse e dinin se Perëndia është i përsosur dhe dëshiron të mirën e tyre. Kështu, për ta, shprehja «ligji» nuk kishte kuptimin negativ. Më vonë filloi të fitonte kuptimin negativ, kur njerëzit nuk donin t'i bindeshin dhe shanin Perëndinë. Sot kemi kuptimin negativ për idenë e ligjit për arsye që vijojnë:

- 1) Ligjet njerëzore nuk janë të përsosura si ligji i Perëndisë.
- 2) Ne jemi nga natyra mëkatarë, rebelë që e shkelim pa problem ligjin e Perëndisë, d.m.th. nuk u nënshtrohemi udhëzimeve të Perëndisë për jetën tonë.

Por ligji i ishte dhënë popullit izraelit për të mirën e tij, sepse:

- 1) Ishte dhënë nga Perëndia,
- 2) Perëndia donte që populli i tij të lulëzonte që ta përdorte për shpëtimin dhe lulëzimin e kombeve të tjera.

3) Ligji ishte pasqyrimi i karakterit të Perëndisë, i cili është i mirë.

Së pari, pra, Izraeli pranon të bëhet populli i Perëndisë, sepse Ai e ka çliruar sipas premtimeve të tij të lashta. Pas kësaj izraelitët marrin emrin e tyre: populli i shenjtë. Kjo shprehje do të thotë se ata janë të mënjanuar për shërbimin e Perëndisë. Pastaj Perëndia ua jep ligjin e tij për t'u treguar se ai donte që të funksiononin si komb dhe si individë. Në mal, së pari Perëndia u foli drejtpërdrejt duke ua dhënë themelin e ligjeve të tij: ky themel përbëhet nga dhjetë urdhërimet. Pjesa tjetër e Ligjit u njoftohet më vonë me anë të Moisiut. Kombi i pranon kushtet dhe besëlidhja ratifikohet. Ligji, kodi ose hebraisht Tora, do të thotë udhëzimet për mënyrën e jetës së drejtë, d.m.th. sipas vullnetit të Perëndisë. Ky kod ndahet, kryesisht, në tri kategori:

1) kodi moral, 2) kodi civil, 3) kodi i kultit.

Çdo kategori bazohet në parakushtin që izraelitët i takojnë Perëndisë. Kështu, pra, disa forma sjelljeje nuk janë në pajtim me këtë marrëdhënie, përse i përket individit si dhe kombit. Perëndia do t'i dënojë ata që nuk e dëgjojnë. Lista të ndryshme janë të shpërndara nëpër të pesë librat e parë të Biblës. Këto lista të ligjeve mund të ndahen në katër grupe kryesore:

1) **Statutet**, të cilat janë në formë ndalimesh absolute. Të gjitha ato fillojnë me formulimin: *Mos bëj këtë...* (nënkuptohet, sepse mua më takoni). Me fjalë të tjera: Mos bëj atë që s'është në përputhje me karakterin tim. Në këtë kategori janë dhjetë urdhërimet. Këto janë kodi moral, e kjo tregon vullnetin e Perëndisë për secilin.

2) **Vendimet gjyqësore** ose precedentët. Këto janë kodi civil dhe kanë formulimin që vijon: *Në qoftë se njeriu bën këtë, duhet të paguajë një çmim të tillë...*

3) Janë shumë **forma ndërmjetëse** me formulimin urdhëror: *Në qoftë se njeriu bën këtë, do të dënohet me vdekje*. Këto ligje kanë të bëjnë ekskluzivisht me Izraelin si shtet teokratik, d.m.th. drejtpërdrejt nën sundimin e Perëndisë. Kjo shpjegon formulimin e tyre ekstrem.

4) **Libri i Levitikut** (Kodi i kultit ose kodi priftëror) ka të bëjë me mënyrën se si Perëndia do që të adhurohet nga izraelitët në kultin nën Tendën e shenjtë (Tëbanesë) ose, më vonë në Tempull. Kjo tregon se si duhet të sillen priftërinjtë. Megjithatë, disa dijetarë mendojnë se ky libër i drejtohet popullit në gjithësi, kështu që izraelitët mund të kushtojnë flijime të drejta, që priftërinjtë të përgjigjen para popullit, që ta mos shfrytësojnë.

Tregon, gjithashtu, se si duhet të sillen levitët (ata që i ndihmonin priftërinjtë). Meqë Perëndia është i shenjtë dhe ngjall nderim të madh, këto ligje na kujtojnë udhëzimet për sjelljen në një central atomik. Parimet janë të njëjta: duhet t'i afrohet Perëndisë vetëm me kushtet e veta.

Në librin e Levitikut shpjegohet më hollësisht për rregullimin e adhurimit në shenjtëroren e shenjtë, dhe kjo permendohet jo imtësisht në librin e Daljes. Kurse në këtë libër shpjegohet për specifikimet dhe strukturën e Tendës së shenjtë, libri I Levitikut shpjegohet se si duhet kujdesur shenjterorja dhe sallën e fronit të Mbretit të madh. Kjo vepër është një traktat ligjor shumë i rëndësishme, sepse përmban rregullimet sipas së cilave duhej rregulluar jeta fetare dhe civile e kombit hebre pas pushtimit të Kanaanit.

Libri i Levitikut është një doracak referimi drejtuar priftërisë së DhV, dhe përbëhet nga dy ndarje ose tema kryesore me kapitulli 16 në mes, ku bëhet fjalë për regullimet lidhur me ditën e pajtimit. Në 16 kapitujt e parë trajtohet për parimet dhe procedurat të flijimeve lidhur me heqjen e mëkatit dhe me pajtimin e individit me Perëndinë. Në 11 kapitujt e fundit trajtohet për etikën, moralitetin dhe shenjtërimin. Tema lidhëse e librit është ngulimi në shenjtërinë e Perëndisë, lidhur me kërkesën për shfaqjen e këtij atributi në jetën e izraelitëve. Lënda e librit është me natyrë priftërore dhe për këtë arsye ka të bëjë me kërkesat e besëlidhjes të Izraelit në një nivel që nuk gjendet gjetkë në Pesëlibërsh. Rregullimet dhe procedurat lidhur me ritet fetare të ditës së pajtimit janë ilustrim për këtë tendencë (R.K. Harrison: *Leviticus*).

Kodi ishte i pashoq për arsyet që vijojnë:

1) Çdo anë ishte dhënë drejtpërdrejt nga Perëndia. Mosbindja konsiderohej si rebelim kundër Tij. Ky kod s'ishte as relativ dhe as arbitrar. Kodi përfshinte tërë jetën personale si dhe kombëtare. Secila kategori ishte barabar e rëndësishme.

2) Në kod dallohet një pikëpamje shumë e lartë e jetës njerëzore. Brutaliteti ishte i përjashtuar dhe dënimi duhej të ishte në pajtim me krimin. Secili, si edhe mbreti, ishte i barabartë para ligjit. Përkundrazi, në qytetërimin hitas, dënimi që pranohej, varej nga klasa shoqërore e individit. Në Izrael, ligji ishte absolut përveç në rrethana lehtësuese.

3) Askush s'ishte i diskriminuar. Në fakt, ligji merrte parasysh njerëz pa privilegj: vejusha, jetime, të huaj, të arratisur dhe skllevër.

E ç'mund të themi sot për këtë kod izraelit?

1) Ai na jep aftësi për të depërtuar në mendjen e Perëndisë.

2) Kodi i ishte dhënë një populli, i cili ishte zgjedhur tashmë nga Perëndia. Për këtë, pra, kodi s'ishte një mënyrë për të shpëtuar.

3) Sot nuk ekziston në botë ndonjë shtet teokratik, d.m.th. një komb drejtpërdrejt nën sundimin e Perëndisë. Sidoqoftë, do të jetë një shtet i tillë në kohën e sundimit mesianik të një mijë vjetëve, kur Izraeli do jetë i lindur rishtas me anë të Shpirtit të Perëndisë.

4) Qendra e qëllimeve të Perëndisë, sot, s'është më vetëm një komb drejtpërdrejt nën sundimin e Tij, por një popull, të cilit i takojnë popujt nga çdo komb. Ky popull quhet Kisha (Bashkësia e Mesisë). Kisha e vërtetë përbëhet nga të gjithë ata që besojnë në Jezusin, Mesinë, jeta e të cilëve është e shndërruar me anë të Shpirtit të Perëndisë. Për ta, vetëm kodi moral është i vlefshëm, megjithëse kodet e tjera na tregojnë shumë

për mendjen dhe karakterin e Perëndisë dhe janë shkruar për mësimin tonë.

Koncepti i shenjtërisë është një nga kyqet për të kuptuar librin e Kodit Priftëror. Një send ose një individ quhet i shenjtë, kur përdoret në adhurimin e Zotit ose kur ky individ shugurohet për shërbimin e Tij dhe kështu i takon. Ky parim mund të konstatohet në planin e kampit:

Vendi	Individi
shenjtërorja	priftërinjtë
kampi	populli
jashtë kampit	ata quhen përkohësisht të papastër.
shkretëtira	shpirtra të papastra (djallëzorë)

Sa më afër është diçka ose dikush Zotit, aq më shumë bëhet i shenjtë. Ky parim konstatohet në planin e tendës së shenjtë

Vendi	Individi
tremi i brendshëm	levitët
shenjtërorja e jashtme	priftërinjtë
shenjtërorja e brendshme	kryepriifti

Ndarjet kryesore e librit të Kodit Priftëror janë si vijon:

1. Rregullimet për kushtimin e flijimeve të ndryshme
 - a). Mësimet themelore rreth flijimeve
 - b). Hollësitë administrative
2. Shugurimi i Aharonit dhe bijve të tij dhe kushtimi i flijimeve të parapras ndërtimit të shenjërës.
3. Seri ligjesh që rregullojnë pastërri rituale
 - a). ushqimet dhe kafshët e pastra dhe a papastra
 - b). ritual rreth lindjes
 - c). tumorët e lebrotura në njerëz, veshje të ndotura dhe shtëpi
 - d). nxjerrje nga organet gjenitale
4. Rregullimet rreth Ditës së Shlyerjes së mëkateve
5. Kodi i shenjtërimit

Ndoshta na çuditen disa elemente të Ligjit.

1. Siç duket, ka paragjykim kundër seksualitetit, por duket marrë parasysh se:

- a). Zoti nuk pranon të adhurohet si idhull: refuzon gjithçka që ka të bëjë me adhurimin kananas, të cilit i punojnë mendja e sëmure seksi dhe kulti i pjellorisë. Mjetet e mëtejshme për të nxitur pjellori ishin

zierja e edhit në qumështin e s'emës (Dal 23,19; 34,26; Lp 14,21) dhe travestizmi (Lp 22,5). Priftërit kananas merreshin me prostitucionin sakral dhe shërbënin lakuriq.

b). Zoti shpiku seksualitetin për t'u përdorur në kuadër të martesës. Ai hedh poshtë çdo formë zvetënim: satani është i vendosur për të bërë krejt të kundërtën e planit të Zotit.

2. **Koncepti i pastërtisë dhe të papastërsisë.** I pastër do të thotë: i aftë për të ardhur në pranimin e Zotit për ta adhuruar. I papastër do të thotë të kundërtën. Faktorët që përcakton ose jo këtë kategori janë si vijon:

a) Ndonjë gjë që është i vdekur, ose që përmban qeliza të vdekura (si p.sh. gjak i menstruacionit, prurje e farës itd). Kontakti me gjëra të tilla e bën individin të papastër, sepse trupa ose qeliza të vdekura kanë të bëjnë me mëkatit (zbërthim, kalbëzim).

b) Ndonjë gjë që është në sy të Zotit, i pavend. Ndonjëherë nuk jepet asnjë arsye për këtë.

c) Disa kafsha klasifikohen si të papastra, mundësisht sepse ato ushqehen me gjak ose me kërmë. Kafshat zëvendësojnë njerëzit: në ritualin e pajtimit kafsha mund të sakrifikohet në vend të njeriut, sepse të dy kanë frymën e jetës që mbahet në jetë me anë të qarkullimit të gjakut.

3. **Gjaku ndalohej të hahet**, sepse ishte i rezervuar për përdorim në ritualin e shlyerjes të mëkatit. Në gjak është parimi i jetës që flijohet në vend të jetës së mëkatit.

4. **Pretendimi për të qenë i përsosur.** Mbreti David pretendon në disa psalme të jetë i pa të metë, por kjo do të thotë se u është përmbajtur kushteve të jashtme të Ligjit. Katolikët do të thonin: Davidi ishte në gjendje të hirit. Ap. Pali tha më vonë: për sa i përket drejtësisë — asaj të Ligjit — i patëmetë (Fil 3,6).

5. **Sakatim e përjashton njeriun nga pjesëmarrja në kultin e Tempullit.** Arsyeja e kësaj (siç duket) padrejtësie është kjo: sakatimi ishte shpeshherë karakteristikë e kultit idhujtar. "Kur mblidhet bashkësia e Zotit, nuk duhet të jetë i pranishëm asnjë njeri që është i tredhur ose të cilit i është prerë organi seksual. Në të nuk duhet të marrë pjesë as ai njeri që ka lindur nga marrëdhënia me një prostitutë kultike. Edhe pasardhësit e tij janë të përjashtuar nga bashkësia e Izraelit, deri në brezin e dhjetë. (Lp 23,2-3). Adhuresit e Baalit ose Astartës shpeshherë sakatoheshin në shenjë besnikërie ndaj këtyre idhujve. shih edhe Zah 13,4-6: "Atëherë profetët do të ruhen të mos i tregojnë haptas vegimet

e tyre; ata nuk do të paraqiten të veshur me mantelin me qime çjapi të profetëve, kur të shpallin porosinë e tyre të rreme. Në qoftë se ndokush prej tyre vihet para përgjegjësisë, do të thotë: «Nuk jam profet. Jam bujk! Nuk kam ushtruar asnjë zana tjetër qysh në fëmijëri.» E kur të vihen në dukje shenjat e plagëve në trup, do të thotë: «I kam marrë nga një përleshje me disa shokë kur po pinim!»

6. Po pse në Dhiatën e Re, siç duket, flitet vetëm për Ligj në një terminologji kaq negative? Vetëm flitet ashtu ku nënkuptohet mallkimi që sjell ligji i shkelur, ose në lidhje me përmbajtjes së Ligjit si mjet për të merituar shpëtimin. Në Bibël kurrë nuk mësohet që mund të shpetojmë duke iu përmbajtur Ligjit. Udhë e shpëtimit, sipas Perëndisë, është gjithnjë me anë të një flije pajtuese – flisë së Mesisë. Jemi të falur dhe të shpëtuar vetëm për shkak të pranimit të Jezusit si flijim për mëkatet tona – vetëm atëherë mund të lindemi në familjen e Perëndisë dhe Shpirti i Perëndisë fillon t’i shkruajë ligjet e Perëndisë në zemrat tona. Me fjalë të tjera, Shpirti i shenjtë fillon të riprodhojë karakterin e Perëndisë në ne, por kjo varet nga qëndrimi ynë. Për këtë duhet të lexojmë dhe të degjojmë Fjalën e Perëndisë, Biblën.

7. Dënimi me vdekje ngarkohej për vrasje, krime seksuale duke përfshirë edhe përdhunim, adhurim i perëndive të huaja dhe ndërlirim në magji ose në tregi me skllëvër, si dhe për birin e pabindur (Dt 21,18-21). Ndryshe nga kulturat e tjera vjedhje dhe shkelja e ligjeve rreth pronarisë nuk dënoheshin me vdekje. Çdokush, duke përfshirë edhe mbretin, ishte i barabartë para Ligjit. Burgjet ishin caktuar për parburgim. Legjislacioni i DhV kërkonte të kufizojë hakmarrje. Gjohat ngarkoheshin në trajtë parash të paguar palës së ofenduar si mjet kompensimi për padrejtësi dhe mund të ngarkohej me pajtim të dyanshëm, për të zëvendësuar dënimin me vdekje, për kurorëthyerje për shembull.

8. Zotërimi i tokës. Toka e premtuar quhej prona e Perëndisë dhe e dhënë qiramarrësve. Pas pushtimit të tokës çdo fis mori trashëgim pjesën e tij të territorit sipas madhësisë së tij. Pas çdo 47 viteve kjo territori duhej t’i kthehej pronarit të parë. Në këtë kohë anuloheshin edhe të gjitha borxhet. Çdo 7 vit toka duhej të rrinte ugar.

9. Stinat. Megjithëse kishte të korrat dhe të vjelat të ndryshme, kishte në të vërtetë vetëm dy stina: mbjelljet dhe korrjet. Yllësia e plejadës dominonte stinën dimërore (mbjelljet), kurse yllësia e Orionit dominonte stinën veruese (korrjet) (Amos 5,8). Kështu yjet shërbenin si aparat matës për bujkun. Gjatë dimrit kishte dy lloje shiu: kisha e parë (në vjeshtë) kurse kisha e dytë (në pranverë).

DHJETË URDHËRIMET

Dhjetë urdhërimet (ose porositë) formojnë thelbin e kodit moral. Ato tregojnë se ç'kërkon Perëndia nga populli i Tij, në qoftë se ky popull do të mbetet në bashkësi me Të. Më tej, ato shprehin karakterin e Perëndisë, i cili do që të riprodhohet ky karakter në popullin e tij. Nga bindja ndaj dhjetë urdhërimeve varet bashkësia e popullit me Perëndinë, dhe jo zgjedhja e tyre. Me fjalë të tjera, dhjetë urdhërimet nuk janë mënyrë për të shpëtuar, por për të mbetur në bashkësi me Perëndinë.

Porosia e parë thotë: *Mos ki perëndi të tjera para meje!* Shprehja «para meje» do të thotë «në praninë time» ose «duke më shërbyer mua». Ky urdhër është ndryshe nga ato që gjejmë te fetë e tjera të asaj kohe, në të cilat pranonin vërtet një perëndi, por edhe adhuronin shumicën e hyjnive të ulta. Kërkesat e Perëndisë janë absolute. Në besimin biblik përjashtohet adhurimi i hyjnive të dorës së dytë ose i qenieve të hyjnizuara. Përjashtohen edhe idhujt si për shembull makina e re ose filozofia rivale që është në rrezik ta zëvendësojë Perëndinë ose ta plotësojë. Perëndia lidhet ngushtë me shfaqjen e vetes që ndodhet në Bibël. Vetëm Bibla është e autoritetshme. Për këtë, pra, bëjmë idhujtari në qoftë se vëmë ndonjë libër tjetër në të njëjtin nivel.

Porosia e dytë thotë: *Mos bëj kurrfarë pikturë as skulpturë.... mos i adhuro as mos u shërbe...!* Ky është urdhri i rreptë që të mos bëjë statujë a figurë që simbolizon një fuqi të mbinatyrshme dhe të mos i adhurojë e nderojë si hyjni. Në qoftë se njeriu bën pikturën e Perëndisë, kjo i heq esencën, d.m.th. shenjtërinë ose ndryshimin, e sjell në nivelin e njeriut që përpiket ta manipulojë për qëllimet e veta. Në këtë mënyrë krijohet feja e kotë, besëtytnia, opiumi për popullin. Në këtë urdhërim Perëndia thotë se nuk duron rivalët.

Porosia e tretë thotë: *Mos e merr nëpër gojë kot emrin e Zotit.* Emri i Zotit lidhet me karakterin dhe personin e Tij. Për këtë, pra, lidhja e emrit të Perëndisë me praktikë magjike, me një betim të rremë ose me sharje, do të thotë lidhja e Perëndisë me perëndi të tjera, me Satanin dhe me mëkate personale. Në qoftë se njeriu shan, kjo do të thotë se e merr lehtësisht edhe Perëndinë. Fëmijët e vërtetë të Perëndisë nuk shajnë, sepse Shpirti i shenjtë në ta e ka ndryshuar qëndrimin e tyre ndaj Perëndisë, Atit të tyre. Perëndia është i shenjtë, d.m.th. i ndryshëm, i ndarë nga mëkati. Edhe ne duhet të jemi kështu.

Porosia e katërt thotë: *Të bie në mend dita e shtunë për ta shenjtëruar. Puno gjashtë ditë dhe kryej punët e tua, por e shtata ditë është e shtuna, ditë pushimi kushtuar Zotit, Perëndisë tënd.* Ky urdhërim iu dha izraelitëve që

ta kujtojnë ditën e pushimit e t'i përmbahen, për ta mënjeluar si një ditë të veçantë, veçanërisht për adhurimin e Perëndisë. Një ditë prej shtatë ditëve duhet të mënjanohet.

Porosia e pestë thotë: *Ndero babanë tënd dhe nënën tënde*. Nderimi i prindërve do të thotë t'u japësh të drejtat e tyre, t'u japësh nderimin që u duhet, sepse është Perëndia që i emëroi prindërit dhe në një farë kuptimi ata përfaqësojnë Perëndinë për ne. Janë sfera e autoritetit të caktuar nga Perëndia. Kjo nuk ndodh kur prindërit kërkojnë nga fëmijët e vet atë që i takon vetëm Perëndisë. Fëmijët duhet t'i nderojnë prindërit e vet dhe ta sigurojnë pleqërinë, por nuk janë të detyruar të jenë të një mendjeje politike ose fetare me ta.

Porosia e gjashtë thotë: *Mos bëj vrasje*. Nuk thotë «Mos vra», dhe për këtë, pra, ky urdhërim nuk mund të përdoret për të justifikuar pacifizmin ose anulimin e dënimit me vdekje. Që të dyja këto pranoheshin në Izraelin e lashtë.

Porosia e shtatë thotë: *Mos bëj kurorëthyerje!* (d.m.th. tradhti bashkëshortore) Në këtë urdhërim ndalohet shkatërrimi i martesës për shkak të imoralitetit të një pale të tretë, me të cilën një nga partnerët ka marrëdhënie seksuale. Kurorëthyerja në të vërtetë është një formë vjedhjeje; vjedhja e njërit nga partnerët, sepse marrëdhënia bashkëshortore është aq e ngushtë dhe e pandarë saqë dy bëhen një.

Porosia e tetë thotë: *Mos vidh!* Vjedhja është përvetësim në mënyrë të fshehtë i diçkaje që është pronë shoqërore a pasuri e tjetërkujt. Mashtrimi në shkollë ose udhëtimi pa biletë është një formë vjedhjeje, gjithashtu.

Porosia e nëntë thotë: *Mos bëj dëshmi të rremë kundër të afërmit tënd!* I afërmi këtu do të thotë «bashkatdhetar izraelit yti» e kështu «fqinji yt». Ndalohet, pra, të jepet dëshmi e rreme për dikë në gjyq. Ky parim përfshin edhe mashtrimin ose gënjeshtren. Një dëshmi e rreme mund të dëmtojë një çështje gjyqësore dhe të shkaktojë dënimin e njeriut të pafajshëm. Një gënjeshtër ose mashtrim mund ta dëmtojë marrëdhënien ndërmjet njerëzve ose ndërmjet njeriut dhe Perëndisë.

Porosia e dhjetë thotë: *Mos lakmo!* Ndalohet të lakmosh me qëllim që të marrësh atë që i takon tjetërkujt. Porosia e fundit zbulon motivacionet e fshehta të zemrës njerëzore.

Por ç'është lidhja e dhjetë urdhërimeve me periudhën e Dhiatës së Re? Në Dhiatën e Vjetër, siç kemi mësuar, Perëndia ia dha dhjetë urdhërimet popullit, me të cilin tashmë kishte lidhur besëlidhjen e tij. Bindja ndaj urdhërimeve ishte një kusht, jo për shpëtim, por për lulëzim. Por, mbetet një problem: populli ende nuk e kishte Shpirtin e shenjtë. Shpirti i shenjtë, d.m.th. Shpirti i Perëndisë, vepronte mbi njerëzit e Izraelit,

duke u dhënë dhunti për shërbimin e Perëndisë, por nuk vepronte nga përbrenda. Disa nga dhuratat e Shpirtit dukeshin, por jo duke folur në përgjithësi, frytin e Shpirtit të shenjtë. Ligji ishte jashtë, jo brenda në zemrat e njerëzve. Populli priste me padurim ardhjen e Mesisë që duhej t'u shlyente mëkatet dhe t'u jepte Shpirtin e shenjtë që të banonte përjetësisht brenda, në zemrat e tyre.

I tërë mësimi i Jezusit nënkupton banimin e Shpirtit të shenjtë në njerëzit. Jezusi është Moisiu i dytë, ligjdhënësi i madh, i cili e interpreton ligjin e Perëndisë në nivelin më të lartë, nivel që mund të realizohet vetëm për ata që janë të lindur rishtas me anë të Shpirtit të shenjtë, d.m.th. në bashkësinë e atyre që i takojnë Mesisë për shkak të besëlidhjes që Ai e lidh me ta. Perëndia të fton tani të bëhesh pjesëtar i asaj bashkësie tani. Ai do të ta japë Shpirtin e Tij, që të mos jesh më skllav i mëkatit dhe legalizmit fetar, por që të shndërrohesh në përgjasimin e Tij. Vetëm ata që janë të lindur rishtas me anë të Shpirtit të Perëndisë mund të pranohen si fëmijët e tij dhe kështu si trashëgimtarët e Tij. Ti nuk mund të bëhesh fëmijë i Perëndisë duke iu bindur ligjit të tij – ti duhet të lindesh në familjen e tij për ta marrë Shpirtin e tij. Vetëm atëherë ligji i Perëndisë do të bëhet diçka e brendshme dhe Shpirti i Perëndisë do të fillojë ta riprodhojë karakterin e Perëndisë në ty.

SISTEMI I FLIJIMIT

Drejtesia e kombit ishte ndarë në kategori të ndryshme. Njëra nga këto kategori ishte kodi i kultit. Një libër i plotë në Bibël i kushtohet kësaj çështjeje. Në librin e **Levitikut (Kodit Priftëror)** gjejmë kodifikimin dhe sistematizimin e flijimeve për kombin në tërësi. Njerëzit bënë flijime që nga fillimi i njerëzimit, por në librin e kodit priftëror, i cili është një lloj manuali për priftërinjtë, Perëndia kërkoi sistematizimin e flijimeve brenda caqeve të kultit kombëtar. Sot me vështirësi e kuptojmë idenë e flijimit. Lexojmë, për shembull, në Fjalorin e shqipes së sotme përkufizimin që vijon: «Qenie e gjallë (njeri ose bagëti) që, sipas besimeve të kota, therej për nder të një hyjnie; kurban.» Sipas kuptimit bashkëkohor, një flijim i takon sistemit primitiv, por megjithatë ideja mbetet në gjuhën e sotme, si provohet në përkufizimin e mëtejshëm: «Ai që jep jetën për një çështje të madhe, për interesat e larta të atdheut e të popullit, theror, dëshmor.» Më tej u japim dhurata atyre që i duam dhe i nderojmë. Në Izraelin e lashtë, pasuria e individit matej sipas prodhimeve bujqësore që kishte, sipas sasisë së bagëtisë së tij. Sot kemi prirje ta matim sipas parave.

Në Izraelin e lashtë, njerëzit kushtonin flijime të ndryshme për arsye të ndryshme. Sidoqoftë, në rastin e Izraelit, duhet të modifikohet përkufizimi i fjalorit, sepse:

1) Flijim mund të bëhet edhe një send, si për shembull një prodhim bujqësor.

2) Flijimi i njeriut ndalohej.

Të gjitha flijimet kishin këto të përbashkëta; u kushtoheshin në kup-timin e kultit të adhurimit për Perëndinë. Adhurimi i Perëndisë përbëhej parimisht nga shprehja e nderimit për planin e Tij të përsosur për jetën si edhe për lulëzimin. Nganjëherë njerëzit bënin një flijim për nder të Perëndisë, për ta falënderuar e për të treguar që gjithçka që kishin i takonte në të vërtetë Perëndisë. Nganjëherë njerëzit bënin një flijim si shprehje e bashkësisë së tyre me Perëndinë. Në këtë rast adhuruesit e hanin gjysmën si shprehje e bashkësisë me Perëndinë, gjysmën tjetër e digjnin si shenjë që kjo pjesë i takonte Perëndisë. Nganjëherë bënin një flijim, sepse kishin mëkatuar kundër Perëndisë. Në këtë rast, vritej një bagëti dhe gjaku derdhej për të treguar që mëkati kushton jetën – ose bagëtia duhet të vdesë ose njeriu, e Perëndia e jep bagëtinë në vend të njeriut, sepse nuk do që të vdesë mëkatari. Në qoftë se njeriu mëkatoi kundër Perëndisë, u vendos në të padrejtën dhe duhej të priste dënimin e Perëndisë. Për ta vënë njeriun përsëri në rregull me Perëndinë, duhej që për jetë të jetëve të flijohej një bagëti në vend të njeriut. Në këtë mënyrë, Perëndia u mësonte njerëzve se mëkati është shumë serioz dhe nuk mund të trajtohet me mendjelehtësi. Por, në mëshirën e tij, Perëndia na ka dhënë zgjidhjen e problemit – një bagëti (qenie të gjallë) për të vdekur në vend të njeriut.

Kodifikimi i sistemit të flijimeve në librin e Kodit Priftëror ishte si vijon: ishin pesë lloje kryesore të flijimeve:

1) **Flijimi i përkushtimit** Bagëtia e caktuar për djegie sillej në Tendën e shenjtë ose në Tempull (d.m.th. në prani të Perëndisë) dhe atje digjej në tërësi. Njerëzit e kushtonin këtë lloj flijimi për nder të Perëndisë, për t'iu përkushtuar Atij plotësisht.

2) **Flijimi i miqësisë**. Quhej edhe flijimi i falënderimit ose i bashkësisë. Bagëtia sillej para Zotit dhe therej. Pjesërisht digjej (pjesa e kushtuar Perëndisë), dhe pjesërisht hahej nga adhuruesit. Kjo ishte mënyrë e falënderimit të Perëndisë, dhe shenjë e bashkësisë ndërmjet Perëndisë dhe adhuruesve të tij.

3) **Blatimi drithor** drithi sillej në prani të Perëndisë. Kjo tregonte se Perëndia është pronari i gjithçkaje që kemi, dhe shenja e kushtimit të punës Perëndisë.

4) **Flijimi i dëmshpërblimit.** Një bagëti vritej para Zotit si dëmshpërblim për dëmin që i kishte bërë një izraeliti tjetër ose Perëndisë. Në të dy rastet mëkati u bë kundër Perëndisë dhe po në të dy rastet, duhej të paguhej dëmi. Ka dëshmi se individit që kishte bërë mëkat me rebelim mund, falë pendimit, të zvogelonte fajin në mëkat të pavëmendshëm, i cili mund të shlyhej me kushtimin e flijimit të dëmshpërblimit.

5) **Flijimi i pajtimit.** Njerëzit e bënin këtë flijim, duke therur bagëtinë, për të shlyer mëkatet e individit ose të kombit. Ja pikërisht lloji që e bëri Jezusi duke u flijuar.

Të gjitha këto flijime kishin për rit paraprak derdhjen e gjakut, e kjo ishte e nevojshme, sepse mëkatari vinte në prani të Perëndisë së shenjtë.

Në Ditën e Pajtimit (hebraisht: Jom Kipur), një herë në vit, kryepriifti hynte në vendin e shenjtë të Çadrës, ose më vonë, të Tempullit. Së pari ai duhej të bënte një flijim për mëkatet e veta. Pas kësaj bënte flijimin e dy cjepve. Një cjap e therte, kurse tjetrin e largonte në shkretëtirë. Cjapi i parë simbolizonte vetë pajtimin (paga e mëkatit është vdekja), kurse i dyti simbolizonte pasojën e pajtimit (largimin e fajit). Të dy së bashku quheshin «fli pajtuese». Ja ç'bëri Jezusi në kryq për ne. Të gjitha flijimet me derdhjen e gjakut kishin katër parime:

- 1) Zbutja e zemërimit të Perëndisë ose largimi i zemërimit të tij.
- 2) Shlyerja e mëkatit, d.m.th. largimi i mëkatit,
- 3) Zëvendësimi: mëkatari duhej të vinte duart mbi kafshën, e cila duhej të therej (si shenjë identifikimi me flinë) dhe, njëkohësisht pranonte mëkatin e tij.
- 4) Vetë Perëndia e furnizonte flinë për pajtim. Të gjitha meritat ishin të përjashtuara. Njeriu duhej ta pranonte menyrën e pajtimit që vinte nga Perëndia.

Por sistemi i flijimeve të Dhiatës së Vjetër ishte i kufizuar sepse:

1) Ai shpëtonte vetëm nga dënimi i përkohshëm (d.m.th. nga vdekja fizike). Nuk mund t'i jepte adhuruesit shpëtimin e përjetshëm. Flijimi ishte i vlefshëm vetëm në qoftë se nuk bëhej ndonjë mëkat tjetër, pastaj duhej bërë përsëri një flijim i ri, dhe kështu me radhë; një mëkat një flijim.

2) Sistemi nuk kishte vlerë për çdo lloj mëkati. Për përbuzjen publike të Perëndisë s'kishte asnjë flijim – mëkatari përjashtohej nga bashkësia e besëlidhjes dhe vritej me gurë. Mbreti David ishte pikërisht në këtë gjendje pasi bëri kurorëthyerje me gruan e tjetrit dhe shkaktoi vdekjen e burrit të saj në frontin e luftës. S'i mbeti tjetër veçse të hiqej në mëshirën e Perëndisë.

3) Sistemi i fljimeve ishte një rregullim i përkohshëm që duhej të vepronte deri në ardhjen e Mesisë (Shërbëtorit të Zotit), i cili bëri fljimin më të mirë, një herë e përgjithmonë.

Vetëm me arritjen e Besëlidhjes së Re paraqitet rasti i fljimit më të mirë. Fljimin që bëri Jezusi në kryq kishte veçoritë karakteristike që vijojnë:

1) Ky fljim na shpëton një herë e përgjithmonë. Na jep shpëtimin e përjetshëm, sepse është i vlefshëm për të gjitha mëkatet e kaluara, të tanishme dhe të ardhshme. Ndryshe nga fljimet sipas Besëlidhjes së Vjetër, ky fljim nuk përsëritet. Përse jo? Siç shpjegohet në Letrën drejtuar Hebrenjve, personi i cili u fljua, Jezusi, Biri i Perëndisë, është i përjetshëm, duke qenë Perëndi. Për këtë, pra, u fljua vetëm një herë, por fljimi pajtues i tij është përjetësisht i vlefshëm. Ky fljim nuk mund të përsëritet.

2) Ky fljim është i vlefshëm për çdo lloj mëkati. S'ka rëndësi ç'ke bërë, sa je i keq – në qoftë se pranon Jezusin për fljimin tënd, ti je i falur përjetësisht dhe bëhesh fëmijë i Perëndisë.

Tani që Mesia ka ardhur, sistemi i mëparshëm është anuluar. Mbetet vetëm një fljim për mëkatet që është i pranishëm para Perëndisë – fljimi i Birit të Tij, Jezusit, Mesisë.

FESTAT E IZRAELIT

Në fetë pagane, festat ose ritet janë të lidhura me ngjarjet mitologjike që përkujtojnë perënditë ose forcat e misterioze të kozmosit. Festimi i tyre ka për qëllim zaptimin e ndikimit të tyre mirëbërës. Në Izraelin e lashtë, të kremtat kishin një kuptim krejtësisht të ndryshëm. Ato ishin të lidhura me ngjarjet që kishte përjetuar personalisht kombi izraelit. Në brezat e mëtejshme hebrenjtë i përkujtonin mrekullitë e bëra nga Perëndia. Ata i festonin duke kënduar për fuqinë, dashurinë e tij, për karakterin dhe premtimet e tij. Për shembull, ngjarjet e Daljes nga Egjipti kujtoheshin me anë të festës së Pashkës, kurse dhënia e Ligjit në Sinai me anë të festës së Rrëshajëve. Por, çdo festë kishte njëkohësisht një kuptim profetik. Ato të gjitha parashikonin plotësimin e tyre me ardhjen e Mesisë. Është kuptimplotë se vetë Jezusi nuk themeloi festa çifute të reja, sepse ngjarjet që ato simbolizuan u plotësuan me veten e tij. Po ashtu, apostulli Pali shkroi: *Prandaj askush të mos guxojë t'ju dënojë për çështje ushqimi e pijeje, për çështje festash të hënës së re ose të të shtunave, sepse këto janë vetëm hija e atyre që duhej të vinin, kurse realiteti është (Jezus) Mesia!* (Kolosi-

anëve 3,16-17). Aspekti profetik i këtyre festave dhe plotësimi e tyre në Jezusin, Mesinë është ai që na intereson ne si të krishterë.

Festat izraelite të Besëlidhjes së Vjetër mund të ndahen si vijon:

1) Festat e mëdha ishin para së gjithash festat e pelegrinazhit, kur hebrenjtë shkuan në pelegrinazh deri në Jerusalem ku festohej e kremtja. Këto festa ishin ngjarjet e gëzueshme (hebraisht: *hag* i lidhur me *hug* = rreth. Pra, vallëzim në rreth). Ato ishin si vijojnë:

- a) *Pesah* (Pashka) në muajin nisan (mars/prill).
- b) *Shavuot* (Rrëshajët) në muajin sivan (maj/qershor)
- c) *Sukot* (Tëbanat) në muajin tishri (shtator/tetor).

2) Pastaj vijjnë festat solemne me pendim kombëtar. Ato ishin:

- a) *Rosh-ha-Shana* – Viti i Ri në muajin tishri (shtator/tetor)
- b) *Jom Kipur* – Pajtimi i madh në muajin tishri (shtator/tetor)

Kishte edhe festa më të vogla

a) *Hanuka* (Festa e Rikushtimit të Tempullit) në muajin kisleb (nëntor/dhjetor)

b) *Purim* (Festa e shortit) në muajin adar (shkurt/mars)

Pashka, Rrëshajët dhe Tëbanat ishin tri festat e mëdha të vitit fetar çifut. Çdo çifut besimtar ishte i detyruar të shkonte në pelegrinazh të Tempullit në Jerusalem tri herë në vit për t'i kremtuar.

Festa e Pashkës (hebraisht: *Pesah*) kalonte tetë ditë dhe i përkujtonte ngjarjet e Daljes kur Perëndia ruajti të parëlindurit dhe e çliroi kombin nga robëria në Egjipt. Kjo festë quhet, gjithashtu, Festa e Bukëve të ndorme (*Hag haMacot*), sepse buka që e pjekin në pragun e Daljes nuk kishte fare brume për shkak të nxitimit të tyre. Në shtëpitë e sotme çifute gruaja kalon një muaj duke kërkuar mbeturinat e bukës së ndorme për t'i zhdukur. Kështu përgatitet për festimin e Pashkës. Këtë na kujton një fragment i Dhiatës së Re ku shkruhet: *Po a nuk e dini se pak tharm e brumos mbarë brumin? Pastrohuni nga tharmi i vjetër që të bëheni brumë i ri, sikurse edhe jeni të ndorme, sepse Mesia – Qengji ynë i Pashkës – është flijuar tashmë. Prandaj, le të kremtojmë, jo me tharmin e vjetër, as me tharmin e zemrës së keqe e të ligësisë, por me bukë të pabrume të pastërtisë e së vërtetës.* (I Korintasve 5,6-8).

Nga koha e Jezusit kësaj feste iu shtua edhe një element i ri: therja e qengjave në oborrin e Tempullit të meshkujve izraelit si edhe lyerja e altarit e jo shtalkat e derës së shtëpisë me gjakun e tyre. Kryetari i çdo shtëpie izraelite sillte një qengj. Këndohej një sërë psalmesh të quhur Hallel dhe dëgjohej shofari (briri i dashit). I therin qengjat, e mbledhin

gjakun e tyre, me të cilin e lyejnë altarin. Kryetari i çdo shtëpie kthen te familja e vet qengjin e vdekur, të cilin pastaj e pjekin. Pas kësaj festohet me darkë solemne në çdo familje me anë të liturgjisë së duhur (që quhet *seder* ose rendi). E gjithë darka është simbolike. Elementet më të rëndësishme janë si vijojnë: një gotë me ujin e kripur që përkujton kalimin e detit të kuq, tri macot (bukë të ndorme) në tabaka që kujtojnë për bukët e pjekura me nxitim, një këmbë qengji që simbolizon qengjin e Pashkës, katër gota me verë të kuqe që përkujtojnë gjakun e derdhur, si edhe barishte të ashpra me salcë. Pihet nga gotat në fazat e ndryshme të liturgjisë.

Në Pashkë festohet çlirimi nga Egjipti, por bëhet parashikimi i çlirimit edhe më të madh; atë të kryer me anë të vdekjes së Jezusit në kryq. Në darkën e fundit Jezusi u dha Pashkës një kuptim të ri. Duke festuar darkën solemne të Pashkës së bashku me nxënësit e vet, Jezusi tha se maca e thyer (d.m.th. buka, numri njëjës i fjalës hebraike *macot*), simbolizonte trupin e tij të mbërthyer në kryq, kurse katër gotat me verë të kuqe përfaqësojnë gjakun e tij që do të derdhej në kryq. Ai ishte qengji i vërtetë i Pashkës. Si nxënësit pinë verën, Jezusi tha: *Kjo gotë është besëlidhja e re (e lidhur) me gjakun tim; sa herë që ta pini (në darkën e Zotit), bëjeni këtë për kujtim timin.* (I Korintasve 11,25). Kështu, Jezusi është plotësimi i Pashkës. Mjerisht çifutët ende nuk e pranuan këtë, dhe për këtë mbeten në një rrugë pa krye.

Festa e Rrëshajëve Në Bibël kjo festë quhet edhe Festa e të korrave, ose Festa e Javëve (*Hag ha-Shavuot*) ose Festa e Prodhimeve të para (*Hag ha-Asif*). Për festimin e kësaj feste, njerëzit sjellin në Tempulli prodhimin e parë të tokës (grurë, elb, rrush, fiq dhe hurma). Ato u jepen priftërinjve, të cilët ia kushtojnë Perëndisë në altar. Në qytetin më të afërt formohet një procesion, i cili nisët me demin flijues në krye. Njerëzit këndojnë psalmet duke i shoqëruar me flaut. Kur arrijnë në Jerusalem, kryetarët e qytetit si edhe priftërinjtë u dalin përpara. Pas ceremonisë së kushtimit të prodhimeve në Tempull, pelegrinët kalojnë natën në Jerusalem. Në ditën e dytë, prodhimet u jepen priftërinjve në shërbim.

Por në këtë të kremte festohej edhe dhënia e ligjit në Sinai, kur lindi kombi i Izraelit, si edhe Kisha më vonë. Në fillim kjo festë konsiderohej si dita e tetë e Rrëshajëve, por e ndarë nga ajo për shtatë javë. Në të vërtetë e para tufë gruri kushtohej menjëherë një ditë pas Pashkës. Në të njëjtën mënyrë, dita e Rrëshajëve të krishterë ishte e lidhur ngushtë me ngjarjet e Pashkës. Dita e Rrëshajëve (d.m.th. pranimi i Shpirtit të

shenjtë) ishte pasoja e vdekjes dhe ringjalljes së Jezusit. Jezusi, Mesia, u flijua për mëkatet e popullit të vet si dhe për mëkatet e mbarë botës. Në ditën e tretë Jezusi u ngjall dhe iu paraqit nxënësve të vet gjatë një periudhe 40 ditorshe. Ai u tha të vazhdonin të luteshin për ardhjen e Shpirtit të shenjtë, të cilin ai do t'ua dërgonte pas ngritjes së tij në qiell, duke provuar kështu se ai është Mesia. Shpirti i shenjtë ishte dhurata personale e Mesisë, Personit të dytë të Trinisë. Dhjetë ditë pas ngritjes së Jezusit në qiell dhe 40 ditë pas ringjalljes së tij, Jezusi e dërgoi Shpirtin e shenjtë dhe lindi Kisha. Nxënësit e Jezusit, të pajisur me fuqinë e Shpirtit të shenjtë, dolën dhe ua predikuan të gjitha kombeve lajmin e gëzueshëm për Jezusin. Izraeli i sotëm mjerisht ende mbetet shërbëtor i pagojë i Zotit dhe mjerisht nuk e predikon këtë lajm të gëzueshëm. Por, do të vijë koha kur të bëhet kjo dhe atëherë do të ketë të korra edhe më të mëdha.

Festa e Tëbanave (hebraisht: *Hag haSukot*) përkujton endjen e Izraelit në shkretëtirë gjatë 40 vjetëve, kur kombi varej plotësisht nga Perëndia për ushqimin e tij e t.j. Gjithashtu, festoheshin të korrat e mbledhura. Festohej dhjetë ditë pas festës *Jom Kipur*. Menjëherë pas *Jom Kipurit* fillojnë përgatitjet për festën e Tëbanave. Njihej si festa e madhe ose thjesht si «festa». Gjatë kësaj feste izraelitët banojnë në kamp, në tëbana për të kujtuar jetesën e tyre nën çadra në kohën e endjes në shkretëtirë. Festimi kalon gjatë shtatë ditëve. Priftërinjtë bëjnë flijime për shtatëdhjetë kombet e botës. Ky ishte një gjest profetik, i cili parashikonte kohën kur kombet e tërë botës do ta adhurojnë Perëndinë e Izraelit. Në kohën e festës, mijëra pelegrinë erdhën në Jerusalem duke valëvitur degë palmash si shenjë gëzimi. Rreth Tempullit ndodheshin katër shandanë shumë të mëdhenj, të cilët e zotëronin Jerusalemin. Pelegrinët mbanin dritëzat, të cilat i mbushnin me vaj ulliri nga katër enët prej guri që ishin shumë të mëdha kur vinin në Tempull, duke kënduar psalmet. Është kuptimplotë se pikërisht në këtë kohë Jezusi u ngrit në Tempull dhe tha: *Unë jam drita e botës! Kush vjen tek unë nuk do të ecë në errësirë por do të ketë dritën e jetës.* (Ungjilli sipas Gjonit 8,12). Në një ceremoni tjetër, nxorën ujin nga pishina e Shiloahut dhe e sollën në Tempull ku e përziën me verë dhe e derdhën në një cisternë para altarit. Në ditën e tetë të festës pelegrinët sollën të dhjetën e prodhimeve të tyre dhe iu falën Perëndisë për t'u dhënë shi për vitin që po vinte. Në këtë sfond duhet të kuptohet kapitulli i shtatë i ungjillit sipas Gjonit. Gjatë festës Jezusi u paraqit në Tempull dhe tha se Ai është uji i jetës. Me fjalë të tjera tha se ai është i vetmi që mund të japë Shpirtin e Perëndisë. Në ditën e nëntë e lexuan

Ligjin edhe burrat që u gëzuan për Ligjin kombëtar (shfaqjen e vullnetit të Perëndisë). Ata vallëzonin duke mbajtur pergamenën e Ligjit në krah. Kjo ceremoni quhej *Simhat Tora*. Jezusi në kap. 7. tha se askush nga ata nuk iu bind Ligjit – të gjithë ata janë të prishur për shkak të ndikimit negativ të mëkatit. Për këtë arsye ata të gjithë kanë nevojë për atë që Ai, Mesia, dëshiron t’u japë: jetën e re me anë të Shpirtit të shenjtë duke banuar në besimtarë. Kjo, jeta e re, mund të fillojë kur të pranojmë falimentimin tonë dhe të pranojmë ndjesën e Perëndisë për shkak të asaj që Jezusi bëri në kryq (shpëtimin tonë). Vetëm atëherë mund ta marrim Shpirtin e shenjtë, për të cilin foli Jezusi.

BESËLIDHJAT

Një nga temat kryesore të Biblës është besëlidhja. Në të vërtetë titulli i librit të **Ligjit të përtërirë** do të thotë Libri i Besëlidhjes së ripërtërirë Gjithnjë, në Bibël, mund të vërehet që Perëndia dëshiron ta shpëtojë njeriun nga pasojat e mëkatit, d.m.th. pasojat e rebelimit të tij. Perëndia vepron kështu duke u lidhur me njeriun me anë të besëlidhjes që mban një premtim dhe nganjëherë disa kushte. Në Bibël lexojmë për besëlidhje të ndryshme, por të gjitha kanë disa elemente të përbashkëta:

- 1) Perëndia merr iniciativën,
- 2) Ai jep një premtim dhe e vulos me anë të një flijimi,
- 3) Ai i jep njeriut një shënje konkrete për këtë.

Pas rënies së njeriut në mëkat, Perëndia nuk kënaqet ta lërë punën atje. Ai i jep një premtim në formë të një besëlidhjeje të nënkuptuar: ai do t’u japë një Shpëtimtar që do të vijë për të luftuar kundër Satanit. Ai do ta mundë Satanin, por me çmimin e jetës së vet. Satani do të goditet për vdekje dhe për këtë pasojat e rënies së njeriut do të anulohen. Më tej, nënkuptohet që ky Shpëtimtar do të rrjedhë nga Hava (Eva), prandaj do të jetë një njeri. Ky premtim quhet Lajmi i mirë i parë, dhe thotë kështu: *Unë (Perëndia) do të bëj që ti (gjarpri) dhe gruaja ta urreni njeri-tjetrin: pasardhësit e saj dhe ti gjithnjë do të jeni armiq. Një nga pasardhësit e saj do të ta shtypë kokën, kurse ti do t’i kafshosh thembrën.* Siç duket, Hava e merrte parasysh këtë premtim, sepse pas vdekjes së Hevelit (Abelit), ajo e quajti zëvendësin e tij Shet (I Caktuari). Në kapitujt e parë të Zanafillës theksohet shumë vazhdimi i rrjedhjes së besimtarëve që duhet të çojë deri në Mesinë (Çlirimtarin e premtuar). Përmenden 10 para dhe 10 pas përmytjes së madhe sepse ishin njerëz besimtarë.

NOAHU Ka një besëlidhje të qartë ndërmjet Perëndisë dhe Noahut si zëvendësit të njerëzimit që mbeti gjallë pas përmbytjes. Në këtë besëlidhje Perëndia premtonte t'i kufizojë pasojat e mëkatit. Kurrë më s'do të ketë përmbytje: sigurohen stinët si edhe një pjellori relativisht e mirë: sistemi ligjor (drejtësia) hyn në fuqi që t'i frenojë pasojat e mëkatit (anarkinë, padrejtësinë e të tj.).

Ashtu si edhe besëlidhjet e tjera, kjo besëlidhje bazohet në premtimin e Perëndisë: Ai do të ketë mëshirë dhe do të shpëtojë. Ratifikohet nga një fli së cilës Perëndia i shton vulën e vet: në këtë rast, ylberin. Kjo s'është një marrëveshje ndërmjet të barabartëve. Perëndia vetë e merr iniciativën dhe lidhet me premtimet e veta.

AVRAHAMI Perëndia lidh besëlidhje edhe me Avrahamin (Abrahamin), stërgjyshin e popullit të zgjedhur. Në këtë rast vula e vet është syneti (rrethprerja). Izraeli është komb i zgjedhur për shkak të të parëve të tij (d.m.th. Avrahamit dhe fëmijve të vet të lindur sipas premtimit). Zgjedhja e tij varet nga Perëndia që nuk e merr mbrapsht atë që tha. Kjo zgjedhje nuk mund të komprometohet nga mosbindja e kombit ndaj besëlidhjes së Sinait, të lidhur më vonë në kohën e Moisiut. Perëndia ia premtoi Avrahamit tri gjëra:

1) të krijojë nga pasardhësit e tij një komb të fuqishëm (kjo u plotësua në kohën e Daljes nga Egjipti),

2) t'i japë kombit tokën e Izraelit përgjithmonë (kjo ndodhi në kohën e Pushtimit të Kënaanit 40 vjet pas Daljes). Ky premtim është ende i vlefshëm.

3) që të vijë Mesia prej pasardhësve të Avrahamit për të bekuar dhe shpëtuar botën. Kjo besëlidhje me Avrahamin u vulos me anë të një flijimi.

KOMBI IZRAELIT NËN UDHËHEQJEN E MOISIUT Vula e kësaj besëlidhjeje ishte rrasat, mbi të cilat ishin shkruar dhjetë urdhërimet – kushtet për lumturinë e popullit. Kjo besëlidhje, ndryshe nga besëlidhjet e tjera, ishte e përkohshme – ajo e parashikonte dhe priste kohën kur Mesia do të vinte për ta plotësuar premtimin për Mesinë të dhënë Avrahamit duke e sjellë shpëtimin e përjetshëm dhe Shpirtin e shenjtë. Nga dëgjesa ndaj këtij ligji varej jo zgjedhja e Izraelit, por lulëzimi i kombit, lumturia e njerëzve izraelitë. Ajo është, në të vërtetë, ratifikimi në nivelin kombëtar i premtimit të bërë Avrahamit më parë. Si mbreti që ka shpëtuar kombin e vogël nga robërimi dhe shtypja, Perëndia si feudali e lidh besëlidhjen ose marrëveshjen e vet me kombin ose vasalët e vet. Ai

mban një kopje të marrëveshjes dhe ia jep popullit kopjen e dytë, d.m.th. rrasat e Ligjit. Populli e mban kopjen e dytë në arkën e besëlidhjes. Sipas kushteve të besëlidhjes, populli do të dënohet në qoftë se është i padëgjueshëm. Dënimi i fundit është mërgimi nga vendi që Perëndia ia dha kombit, në përputhje me premtimin e dhënë Avrahamit. Fjalor tipik i lidhur me këtë lloj besëlidhjeje ishte: *ahav* (do), *hesed* (dashuri në kuadër të besëlidhjes, besnikëri), *tova* (mirësi ose miqësi), *shalom* (paqe dhe lulëzim në kuadër të besëlidhjes), dhe *jada* (njoh – shbërbej me besnikëri në përputhje me besëlidhjen).

Besëlidhja që Zoti e lidhi me Davidin mund të shihet si zgjerim i besëlidhjes së Sinait. Ky u desh me zhvillimin e situatës së re historike. Mbreti izraelit u bë tani ndërmjetës mes Zotit dhe popullit të tij. Kështu u desh një besëlidhje me këtë mbret. Sipas 2 Samuelit 7, Zoti do t'i jetë Atë birit të Davidit dhe mbreti do t'i jetë bir Zotit. Gjejmë një paralel në marrëveshjet vasale hitase ku lexojmë se bijtë e vasalit besnik do të mbretërojnë përgjithmonë në fronin e tij. Me gjithë dështimin e Izraelit dhe dinastisë davidike, ky premtim në fund plotësohet në personin e Mesisë.

Nganjërherë besëlidhja rishikohej dhe ripërtërihej (ky është kuptimi i Ligjit të ripërtërirë: ripërtëritja e besëlidhjes. Në këtë libër përshkruhet ripërsëritja e besëlidhjes për hir të brezit të ri në prag të pushtimit të tokës së premtuar, pas endjes në shkretëtirë (Regjistrimet). Ky libër paraqitet në formën e predikimit, sepse është thirrja për besnikërinë e popullit. Është domëthënëse se ky libër lexohej me rastin e festës së tëbanave, sepse në fillim ky ishte kuadri i ceremonisë së ripërtëritjes së besëlidhjes. Më vonë profetët do ta kenë përsërirur këtë thirrje me rastin e kësaj feste.

Forma të shkurtra të këtij modeli marrëveshjeje gjenden te Dalja 19-24; Joshua 24 dhe 1 Samuel 12, por gjendet hollësisht në librin e Ripërtëritjes së Ligjit si vijon:

1-3. Prologu historik – rishikim i marrëdhënieve të mëparshme.

4-6 Kushtet

27 Pika e marrëveshjes.

28 Bekimet dhe mallkimet.

Kodi priftëror është në thelb një manual për priftërinjtë. Shënimi i zakonshëm «Levitiku» është mashtrues sepse jo i gjithë fisi i Leviut ishin priftërinj: vetëm ata të një familjeje të veçantë brenda fisit. Hollësitë lidhur me jetën e përditshme të mësonin dhe i impononin priftërinjtë. Zoti e kishte zgjedhur Izraelin për të qenë një popull priftëror dhe një komb i shenjtë: d.m.th. një popull që do të ndërmjesonte për kombet e

tjera, t'i drejtonte në adhurim dhe të pasqyronte karakterin e shenjtë të Atij, të cilit i takonte. Tema e librit «Kodi Priftëror» është mbajtja e marrëdhënies ndërmjet Zotit dhe Izraelit që ishte themeluar qysh me rastin e Daljes nga Egjipti. Në këtë libër shohim se si vetë Zoti i furnizon mjetet për këtë, nëpërmjet sistemit të flijimeve.

Qëllimi i marrëveshjes (d.m.th. ligjit) ishte mbajtja e popullit, edukimi në vullnetin dhe natyrën e Perëndisë, derisa të vijë Mesia, dhe përdorimi i kombit si dëshmi për vetveten ndër popuj të tjerë. Apostull Pali thotë se Ligji ishte (për çifutët) edukatori ynë derisa të vinte Mesia i cili na vë në rregull me Perëndinë përgjithmonë. Me fjalë të tjera, Ligji duhej t'i tregonte popullit se si kishte nevojë për Shpëtimtarin, sepse ishte mëkatar duke shkelur Ligjin. Sipas Perëndisë, Ligji ishte provizor deri në ardhjen e Mesisë, i cili duhej t'i vinte njerëzit në rregull me Perëndinë përgjithmonë, që të pranojnë Shpirtin e shenjtë. Por, çifutët e mbanin Ligjin për një qëllim me vete, dhe në kohën e mërgimit kur s'kishte më tempullin me sistemin e flive, përpunuan një sistem të shpëtimit me anë të meritave, pa marrë parasysh nevojën e flive për mëkatet. Sidoqoftë, në Bibël kurrë nuk thuhet për shpëtimin me anë të meritave – vetëm me anë të besimit në saje të një flije.

ENDJA NË SHKRETËTIRË

Populli izraelit, pas ikjes nga Egjipti, nuk mori udhën e drejtpërdrejtë për në Tokën e Premtuar, sepse kjo udhë ishte e rrethuar dhe e kontrolluar me fortesat egjiptiane, të cilat shtriheshin deri në Palestinë. Por, ata morën udhën që çonte për në jug të gadishullit të Sinait, sepse këtu, në malin e Sinait, populli kishte një pikëpjekje me Perëndinë. Pas kësaj pikëpjekjeje me Perëndinë, izraelitët u organizuan në një ushtri të disiplinuar dhe u nisën për në veri për të pushtuar Tokën e Premtuar. Por nuk kishin sukses sepse nuk e merrnin seriozisht fjalën e Perëndisë, dhe madje ngritën krye kundër Tij. Për dënim izraelitët ishin të detyruar të kalonin edhe 38 vjet të tjera në errësirë deri në vdekjen e atij brezi. Kjo do të thotë se do të kishin arritur në Tokën e premtuar brenda 2 vjetësh, por për shkak të rebelimit të tyre, arritën vetëm pas 40 vjetësh. Shumica e hollësive për këtë periudhë është shkruar në librin me titull hebraik «Në shkretëtirë.»

Libri i Numrave (ose, më mirë, i Numërimeve, Regjistrimeve) është një tregim i ndërlikuar rreth pabesisë, kryengritjes, apostazisë dhe dështimit, i krahazuar me besnikërinë, praninë, furnizimit dhe vetëpër-

mbajtjes së Zotit.. Pas kalimit të Detit të Kuq, izraelitët u drejtuan për në jug. Udhë e tyre i shpinte gjatë bregut të jugperëndor të gadishullit të Sinait nëpër një varg oazash të njohura. Gjatë udhëtimit të tyre për në pikëpjekjen me Perëndinë në malin e Sinait, Perëndia përmbushi nevojat e tyre në një mënyrë të mrekullueshme, bile në një ambient armiqësor. Në një vend me emrin Mara (Hidhërimi), Perëndia ktheu ujin e hidhur në ujë të ëmbël, të pijshëm, dhe e ushqeu popullin me manë (diçka e njëjtë si breshëri-kokrrizi) dhe me shkurta. Ai ua shoi etjen me ujë nga shkëmbi. Ua dha fitoren mbi midanasit, një takim me Jitron, vjehrrin e Moisiut, tek i cili kishte lënë familjen e vet pasi u kthye në Egjipt. Uji i grumbulluar në gurë gëlqereje, mana dhe shkurtat janë të gjitha fenomene që ndeshen edhe sot në shkretëtirën e Sinait. Elementi i mrekullueshëm që shënon furnizimin e Perëndisë, njihet me sinkronizimin e ngjarjes, me vendin ku ndodhi dhe me sasinë, me të cilën ndodhi. Për shembull, megjithëse mana është një fenomen natyror, sot ndeshet në pjesën qendrore të Sinait, dhe jo gjatë bregut të detit ku udhëtonin izraelitët. Më tej, thuhet se Perëndia furnizoi mjaft manë për ushqimin e tërë popullit, çdo ditë (përveç së shtunës) gjatë një periudhe prej 40 vjetësh! Kjo është mrekulli shumë e madhe. Kjo na jep një ide për mënyrën se si vepron Perëndia jo si magjistari (siç bën Satani), por i siguron, në rast nevojë, fëmijët e tij në mënyrë të mrekullueshme. Ai përdori fenomenet e natyrës në një mënyrë mbinatyrore, e kjo tregon se Ai, drejtuesi i krijimit të vet, vepron.

Gjatë muajit të tretë të udhëtimit, populli mbërriti në malin e Sinait, ku kaluan një vit. Atje Perëndia i shfaqet popullit, e në një ceremoni madhështore të lidhjes së besëlidhjes, e bëri popullin e tij. Këtu, gjithashtu, mësojmë se si Perëndia do që të adhurohet – me anë të priftërisë që drejton shenjtëroren e Tendës së madhe me ndihmën e urdhrin të levitëve. Gjithashtu, në malin e Sinait, u organizua si komb. Kur kishin ikur nga Egjipti, ata ishin fundërrit e shoqërisë egjiptiane duke qenë skllevër. Në rrëzë të malit, me urdhrin e Perëndisë, u organizuan në një grup njerëzish të disiplinuar, në një lloj ushtrie. Për ta organizuar ushtrinë, duhej të bënin një regjistrim, nga i cili vjen titulli i librit në përthimin grek (Regjistrimet, ndryshe Numrat, por më mirë Numërimet), sepse libri fillon me një regjistrim në rrëzë të Sinait dhe mbaron me një regjistrim të organizuar në prag të tokës së premtuar.

Sidoqoftë gjithçka nuk shkoi sipas planit. Izraelitët, duke qenë kryesisht të pa njohur me veprimet e Shpirtit të shenjtë, ishin një komb shumë rebel dhe tregimi për sjelljen e tyre në kohën e endjes në shkretëtirë s'është aspak për lëvdata.

Kur hasnin me vështirësi, ankoheshin dhe donin të ktheheshin në robërinë egjiptiane. Disa prej tyre ngritën krye kundër Moisiut, udhëheqësit të tyre, dhe disa herë e gjuajtën me gurë. Në çast ktheheshin në idhujtari. Në çdo rast, Perëndia i dënonte me fatkeqësi ose disfata, të cilat i shkatërruan pjesërisht. Në fund Perëndia u betua se nuk do të lejonte që ai brez të hynte në Tokën e Premtuar, dhe kështu eshtrat e tyre i lanë në shkretëtirë. Perëndia i drejtonte çdo ditë, i mbronte dhe kujdesej për ta. Duke u nisur nga mali i Sinait, ku kaluan një vit, udhëtuan drejt veriut duke ndjekur vargun e oazave derisa arritën në Kadesh-Barnea. Ky vend ndodhet sot në kufirin verior të shtetit të sotëm izraelit. Nga ky vend Perëndia i urdhëroi izraelitët të dërgonin dymbëdhjetë zbulues në tokën e premtuar që, kur të ktheheshin, të raportnin. Të gjithë (përveç dyve – Joshuas dhe Kalevit) u kthyen me një raport shumë negativ; ata erdhën në përfundim se Perëndia nuk ishte në gjendje t’u japë tokën, me gjithë premtimin e Tij. Ata ngritën krye kundër Moisiut dhe kundër Perëndisë. Si pasojë ata duhej të pritnin edhe 38 vjet në shkretëtirë derisa të shfarosej ai brez. Të vetmit e atij brezi që hynë në tokë 38 vjet më vonë, ishin Joshua dhe Kalevi.

Titulli hebraik i librit të Regjistrimeve ose Numrave është *ba-midbar*, i cili do të thotë “në errësirë,” sepse tregim ka të bëjë me udhëtimin e Izraelit nga Sinai deri në kufijtë e Tokës së Premtuar. Megjithatë ka shumë lëndë që trajton tema të tjera.

Libri i Ripërtërimit të besëlidhjes është organizuar si seri fjalimesh nga Moisiu drejtuar popullit izraelas në tokën e Moabit, ku ishin ndaluar pas udhëtimit të gjatë nëpër shkretëtirë dhe kur ishin në prag të hynin në Kanaan. Disa nga pjesat më interesante janë si vijon:

(1) Moisiu mban mend ngjarjet më të mëdha të 40 vitëve të kaluara. Ai i bën thirrje popullit të kujtohen se si Perëndia i ka udhëhequr nëpër shkretëtirë dhe të mbeten të bindur dhe besnik ndaj Perëndisë.

(2) Moisiu rishikon Dhjetë Urdhërimet dhe thekson kuptimin e urdhërimit të parë, duke i bërë thirrje popullit të mbetet besnik ndaj Zotit. Pastaj ai zbulon ligjet që duhen rregulluar jetën e Izraelit në Tokën e Premtuar.

(3) Moisiu mban mend popullin për kuptimin e besëlidhjes së Zotit me të, dhe i bën thirrje të ripërtërit zotimin ndaj detyrimeve të besëlidhjes.

(4) Joshua emërohet udhëheqës vijues të popullit të Zotit. Pas këndimit të këngës që kremton besnikërinë e Zotit dhe pas dheniës së bekimit të të gjitha fiset e Izraelit, Moisiu vdes në Moab, në lindje të lumit Jordan. Tregimin për vdekjen e Moisiut e shkroi Joshua, pasardhësi i tij i frymë-

zuar nga Shpirti i shenjtë.

Tema e madh e librit është se Perëndia shpëtoi dhe bekoi popullin e tij të zgjedhur, të cilin e do: populli i tij duhet ta mbajë mend, ta dojë dhe t'i bindë, kështu që të ketë lulëzim dhe bekim të vazhdueshëm.

Rreshtat kyç në këtë libër përmajnë fjalët që Jezusi quan udhërimin më të madh: "Ta duajë Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemër, me gjithë shpirt dhe me gjithë forcën tënde " (6.4-6).

Në librin e Ripërtëritjes së Besëlidhjes Moisiu e zgjeron ligjin ose kontratën që populli duhet ta miratojë "Atje, në vendin e Moavit, Zoti i dha urdhër Moisiut që, në emër të tij, të lidhë me izraelasit besëlidhje, si **plotësim i besëlidhjes** që kishte lidhur me ata në malin Horev. Këtu vijoje fjalët, me të cilat u lidh besëlidhja. (28,69). Ka paralajmërim të shpeshta për rreziqet lidhur me ngatërime me idhujtari dhe praktika të ndaluara lidhur me idhujtari.

Shumë ngjarje që ndodhën gjatë endjes në shkretëtirë janë të cituara në DhR për shkak të mësimëve që mund të na mësojnë. Në fakt, apostull Pali na tregon se Shpirti i shenjtë shkaktoi shkrimin e DhV, në mënyrë që besimtarët e mëtejshëm të gjenin atje mësimë shpirtërore. Është shkruar që të dallohen parimet shpirtërore.

Mësimi i parë që e hasim është se Perëndia është i pranishëm ndër popullin e tij. Izraelitët duhej ta kuptonin këtë duke shikuar renë e veçantë që i shoqëronte ditën dhe flakën e zjarrtë që i udhëhiqte natën. Prania e Perëndisë shihej, gjithashtu, në arkën e besëlidhjes që ishte e ruajtur në Tendën e bashkimit dhe më vonë në Tempull. Në kohën kur ekzistonte Tempulli, kjo ishte shenja se Perëndia banonte ndër popullin e vet, por kur u shkatërrua Tempulli, kjo tregoi që Perëndia nuk banonte më ndër ta. Në ungjillin sipas Lukës, shkruhet që Jezusi, Mesia, duhet të bëhet «lavdia» e popullit të vet. Në DhV «lavdia» do të thotë «prania e Perëndisë» – dhe kjo shpjegon se Jezusi duhet të bëhet prania e Perëndisë ndër popullin e vet. Në librin e fundit të Biblës lexojmë se në gjithësinë e re që Perëndia do ta krijojë pas shkatërrimit të kësaj bote, *Banesa e Perëndisë do të jetë ndër njerëz. Ai do të banojë ndër ta dhe ata do të jenë populli i tij, dhe Ai, Perëndia me ta (Immanuel), do të jetë Perëndia i tyre.* Edhe tani, Jezusi u ka premtuar besimtarëve që, gjatë mungesës së tij fizike: *Aty ku janë të mbledhur dy apo tre në emrin tim, unë jam ndër ta.* Jezusi quhet Immanuel = Perëndia me ne. Perëndia, e siguron dhe e çliron popullin e vet nga armiqtë e tyre, e mbron nga fuqitë e errëta dhe e shpie në Tokën e Premtuar, gjithësinë e re.

Mësimi i dytë është që Perëndia e disiplinon popullin e tij sipas ne-

vojës; për shkak të pakënaqësisë, të pabesisë dhe të mendjemadhësisë. Kjo disiplinë vjen në formë dënimesh që na ndodhin në këtë botë, si edhe në formë vdekjeje fizike në kushtet e jashtëzakonshme. Sidoqoftë, kjo nuk ka veprim në gjendjen e tyre të përjetshme si populli i Perëndisë. Perëndia është i shenjtë (i ndryshëm nga ne) e nuk mund të lejojë rebelim të madh pa dënim, përndryshe kjo do ta komprometonte karakterin e tij dhe të drejtën e pronësisë së fëmijve të vet. Ai i disiplinon fëmijët e tij për të mirën e tyre, që t'i ngjajnë Atij edhe më shumë, që të mos dënohen së bashku me botën e humbur.

Mësimi i tretë është që Perëndia është zot i historisë. Në ngjarjet pas Daljes së izraelitëve, shohim se si Perëndia i plotëson premtimet e dhëna Avrahamit dhe pasardhësve të tij. Atë që ka ndër mend Perëndia të bëjë, edhe e bën, me gjithë rebelimin e njerëzve dhe me gjithë rrethanat kundërshtare. Perëndia na ka thënë, në Bibël, atë që ka ndër mend të bëjë, edhe do ta bëjë. Populli, me gjithë rebelimin të tij, në fund do ta trashëgojë Tokën e Premtuar.

Mësimi i katërt është që Perëndia është i shenjtë dhe nuk toleron idhuj rivalë. Por, mund të bëjmë bashkësi më të ngushtë me të, me kusht që t'i afrohem me kushtet e tij. Gjithnjë jep mënyrë për t'u falur – kështu, pra, nuk ka kurrë justifikim të mos i afrohem. Për shkak të besnikërisë së tij ndaj popullit të vet, kërkon që edhe ne, nga ana jonë, të jemi besnikë ndaj tij. Duhet ta nderojmë jetën, familjen dhe pasurinë e tjetërkujt. Duhet të kujdesemi për bashkbesimtarin dhe të refuzojmë gjithçka që është në rrezik të minojë besimin e tij.

Kështu, pra, mund të shohim që Perëndia i DhV është i njëjti Perëndi që e gjejmë në DhR – Perëndia i shenjtë, por i mëshirshëm dhe zemërmirë. Ai të pret t'i bashkohesh Atij – me anë të Jezusit – ndërmjetësit dhe Shpëtimtarit tënd.

Qëllimi i zgjedhjes së Izraelit (dëshimim para popujve të tjerë që duhen bekuar për shkak të Izraelit) nuk theksohet në këtë libër. Puna kryesore e Moisiut është parashtrimi para Izraelit rreziqet e prishjes së besimit të tyre, humbjes së të vertetës së besuar, në tokën e tyre të re. Seksoni i fundit i librit cakton bekimet e bindjes, por edhe mallkimit të mosbindjes. Lista e bekimet jep vargun e dhuratave që i jepen popullit të tij, politike, bujqesore dhe luftarake. Përkundrazi, vargu më i gjatë e mallkimeve paralajmëron gjithçka çmon Izraeli: liri, shëndet, prosperitat, humbja e tokës. Rebelimi kundër kushteve të besëlidhjes do të thoshte Zoti shpëtimtar që bëhet Zoti Gjyqtar.

PUSHTIMI I TOKËS SË PREMTUAR

Pas 40 vjetëve të endjes në gadishullin e Sinait, izraelitët më në fund ishin gati për të pushtuar Tokën e Premtuar. Premtimi që Perëndia ua kishte dhënë Avrahamit dhe pasardhësve të tij, ishte në fund në prag të plotësimit. Por në këtë vend banonte një numër popujsh që së bashku quheshin amoras. Megjithëse këta popuj ishin të qytetëruar, ishin edhe moralisht të prishur. Meqë i kishin arritur kulmit të degjenerimit, Perëndia kishte vendosur të ndërhynte për t'i shkatërruar. Kështu u arrit pika, ku u përputhën të dy aspektet e planit të Perëndisë: dënimi i banorëve të tokës dhe dhënia e tokës kombit izraelit, në përputhje me premtimin që Perëndia ia kishte dhënë Avrahamit 600 vjet më parë. Për këtë ndodhi mund të lexojmë në **librin i Joshuas**.

Perëndia nuk e lejoi Moisiun të hynte në tokën e premtuar në krye të popullit – lejoi vetëm ta shihte nga maja e një mali të lartë. Vdiq duke e shikuar Tokën e Premtuar, por jo para se të kishte emëruar pasardhësin e tij: Joshuas, i cili kishte qenë njeriu i tij i besuar për një kohë të gjatë. Kështu, Joshua, atëherë 70 vjeçar, duhej të komandonte ushtrinë pushtuese izraelite. Ishte viti 1406 para erës sonë.

Por më së pari, Joshua duhej të kujtohej se në fakt bënte një luftë të shenjtë. Perëndia e përdorte kombin izraelit për të dënuar banorët e Kënaanit, për shkak të prishjes së tyre. Perëndia i tha Joshuas se sukcesi i fundit në këtë luftë varej nga dy faktorë:

1) Besimi i tij – Perëndia i kishte thënë që do t'ia jepte tokën. Prandaj Joshua duhej të luftonte duke sjellë ndër mend këtë premtim.

2) Bindja e tij ndaj ligjit të dhënë në malin e Sinait. Duhej të mendohej për ligjin e Zotit natë e ditë. Para sulmit izraelit në qytetin e parë, Jeriho, Perëndia iu paraqit si komandant i ushtrive qiellore që luftonin së bashku me të. Duhej të kujtohej që, njëkohësisht me pushtimin, do të kishte luftë në sferën shpirtërore ndërmjet Perëndisë dhe fuqive të këqija që i mbizotëronin banorët e prishur të Kënaanit. Jeriho, qyteti i parë për t'u sulmuar, i kushtohej, si e zbulon emri i tij, perëndeshës së Hënës. Joshuas i kujtohet se në luftë duhet të luftohet sipas rregullave të caktuara nga Perëndia.

Para pushtimit, në anën tjetër të Jordanit, kombi izraelit, nën udhëheqjen e Moisiut, kishte shkuar përpara në veri deri në fundin verior të Detit të Vdekur. Me dy sulme të rrufeshme e kishte thyer rezistencën në bregun lindor të lumit Jordan deri në krahinën e Bashanit (sot Golan, afër liqenit të Galilesë). Por, pushtimi i tokës së Kënaanit ishte tjetër

punë. Perëndia kishte dhënë urdhër të sulmojë në një vend pak në veri të Detit të Vdekur; atje ku lumi Jordan ishte më i gjerë. Por, Joshua duhej të përballonte dy probleme të mëdha. Pranvera sapo kishte shkuar dhe dëbora e malësisë së Hermonit në veri ishte e shkrirë. Lumi Jordan, që duhej ta kalonte, ishte përmbytur. Qytetet në bregun tjetër ishin të fortifikuara dhe banorët mirë të armatosur. Në fakt toka e Kënaanit ishte nën kontrollin e Egjiptit (që e kishte bashkangjitur më 1550) me anë të një rrjete shtetësh vasale. Për fat të mirë, midis v. 1410 dhe 1374, faraoni i asaj kohe, Amenopisi III, e kapërthente vemendjen me Mitanin (shtet që ndodhej në veri të Palestinës) dhe si pasoje lëri pas dore tokën e Kënaanit. Është me rëndësi që ajo gjendje mbretëronte pikërisht në kohën e pushtimit izraelit. Joshua në këtë kohë ishte vendosur në fushim në rrafshinën e akacieve (hebraisht Shitim). Para tij shtrihej lumi Jordan, të cilin duhej ta kalonte, dhe në bregun tjetër ndodhej edhe një rrafshinë e zotëruar nga një qytet i madh i fortifikuar që quhej Jeriho. Duhej ta pushtonte këtë qytet për të krijuar një kryeurë në bregun tjetër për veprime të mëtejshme ushtarake. Joshua dërgoi dy zbulues, të cilët morën vesh që ushtria kundërshtarë ishte demoralizuar, sepse e kishte kuptuar që Perëndia ishte me popullin izraelit dhe që së shpejti ata do të dënoheshin për jetesën e tyre të prishur.

Perëndia bëri një mrekulli duke shkaktuar ndaljen e rrjedhës së lumit Jordan për një kohë të mjaftueshme kështu që ushtria izraelite mund të kalonte në terik. Perëndia e bëri këtë duke shkaktuar vithisjen e shkëmbinjve me anë të një tërmeti për ta bllokuar lumin në veri, në një vend të quajtur Adam. Pastaj, izraelitët shkuan përpara dhe ngritën kampin e tyre në bregun tjetër. Ditën tjetër u nisën dhe rrethuan Jerihon. Perëndia kishte premtuar të bënte edhe një mrekulli. Për shtatë ditë, ushtria izraelite shkante një herë rreth qytetit të dënuar në një procesion solemn dhe ditën e shtatë, shkoi shtatë herë rreth qytetit dhe papritur, sipas premtimit të Perëndisë, muret u rrënuan edhe për shkak të një tërmeti që do të ketë rënë pikërisht në kohën e duhur. Ata e pushtuan qytetin, vranë të gjithë banorët e tij dhe e dogjën me të gjitha pasuritë. Qyteti i Jerihos, ishte, si të thuash, fryti i parë i fushatës dhe kështu duhej t'i kushtohej Perëndisë plotësisht: qyteti u bë flijim i djegur për nder të Zotit. Të vetmit individë që shpëtuan ishin Rahava dhe familja e saj, sepse ajo i kishte pritur mirë zbuluesit izraelitë: ishte besimtare në Perëndinë e Izraelit.

Pas marrjes së objektivit të parë, kryeura në rrafshinën e Jerihos, Joshua shkoi më në thellësi të vendit, në malësi, në mënyrë që të pushtojë

edhe pikën e dytë strategjike, qytetin e Ait, rreth 20 kilometra në veri të Jerusalemit. Pushtimi i Ait ishte shumë i rendësishëm, sepse i dha mundësinë Joshuas të vërë nën kontroll vargmalin e Palestinës qëndrore. Pas marrjes së kësaj pike strategjike, Joshua ndërmori edhe një varg sulmesh të rrufeshme në mes, në jug dhe në veri të vendit. Në këtë mënyrë shpartalloi gjithë rezistencën dhe e mposhti tërë vendin brenda pesë vitesh.

Taktika e tij në këto fushata ishte lufta rrufe: një varg goditjesh të rrufeshme, duke kaluar përreth qendrave të fortifikuara dhe kështu duke iu shmangur rrethimeve të gjata. Joshua gjithnjë i joshte ushtritë e tyre përjashta, nga qytetet, para se të luftonte kundër tyre. Kështu i shpartalloi rezistencën dhe mposhti tërë vendin. Shumë qytete të fortifikuara nuk i sulmoi, kryesisht ato që ishin të lidhura me Egjiptin. Brezit të ri izraelit në kohën e gjyqtarëve (Çlirimtarë të veçantë) i duhej t'i spastronte mbeturinat e armikut. Mjerisht u duhej shumë kohë për ta realizuar këtë, sepse shpesh binin në idhujtari – d.m.th. komprometoheshin me armikun dhe kështu nuk i plotësuan kushtet hyjnore për fitore.

Cila është dëshmia historike për këtë periudhë? Së pari, siç e kemi mësuar, në këtë kohë Egjiptit i tërhiqnin vëmendjen gjera të tjera dhe nuk ishte në gjendje të ndihmonte mbretërit vasalë të tij dhe qytetet e tyre. Së dyti, kemi një provë të caktuar për pushtimin izraelit të asaj kohe, nga letërkëmbimi i Amarnës (i shkruar në derrasa prej deltime të zbuluara në Egjipt). Këto tabela përmbajnë letërkëmbimin e mbretërve të Kënaanit (d.m.th. të Palestinës) me faraonët e Egjiptit. Në këto letra luten shumë për ndihmë (posaçërisht për harkëtarët), sepse po i sulmonte një popull me emrin *hapiru* (d.m.th. hebrenjtë). Qytetet e përmendura në këtë korrespondencë janë pikërisht ato qytete, të cilat Joshua i pushtoi vetëm më vonë. Joshua, në njerën nga këto letra, është përmendur edhe me emër. Në një letër tjetër marrim vesh se një nga mbretërit vasalë që mbretëronte në qytetin e Shehemit u bë tradhtar dhe tokën e tij e vuri në dispozicion të hebrenjve. Është kuptimplotë që ceremonia e ripërtëritjes së besëlidhjes në fund të librit të Joshuas ndodhi pikërisht në këtë krahinë, afër Shehemit, midis dy kodrave të Evalit dhe Gerizimit. Atje ende qëndron edhe përmendorja e ngritur nga Joshua.

Dëshmia për prishjen morale të banorëve të tokës që i sulmoi Joshua, u gjet në tabelat e Ugaritit (një qytet në veri të Bejrutit të sotëm). Në këto tabela përshkruhen aspektet e qytetërisë së Kënaanit të asaj kohe. Janë tri gjera që dallohen: imoraliteti ekstrem me çdo lloj prishjeje, brutaliteti dhe sadizmi, idhujtaria e lidhur me flijime fëmijësh dhe me prostitucion të shenjtë, dhe kështu adhurimi i djajve.

Dëshmia për shkatërrimin e Jerihos nuk mungon. Arkeologu i njohur, Kathleen Kenyon, kreu disa gërmime në vitet 1950-60. Ajo zbuloi dëshmitë që vijojnë:

1. Muret ishin shembur befás.
2. Shinikë drithi u gjetën brenda muresh, e kjo është në përputje me pohimin që qyteti u pushtua befás. Po dorëzohej qyteti pas një rrethimi të gjatë, drithi do të ishte harxhuar.
3. Kantieri ishte mbuluar nga një shtresë të trashë shkumbi, e cila (sipas datimit të karbonit 14) u shtrua rreth 1400 para erës sonë.
4. Hajmalitë egjiptiane të gjetura në varret e Jerihos datohen rreth 1400 para erës sonë.
5. Megjithatë, arkeologu Kenyon erdhi gabimisht në përfundimin që mungesa e një lloji poçerie të veçantë dhe të njohur në këtë kohë, dëshmonte një datim prej 1550 (150 vjet para datimit të supozuar të pushtimit të qytetit). Por ajo bëri gërmime vetëm në lagjet e varfër të qytetit ku do të mungonte ky lloj poçerie të importuar të shtrenjtë. Përveç kësaj, poçeria tjetër e gërmuar në vitet 1930 ishte e njohur rreth 1400 para erës sonë.

Kohët e fundit arkeologët kanë zbuluar germadhat e qytetit të Ait. (Khirbet el-Maqatir). Kjo vendndodhje është zbuluar kohët e fundit dhe gjurmët e një zjarri të madh të datës 1405 janë gjetur vetëm mbi themelin shkëmbor. Një luginë e thellë e afërt është ndoshta aty ku zbuluesit u fshehën në pritë, e cila është 5 minuta larg. Qytetet e vetme që u dogjën në fushatën e Jozueut ishin Jeriko, Hacor dhe Ai. Në të gjitha rastet e tjera banorët u ngritën për të luftuar jashtë qytetit të tyre dhe u mundën në betejë të hapur. Prej dy bubuzhelëve të gjetur, i pari datohet në mbretërimin e Amenhotepit II (1455-1418) dhe i dyti datohet në 1485 në mbretërimin e Thutmoses III, por asgjë më vonë. Kjo do të thotë se Jeriko duhet të jetë pushtuar në të njëjtën kohë.

Perëndia i vërtetë, Perëndia i izraelitëve, sundimtari moral i botës, nuk mund t'i duronte këto gjëra të këqia. Duhej të ndërhynte menjëherë për të përfunduar gjithçka.

Po, të gjitha këto ngjarje ndodhën, pikërisht siç është shkruar në Bibël. Kjo do të thotë se duhet t'i marrim seriozisht edhe gjërat e tjera që janë shkruar atje. Ka Perëndi. Me të vërtetë i shpëton ata që besojnë në Jezusin, në atë që është më i madh se Joshua. Ai na jep tani trashëgimin tonë, por duhet të luftojmë njëkohësisht për këtë, që të qëndrojmë të patundur në besim. Ai do t'i udhëheqë nxënësit e vet në tokën qiellore të premtuar, Jerusalemin e ri, ku do ta shohim Perëndinë ballë për ballë dhe ku do të gëzohemi në prani të tij përgjithmonë.

JOSHUA

Emri «Joshua» ose «Jëhoshua» (forma më e gjatë) do të thotë «Perëndia është shpëtim» (d.m.th. Perëndia shpëton ose Perëndia është Shpëtimtar). Po ky emër i përkthyer në gjuhën aramaiste është «Jeshua» kurse në gjuhën greqishte «Jezusi». Joshua ishte njeriu që Perëndia e nxori nga gjiri i popullit pas Moisiut për të udhëhequr popullin izraelit. Detyra e tij kryesore ishte pushtimi i tokës së premtuar, Palestinës, për t'ia dhënë popullit izraelit. Duhej ta sulmonte vendin sepse ishte i pushtuar nga popuj të tjerë të prishur.

Joshua ishte jashtëzakonisht i kualifikuar për të qenë pasardhës i Moisiut. Para së gjithash ishte besimtar, d.m.th. njeri që i zinte besë fjalës së Perëndisë dhe e zbatonte. Në fakt ky ishte njëri nga tre pjesëtarët, të cilët i shpëtuan gjallë shkatërrimit të mëparshëm të brezit të pabesë. Merrte seriozisht shenjtërinë e Perëndisë si dhe premtimet e tij.

Joshuas nuk i mungonte përvoja. Moisiu tashmë e kishte aftësuar për detyrën e tij. Së bashku me Moisiun, kishin fituar përvojë në zbatimin e urdhrave të Perëndisë si dhe mënyrat vepruese të tij. Kishte qenë i pranishëm kur Moisiu fliste me Perëndinë ballë për ballë. Kishte qenë dëshmitar për fitoret që Perëndia ia kishte dhënë popullit të tij në betejë.

Joshua ishte, gjithashtu, kryekomandant i aftë, i cili për një kohë të gjatë (ishte 70 vjeçar kur u emërua gjeneral) kishte fituar njohjen e mirë të taktikës. Kishte mësuar se me anë të dinakërisë dhe të shpejtësisë ka mundësi ta mundë armikun më të fortë. Kishte mësuar se duhej disiplina e rreptë për të udhëhequr një ushtri të tillë fitimtare. Duhej të ndiqte udhëzime të caktuara për të siguruar ndërhyrjen e Perëndisë dhe kështu, fitoren.

Mirëpo, gjithçka nuk shkoi pikërisht sipas planit, dukuri që mund t'i ndodhë çdo gjenerali. Pas fitores në Jeriho, duhej të përballonte një rast të mosbindjes. Sulmi i parë kundër qytetit Ai, objektivit të dytë të vendosur në veri të Jerusalemit, dështoi sepse një nga ushtarakët së bashku me familjen e tij nuk iu ishte bindur urdhrit të rreptë të Perëndisë. U bënë hetime gjyqësore për të zbuluar identitetin e fajtorit. Ishte Ahani. Izraelitët e ekzekutuan atë së bashku me familjen e tij si bashkëfajtorë duke i mbytur me gurë në vend. Joshua duhej të përballonte një qytetërim me nivel të lartë dhe të prishur që duhej të shkatërrohej plotësisht, përndryshe do të molepste brezat e mëtejshme izraelite dhe do të minonte besimin e tyre në Perëndinë. Duhej disiplina e rreptë në sferën shpirtërore, sepse fitorja varej nga Perëndia.

Në rastin tjetër, Joshua u mashtrua nga një dinakëri. Joshua u betua me betim të paarsyeshëm që të mbronte një grup njerëzish që shtireshin si të arratisur nga një vend i largët. Në të vërtetë, dolën si dezertorë nga ana e armikut, të cilët ishin shumë frikacakë për të luftuar. Që atëherë Joshua duhej ta mbante këtë barrë. Por përse? Kryesisht sepse disa herë Joshua ishte i pakujdesshëm; nuk e kërkonte gjithnjë siç duhej këshillën e Perëndisë. Ashtu ndodh me besimtarët edhe sot; ata shpesh bëjnë gabime të mëdha, në qoftë se nuk këshillohen më përpara me Perëndinë.

Në kohën e fushatës ushtarake, Joshua kishte të drejtën të ishte dëshmitar i mrekullive të shquara. Së pari, ishte mrekullia e kalimit të Jordanit në terik pas bllokimit të ujërave me anë të një tërmeti. Së dyti ishte zaptimi i qytetit të fortifikuar të Jerihos pa veprime luftarake. Në të dy rastet ka të ngjarë që Perëndia përdori një tërmet në kohën e duhur dhe në vendin e duhur për të realizuar mrekullinë. Gjithashtu, lexojmë për mrekullinë e natës së zgjatur me anë të errësirës së një shtrëngate me breshër të pa fund, pikërisht në mes të stinës së thatë. Kjo i dha Joshuas mundësi për ta mundur plotësisht armikun.

Koha erdhi kur Joshua e kishte mundur plotësisht armikun dhe kur i tërë vendi ishte nën kontrollin e tij, megjithëse mbeteshin strofkat e rezistencës që duheshin të spastroheshin më vonë. Atëherë, toka u nda ndërmjet dy mbëdhjetë fiseve izraelite, sepse ishte trashëgim i tyre – Perëndia ia kishte dhënë tokën!

Kufijtë e territorit të caktuar, të secilit fis përshkruhen me hollësi të madhe. Territori që Perëndia u kishte dhënë u ishte shumë i çmuar. Ata s'donin t'ia shitnin askujt, sepse ishte trashëgim i tyre dhe i tillë duhet të jetë përgjithmonë. Gjatë disa periudhave ky territor, ky trashëgim u ishte hequr për shkak të mërgimit – pasoja e pabesnikërisë dhe mosbindjes së tyre, por megjithatë toka ende u takon atyre ligjërisht. Në shtetin e sotëm Izraelit kjo u bë një çështje shumë e kundërshtuar nga ana e arabëve, e kjo tregon se Biblia nuk e humbi aktualitetin e saj.

Në fund të fushatës së suksesshme, Joshua dërgoi për të thirrur tërë kombin izraelit që të gjitha fiset të vijnë në Shehem. Afër Shehemit (Nabulusit të sotëm), midis malit Eval dhe malit Gerizim, kombi mori pjesë në ceremoninë e ripërsëritjes së besëlidhjes. Ligjin ose kartën shtetërore e lexuan me zë të lartë dhe kombi ia dha Perëndisë përsëri betimin e besnikërisë. U ngrit përmendore për ta përkujtuar ngjarjen. Kjo përmendore qëndron edhe sot.

Më vonë, Joshua u largua për të banuar në tokën e tij në Timnat-Sera që andej mund të shihej rrafshina e Sharonit si edhe deti Mesdhe. Më

rastin e largimit të tij nga puna, mbajti një fjalim të ndarjes, në të cilin e nxiti kombin të mbetej besnik ndaj Zotit. Ky fjalim është i regjistruar në fund të librit të Joshuas, të cilin ai vetë e shkroi.

Joshua veçohet me përdorimin e shpejtësisë, befasisë dhe dredhisë. Ai me urtësi shmang beteja fushore në rrafshina ku ishte në pozitë të papëlqeshme për shkak të përdorimit të koçive të luftës nga ana e armikut.

Qytetet-shtetet që pushtoi Joshua kishin qenë nën sundimin egjiptian, por Egjipti, për shkak të disfatës pranë Detit të Kuq, ishte tepër i dobët për të ndërhyrë, megjitha thirrjet për ndihmë nga këto qytete, siç regjistrohet në letrat e Amarnës.

Librin e Joshuas e shkroi Joshua, por prifti Elazar e redaktoi duke shtyrë tregimin për vdekjen e Joshuas. Këtë tregim e editoi pastaj edhe Samueli, i cili citoi nga libri i Jasharit.

Cilat janë mësimet shpirtërore që mund të mësojmë nga jeta e Joshuas? Joshua nuk ishte pa të meta – bëri disa gabime, por në përgjithësi mund të vërehet se ishte një njeri besnik, që i besonte fjalës së Perëndisë. E merrte fjalën e Perëndisë seriozisht, u besonte premtimeve të tij dhe i zbatonte ashtu siç kërkohesh.

Ai ishte, gjithashtu, një njeri që vuri dhuntitë e tij në dispozicion të Zotit e të cilat Zoti i përdorte. Në fillim të librit të Joshuas lexojmë për premtimin që ia dha Perëndia, i cili, me anë të bindjes së tij, u bë realitet.

Dita më e gjatë: Gjuhësia e tregimit të Joshuas 10,11-14 lë të kuptojë se ndodhi një çudi e madhe. Kjo vërtetohet nga tregime të ngjashme në regjistrimet/legjendat e racave të tjera. Siç duket, rrotullimi i planetit tonë u ngadallësua deri në gjysmën e shpejtësisë së zakonshme. Kjo nuk ka ndikur në shpejtësinë e lëvizjes së planetëve të tjera rreth diellit.

GJYQTARËT DHE ÇLIRIMTARËT

Libri i Gjyqtarëve (ose Çlirimtarëve) ka të bëjë me periudhën e historisë izraelite nga vdekja e Joshuas deri në ardhjen e **Samuelit** 340 vjet më vonë. Në këtë periudhë kishte pak centralizim – çdo fis ishte pothuajse i pavarur. Kishte një faltore kombëtare qendrore në Shilo ku ishte mbajtur arka e besëlidhjes. Atje takoheshin kryetarët e fiseve në kohën e festave, jo vetëm për të adhuruar Perëndinë, por edhe për të bërë këmbim mendimesh për problemet e përbashkëta, për të shuar grindjet politike dhe për të pranuar bashkëveprimin në çështjet e interesave të dyanshme. Përveç kësaj, fiset nuk takoheshin. Ishte një konfederatë e lirë fisnore. Megjithatë, situata ndryshonte kur kërcenohej

ndonjë armik i jashtëm. Atëherë fiset duhej të bashkoheshin nën një udhëheqës ose gjyqtar të emëruar veçanërisht për ta shpërrur këtë gjendje kritike. Armiqtë paraqiteshin zakonisht kur Izraeli dilte i pabesë ndaj Perëndisë dhe binte në idhujtari me pjesën e banorëve të vendit që mbetej. Prandaj, gjyqtari ishte në të vërtetë diktator ose kryetar kombëtar, por jo mbret. Ndryshe nga mbreti, nuk i takonte ndonjë dinastie – u zgjodh drejtpërsëdrejt nga Perëndia. Quhej gjyqtar, sepse një nga detyrat e tij ishte qarkullimi fis më fis për të shuar grindje. Këta dymbëdhjetë gjyqtarë përmendohen në librin e gjyqtarëve, prej të cilëve gjashtë janë vetëm të përmendur me nxitim dhe gjashtë luajnë një rol shumë me rëndësi në historinë izraelite të asaj kohe.

Libri i Gjyqtarëve na tregon se ç'ndodhi pas vdekjes së Joshuas dhe kështu përgatit atë që vijon. *Gjatë jetës së Joshuas, populli izraelit i shërbente Zotit, pas vdekjes së tij vazhdon të shërbente Zotit në kohën e jetës së atyre kryetarëve që vetë kishin parë gjërat e mëdha që Perëndia i kishte bërë për Izraelin.* Ai brez vdiq e brezi që erdhi pas e harroi Zotin dhe atë që Zoti kishte bërë për Izraelin. Atëherë populli izraelit mëkatoi kundër Zotit dhe ra në idhujtari të popujve që e rrethonin. Perëndia lejoi që të sulmohet nga armiqtë. Izraelitët s'ishin në gjendje t'u bënin ballë, dhe kështu iu lutën Perëndisë për ndihmë. Perëndia nxori nga gjiri i popullit një udhëheqës plot fuqi hyjnore që e bashkoi popullin, e udhëhoqi në fitore kundër armikut dhe i dha përsëri paqen. Por, me kalimin e kohës, populli u zhyt në vetëkënaqësi dhe përsëri ra në idhujtari, u përsëriti i njëjti rreth vicioz. Kështu, pra, libri i Gjyqtarëve është një raport i pabesisë së përsëritur të izraelitëve, por megjithatë, tregimi për mëshirën e qëndrueshme të Perëndisë si dhe për çlirimin që ia jepte popullit nga armiqtë e tij kurdo që ishin futur në qorrsoak dhe i drejtoheshin Perëndisë me lutje të dëshpëruara.

Siç është shkruar në librin e Joshuas, Joshua mundte armatat që i dilnin përpara, por kishte shumë qytete të fortifikuara që nuk i pushtoi. Vetëm vendosi territorin e tyre nën kontrollin e tij. Pas kalimit të një brezi, armiku organizoi armata të reja që e sulmoi fisin izraelit që gjendej në territorin e tyre. Duke folur në përgjithësi, izraelitët mbanin nën kontrollin e tyre malësinë, e jo rrafshinën, sepse armiku kishte një armë që u mungonte izraelitëve – koçi luftime (ekuivalenti i tankut të sotëm). Përveç armiqve të brendshëm që Perëndia i nxori për ta dënuar Izraelin dhe për të vënë në provë besnikërinë e tij, herë pas here vinin sulmuesit nga vendet jashtë kufijve izraelitë. Sfondi historik është plotësisht në përputhje me raportet e librit të Gjyqtarëve, si do të shohim.

Para se të diskutojmë me hollësi për periudha të ndryshme të shtypjes dhe çlirimeve të mëtejshme nga çlirimtarët e zgjedhur të Perëndisë, duhen marrë parasysh ato që vijnë. Disa nga peritdhat sinkronizoheshin pjesërisht. Me fjalë të tjera, disa herë gjyqtarët ose çlirimtarët vepronin njëkohësisht por në territore të ndryshme dhe në mes fiseve të ndryshme. Shkruhet, gjithashtu, që pas çdo çlirimi, Perëndia jepte një periudhë paqeje ose pushimi. Ka dëshmi historike që ndoshta tregojnë se këto periudha paqeje përputhen me shtimin e kontrollit egjiptian të shteteve të tyre vasale në Palestinë, të cilat kurrë nuk i kishin lënë egjiptianët. Kjo me radhë ishte mjet frikësimi për ata që donin të ngritnin krye përjashta ose përbrenda.

Duhet marrë, gjithashtu, parasysh natyra e idhujtarisë, në të cilën po binin izraelitët. I përvetësuan zakonet e kënanasve, sepse martoheshin me ta. Në fenë e tyre pagane, gjithçka centralizohej rreth kultit të pjellorisë. Besonin se vetë perënditë ishin lindur nga marrëdhëniet seksuale ndërmjet fuqive primitive të kozmosit, dhe që të gjitha qeniet (njerëzit dhe perënditë) kishin një prejardhje të përbashkët. Sipas besimit të tyre të kotë, krijimi ishte pasoja e marrëdhënieve seksuale ndërmjet perëndive siç ishte edhe pjelloria e tokës. Kështu, pra, çdo vit çdo bujk madje edhe mbreti kishin marrëdhënie seksuale me prostituta «të shenjta» që t'i nxitonin perënditë t'i imitonin për t'u dhënë pjellori fushave dhe kështu prodhime të mira. Këto rite u bëheshin në majat e kodrave pyjore ku ngritën shtylla druri për të simbolizuar hyjneshën, me emrin Ashera, dhe ngritën gurë pingul për të simbolizuar hyjninë mashkull me emrin Baal. Në qoftë se nuk erdhi pjellori, p.sh. për shkak të thatësisë, kjo do të thoshte se perënditë ishin të inatosur dhe duhej të zbuteshin me anë të një flie njerëzore; fëmijët u dogjën të gjallë në zjarr kushtuar perëndisë Moloh. Fëmijët sakrikoheshin gjithashtu në kohën e krizës. Gjatë një rrethimi të Kartagës historianët shkruan që disa 200 fëmijë u flijuan. Arkeologët kanë zbuluar një varrezë për fëmijë me mbeturinat të djegur. U zbuluan edhe 20.000 urna me mbeturinat e fëmijëve të djegur me dy vjet e më poshtë.

Çdo tokë kishte pronarin e saj shpirtëror ose «baal». Mbi çdo territor mbretëronte një «baal». Për këtë, pra, gjejmë emrat si Baal-Peor, Baal-Bërit, Baal-Bek e tj. Ky besim i kotë karakterizohej nga mizoria e tmerrshme dhe imoraliteti i madh. Gjithçka ishte e themeluar në një formë primitive të teorisë së evolucionit. E prishte dhe e poshtëronte njeriun dhe ishte në kundërshtim të plotë me besimin izraelit.

Gjyqtari i parë, për të cilin mësojmë quhet **Otnieli** (1375-1336 para

erës sonë), të cilin Perëndia e paraqiti për të çliruar izraelitët nga shtypja e Kushan-Rishataimit. Kjo ishte, siç duket, mundësisht pasoja e ekspansionizmit hitas në veri të Izraelit, në kohën kur pushteti egjiptian i faraonit Amenofis IV dhe faraonit Tutankamon ishte i dobësuar. Pas Otnielit, pushteti egjiptian shtohet përsëri në Palestinë dhe vijon edhe një periudhë paqeje.

Çlirimtari tjetër që Perëndia e paraqiti ishte **Ehudi** (1319-1240) për të shpëtuar Izraelin nga shtypja e moavasve. Njëkohësisht, në një krahinë tjetër të Izraelit, Perëndia nxori nga gjiri i popullit edhe një çlirimtar, me emrin Shamgar, për të shpëtuar Izraelin nga shtypja e filistenjve. Kontrolli egjiptian mbi Palestinë u përforcua përsëri nën sundimin e faraonit Seti (1304-1290) dhe faraonit Ramses I (1290-1224). Pastaj pushteti egjiptian u dobësua përsëri dhe kënanasit mbizotëronin në Palestinë dhe e shtypnin popullin izraelit. Perëndia nxori edhe një çlirimtar, kësaj here një grua me emrin Dëvora (1240-1201) e cila, së bashku me gjeneralin e saj, Barak, mundi Siserën, gjeneralin kenanas. Kontrolli egjiptian u kthye në kohën e faraonit Meneptah (1224-1204) nga i cili është trashëguar një gur ku është shkruar një raport për fushatën fitimtare kundër rebelëve në Palestinë. Pushteti egjiptian u dobësua përsëri dhe Perëndia nxori edhe një çlirimtar me emrin **Gidon** (1194-1155) për t'i shpëtuar izraelitët nga midanasit. Ata futnin nga shkretëtira në Palestinë mbi deve të shpejta për të plaçkitur tokën e Izraelit. Që atëherë, përveç edhe një periudhe tjetër shtypjeje nën amonastit (kundër të cilëve Perëndia nxori nga gjiri i popullit një çlirimtar me emrin **Jiftah**), me kalimin e kohës, armik kryesor bëhen gjithnjë e më shumë filistenjtë që shtypnin popullin izraelit. Për këtë, Perëndia nxori nga gjiri i popullit një sërë çlirimtarësh krahinorë, veprat heroike të të cilëve u ndërpriten shumë herë, përta i përket kronologjisë. Më i njohuri nga të gjithë këta është një njeri me emrin **Shimshon** (gr. Samson) (1071-1051). Ai kishte një jetë me shumë gjallëri. Megjithëse klasifikohet si gjyqtar, i ngjan më tepër një njësie sulmuese nga një njeri, i cili shkaktoi viktimat më të mëdha në rradhët e armikut. Mjerisht kishte një dobësi: dashuronte femrën e armikut, e kjo në fund e rrënoi. Ballafaqimet dhe përleshjet me filistenjtë në fund u zgjeruan në një varg luftërash të mëdha. Kjo ndodhi në kohën e profetit dhe gjyqtarit **Samuel** (hebr. Shëmuël) dhe të mbretit të parë izraelit të quajtur Shaul (gr. Saul), duke filluar nga viti 1040.

Shumë nga këta çlirimtarë janë përmendur ndër heronjtë e besimit të Dhiatës së Vjetër në letrën drejtuar hebrenjve, në kapitullin e njëmbëdhjetë, ku shkruan si vijon; *Meqenëse i besuan fjalës së Zotit, luftuan kundër*

kombeve dhe i mundën. Administrimi i tyre (si gjyqtarë) ishte i drejtë, dhe panë se si Perëndia i plotësoi premtimet e tij...Ishin të dobët, por u përforcuan; ishin të fuqishëm në betejë dhe mundën tërë ushtritë e huaja... E gjithë kjo ndodhi për shkak të besnikërisë së tyre ndaj Perëndisë.

Edhe **Libri i Rutës** i përket periudhës së Gjyqtarëve, por ndryshe nga ata, na paraqit një atmosferë tjetër, jo të apostasisë, por ambienti ku shihet qart dora e Zotit. Libri shërben si urë lidhëse për të paraqitur monarkinë, dhe posaçerisht dinastinë e Davidit, mbretit të Judës, (dhe kështu, dinastinë e Mesisë) si plotësim i profecive të Zanafillës (49,10). Dallimi i Bet-Lehemit në kapitujt e fundit të librit të Gjyqtarëve dhe në librin e Rutës sqarohet nga fakti se atje lindi më vonë Davidi dhe atje Davidi u shugurua mbret. Boazi del si pasardhës i drejtpërdrejt i Percit, birit të Judës dhe Tamarës. Në të vërtetë ka paralel të qartë ndërmjet Tamarës dhe Rutës: të dy gratë bëjnë gjithçka për të siguruar për vete pasardhës të drejtë.

Gjenealogjia e 10 brezave nga Pereci deri në David lë jashtë disa breza, ashtu si tregon 1 Kronikat 2, por ajo formon një përfundim të përshtatshëm për mbarë librin. Ndërsa fjalët hyrese treguan për zinë e bokës, shpërnguljen dhe vdekjen, përfundimi i librit jep shpresë për të ardhmen. Lista e emrave që përfshin periudhën deri në David, e përkujton lexuesin se ajo që i ndodhi Naomit dhe Rutës bente pjesë me zhvillimin e veprës shpëtuese të Zotit nëpër shekujt. Jeta kishte kuptim sepse Zoti, i cili i kishte bërë premtime të qarta Avrahamit, ishte veprues në çdo brez, duke shfaqur karakterin e tij, duke mbajtur premtimet e tij dhe duke arritur qëllimet e tij. Ky ishte faktori i padukshëm që krijonte një perspektivë historike në Izrael, e cila ishte unike në botën e lashtë. Megjithatë historia e Izraelit nuk ka të bëjë vetëm me njerëz të shquar në Izrael: Ruta, Naomi dhe Boazi ilustron që madhësia e vërtetë pasqyron karakterin e Perëndisë vepruese, dashuria e vazhdueshme e të cilit lind një dashuri përgjigjëse tek ata që besojnë në Të.

Libri ilustron disa koncepte hebraike të ndryshme:

- 1) Hesed (besnikëria e Boazit ndaj besëlidhjes)
- 2) Ligji i leviratit – detyrim sipas të cilit një farefis duhet të martohet me vejushën e një farefisi tjetër i cili ishte pa bir, për të lindur edhe një bir tjetër, kështu që të ruhej intakt gjenealogjia e familjes. (Lp 25,5-10)
- 3) Shpengimi i tokës: pronarësia e tokës së të parëve duhej të ruhej brenda familjes (Lev 25,25 ff).

Gjatë festës së Rëshajës lexohej nga libri i Rutës, e cila ishte joçifute, por e adoptuar në kombin e Izraelit, dhe kështu ky libër parashikon përfshirjen e joçifutëve në tepricës besimtare të Izraelit.

MONARKIA

Pas librit të Gjyqtarëve vijnë **librat e Samuelit**, libri i parë dhe libri i dytë, në të cilët përshkruhet lindja e monarkisë në Izrael. Libri i Gjyqtarëve ka të bëjë me periudhën midis Pushtimit dhe fillimit të monarkisë në Izrael (d.m.th. 1375-1030). Librat e Samuelit trajtojnë periudhën më të shkurtër prej 1040 deri në 970 kur u themelua monarkia në Izrael. Kryefigura në fund të kësaj periudhe të Gjyqtarëve ishte Samueli. Ai ishte më i madhi nga profetët e mëparshëm që nga koha e Moisiut, por edhe gjyqtari më i madh dhe i fundit. Në këtë kohë populli izraelit përballonte rrëzikun më të madh që nga koha e Joshuas. Me tërheqjen e kontrollit egjiptian nga Palestina, varej se nga cili do të fitonte hegjemoninë politike mbi Tokën e Premtuar; filistenjtë ose fiset izraelite.

Filistenjtë (os pëlishtasit, të cilët i kishin vënë emrin e tyre tokës së Palestinës) në fillim i takonin qytetërimin grek të centralizuar në Kretë. Kur ky qytetërim u shkatërrua më 1470 nga një përplasje vullkanike shumë e madhe, shumica e banorëve u shpërngul në jug, së pari në Egjipt ku u zbrapsën, dhe pastaj në bregdetin e Palestinës. Atje u ngulën dhe themeluan një qytetërim që përbëhej nga pesë shtete qytetërore me emrat: Ashdod, Ashkelon, Gaza, Gat dhe Ekron. Shumë kohë më parë filistenjtë kishin pasur marrëdhënie tregtare me Palestinën gjatë viteve 1900-1700. Për këtë lexojmë në librin e Zanafillës. Por tani ishin në rrezik ta shkatërronin popullin izraelit në luftën e tyre për hegjemoni. Ishte pikërisht rreziku i filistenjve që e shtyri profetin Samuel të emërohet udhëheqës, veçanërisht pasi Izraeli kishte humbur fazën e parë të luftës si edhe arkën e besëlidhjes, të cilën e kishin kapur filistenjtë. Ata tani i pushtonin pjesët e mëdha të territorit izraelit. Atëherë Samueli po plakej dhe populli kërkonte një mbret për ta bashkuar dhe për ta udhëhequr në betejë, në këtë ngushticë. Perëndia ishte kundër kësaj dëshire të popullit të kishte një dinasti, ku biri automatikisht do të trashëgonte fronin e të atit: Ai dëshironte që çdo mbret të ishte pasoja e zgjedhjes së vet vetjake. Mjerisht, populli ngulte këmbë të kishte një mbret sipas modelit të kombeve pagane. Njeriun që e zgjodhën quhej **Shaul** (Saul). Ai kishte dalë si gjeneral i shkëlqyeshëm në një rast të mëparshëm. Sidoqoftë, nën sundimin e Shaulit, profeti Samuel mbetej udhëheqës fetar. Mjerisht

Shauli nuk kishte sukses, sepse megjithëse ishte gjeneral i mirë, nuk ishte i ndjeshëm ndaj vullnetit të Perëndisë. E siç kemi vërejtur në rastin e Moisiut dhe të Joshuas, ky kualifikim fetar ishte pikërisht i domosdoshëm për sukses në një komb drejtpërdrejt nën sundimin e Perëndisë (ishte shtet teokratik). Pikërisht ky kualifikim i mungonte Shaulit dhe kështu dështoi. Kurrë plotësisht nuk arriti ta përforconte pozitën ose dinastinë e tij. Ishte e qartë para vdekjes së tij, që pasardhësi i tij do të ishte Davidi. Dështimi i Shaulit në sferën shpirtërore nxiti në vete xhelozi të tmerrshme për Davidin. Kundër Davidit Shauli ndërmori një luftë partizane, në të cilën Davidi ishte partizan, gjatë viteve të fundit të mbretërisë së tij. Në fund Shauli ra në një betejë vendimtare kundër filistenjve.

Shauli është shembull i njeriut, të cilit iu dha një dhunti shpirtërore (atë të mbretit), por tek i cili kurrë nuk u tregua cilësitë e rilindjes. Kurrë nuk e quan «njeri sipas zemrës së Zotit» (d.m.th. njeri i rilindur) siç ishte Davidi. Në DhV elementi karizmatik (d.m.th. me dhunti shpirtërore) nuk përputhej gjithnjë me elementin e rilindur. Zgjedhja hyjnore e Shaulit ishte, siç duket, e motivuar nga dëshira e Zotit të bënte që Izraeli t'i pësonte pasojat e vendimit të tyre mëkatar kundër Tij, por zgjedhja e Tij përfundimtare ishte Davidi, të cilit, ndryshe nga Shauli, Ai i bëri premtimet që nuk mund të anuloheshin. Dobësia kryesore e Shaulit (e cila shkaktoi në fund rrënien e tij). ishte karakteri i tij impulsiv dhe moskokëqarje për zëdhënësin e Zotit (kryesisht Samuelein).

Davidi ishte njeriu që trashëgoi fronin më 1010. Ai mbretëroi deri në vitin 970. Biri i tij, **Solomon** (hebr. Shëlomo) erdhi në fuqi pas tij dhe mbretëroi deri në vitin 931, kur mbretëria e tij u nda në dy pjesë. E gjithë kjo periudhë konsiderohet si koha e praruar e kombit izraelit.

Davidi, ndryshe nga Shauli kishte shumë sukses dhe pastaj konsiderohej si mbret ideal. Ai e themeloi dinastinë e tij që zgjati shumë kohë, rreth 400 vjet, deri në rrënimin e mbretërisë së Judës më 587. Siç duket, sigurimi i dinastisë së Davidit bazohej në besëlidhjen që Perëndia e lidhi me të me fjalët që vijojnë: *Zoti iu betua Davidit që do të mbante këtë fjalë: Unë të premtoj që biri yt do ta trashëgojë fronin. Në qoftë se bijtë e tu i përmbahen besëlidhjes sime së bashku me urdhërimet që ua kam dhënë, atëherë edhe bijtë e tyre do ta trashëgojnë fronin përgjithmonë.* (Psalmi 132,11-12).

Jeruselemi u bë kryeqytet – qyteti që Davidi e kishte zënë nga jëbusasit. Ka shumë të ngjarë që Davidi e adoptoi rolin e kryepriutit sipas zakonit të mbretërve jëbusas (prej të cilëve njëri kishte qenë Melkizedeku), sepse, siç duket, e udhëhiqte popullin në adhurimin e Perëndisë.

Sipas besëlidhjes që mbretërit hitas bënë me vasalet e tyre, zoti i jepte vasalit të tij një dinasti të qëndrueshme në qoftë se mbreti vasal ishte një nga fiset e tij prej gjakut. Meqë besëlidhja e Sinait, siç duket, bazohej në të njëjtën formë, kjo ndoshta do të shpjegonte se përse e quanin bir i Perëndisë mbretin izraelit.

Përgjegjësia kryesore e mbretit ishte sigurimi i sundimit të drejtë. Për këtë nuk ishte vetëm gjykatësi i lartë por edhe i detyruar të lexonte ligjin (d.m.th. kodin dhe kushtetutën së bashku) me zë të lartë para popullit çdo vit. Ai vetë ishte nën ligjin e Perëndisë siç ishte edhe populli.

Por shumica e mbretërve që vinin pas Davidit ishin të këqij dhe nxitonin lulëzimin e padrejtësisë dhe të korrupsionit, jo vetëm në mbretërinë veriore (që quhej Izrael) por edhe në mbretërinë e jugut (që quhej Juda) – të dy lindën me ndarjen e mbretërisë së Solomonit. Disa nga këta mbretër përpiqeshin ta kthenin popullin në besnikërinë ndaj besëlidhjes së parë (p.sh. mbretërit Hizkija dhe Joshija), por profetët frenonin kokëfortësinë e mbretit.

Theksi kryesor i librave të mbretërve është si vijon:

1. Besnikëria ose pabesi ndaj besëlidhjes cakton fatet e të dy mbretërve. Theksi i veçantë bie mbi lartësitë dhe ultësitë e kësaj marrëdhënie..
2. Ka theks në plotësimin e profecisë. Asgjë s'është fryt i rastësisë. Perëndia drejton përfundimisht historinë.
3. Me gjitha dështimet, besëlidhje lidhur me Davidin quhet garancia e triumfit përfundimtar të Izraelit me ardhjen e Mesisë.

Libri i Kronikave është shkruar për inkurajimin dhe rritjen në fe të të mërguarve të kthyer në atdhe, të cilët filluan të dyshonin nëse kishte shpresë për plotësimin e planit të Perëndisë për të ardhmen. Në fakt autor i librave të Kronikave thekson pa pushim se si një sasi e madh izraelasësh nga veriu kishte kërkuar strehë te mbretëria e jugut.

Dështimi i këtyre mbretërve të jetojnë sipas parimeve të dinastisë së Davidit përforconte pritjen e sundimtarit të drejtë që duhej të vinte, Mesinë (mbretin e shuguruar nga Perëndia). Me rrënimin e mbretërisë së jugut (Judës) më 587 dhe me dështimin e kryetarit davidik, Zërubabelit, që ta përtërinte dinastinë pas mërgimit, shtohej pritja për ardhjen e Mesisë. Mesia jo vetëm se do t'i plotësonte profecitë për vete të shkruara në librin e Zanafillës, por edhe do të ishte plotësimi i përsosur i premtimeve që Perëndia ia kishte dhënë dinastisë së Davidit. Gjatë periudhës 104-37 para erës sonë, disa nga kryepriftërinjtë makabe pranuan titullin e «mbretit» edhe disa pretendonin që ata vetë ishin plotësimi i

shpresës mesianike. Është thelbi i lajmit të DhR se kjo shpresë u plotësua vetëm në Jezusin, Mesinë.

DAVIDI

Shauli ishte mbreti i parë i popullit izraelit, por shpirtërisht ishte i dështuar. Edhe në kohën e tij, u bë e qartë se cili do të ishte pasardhësi i tij. Emri i pasardhësit ishte David – ai që duhej të bëhej mbreti më i madh i Izraelit, si edhe stërgjyshi i Mesisë. Davidi ishte nipi i madh i Rutës dhe Boazit dhe më i riu nga tetë vëllezërit. Ai lindi në Bet-Lehem. Prindërit i tij ishin nga fisi i Judës. U rrit si bari, dhe si bari mësoi të bëhet guximtar sepse e mbronte kopenë e të atit nga grabitqarët. Gjithashtu, mësoi butësi dhe kujdes, cilësi për të cilat më vonë duhej t'i këndonte si tiparet e Perëndisë. Si Josefi, edhe Davidi vuante nga zemërimi dhe xhelozia e të vëllezërve më të vjetër.

Perëndia e refuzoi Shaulin si mbret, dhe i zbuloi profetit Samuel se Davidi do të bëhej trashëgimtari i tij. Prandaj Samueli e shuguroi mbret në Bet-Lehem pa asnjë ceremoni publike. Pas kësaj, gjendja e Shaulit u keqësua edhe më tej. U çmend dhe u bë xheloz për Davidin dhe u përpoq ta vriste në disa raste. Në vitet e fundit të jetës së Shaulit, Davidi ishte vazhdimisht në arrati, duke jetuar jashtë ligjit dhe duke bërë luftë partizane kundër Shaulit, në shkretëtirën e Judës. Shumica e përvojave që i bëri Davidi, përsa i përket çlirimit të Perëndisë gjatë kësaj kohe, janë përmendur në disa nga psalmet që i shkroi. Në fund Shauli ra në betejë me filistenjtë.

Pas vdekjes së Shaulit, Davidi u vendos në Hevron (tani ishte 30 vjeçar) ku mbretëroi shtatë vjet e gjysmë, por ende duhej të luftonte kundër mbeturinave të partizanëve të Shaulit. Pasi i mundi ata, pushtoi Jerusalemin që u bë kryeqyteti i tij. Pas kësaj, e solli arkën e besëlidhjes nga Kiriati-Jearimi deri në Jerusalem, kështu që qendra politike u bë edhe qendra fetare e kombit. Për arkën fitoi një vend në vendin më të lartë të këtij qyteti, d.m.th. në kodrën e Morisë, e cila në këtë kohë i takonte jebusazit Arauna, i cili e përdorte si lëmë. Davidi nguli këmbë që ta blinte këtë parcelë toke megjithëse i ishte ofruar falas. Në fund e bleu dhe në të ngriti një lloj tende për ta strehuar arkën, e kjo theksoi lidhjen e tij me çadrën nomade që e kishte mbuluar shenjtëroren në shkretëtirën e Sinait. Ngritja e kësaj çadre të veçantë ku më vonë u ngrit Tempulli, në kryeqytetin administrativ, kontribuoi për lidhjen e fiseve izraelite me Jerusalemin dhe për përforcimin e bashkimit politik të tyre.

Davidi siguroi kufijtë e Izraelit të bashkuar me anë të një kombinimi

të urtë të lidhjeve diplomatike dhe të një vargu fushatash ushtarake të suksesshme kundër filistenjve dhe fqinjëve të tjerë kërcenuesë që i vuri nën haraç. Gjatë mbretërisë së tij Izraeli u bë shteti më i fuqishëm në territorin që ndodhej midis Asirisë në verilindje dhe Egjiptit në jug-perëndim. Mposhtja e filistenjve e vendosi rrafshinën bregdetare të Detit Mesdhe nën kontrollin e tij. Zaptimi i Damaskut si edhe qyteteve më në veri e vendosi tokën nën kontrollin e tij deri në lumin Euftrat. Kufijtë lindorë të tij përfshinin Transjordanin dhe territoret e tij i jepnin rrugëdalje në Detin e Kuq nëpër Gjirin e Eilatit. Kështu, pra, mund të vërehet që arritjet e tij ishin të mëdha. Për herë të parë që nga pushtimi nën komandën e Joshuas, Izraeli ishte një shtet i fuqishëm dhe plotësisht i pavarur. Në të vërtetë vetëm me mbretërinë e Davidit realizohet premtimi i trashëgimit të mbarë tokës, një territor që shtrihej nga përroska El-Arish deri në lumin Euftrat. Kjo do të jetë përsëri realitet vetëm nën sundimin e Mesisë. Gjithashtu, nën mbretërimin e Davidit, Jerusalemi u bë kryeqytet fetar dhe politik. Shumë gjëra të tjera që futi Davidi u bënë normative për jetën e kombit.

Perëndia lidhi me Davidin një besëlidhje të veçantë, e cila në thelb është zgjerimi i besëlidhjes së Sinait, që dinastia e tij do të bëhet e përjetshme – një nga pasardhësit e tij do të jetë gjithnjë në fuqi, në fron të Izraelit. E vetmja mënyrë, në të cilën kjo mund të bëhet një realitet i përjetshëm është që një individ i përjetshëm ta zërë fronin – d.m.th. Mesia hyjnor që duhej të ishte pasardhësi i Davidit.

Në Bibël thuhet se Davidi ishte njeri sipas zemrës së Perëndisë. Në qoftë se lexojmë psalmet, shumicën e të cilave i shkroi dhe i këndonte Davidi, mund të vërehet që ai gëzonte një marrëdhënie të ngushtë me Perëndinë. Megjithëse ishte mbret aq i madh, i besonte Perëndisë si një fëmijë. Mjerisht në kulmin e suksesit dhe pushtetit të tij, kjo marrëdhënie u komprometua shumë për shkak të një krimi të tmerrshëm. Megjithëse kishte disa gra, bëri tradhti martesore me gruan e tjetërkujt dhe urdhëroi që burri i saj të vritet në frontin e luftës. Kështu, pra, u bë fajtor jo vetëm për kurorëthyerje por edhe për vrasje. Megjithëse bëri pendim të thellë, kishte bërë mëkat që nuk mund të shlyhej me anë të sistemit të flijimeve të asaj kohe. S'i mbetej tjetër veçse të hidhej në mëshirën e Perëndisë. Për shkak të marrëdhënies së ngushtë që kishte pasur me Perëndinë dhe për shkak të përgjegjësisë së madhe si mbret i Izraelit, e pagoi shumë shtrenjtë sjelljen e tij. Që atëherë vazhdimisht kishte andralla. Ai duhej të përballonte një sërë kryengritjesh të organizuara prej disave nga njerëzit e tij më të besuar. Edhe biri i tij, Avshalomi, u rebelua kun-

dër tij. Të tjerët thurnin intriga prapa shpinës së tij për trashëgimin e fronit.

Me gjitha shkarjet e tij morale, Davidi ishte njeri i shquar. Ishte njeri i veprimit, poet, i butë, zemërmirë ndaj armiqve të tij, mbajtës i rreptë i drejtësisë, mik besnik – ishte gjithçka që njerëzit mund të gjejnë tek një mirëbërës. Ishte i shëndetshëm dhe ngjallte admirim te njerëzit, në saje të faktit që Perëndia vepronte përmes tij, sipas mëshirës së tij. Hebrenjtë e konsiderojnë Davidin si themeluesin i mbretërisë së tyre, dhe jo Shaulin.

Edhe, para së gjithash, Davidi ishte stërgjyshi i Mesisë, mbretit sipas dinastisë së Davidit që duhej ta çlironte popullin e tij, të ulej në fronin e Davidit përgjithmonë dhe të sundonte tërë botën. Perëndia i kishte dhënë premtime (p. sh. përsa i përket ringjalljes së trupit), që u plotësuan vetëm shumë kohë më vonë nga pasardhësi i tij, Jezusi, Mesia. Këto premtime gjenden kryesisht në librin e Psalmeve, sepse Davidi i shkroi nën frymëzimin e Shpirtit të shenjtë – ishte profet. Ishte, gjithashtu, prift-mbret si mbretërit e mëparshëm të Jerusalemit – më i madhi prej të cilëve kishte qenë Melkicedeku. Nën sundimin e Davidit, mbretëria izraelite shtrihej deri në kufijtë gjeografikë që do të karakterizojnë mbretërinë mesianike që do ta themelojë Mesia pas kthimit të tij. Me fjalë të tjera, Davidi është pasqyrimi i papërsosur i atij që do të ishte Mesia.

SOLOMONI

Trashëgimtari i fronit të Davidit ishte një nga bijtë e tij i quajtur Solomoni (heb. Shëllomo). Ai u emërua mbret pas shumë intrigave në oborr gjatë vjetëve të fundit të Davidit. Emri i tij u lidh me kohë me gjithfarë legjendash dhe tregimesh popullore. Në letërsinë hebraike, arabe dhe etiopiane gjenden tregime për Solomonin. Por, çfarë ishte njeriu i vërtetë? Në përgjigje të kësaj pyetjeje, duhet t'i drejtohem Biblës. Atje marrim vesh se megjithëse ishte njeri i shquar dhe filloi mirë, më vonë u largua nga ligjet e Perëndisë dhe bëri kompromise fatale, e kjo në fund e shkatërroi. Gjatë mbretërimit të tij ai mbolli epokën e padrejtësisë, por pasardhësit e tij korrën furtunën e mbretërisë së ndarë dhe në fund mërgimin e kombit për shkak të pabesisë ndaj Perëndisë.

Solomoni ishte sundimtari i parë izraelit dinastik. Shauli dhe Davidi u emëruan mbretër të parë të Izraelit, sepse Perëndia u kishte dhënë fuqi të veçantë. Megjithëse Solomoni u bë mbret pa këtë fuqi të veçantë, më vonë ai e mori kur Perëndia iu paraqiti atij. Dhuntinë që e zgjodhi ishte urtësi, dhe Perëndia ia dha me bollëk. Jo vetëm që kishte urtësi

për të marrë vendime gjyqësore, por edhe u bë dijetar i shquar i ngjashëm me një princ të rilindjes së Evropës. Librat që i shkroi dëshmojnë, gjithashtu, për këtë aftësi. Gjatë periudhës së qëndrueshme të sundimit të tij, ndodhi një rilindje e letërsisë. Shumë letërsi u mblodh, u kodifikua si dhe u shkrua, si për shembull Libri i Predikuesit (Kohéleti), Libri i Proverbave (Fjalët e urta) dhe ndoshta Kënga e Këngëve (Poema më e bukur).

Si mbret, Solomoni trashëgoi të mira të shumta, në lëmin e arritjeve ushtarake dhe politike të të atit, mbretit David. Meqë nuk kishte asnjë kërcënim të jashtëm dhe kështu asnjë betejë për të luftuar, ishte në gjendje të merrej eksklusivisht me ruajtjen e arritjeve ushtarake dhe diplomatike të të atit dhe me përparimin e lulëzimit material të kombit. Ai ndërtoi një ushtri të fuqishme, të bazuar në koçi lufte. Gjithashtu, fortifikoi qendra strategjike dhe ndërtoi baza ushtarake (si p.sh. Megiddo, Hacor). Në sferën diplomatike përforcoi besëlidhjet e lidhura nga i ati, kryesisht me mbretin Hiram nga Tiri dhe lidhi besëlidhje të reja. Ndërmjet tyre ishte marrëdhënia miqësore me Egjipt, të cilën e përforcoi me anë të një martese me bijën e faraonit. Kjo ilustron edhe madhësinë e Izraelit si dhe nivelin e ulët, në të cilin kishte rënë Egjipti; zakonisht mbretërit e perandorisë egjiptiane nuk i jepnin në martesë bijat e tyre as mbretërve të Babilonisë a Mitanisë! Në sferën ekonomike, Solomoni ndërtoi një skuadër anijesh mineralmbajtëse për të bërë tregti detare të lulëzuar dhe zhvilloi industrinë e bakrit. Rrugët tregtare të rëndësishme ishin nën kontrollin e tij. Vizita e mbretëreshës së Sabës do të ketë pasur një qëllim tregtar, megjithëse erdhi ta dëgjonte për vete urtësinë e Solomonit. Fakti që rrugët tregtare në jug ishin nën kontrollin e Solomonit bëri që pozita strategjike e sabeasve të Arabisë jugperëndimore të ishte në rrezik financiar, sepse tregtia e temjanit dhe e erëzave ishte nën kontrollin e tyre. Udhëtimi i mbretëreshës pati sukses, por ajo duhej t'i ndante fitimet e saj me Solomonin, ashtu si duhej ta bënë edhe sheikët e tjerë arabë. Pyetjet që i kishte bërë mbretëresha Solomonit do të ishin jo gjëgjëza, por me natyrë diplomatike dhe etike, për ta vënë në provë për të parë nëse do të ishte partner tregtar i besueshëm. Përveç kësaj, Solomoni bëri punën e ndërmjetësit për marrëdhënie të ndryshme tregtie. U bë përfaqësues eksklusiv, nëpërmjet të cilit hitasit dhe aramasit duhej të bënë pazarllëk për të blerë kuajt nga Cilicia (në Turqinë e sotme) dhe koçi lufte nga Egjipti. Këto dhe ndërmarrje të tjera bënë që argjendi të jetë aq i përhapur sa gurë dhe cedër, aq i përhapur sa fiktë në Jerusalem ku banonte Solomoni në salltanet oriental.

Solomoni u bë i njohur për ndërtesat që i ngriti. E ndërtoi Tempullin në Jerusalem. Gjithashtu, ndërtoi për vete një pallat madhështor të ndarë

në disa pjesë. Sidoqoftë, ndërsa nevojiteshin shtatë vjet për ndërtimin e Tempullit, për ndërtimin e pallatit mbretëror nevojiteshin trembëdhjetë vjet. Solomoni mund t'i kompensojë këto shpenzime të larta me tregti.

Kjo tregon se çfarë ishin përparësitë e tij! Për shkak të pozitës së lartë shoqërore të gruas së tij egjiptiane (ajo ishte bija e faraonit), ia ndërtoi një krah të veçantë për pallatin ku banonte. Për ndërtimin e këtyre ndërtesave, i duheshin gurë të veçantë që duhej të nxirreshin nga gurorja dhe të transportoheshin deri në Jerusalem. I duhej, gjithashtu, dru cedri që e blinte nga mbreti Hiram nga Tiri. Për realizimin e këtyre planeve, ai futi një sistem punësh të detyruara, edhe për izraelitët. Sikurse njeriu zakonisht duhej të bënte shërbimin e tij ushtarak në ushtri, në kohën e Solomoni, duhej të bënte shërbimin e tij në brigadën e punës së detyruar.

Solomoni ishte administrator i shquar, por edhe i rreptë. Ai ndërroi kufijtë fisnorë tradicional ndër rrethet administrative: dymbëthjetë në Izrael dhe një në Judë. Secili nga këto rrethe tatimore ishte i detyruar të furnizonte oborrin me para dhe me ushqim për një muaj në vit. Vërehet nga marrëveshja që pjesa veriore e mbretërisë (më vonë Izraeli) ishte trajtuar ashpërsisht, kurse pjesa jugore (më vonë Juda) me butësi.

Pas shqyrtimit të pasurisë dhe madhësisë së sundimit të Solomoni, duhet të shqyrtojmë se cilat ishin të metat e sundimit që më vonë do të shkaktonin ndarjen madje edhe përplasjen e mbretërisë së tij.

1) Programi i ndërtimit të tij madhështor u krye me çmim të tmerrshëm – çmimi i armiqësisë të popullit. Në të vërtetë Solomoni nuk i lejohej t'i përdorte shtetasit e tij për punë të detyruar. Ata i mbanin mëri për këtë, e ky qëndrim pastaj i çoi në kryengritje.

2) Megjithëse u rrit niveli i jetesës në Izrael, ndarja e pasurisë nuk ishte e barabartë. Pasuria e fituar nga tatimi i rreptë mbetej në duart e pak njerëzve.

3) Solomoni u martua me shumë gra të huaja për të lidhur besëlidhjet me vendet e tjera. Por, kjo solli hyrjen e feve të huaja që i toleronte për t'u pëlqyer grave të tij. Solomoni toleronte idhujtari.

4) Solomoni s'e kishte të njëjtën rëndësi si i ati, Davidi. Pasiguria e shtyri t'i zhdukte armiqtë e tij personalë, kurse Davidi gjithnjë kishte pritur që Perëndia t'i jepte të drejtë. Besëlidhja që Perëndia e kishte lidhur me Izraelin ishte bazuar në parimet e monoteizmit, drejtësisë dhe barabartësisë para ligjit. Solomoni, me sjelljen e tij si mbret oriental tipik i kombeve të rrethuara, i kishte shkëlur në mënyrë skandaloze parimet e besëlidhjes. Dënimi për këtë ra në pasardhësit e Solomoni që ndoqën politikën e tij. Në të vërtetë, shumica e prirjeve të këqia (si

idhujtaria dhe shpërdorimi i pushtetit) të mbretërve të mëparshëm të Izraelit dhe të Judës, mund të ndiqen prapë deri në Solomonin. Solomoni u dha shembull shumë të keq që mjerisht e ndoqën, e kjo më vonë e rrënoi vendin. Në Bibël thuhet se *,megjithëse Zoti, Perëndia i Izraelit, i ishte shfaqur Solomonit dy herë, dhe e kishte urdhëruar që të mos adhuronte perëndi të huaja, Solomoni nuk e dëgjoi Zotin, por u largua nga ai. Për këtë Zoti (i besëlidhjes) u zemërua me Solomonin dhe i tha: ,Meqë me qëllim e ke shkelur besëlidhjen time me ty dhe nuk iu ke bindur urdhrave të mia, të premtoj se unë do të ta heq mbretërinë dhe do t'ia jap njërit nga nëpunësit e tu. Sidoqoftë, për hir të atit David, unë nuk do të bëj kështu gjatë jetës sate, por gjatë sundimit të birit tënd. Unë nuk do t'ia heq tërë mbretërinë; në vend të kësaj unë do t'ia lë një fis për hir të shërbëtorit tim David dhe për hir të Jerusalemit, qytetit që e përvetësova.*

Mund të shohim, pra, që megjithëse Solomoni ishte njeri i madh, nuk mund të krahasohej me Davidin. Kur ishte në moshë, Solomoni u largua seriozisht nga udha e Perëndisë dhe mbolli farën e rrënimin të fundit të kombit – shkatërrimit dhe mërgimit.

Jeta e Solomonit paraqitet për ne një paralajmërim serioz. Ai filloi mirë por mbaroi shumë keq. Në qoftë se ne do ta pranojmë shpërblimin që na përgatiti Perëndia, duhet të mbetemi të qëndrueshëm deri në fund. Vlerësimi i jetës sonë është bazuar në gjithçka që kemi bërë dhe do të bëjmë, e jo vetëm në disa periudha të jetës sonë.

MBRETËRIA E NDARË

Politika shtypëse e Solomonit solli si përfundim zemërimin e përhapur ndër shtetasit. Ky zemërim arriti kulmin me vdekjen e mbretit. Trashëgimtari i tij, Rëhavami, u përpoq të zgjidhte problemin duke shtuar edhe më shumë masat shtypëse, të cilat i kishte përdorur Solomoni për të nxjerrë tatim për shpenzime publike si edhe mbretërore. Si pasojë, dhjetë fiset veriore u ndanë dhe themeluan shtetin e tyre të pavarur, të cilin e quajtën Izrael. Kjo lëvizje e pavarësisë ishte zhvilluar nën udhëheqjen e njëfarë agitatori me emër Jaravam, të cilin e kishte nxitur Egjipti. Më vonë ky u bë mbreti i parë i shtetit të ri të quajtur Izrael.

Kështu u nda mbretëria e mëparshme: në veri ndodhej shteti i ri me emrin Izrael, i cili përfshinte dhjetë fiset izraelite. Në jug e vetmja pjesë e mbretërisë së mëparshme që kishte mbetur ishte Juda vetëm me një fis. Ndarja ndodhi më 931 para erës sonë, por as njëri as tjetri nga shtetet nuk ishin të mbarë. Shteti i ri me emrin Izrael arriti të qëndronte deri në vitin 721, kur asirianët dëbuan popullsinë. Ndërsa shteti me emrin Juda ia arriti të rezistonte deri në vitin 587 para erës sonë kur babilonasit e

dëbuan popullsinë dhe e shkatërruan Jerusalemin me gjithë Tempull.

Asnjë nga mbretërit e mëtejshëm nuk arriti shtatin e Davidit, me të cilin ata krahasohen në Bibël. Problemi i parë i tyre ishte idhujtaria – shenjë e largimit të tyre nga kushtet e besëlidhjes që Perëndia e kishte lidhur me stërgjyshërit e tyre. Problemi i dytë ishin besëlidhjet me kombet e tjera, të cilat nuk kishin të njëjtin botëkuptim, sepse izraelitët refuzuan të mbeshteten në Perëndinë për zgjidhjen e dilemave politike. Perëndia vazhdimisht i paralajmëronte mbretërit e Izraelit si edhe Judës me anë të përfaqësuesve të tij, se në qoftë se vazhdonin të refuzonin ta dëgjonin dhe t'i besonin, me kohë Ai do të sillte rrënim. Me përjashtime të rralla, mbretërit refuzuan t'i dëgjonin profetët, kështu pra, pasojat për dy shtetet ishin të pashmangshme – shkatërrimi, dëbimi dhe mërgimi.

Historia e mbretërisë veriore, Izraelit, mund të ndahet në katër periudha. Periudha e parë (931-880) karakterizohej nga rivaliteti dhe luftërat ndërmjet Izraelit dhe Judës. Jaravami I, mbreti i parë, ngriti një sistem rival të adhurimit në mbretërinë e tij për të penguar pelegrinët që të shkojnë në jug, në Jerusalem. Ky kult rival u degjenerua shpejt në idhujtari. Me këtë rast shumë izraelitë të përshpirtshëm ikën në mbretërinë jugore (Judë). Ky kult i demit (mbi të cilin gjoja qëndronte Zoti i padukshëm) shpejt degjeneroi në një kult idhujtar të demit. Mbreti i fundit i kësaj periude, Omri, u bë figurë me rëndësi ndërkombetare, megjithëse i kushtohet shumë pak vend në librin e mbretërve. Lidhi një traktat me Sirinë dhe pastaj me Fenikinë. Ky traktat i fundit u vulos me martesën mes birit të tij, Ahabit, dhe princeshën fenikase, Jezabelë, por kjo duhej të kishte pasojat të kobshme.

Periudha e dytë (880-841) karakterizohej nga ngritja e dinastisë së Omriut dhe nga ndërtimi i kryeqytetit duke përfshirë edhe pallatin e stolisur në Shehem (që e quanin Samari, hebraisht Shomron = zonë kufitare, ose sot Nablus), gërmadhat e të cilat mund të shihen edhe sot. Biri i Omriut, Ahavi, importoi nga Tiri punëtorët dhe aftësitë për të ndërtuar pallatin. Për të përforcuar besëlidhjen me Tirin kundër Sirisë, ai u martua me princeshën e Tirit, Izobalën (ndryshe Jezabelën). Për t'i bërë qejfin gruas së vet, e lejoi t'i importonte 400 profetët e fesë së saj pagane në Izrael. Kjo kishte si përfundim jo vetëm imoralitetin dhe padrejtësinë, por edhe idhujtarinë. Perëndia nxori nga populli njeriun e tij me emrin **Elija**, për ta përballuar këtë gjendje. Profeti i njoftoi mbretit se Perëndia do të sillte thatësi për ta dënuar kombin për pabesinë e tij. Do të jetë në kohën e kësaj thatësie që rrezikonte të shkatërronte

ekonominë bujqësore të Izraelit (Izrael shkëmbente fruta perime me mallrat luxioze të Fenikisë), që ndodh ngjarja lidhur me vreshtin e Navotit. Jezabela shpall agjërime gjoja për të caktuar cilin është fajtor për thatësinë dhe e vë Navotin para popullit në një seancë identifikimi. Fajtori identifikohet nga dy dëshmitarë të rremë dhe ekzekutohet. Thatësira merr fund vetëm pas një prove force ndërmjet Elijes, përfaqësuesit të Perëndisë, dhe profetëve paganë në vargmalin Karmel (afër Haifës së sotme) kur Perëndia, duke dërguar zjarr, tregon se si Ai ishte Perëndia i vërtetë. Perëndia i Izraelit bën pikërisht atë që duhet të ketë bërë Baali, e ashtuquajtura perëndi e stuhisë dhe të shiut: dërgon një rrufe nga qielli i kthjellët. Megjithatë Elija vjen në konkluzionin që misioni i tij për ta kthyer popullin përsëri te Perëndia, ka dështuar, sepse pendimi është vetëm sa për sy e faqe. Siç duket, Zoti është i një mendjeje me Elijen, sepse menjëherë i jap urdhër të shugurojë (d.h.th. të emërojë) disa mbretër (Hazaelin dhe Jehuin) si dhe pasardhësin e Elijes, Elishën, si agjentët e tij për ta ndëshkuar popullin me gjakderdhje të tmerrshme, por njëkohësisht premtori t'i kursejë 7.000 besnikët e tij.

Një ngjarje e mëtejshme që kishte të bënte me padrejtësinë sociale të turpshme të mbretit dhe të gruas së tij pagane, kishte si përfundim që Elija profetizoi mbarimin e dinastisë së Omriut. Kjo u plotësua pikërisht kur Jehu udhëhoqi revolucionin e përgjakshëm që shkaktoi zhdukjen e dinastisë së Omriut. Pjesa e fundit e kësaj periudhe karakterizohet me luftërat kundër Sirisë, në kohën kur vepronte profeti **Elisha** (gr. Elizeu), i cili paralajmëronte mbretërit e pabesë. Elinë e zëvendësoi Elisha, sikurse edhe Moisiun e zëvendësoi Joshua.

Shërbimi i tij zgjatohej nëpër një periudhë prej 50 vitesh (duke përfshirë mbretërimet e Joramit, Jehuit dhe Jehoazahit) dhe fokusohet mbi përgatitjen e një tepricë besnike. Kjo tregon për kujdesin e Zotit për mbretërinë veriore megjithatë apostate. Elisha përshkruhet si Joshua e dytë (kthehet në gjurmët e Joshuas) i cili zëvendëson Moisiun e dytë (Elijën). Shërbimi i Elijes përbëhet nga thirrjen e popullit të kthehej te Zoti. Jezusi kishte dhënë të kuptonte se Gjon Pagëzori e kishte vazhduar shërbimin e Elijes. Këtë shërbim do të vazhdojë, siç duket, një profet i ngjashëm pak para kthimit të Jezusit (shih. Apok 11,3-10)

Profeti Jona na jep një vështrim të rëndësishëm në mendjen e Zotit. Fakti se shumë hollësi historike mungojnë në librin e Jonës, na tregon se autori na lë të kuptojë se Zoti shqetësohet edhe për kombet pagane, pikëpamje që zhvillohet te DhR. Regjistrimet asiriane na tregojnë se pak para vizitës së Jonës, kishte qenë disa epidemi (më 765 dhe 759) si dhe

eklipsin e plotë të diellit (më 763), dhe se në kohën e bashkëregjencës së mbretëreshës Semiram dhe Adad-Nirariut, popullsia e Ninaves ishte kthyer në monoteizëm.

Periudha e tretë (841-752) ka të bëjë me dinastinë e Jehut, e cila nuk kishte sukses. Me gjithë zilinë e tij për të masakruar dinastinë e Omriut, s'kishte asnjë dëshirë të vërtetë që të nderohet Perëndia. Nga një mbi-shkrim asirian e dimë se Jehui ishte vasal i Asirisë. Më vonë, me dobësinë e Asirisë, depërtimet siriane (shenje e mosmiratimit të Zotit) po vazhdonin deri në ngritjen e mbretit të madh të kësaj periudhe, me emrin Jaravam II. Ky arriti lulëzim të madh, por në kurriz të drejtësisë shoqërore. Kjo shkaktoi paditjen e tij edhe nga dy profetët që Perëndia i ngriti, me emrin Amos dhe Hoshea.

Periudha e katërt (752-722) ka të bëjë me 30 vitet e fundit të mbretërisë së Izraelit. Asiria ishte fuqia mbizotëruese në veri që i kërcënonte të gjitha territoret me forca të tmerrshme ushtarake. Edhe Izraeli me radhë u bë shtet vasal i Asirisë, për shkak të një sërë mbretërisht të dobët, të cilët erdhën, njëri pas tjetrit, në një kohë të shkurtër, sepse ose u vranë ose u zhdukën me anë të revolucioneve. Më 721 Izraeli mendjeshkurtër ngriti krye kundër Asirisë, zotit të tij feudal, dhe vendi u pushtua, qytetet u shkatërruan dhe popullsia u dëbua. Paralajmërimet dhe profecitë e Amosit dhe Hoshean u plotësuan. Fjala e Zotit u vërtetua.

Historia e mbretërisë jugore Juda, mbretëria e jugut, në fillim kishte përparësi në kryeqytetin e themeluar prej kohësh dhe në Tempullin madhështor me kultin e vërtetë, të përkrahur nga një dinasti mbretërisht të emëruar nga vetë Perëndia. Në kohën e sundimit të mbretit të parë pas ndarjes, Rëhavamit, thesaret e vendit ua kishin dorëzuar egjiptianëve për ta liruar me shpërblësë. Erdhën edhe andrallat e brendshme, kur mbreti me emrin Jëhoram, biri i Jëhoshafatit, u martua me Atalinë, bijën e Ahavit, mbretit të prishur të Izraelit. Kur vdiq burri i saj, ajo u bë sundimtare dhe futi idhujtari në vend. Ajo u përpoq të masakronte tërë dinastinë e Davidit, por dështoi. Anëtari i vetëm i dinastisë që mbeti në fund, si përfundim të një revolucioni që ndodhi në pallat, u shugurua mbret. Ky njeri, Jehoashu, futi një reformë të kufizuar, por kur Asiria kërcënonte ta sulmonte Jerusalemin, thesaret e Tempullit iu dorëzuan mbretit asirian, që të tërhiqet. Gjatë shek. VIII para erës sonë, mbret i shquar ishte Uzija. Nën sundimin e tij, vendi përjetoi një lulëzim të paparë që nga vdekja e Solomonit. Që atëherë shteti i Judës pati dobi nga zakoni i bashkëmbretërimit: biri i mbretit vihej në fron nga i ati për ta identifikuar qart si princ trashëgimtar shumë kohë para vdekjes së të atit.

Në vitin e fundit të sundimit të tij, profeti Isaia (hebr. Jeshaja) mori thirrjen për t'u bërë profet. Së bashku me një profet tjetër me emrin Mihaja, Isaia u bë zëdhënësi i Perëndisë para mbretërve të Judës në kohën e kërcënimit asirian. Kur Izraeli dhe Siria u bashkuan kundër Judës, mbreti i Judës, Ahazi, mendonte të thërriste për ndihmë perandorin asirian. Isaia e këshilloi që të mos vepronte ashtu, sepse edhe nënshtrimi miqësor do ta detyronte shtetin e tij të adoptonte kultin e perëndive asiriane dhe kështu të binte në idhujtari. Mjerisht, Ahazi e refuzoi këshillën e profetit Isaia dhe kështu, fjalën e Perëndisë. Si pasojë Juda u bë shtet vasal i Asirisë. Në një rast tjetër mbreti Hizkija (gr. Ezekija) mendonte të bashkohej me Egjiptin kundër Asirisë. Mjerisht, edhe kësaj here mbreti e refuzoi shumicën e paralajmërimeve dhe këshillave të Perëndisë që erdhën me anë të këtyre profetëve. Duke menduar se ishte më i urtë se vetë Perëndia, mbreti i Judës u besonte besëlidhjeve të lidhura me Egjiptin për t'i shpëtuar pushtimit. Mirëpo Egjipti kurrë s'ishte mjaft i fortë për ta ndihmuar. Si pasojë erdhi invadimi asirian e me të edhe shkretimi pa mëshirë i vendit jashtë Jerusalemit. Pikërisht në kohë, mbreti Hizkija ndërroi mendje dhe dëgjoi predikimin e profetit Isaia dhe atë të profetit Mihaja, dhe me anë të një mrekullie, Jerusalemi i rrethuar mezi u shpëtua me tërheqjen e papritur të ushtrisë asiriane. Mjerisht, sundimi i keq i mbretit të mëtejshëm, Mënashaut, përmbiti përparimin shpirtëror të paraardhësit e tij, Hizkijës, dhe shteti i Judës u gjet në një kohë të tmerrshme të idhujtarisë kur u vranë shumë njerëz besimtarë. Profetin Isaia e vranë duke e sharruar në një zgavër druri. Disa priftër ishin aq të dëshpëruar saqë emigruan në Egjipt ku ndërtuan një tempull tjetër në një ishull të Nilit.

Pasardhësi i Amonit, Joshija, e ktheu politikën e të atit dhe futi një reformë shoqërore dhe fetare (të dyjat shkonin gjithnjë së bashku). Në kohën e sundimit të tij, Perëndia thirri edhe dy profetë si zëdhënës të tij, Cëfanjën (gr. Sofoninë) dhe Jirmijën (gr. Jereminë). Atyre u shtuan edhe Nahumi dhe Havakuku.

Del qartë se mbreti Menashe dhe biri i tij Amoni, ishin vasalë të Asirisë, por që nga koha e mbretit Joshija, Asiria ishte kaq të dobët saqë Joshija kërkoi pavarësi për Judën. Faraoni kishte lidhur një marrëdhëni me Asirinë, kështu që, kur Asiria ishte nën trysni të babilonasve (që kishin tashmë pushtuar kryeqytetin asirian), faraoni Neko nisi në veri me ushtrinë e tij për t'i ardhur në ndihmë. Por e zuri në rrugë Joshija (më 609) që kishte lidhur besëlidhje të fshehur me babilonasit (shih vizitën e Merodah-Baladanit në librin e Isaisë), e vranë në betejë.

Në fund faraonin e mundën babilonasit në betejën e Karkemishit më 605.

Të gjithë këta profetë profetizonin se si Perëndia do ta përdorte perandorinë babilonase për të dënuar Judën për pabesinë e tij. Më 605 erdhi shpërngulja e parë babilonase kur u dëbua Danieli së bashku me çifutët e tjerë të rëndësishëm. Më 597 pabesia e vasalit, Judës, ndaj perandorit babilonas, Nebukadnecarit, solli si përfundim shpërnguljen e shtetasve më të rëndësishëm, duke përfshirë edhe profetin Jëhezkel (gr. Ezekiel). Plaçkitjen e fundit të kryeqytetit e kishin profetizuar edhe profeti Jeremia në Judë edhe profeti Jëhezkel në mërgim në Babiloni. Siç ka shkruar profeti Ovadja, kulmi i poshtërimit erdhi kur Edomi, shtet i betuar armiqësor, i ndihmoi babilonasit në luftë kundër Judës.

Mbarë periuda paraqitet në **Librat e mbretërve** si dështim të plotë. Shkëputja e Jaravamit quhej veprim idhujtar, refuzim i besëlidhjes dhe fillimi i idhujtarisë në mbretërinë veriore. Është kuptimplotë që Librat e Kronikave shumë rrallë përmendin historinë e mbretërisë veriore, dhe kjo tregon se sipas mendimit të Ezrës (autori i Kronikave), Izraeli ishte shtet i paligjshëm. Gjithashtu duhet marrë parasysh që pas mërgimit, asnjë nga fiset veriore nuk u kthyen në Izrael.

Problemi i idhujtarisë: Për fat të keq, idhujtaria nuk ishte kufizuar në Izrael. Nën sundimin e Menasheut (që ishte vasal i Asirisë) idhujtari ishte futur gjerësisht në Judë. Gjatë mbretërimit të tij Isaia shkroi në fshehtësi profecitë e tij që janë shkruar në pjesën e dytë të librit të tij. Trashëgimin e Menasheut e sulmon Jeremia.

Në të vërtetë, nga të gjithë mbretërit e Judës, vetëm Hizkija e Joshija miratohen pa asnjë kufizim, kurse gjashtë të tjerët (Asa, Jehoshafati, Jehoashi, Amacja, Uzija and Jotami) marrin miratim me kufizim. Në mënyrë konsekvente, të tjerët përbuzën urdhërimet e Zotit dhe me mendjemadhësi nuk pranuan të pendoheshin. Davidi dhe Jaravami u bënë respektivisht norma përsëritmërie ose pabese.

Siç kemi konstatuar, kishte dy reforma kryesore në Judë gjatë kësaj periudhe, ajo e Joshijës dhe ajo e Hizkijës. Reforma e Joshijës erdhi pas periudhës së apostazisë nën Menasheun. Kjo reformë përqëndronte rreth rizbulimit të librit të Ligjit (Libri i ripëritjes së besëlidhjes) dhe ishte ripërtëritje e besëlidhjes së lashtë (2 Mbr 23,1-3). Megjithatë Jeremia rrallë e përmend, sepse ishte i mendimit se ishte sipërfaqësore, dhe kështu filloi të profetizonte rrënimin e mbretërisë jugore. Të dy reforma ishin të lidhura me situatën politike të favorshme: Joshija arriti të nxirrte fitim nga rënia e Asirisë, kurse Hizkija nga lirimi nga kanosja e Sinharibit.

Megjithatë sjellja e mbretërve të pabesë nuk kishte ndikim te premtimi drejtuar dinastisë davidike. Kjo tregon se Mesia duhej të ishte anëtar i dinastisë davidike.

MËRGIMI

Mbretëria e Solomonit u nda më 931 para erës sonë. Dy mbretëritë, Izraeli në veri dhe Juda në jug, kishin një sërë mbretërisht, shumica e të cilëve nuk i dëgjuan profetët që ua dërgoi Perëndia. Pasoja e mosbindjes së vazhdueshme ndaj këtyre paralajmërimeve ishte në fund shkatërrimi i shtetit, dëbimi dhe mërgimi i popullit. Mundësia e këtij dënimi kishte qenë gjithnjë pjesë përbërëse e besëlidhjes ndërmjet Perëndisë dhe kombit.

Vendi i parë që e pësoi këtë përfundim ishte mbretëria e veriut, Izraeli. Perëndia i kishte dërguar një sërë profetësh për ta lajmëruar popullin: Elijën, Elishën, Amosin dhe Hoshean, por në përgjithësi mbretërit nuk i dëgjuan këto lajmërime. Kjo përfundoi me pushtimin e vendit nga Asiria, e cila ishte fuqia më e madhe e asaj kohe. Politika e perandorisë asiriane ishte dëbimi i popujve të shteteve vasale në qoftë se ngrinin krye kundër perandorit. Meqë Izraeli ishte bërë vasal i Asirisë, pikërisht kjo (dëbimi) i ndodhi kombit më 721. Shumë u vranë; kryeqyteti dhe qytete të tjera u shkatërruan dhe popullsia (27.290 gjithsej sipas regjistrimeve të perandorit asirian Sargon) u dëbua në krahina të tjera të perandorisë (Gozan në Mesopotami dhe Media). Si shkëmbim, asirianët sollën një popull tjetër nga ana tjetër e perandorisë dhe e vendosën në ish-tokën e Izraelit. Atje u ndërmartuan me pjesën e izraelitëve të mbetur. Sipas pikëpamjeve të çifutëve në jug, lindi një racë bastarde pjesërisht pagane. I quanin samarianë – popullin, të cilin më vonë do ta hasim në kohën e Dhiatës së Re. Më 332-132 para erës sonë dhe më 136-484 të erës sonë, kishin një tempull në malin Garizim. Kohët e fundit u zbulua gërmadhat e këtij tempulli, dhe kjo është me interes për ne, sepse tempulli ishte ndërtuar sipas modelit të Tempullit të Solomonit në Jerusalem. Ende gjer më sot atje banon një koloni e vogël, ndoshta e atyre që mbaheshin të pastër, afër qytetit Nablus (Shehemit të dikurshëm) si edhe në Holon (pranë Tel-Avivit). Në 1948 ata ishin vetëm me 150 frymë, kurse sot 550. Ende sot mblidhen për adhurim dhe për të kushtuar flijime. Ata kanë variantin e tyre të Torës me emrin Pesëlibërshi samarian. Ata thanë se janë pasardhësit e fiseve Efraim, Gad dhe Mënashe që i shpëtuan sulmit asirian dhe mbeten besnikë ndaj Perëndisë së Izraelit. Përveç kësaj ka edhe gjurmë të dhjetë fiseve të humbura në Etiopi (Falasha), në

Jemen, në Indi (fise Manipur dhe kenanitët), në Kinë (fise Çiangmin dhe Shinlung), në Burmë, dhe në Afganistan (fisi Pashtu). Dhjetë fiset izraelite, siç duket, nuk u humbën pa lënë gjurmë, si mendojnë disa.

Vendi i dytë që pësoi përfundimin e dëbimit dhe të mërgimit ishte mbretëria e jugut, Juda, e kjo ndodhi në tri periudha. Kësaj radhe fjala ishte për perandorinë babilonase. Ngritja e perandorisë së tyre filloi me disfatën e asirianëve më 612. Më 604, tetë vjet më vonë, ndodhi pjesa e parë e dëbimit kur babilonasit shpunë në mërgim profetin Daniel nga Juda së bashku me pjesëtarët e tjerë të elitës çifute. Kjo ndodhi kur çifutët (d.m.th. banorët e Judës) ngritën krye kundër zotërinjve të tyre babilonas. Më 597 Juda ngriti krye edhe një herë dhe kësaj here, babilonasit zaptuan Jerusalemin dhe zunë rob luftime mbretin së bashku me kryetarët e shtetit. Profeti Ezekiel ishte ndër ta dhe ata u dëbuan deri në Babiloni. Kundër këshillës së profetit Jeremia, Juda ngriti krye përsëri më 587, dhe kësaj here pushtuesit e shkatërruan plotësisht Jerusalemin duke përfshirë edhe Tempullin. Përveç kësaj, plaçkitën krahinat fqetare. Shumicën e popullsisë e dëbuan, vetëm njerëzit e ulët nuk u ndoqën, duke përfshirë profetin Jeremia që pushtuesit e mbanin (me të padrejtë) për kolaboracionist. Jeremia ishte nën mbrojtjen e Perëndisë dhe si plotësim i premtimit të Tij, u shpëtua dhe mund të mbetej në vendin e vet duke pasur lirinë e lëvizjes.

Sidoqoftë, e ardhmja e kombit mbeshetej tek të mërguarit në Babiloni (afërsisht 70.000 frymë gjithsej). Ata ishin ajka e shoqërisë çifute: priftërinjtë (si p. sh. Jëhezekeli), specialistët, profesorët dhe intelijenca. Ishin njerëzit e aftë për të menduar për kuptimin e ngjarjeve të kohëve të fundit që u kishin ndodhur: në mërgim kishin mjaft kohë për këtë. A e kishte braktisur Perëndia popullin e vet? Ç' do t'u ndodhë atyre në të ardhmen? Rreziku më i madh ishte asimilimi me kohë i kombit nga populli i vendit, sikurse u ndodhi kombeve të tjera që sot përmenden vetëm në librat e historisë. Por, Perëndia kishte bërë gati zgjidhjen e këtij problemi. Ndër të mërguarit ishte njëfarë profeti me emrin Jëhezekel. Më parë e kishte profetizuar rrënimin e Jerusalemit e tani ua kushtoi vëmendjen të mërguarve. Në një vegim që Perëndia ia dha, pa se si prania e Perëndisë ishte ndër të mërguarit dhe jo më në Jerusalem. Perëndia u premtonte një të ardhme: besëlidhjen e re, ringjalljen kombëtare, Tempullin e ri dhe Jerusalemin e ri. Këto gjëra mezi u plotësuan, pas kthimit të të mërguarve më 539. Realizimi i plotë ende po pret dhe do të ndodhë në kohën e mbretërisë mesianike pas kthimit të Mesisë. Por, çfarë ishin kushtet e të mërguarve gjatë mërgimit? Ku ishin ata? Ç' duhej të bënin dhe çdo të ndalohej? Libri i profetit Jëhezekel bën pak

aluzion për këto. Siç duket, çifutët ishin të vendosur në një krahinë midis Babilonit dhe Urukut, në rrafshinën babilonase, pranë një kanali ujitës të madh me emrin «lumi Hebar» (pranë Nipurit). Sigurisht fjala nuk ishte për ekzistencën e kampit për robërit e luftës, sepse dëshmia shënon që çifutët e mërguar kishin lirinë e madhe të lëvizjes – p.sh. mund të dërgonin lajmëtarë përsëri në Jerusalem. Dihet, ndër të tjera, se profeti Jeremia bëri letërkëmbim me ta kur ishte ende në Jerusalem, para ikjes së tij për në Egjipt si pasojë e dështimit të rebelimit kundër babilonasve. Natyrisht, kishin disa shtrëngime, por mund të mbanin mënyrën e jetës së vet: bujqësinë, kultin fetar, dhe martesën e vet. Ka të ngjarë të ishin të strehuar në shtëpi prej tullash balte, të ngritura në kodrat e braktisura të qyteteve të mëparshme dhe të lashta që ende sot mbulojnë peizazhin e rrafshinës babilonase. Ka të ngjarë të kishin mundësi t'i vizitonin qytetet e mëdha të vendit, ndër të cilat më i madhi ishte Babiloni (Babeli i lashtë) me kopshtet e varura dhe shumë të njohura, fortifikata shumë të mëdha dhe me Portën madhështore të Ishtarit. Profeti Jëhezkel sigurisht pa ziguratët me shkallaret ose kullat tempuj, të cilat i kujtonin Kullën e Babelit. Ajka e të mërguarve, ndër të cilët ishte Danieli, ishte në oborr.

Në librin e Danielit mësojmë diçka për mënyrën e jetesës së tyre si edhe për rivalitetin e interesave dhe besëve që duhej t'i përballonin çifutët. Edhe nga libri i Danielit mësojmë diçka për të ardhmen e kombit izraelit. Në një sërë vegimesh, Perëndia i dha Danielit hollësitë e sakta për të ardhmen, veçanërisht, përsa i përket themelimit të mbretërisë mesianike. Në profecinë e 70 periudhave prej 7 vjetëve, përcaktohet data e ardhjes së Mesisë që doli si hyrja mesianike e Jezusit në Jerusalem, si edhe kryqëzimin që ndodhi një javë më vonë. Profecia vazhdon me njoftim se pas një kohe, do të themelohet mbretëria mesianike pak pas një kohe të tmerrshme të përndjekjes së popullit të Perëndisë. Ende jetojmë në këtë kohë dhe ende nuk ka ardhur ngushtica e madhe dhe e fundit për Izraelin, por shënjat e kohës tregojnë se këto ngjarje po afrohen.

Mërgimi i çifutëve zgjati nga viti 605 (kur u nisen në mërgim të parët çifutë) gjer pak pas vitit 538 (kur u kthye shumica e të mërguarve), por sipas pikëpamjes biblike (në profecinë e Jeremisë) 70 vjet (nga shkatërrimi i Tempullit më 586 deri në rindërtimin dhe rikushtimin e tij më 516).

Gjatë kohës së mërgimit, ndodhën shumë zhvillime përsa i përket fesë së çifutëve. Mjerisht, disa nga këto zhvillime s'ishin aspak pozitive. U veçuan nga ritet e popujve rreth tyre dhe i ndoqën zakonet dhe ritet e tyre të veçanta, duke mbajtur ditën e shtunë dhe ritin e synetit. E

mbanin adhurimin e tyre. Meqë s'kishin asnjë tempull, ngritën shtëpi të lutjes (sinagoga) dhe zëvendësonin flijimet me lutje. Ata i studionin me vëmendje librat e Moisiut si edhe veprat e profetëve të mëparshëm (d.m. th. librat e Joshuas, Gjyqtarëve, Samuelit dhe të Mbretërve). Ata adoptuan gjuhën aramaike.

1) Meqë s'kishin më tempull, filluan të nënvleftësonin rëndësinë e flijimeve që duheshin bërë për ndjesën e mëkateve. Në vend të kësaj, filluan të zhvillonin një sistem shpëtimi me anë të veprave të mira – kryerja e detyrave fetare. Jezusi, kur erdhi, duhej ta korrigjonte këtë prirje, sepse ishte në kundërshtim me shfaqjen e Shkrimit të shenjtë. Njerëzit e kohës së Jezusit u zemëruan për këtë, sepse e kishin zhvilluar sistemin e tyre (në kundërshtim me sistemin e Perëndisë) pa asnjë lidhje me flijimin e Mesisë që duhej të vinte.

2) E dyta prirje e keqe që e trashëguan nga koha e mërgimit ishte lakmia për të holla dhe për tregti, e kjo që atëherë i karakterizon çifutët! Sidoqoftë, një aspekt pozitiv i mërgimit ishte zhdukja e idhujtarisë – që atëherë idhujtaria kurrë s'do të dukej në kombin izraelit.

Mësimi që mund të nxirret nga mërgimi është si vijon: kur Perëndia i disiplinon fëmijët e tij, e bën për të mirën e tyre, që të rifillojnë një jetë të re. Por, ne duhet ta pranojmë disiplinën e Perëndisë me qëndrim të mirë, pa ankim dhe pa justifikim. Atëherë do të mbledhim të korrat e drejtësisë; do të bëhemi më të pjekur, në përputhje me planin e Perëndisë për ne.

KTHIMI NGA MËRGIMI

Çifutët u mërguan në Babiloni. Por, Perëndia i kishte thënë profetit Jeremia se mërgimi do të zgjaste shumë-shumë 70 vjet. Profeti Isaia, gjithashtu, kishte profetizuar rreth 200 vjet më parë se Perëndia do të nxori nga kombet një njeri me emër Kir që do ta përdorte për t'i dhënë fund robërisë së izraelitëve. Dy profetët e kishin parathënë rrënimin e Babilonit. Kishin profetizuar që Babiloni kurrë nuk do të nderohej më si qytet e as që nuk do të banohej më. Kjo profeci u plotësua gjer sot. Kjo së bashku me profecitë e tjera tregojnë se Perëndia është Zoti i historisë, i cili vepron në gjithçka për të mirën e popullit të vet.

Kush do të mendonte se perandoria madhështore babilonase do të merrte fund papritur një natë? Pikërisht ashtu ndodhi. Profecia filloi të realizohej në historinë kur Kiri, mbreti i Anshanit, u bë brenda një kohe të shkurtër pushtues i Lindjes së Afërme. Ai pushtoi Babilonin më 539. Në atë kohë Nabonidi (556-539) ishte mbret, por lejonte birin e tij, Bal-

tazarin, të mbretëronte si nënmbret – atë e ngarkoi me drejtimin e mbrojtjes së kryeqytetit. Kur sulmi armiqësor filloi, Baltazari ishte i pranishëm në një gosti (të shfrenuar) për nder të dy perëndive babilonase, Bel-Mardukut dhe Ishtarit. Me dinakëri Kiri vuri pritë në pjesën e lumit Euftrat, të cilën zakonisht e përdornin për hendek mbrojtës para mureve të qytetit. Kiri e depërtoi sistemin e fortifikimeve duke shkuar shtratit të thatë të lumit. Meqë Baltazari ishte i dehur, s'ishte në gjendje ta drejtonte mbrojtjen e qytetit dhe Babiloni u rrëzua. Baltazarin e vranë dhe e dëbuan në mërgim Nabonidin, atin e tij. Pastaj Kiri ngarkoi mbretin vasal me emrin Astiagu me drejtimin e Babilonit dhe i dha titullin «Dariu» (që do të thotë Pushtues). Një sërë mbretëresh të mëtejme e mbanin këtë titull dinastik. Astiagu kishte qenë më parë mbret i medasve (d.m.th. i Madait), popullit, të cilin Kiri e kishte pushtuar më së pari dhe ia kishte bashkangjitur perandorisë së tij. Për këtë perandorinë e re e quanin medo-persiane.

Kjo na jep një ide për politikën e Kirit, i cili para së gjithash ishte diplomat. Politika e tij ishte kthimi i të mërguarve në vendet e veta dhe nxitja për të rikthyer kultin e tyre. Kështu, më 538 doli urdhërimi i tij e njohur që u dha leje popujve të ndryshëm të ktheheshin në vendet e veta. Atëherë edhe çifutët kishin mundësi të ktheheshin në Jerusalem. Sidoqoftë, të gjithë nuk e shfrytëzuan rastin. Kthimi i lodhshëm, në vendin e tyre, dhe vendosja në kushtet armiqësore kërkonin nga ata një frymë pioniere. Vetëm ata me besim të vërtetë ishin gati për t'u nisur. Kapitujt e parë të librit të Ezrës na tregojnë se si të mërguarit u kthyen dhe se si hodhën pa vonesë themelet e tempullit të ri.

Gjatë mërgimit të tyre çifutët e kishin mësuar aramaishten, e cila ishte gjuha amtare e perandorisë dhe kështu mjet komunikimi i përgjithshëm. Kështu, qysh nga kthimi në atdhe, gjuha e çifutëve ishte aramaishtja. Në **librin e Nehemisë** 8,8 na thuhet se ata bënë një përkthim gojor të Ligjit (d.m.th. në aramaisht), sepse pjesa më e madhe e dëgjuesve nuk e kuptonte më hebraishten.

Perandori persian emëroi Sheshbacarin, guvernator të Judës, njeriun që i kishte shoqëruar të mërguarit prapa në vendin e tyre. Mjerisht çifutët duhej të përballonin kundërshtimin e madh nga popullsia e vendosur në provincën e Judës, me të cilët refuzuan të bashkëpunonin. Për shkak të këtij kundërshtimi, Tempullin e inauguruan 23 vjet me vonesë, në kohën kur Zerubaveli ishte guvernator kurse Jeshua kryepriфт. Profetët Hagai dhe Zëharja e nxitën popullin që ta mbaronin ndërtimin e tempullit. Më 458 (d.m.th. rreth 50 vjet më vonë) erdhi **Ezra**, specialisti i librave të shenjta. Ishte nisur nga Persia për në Jerusalem për të udhëhequr një

mision fetar dhe një reformë të thellë. Ai i kishte marrë leje perandorit persian që ta fuste ligjin e Perëndisë në themel të jetës së përditshme. Prandaj, bëri që të mblihdeshin të gjithë çifutët në një ceremoni fetare ku u detyruan t'i përmbaheshin besëlidhjes që Perëndia e kishte lidhur me të parët.

Ezra bëri një fushatë kundër martesave të përziera. Martesa të tilla ishin të përhapur ndër kryetarët dhe të pasurit. Ezra ishte ndoshta figura më e rëndësishme në jetën fetare çifute që nga koha e Moisiut. Me anë të tij shteti çifut, Juda, (me emër persian provinca e Jahudit) u bë shtet teokratik. Me anë të tij, gjithashtu, u mblodhën librat e shenjta të çifutëve. Ai shkroi i librat e fundit të kanunit çifut (librat e Ezrës, Nehemjës, dhe Analeve) dhe kështu mbaroi kanunin, d.m.th. numrin e librave kano-nike.

Vetëm rreth 50.000 çifutë u kthyen në Izrael. Të tjerët mbetën në Babiloni për arsye tregtare. Edhe të tjerët u shpërngulen më tej në lindje deri në Shushan, në Persi. Në librin e Esterës është shkruar ajo që i ndodhi kësaj kolonie çifutësh midis viteve 483 dhe 473 para erës sonë: se si Perëndia i shpëtoi ata nga një intrigë vrasëse. Atë kohë Kserksi I ishte perandori persian. Libri i Esterës fillon me një gosti të madhe të bërë në Shushan. Tani dihet se ky banket ishte i lidhur me përgatitjet për fushatën ushtarake kundër Greqisë. Më 480 flota e tij pësoi një disfatë të rëndë nga ana e grekëve dhe pas pak u mund edhe ushtria e tij. Kserksi u kthye në Persi shumë i trishtuar. Në këtë rast përpiquej të ngushëllohej me kënaqësitë e pallatit dhe kërkoi mbretëreshë ndërmjet vajzave të bukura të perandorisë së tij. Ai zgjodhi Esterën dhe u martua me të. **Ester**a ishte çifute dhe për këtë ishte në gjendje të ndikonte tek i shoqi që ta shpëtonte popullin e saj nga gjenocidi. Në këtë mënyrë Perëndia e ruajti mrekullisht popullin e vet dhe iu kundërpërgjigj sulmit të atyre që u përpoqën ta shfarosnin popullin e vet. Çifutët gjer më sot e kremtojnë këtë çlirim të shquar në festën e Purimit. Libri përmban një paralajmërim për antisemitët: Lëre të qetë popullin tim: në qoftë se kërkon t'i bësh dëm, dëmi do t'ju kthehet. (Es 9,1)

Ezra e organizoi ekspeditën e tij për në Jerusalem pikërisht 16 vjet pas kremtimit të parë të festës së Purimit. Disa vjet më vonë Kserksi I vdiq dhe më 465 Artakserksi I Longiman trashëgoi fronin. Më 445 Artakserksi I futi një urdhëresë që autorizoi rindërtimin e mureve të Jerusalemit dhe kështu ringjalljen e Izraelit si njësi politike. Perandori persian e emëroi Nehemjën guvernator të Judës dhe e dërgoi në Jerusalem për të kontrolluar zbatimin e urdhëresës. Kundërshtimi u shtyp

dhe pas 52 ditësh mbaroi ndërtimi i mureve. Pas një kohe prej 150 vjetësh kur kishte filluar shkatërrimi i qytetit nga babilonasit, Jerusalemi ishte përsëri qytet i rrethuar dhe i mbrojtur nga muret. Disa vjet më vonë erdhi **Nehemia** përsëri në një mision për ta ndihmuar Ezrën. U bë legjislacion për vazhdimin e kultit në Tempull, por vetë Ezra theksoi veçanërisht bindjen e rreptë të kodit të Moisiut si detyrë të çdo çifuti. Siç kemi parë, ka shumë të ngjarë që Ezra të jetë autori i librave të fundit të Biblës çifute – d.m.th. të Dhiatës së Vjetër. Në **librat e Kronikave** theksohen mësimet shpirtërore që mund të nxirren nga historia e Izraelit. Nga të gjithë librat e DhV, Kronikat paraqet versionin zgjedhës të historisë. Autori nxjerr leksionet morale dhe shpirtërore nga historia e Izraelit. Libri fokuson posaçërisht në mbretëritë e dy mbretëve: Davidit dhe Solomonit. Nga shembujt e cituar, ai na thotë se si të jetojmë dhe si të mos jetojmë (Davidi, Solomoni, Joshija and Hizkija citohen si modelet që duhet të ndjekë Izraeli pas shpërnguljes, sepse pikërisht ata përkrahnin kultin e Tempullit të popullit të Perëndisë). Autori nxjerr kryesisht në pah kthesat e historisë së Izraelit. Ai e ndan historinë e Izraelit në dy epoka: ajo e besëlidhjes së vjetër dhe ajo e besëlidhjes së re mbretërore në të cilën nënvizohen monarkia dhe Tempulli. Tempulli ishte jo vetëm vend adhurimi, por vendi ku silleshin lutjet e popullit, posaçërisht lutjet e rrëfimit dhe ndjesës. Vendi ku u ndërtua Tempulli përkujtonte ndjesën e mëkatit të Davidit i cili kishte urdhëruar rregjistrimin e popullsisë. Marrëdhënia e tij me Batshevën nuk përmendet, sepse s'kishte asnjë lidhje me Tempullin. Te 2 Kronikat 30 hasim skenarin e njerëzve na veriu dhe nga jugu të cilët falen në Tempull, dhe kjo parashkon përfshirjen dhe pajtimin të të dyve. Fjala e fundit i autorit s'është Tora (shpeshherë e shkelur), por ndjesa dhe mëshira që haseshin në Tempull. Libri i Kronikave na paraqet një perspektivë eskatologjike që mungon te librat e Samuelit dhe Mbretërve.

Për të na paraqitur Davidin si mbret ideal (dhe kështu paraardhës i Mesisë), kronisti lë jashtë mosmarrëveshjet e brendshme, grindjet, tragjeditë brenda familjes mbretërore: vrasjen e Amonit, krzengritjen e Avshalomit, fitlat e Adonisë, mëkatin e Davidit etj. E njehta gjë vlen edhe për Salomonin. Lihet jashtë lakmia për shumë gra, të cilave në haremin e tij u dha liri të mëdha në ushtrimin e kultit të tze pagan, dëshira e madhe e pasurimit, vrasjet e vëllezërve e të bashkëpunëtorëve etj.

Së pari, Perëndia sheh gjithçka. Kujdeset për pasqyrimin e karakterit të tij në popullin e tij – e ka shumë për zemër drejtësinë sociale dhe politike. Me fjalë të tjera, Perëndia refuzon gjithçka që ka të bëjë me

opiumin e popullit – d.m.th. hipokrizinë fetare. Kërkonte mes popullit të vet gjykata të paanshme, tregti të drejtë në shesh, pagën e drejtë të punës, bujarinë ndaj të varfërve dhe atyre pa mbrojtje, si edhe adhurimin besnik e të singert.

Mësimi i dytë ishte si vijon: Izraeli s'ishte viktimë e fatit të verbër, por kishte përgjegjësi për katastrofat që ranë mbi të. Perëndia kishte paralajmëruar kombin për alternativat para tij. Perëndia e kishte me gjithë mend atë që tha. Kjo u provua në kohën e mbretit Hizkija, sepse kur dëgjoi dhe u poshtërua për të pranuar këshillën e profetit të Perëndisë, Jerusalemi u shpëtua gjallë.

Mësimi i tretë ishte si vijon: përgjegjësia e njeriut s'ishte në kundërshtim me të vërtetën që punët e njerëzve dhe të kombeve të jenë nën kontrollin e fundit të Perëndisë. Ai është Zoti i historisë si edhe Krijuesi i gjithësisë. Ai mund t'i merrte mbretërit e Babilonisë dhe të Persisë dhe t'i përdorte si vegla të panjohura për qëllimet e tij. Kështu, pra, mosbindja e Izraelit nuk mund t'i pengonte qëllimet e fundit të Perëndisë. Meqë mbretërit e Izraelit kishin qenë të pabesë, Perëndia do të nxirrte nga gjiri i popullit një sundimtar sipas dinastisë së Davidit që do të kryente tërë vullnetin e tij. Meqë kushtet e besëlidhjes së mëparshme u shkelën, Zoti do të lidhë një besëlidhje të re me Izraelin, do t'ia falë mëkatet dhe do të bëjë që Izraeli t'u bindet ligjeve të tij.

Në fund librat e Kronikave u shkruan nga perspektiva ideale. Theksohen vlerat e qëndrueshme të institucioneve të Izraelit, që do të rikthehen me kthimin e Mesisë: tempulli, mbreti hyjnor (Mesia), vendi i ripërtërirë dhe populli i rilindur me Shpirtin e Zotit. Librat e Mbretërve u shkruan (nga Isaia) nga një perspektivë tjetër, për të theksuar dështimin e Izraelit, pothuajse si prolog për librin e Isaisë, që vjen menjëherë pas librave të Mbretërve, sipas renditjes hebraike të Biblës.

Premtimet me pasoja të shumta mbeteshin të paplotësuara kur u ndal profecia: kaluan shekuj, megjithatë ata që qëndronin besnikë në Izrael kurrë nuk humbën bindjen e tyre që, në kohën e duhur, do të ndërhynte Zoti i historisë për të plotësuar gjithçka që u kishte premtuar. Kjo ndodhi me lindjen e Jezusit, Mesisë, kur u vu në lëvizje plani i fundit i Perëndisë.

Analiza e librit të parë të Kronikave

Gjithçka fokusohet te Davidi, mbreti ideal dhe paraardhës i Mesisë.

Kapitujt 1-9 përmbajnë lëndën gjenealogjike më të gjerë të Dhiatës së Vjetër. Megjithatë këto gjenealogji janë sphesh zgjedhëse dhe

stilizuara. Ato theksojnë rendësinë e dinastisë së Davidit (nga erdhi Mesia) dhe rendësinë e fisit të Leviut (nga erdhi priftëria).

Në kapitujt 10-19 flitet për mbretërimin e mbretit Davidit.

- Hipja e tij në fron pas vdekjes së Shaulit (10-12).
- Mbretërimi i tij (13-29), duke përfshirë sjelljen e arkës në Jerusalem. (15-16), besëlidhja që lidhi Perëndia me të (17), regjistrimi i tij i mëkatshëm i popullsisë, dhe si pasojë 70.000 veta vdiqën (21), përgatitjet për ndërtimin e Tempullit të Solomonit (22).
- Vdekja e tij, dhe hipja e Solomonit në fron (29:22-30).

Analiza e librit të dytë të Kronikave

Në kapitujt 1-9 flitet për mbretërimin e lavdishëm të Solomonit .

- Lutja e tij për urtësi kur hipi në fron (1).
- Tempulli i tij (2-7).
- Mbretërimi i tij (8-9).

Kapitujt 10-36,21 fokusojnë në mbretërit e Judës që nga ndarja e mbretërisë deri në vdekjen e Solomonit dhe pasojat e luftës civile deri në largimin në Babilon. Megjithëse historia e kësaj periudhe caktohet nga rënia për shkak të pabindjes së popullit ndaj ligjit të Moisiut, shumica e lëndës ka të bëjë me tetë mbretërit të mirë që kërkuan të rimëkëmbnin jetën shpirtërore të kombit. Disa nga mbretërit që u përpoqën ta kthenin Judën te Perëndia ishin:

- Asa (14-15).
- Jehoshafati (17-20).
- Joashi (23:16-24:16).
- Hizkija (29-32).
- Joshija (34-35).

Me gjitha përpjekjet e tyre të mira, reformat e tyre kurrë nuk vazhduan më gjatë se një gjeneratë para se populli t'i ktheheshin shpinën përsëri Perëndisë. Në kapitullin 36.22-23 flitet për dekretën e Kirit, perandorit të Persisë , që ia dha mundësinë popullit për t'u kthyer te Palestina në fund të robërisë. Kjo ngjarje na çon te libri që vazhdon, Ezra, ku flitet për kthimin nga mërgimi.

LIBRI I ESTERËS

HYRJE

Në fund të mërgimit, vetëm rreth 50 000 hebrenj ishin kthyer në Izrael. Të tjerët kishin qëndruar në Babiloni për arsye tregtare. Akoma të tjerët kishin migruar më në lindje në Shushan të Persisë. Libri i Esterës na tregon se çfarë ndodhi me këtë koloni hebrenjsh midis 483 dhe 473, si Zoti i shpëtoi ata nga një komplot për t'i vrarë. Në atë kohë Kserksi I ishte perandor. Libri hapet me një banquet të shkëlqyeshëm që ai shtroi në Shushan. Tani e dimë që ky banquet dhe festat shoqëruese ishin të lidhura me fushatën ushtarake të afërt kundër Greqisë. Por në vitin 480 flota e Kserksit I u mund shumë nga grekët dhe pak më vonë ushtria e tij u mund gjithashtu. Ai u kthye në Persi një njeri i dëshpëruar. Ishte në këtë fazë që ai u përpoq të ngushëllohej me kënaqësitë e pallatit dhe kërkoi një mbretëreshë midis të gjitha vajzave të bukura të perandorisë së tij. Ai zgjodhi Esterën dhe u martua me të. Estera ishte një hebre dhe ishte në gjendje të ndikonte aq shumë tek burri i saj, sa që njerëzit e saj u shpëtuan nga gjenocidi. Në këtë mënyrë Zoti e ruajti për mrekulli popullin e tij dhe u ktheu tryezat atyre që kishin kërkuar t'i likuidonin. Kjo çlirim i jashtëzakonshëm ende festohet ndër hebrenjtë në festën e Purimit. Libri përmban një paralajmërim për antisemitët, Lëreni popullin tim të qetë; nëse përpiqeni t'i dëmtoni ata, dëmi do të kthehet mbi ju (Es 9, 1).

FENOMENI I PROFECISË

Kur mendojmë për fjalën profeci, shpesh kemi në mendje parashikimin e së ardhmes, por në Bibël ky term ka kuptim më të gjerë. Profetizoj do të thotë flas nën frymëzimin e Shpirtit të Perëndisë: «kështu thotë Zoti». Profetët kishin, gjithashtu, dhuntinë e leximit të mendimeve njerëzore (shikimin e të padukurave). Ky përkufizim duhet të vlejë edhe për profetët e DhR. Misioni kryesor i profetëve në kohën e DhV ishte kthimi i popullit të Perëndia dhe të bindja e mëparshme ndaj besëlidhjes. Në qoftë se populli nuk do të pranonte thirrjen e tyre për pendim dhe kthimin të Zoti, atëherë do të plotësoheshin profecitë për mërgimin dhe shkatërrimin kombëtar.

Kështu, ndryshe nga apokaliptika, profecia kishte një element kushtëzues. Prandaj profetët duhen konsideruar brenda kuadrit të fatit kombëtar të Izraelit; ata ishin zëdhënësit e Perëndisë.

Profecitë biblike kanë të bëjnë, pra, me kombin e Izraelit. Por si mund të dinin dëgjuesit nëse profetët ishin të vërtetë? Për këtë, prej tyre kërkoheshin dy prova:

1. Ajo që thoshnin profetët duhej të ishte në përputhje me pjesën tjetër të shkrimeve me ardhje profetike (d.m.th. DhV). Kjo do të provonte nëse frymëzuesi i profecive të tyre ishte edhe frymëzuesi i shkrimeve të shenjta të tjera (d.m.th. Perëndia). Profecia mund të jetë me prejardhje të ndryshme:

- a) burimi njerëzor – ndonjë njeri me fantazi mund të shtiret si profet.
- b) burimi djallëzor – edhe Satani e njëj të ardhmen dhe ka interes t'i mashtrorë njerëzit, duke përzier elemente të vërteta me elemente mashtruese. Ndryshe nga mashtrime të tilla, nga profecia biblike kërkohet saktësia e plotë.

2. Të paktën një nga profecitë e profetit duhej të plotësohej gjatë kohës sa ishte gjallë profeti.

Pra, profecia shërben si kredencialet e folësit, për të vërtetuar mesazhin e tij nga Perëndia.

Prejardhja hyjnore e profecive biblike shihet si vijon:

1. Faktori i probabilitetit: statistikisht është e pamundur që përmbushja e profecive biblike të jetë fryt i rastësisë.

2. Faktori kombëtar: profecia biblike ka të bëjë me Izraelin dhe me kombet që kishin historikisht ndonjë lidhje me të. Profecia tregon se Izraeli ka një marrëdhënie të veçantë me Zotin, për të mirë ose për të keq. Është e pamundur të shpjegohet historia dhe fati i Izraelit nga ana

thjesht njerëzore.

Ngjarjet për të cilat bëhet fjalë te profecitë e DhV, janë, pra, ngjarje kombëtare, si p.sh. mërgimi, kthimi, rikthimi shpirtëror, ardhja e Mesisë (mbretit kombëtar dhe ndërkombëtar), si dhe rikthimi i mbretërisë së Izraelit.

Përmbajtja e profecive:

1. Profecitë që përmbushen gjatë kohës që profeti është gjallë. P.sh. Ezekieli (Ezekieli) shpall se kombi do të mërgohet për shkak të pabesnikërisë. Kjo profeci përmbushet pas mërgimit të Ezekielit në Babilon, dhe qysh atëherë të mërguarit marrin seriozisht profecitë e tij të tjera.

2. Profecitë që përmbushen para fundit të periudhës së DhV. P.sh. profecia e Ezekielit rreth shkatërrimit të plotë të Tirit, ku thuhet se:

Prandaj unë, Zoti, i them Tirit: «Ti ke të bësh me mua! Do të bëj që shumë popuj të hidhen kundër teje, ashtu siç përplasen deti në shkëmbinj. Muret do të t'i bëjnë rrafsh me tokën dhe kullat do të t'i shembin. Do ta largoj tërë dheun tënd, që vetëm shkëmbi i zhveshur të dalë mbi ujë. Peshkatarët do të shtrijnë mbi të rrjetat për t'i tharë. Unë, Zoti, do ta realizoj (këtë). Popujt do të të plaçkitin dhe do t'i shkatërrojnë qytetet e tua simotra në stere. Do ta provoni se unë jam Zoti.» (Ezekieli 26,3-5).

Babilonasit e rrethuan qytetin për 13 vjet (585-573), qyteti kapitulloi dhe mbretin e zunë rob, por vetëm më vonë (më 332) Aleksandri i Madh, pas një rrethimi 7 muajsh, e përfundoi plotësimin e profecisë për shkatërrimin e qytetit.

3. Profecitë rreth ardhjes së Mesisë në trajtën e Shërbëtorit të Zotit (tek Isaia dhe Psalmet).

4. Profecitë rreth ardhjes së Mesisë si sundimtar paqeprurës (shih Daniel dhe Isaia), që do t'i mundë kombet pagane për të ngritur mbretërinë e tij të dukshme.

5. Profecitë apokaliptike, kryesisht profecia e fshehtësisë së 70 vjetëve, është çelësi i të gjithë profecive pas Danielit, sepse flet për ngjarjet historike që do të na çojnë te ngritja e mbetërisë mesianike.

Tiparet e profecive të DhV:

- 1) Thirrje ndaj vullnetit të dëgjuesve: Pendohuni, ndryshe...
- 2) Zoti do ta ndëshkojë Izraelin (me disfatë dhe mërgim) në qoftë se nuk pendohet duke respektuar përsëri kushtet e besëlidhjes.
- 3) Zoti do t'i ndëshkojë ato kombe që ishin armiq të Izraelit, d.m.th. ose si internuesit, ose si ata që bashkëpunuan me internuesit.
- 4) Zoti do t'i ndëshkojë kombet për shkeljen e të drejtave të njeriut,

sepse ato të drejta përputhen me karakterin e tij të shenjtë.

5) Zoti do ta shkaktojë rënien e atyre kombeve në të cilët Izraeli mbështetej duke lidhur marrëveshje me to. Kjo ndodhë zakonisht kur asirianët, babilonasit ose grekët zbresin hijerëndë duke gëlltitur gjithçka që gjendet në rrugën e tyre.

6) Megjithë dosjen e mjerueshme të Izraelit, Zoti do të ketë fjalën e fundit (në të ardhmen e largët). Shumica e këtyre profecive kanë të bëjnë me rikthimin e Izraelit dhe me mbretërinë mijëvjeçare të Krishtit. Fragmente të tilla gjenden pothuajse te çdo profet.

Përfundim: Perëndia i Izraelit është Perëndia që drejton historinë – këtë e provon përmbushja e profecive. Prandaj duhet të marrim seriozisht ato që thotë Zoti dhe t'i besojmë lajmit të mirë. Atëherë do të shpëtojmë dhe do të kemi një fat të mrekullueshëm.

PROFETËT E BESËLIDHJES SË VJETËR

Në Izrael ekzistonte një klasë njerëzish të cilët nëpërmjet muzikës dhe vallëzimit kalonin në përçartje dhe mendonin se kjo ishte mënyrë me të cilën zbulohet Perëndia. Mbreti Ahav kishte në shërbim të tij 400 profetë të tillë; mënyra se si ata merrnin një përgjigje të caktuar nga Perëndia lidhur p. sh. me një fushatë që mendonin të ndërmerrenin, nuk ndryshonte aspak nga ajo e profetëve të Baalit të cilët rropateshin për të marrë një përgjigje nga perëndia e tyre në malin e Karmelit. Ky profetizim praktikohet edhe në vendet fqinje dhe shumë mbretër mbanin në oborret e tyre njerëz të tillë.

E veçanta e këtyre grupimeve në Izrael qëndronte në faktin se këta njerëz njiheshin si bashkëbisedues të Perëndisë së Izraelit; ata njiheshin si shërbëtorë dhe zëdhënës të Perëndisë. Gjatë gjithë monarkisë në ndeshemi me njerëz të tillë, që prej Natanit i cili u bë përkthyesi i zemërimit hyjnor përballë poshtërsisë së Davidit dhe deri tek Uri i cili fliste si Jeremia kundër profetëve të rremë dhe që guximin e tij e pagoi me jetë.

Për t'u theksuar është fakti se pothuajse të gjithë profetët shkrimtarë u ngritën gjatë momenteve të krizës kombëtare.

Mund të dallojmë katër grupe profetësh që korrespondojnë me katër periudha të ndryshme të historisë të popullit izraelit:

- a) Grupi i parë: Elija, Elisha dhe Joeli, profetë të shekullit të 9-të.
- b) Grupi i dytë: Jona, Isaia, Hoshea, Amosi dhe Mikeja, profetë të shekullit të 8-të.
- c) Grupi i tretë: Jeremia, Obadja, Nahumi, Habakuku, Cefanja dhe

Ezekieli, profetë në fundshekullin e 7-të, pak përpara internimit në Babiloni.

d) Grupi i katërt: Hagai, Zakaria dhe Malahiu, profetët e epokës së kthimit nga internimi dhe të restaurimit në fundshekullin e 6-të dhe në të 5-tin.

Hoshea dhe Amosi u shfaqën, p.sh., nga fundi i lulëzimit të mbretërisë së Jaravamit II dhe Joshijës, në të cilin ndikoi edhe dobësimi i Asirisë. Tregtarët dhe funksionarët, që tregoheshin të padrejtë ndaj klasave të thjeshta, mirëqënien në të cilën jetonin e shikonin si rrjedhojë materiale të zgjedhjes së Izraelit dhe për këtë arsye ata i mbyllnin veshët ndaj thirrjes për hakmarrje në qiell. Pikërisht gjatë kësaj krize një blegtor nga fshati Tekoa shpalli humbjen dhe shpërnguljen. Amosi i shpalli këto lajme në emër të Zotit që nuk mund t'i durojë dot kurrsesi e kudoqofshin padrejtësitë, aq më pak te populli i tij i zjedhur.

Më pas Hoshea do të thërrasë se korrupsioni moral është mosbesnikëri ndaj bashkëshortit besnik dhe të ndershëm. I braktisur nga gruaja të cilën ai ende vazhdon ta dojë, Hoshea në mes të kataklizmave kërcënuese sheh shprehjen e një dashurie të plagosur.

Në vitin 745 para Krishtit, në fronin e Asirisë erdhi Tiglat-Pilezeri. Ai fillimisht iu përvish punës për organizimin e vendit të tij. Por vetëm pas disa vitesh çifutët arritën të kuptonin se çfarë kishte vërtet në mendje ky njeri, gjoja në emër të perëndisë Asur; njerëzit mendjehollë parafytyronin me tmerr mundësinë e një zhdukje të ardhshme të Izraelit dhe Judës; a do të ishte ky fundi i mbretërisë së Zotit? Pikërisht në këtë moment, Jeshaja (gr. Isaia), një njeri i kulturuar dhe me talent, pësoi eksperiencën dërrmuese të Perëndisë së shenjtë të Izraelit, të Zotit të vetëm dhe absolut, të Mbretit. Ai guxoi atëherë të shpallte se, edhe ngadhënjimtari më i fuqishëm i botës nuk është veçse një shkop të cilin Perëndia e ka marrë diku përtej Euftratit për të ndëshkuar popullin e tij. Së shpejti popujt e Sirisë dhe Izraelit do të diskutohen për jetë a vdekje, vetëm në Izrael do të jetojë besimtari, d.m.th. ai që mbështetet vetëm tek Zoti.

Një shekull më vonë babilonasit pushtuan mbretërinë asiriane dhe filluan praktikimin e metodës së tyre internuese. Fundi i Judës ishte i afërt. Jeremia, një njeri i ndjeshëm dhe i vetmuar, por gjithnjë në lidhje me Perëndinë, e përjetoj si rilindjen gjatë sundimit të Joshijës dhe dështimin e masave të marra prej tij, ashtu edhe shkatërrimin e Judës si komb. (Ah, sikur Zoti të mundte të vendoste në zemrat e këtyre njerëzve urdhërimet e tij!). Të mërguarit më 587 u pritën në Babiloni nga Ezekieli, shpëtimtari i çuditshëm, por që kishte mjaft influencë në këtë

vend të largët për shkak të besimit të tij. Rreth vitit 520 një grup izraelitësh u kthyen në vendin e tyre, por në vend të gëzimit ata pësuan zhgënjim tek shihnin gërmadhat e «qytetit të Tempullit». Pikërisht ky moment shënoi dhe fillimin e një krize të re e cila do t'i pengonte profetët (Hagai dhe Zakaria).

Profetët jetuan në mesin e popullit dhe mesazhi i tyre bëhet më i kuptueshëm nëse vendoset në kuadrin përkatës historik. Duke mos qënë ëndërrues, poetë apo filozofë, ata i ndanë dhe i përjetuan intensivisht gëzimet dhe ankthet e Izraelit. Në çdo vend profetët shihnin dorën e Perëndisë së gjallë dhe të shenjtë nga i cili kishin marrë prirjen për të qenë shërbëtorë të tij.

Për më tepër, predikimet që ata iu përcillnin bashkëkohësve të tyre kishin më shumë karakter paralajmërues, sesa parashikues për ngjarjet që do të pasonin. Madje edhe kur shpallën lajmin mbi ardhjen e mbretërisë të Perëndisë e të Mesisë, ata kishin si qëllim të nxisnin, të paralajmëronin, të ngushëllonin dhe të drejtonin thirrjen për pendim, duke i dhënë kështu popullit shpresë. Ata nuk bënë asnjëherë llogari apo parashikime shifrore. Profetët ishin para së gjithash dëshmitarët e palodhshëm dhe shpesh të persekutuar të vullnetit të Perëndisë, kërkesat absolute të të cilit ata i kujtonin pa u lodhur.

ISAIA

Isaia (hebr. Jeshaja) lindi rreth viteve 765. Në vitin e vdekjes së mbretit Hoshe, më 740, atij iu besua misioni i shpalljes së shkatërrimit të Izraelit dhe Judës si ndëshkim për pabesnikërinë e popullit (Për këtë lexojmë në librin e Isaisë 6,1-13). Vitet gjatë të cilave Isaia kreu misionin e tij, rreth 40 vjet, dominoheshin nga kërcënimi gjithnjë e më i madh që Asiria ushtronte mbi Izraelin dhe Judën.

Sipas një tradite çifute, Isaia vinte nga një familje mbretërore, meqenëse ishte djali i Amocit, vëlla ky i mbretit Amaçja. Ndërsa Mihaja, bashkëkohësi i tij, profetizonte përjashta, Isaia, i cili jetonte në Jerusalem, hynte në oborrin mbretëror. Ai jetoj në periudhën e katër mbretërve, Uzija, Jotami, Ahazja dhe Hizkija. Sipas traditës, ai vdiq i moshuar. Atë e persekutuan në periudhën e mbretërimit të Mënasheut, e vendosën brenda një trangu cedre dhe e sharruan.

Portreti i profetit: Rreth viteve 740 p. Krishtit, një njeri hidhet për tokë në Tempullin e Jerusalemit, si pasojë e vegimit shenjtëruës të Perëndisë. Ai dëgjon thirrjen hyjnore, del vullnetar dhe thotë: «Ja ku jam!»

Dhe këtij njeriu iu besua misioni aq i vështirë, ai i shpalljes së ndëshkimit të popullit jobesnik, që për aq kohë nuk pranoi të dëgjonte Zotin e tij (Isaia 6). Isaia dallohej gjithnjë për prirjet e tij në Tempull mbi shpalljen e transhëndencës së Perëndisë dhe të padinjitetit të njeriut. Në mendimet e tij për Perëndinë dallohet triumfi dhe tmërri.

Perëndia është i Shenjti, është i Forti, i Fuqishmi, Mbreti. Ndërsa njeriu është një mëkatar të cilin Perëndia do ta përmirësojë. Ai dëshiron që njerëzit t'i jenë besnikë, Ai kërkon të ketë drejtësi në marrëdhëniet shoqërore si dhe të tregohet sinqeritet ndaj Tij.

Isaia nuk është aspak asket që del nga shkretëtira për të thënë fjalë kërcënuese. Jo, ai është baba i dhimbshur që frekuenton klasën e pasur të Jerusalemit dhe që ka hyrje të lirë te pallati i mbretit. Ai e do gruan dhe dy fëmijët e tij. Shtëpia e tij është dëshmi e misionit të tij, është një shenjë që tregon se Perëndia e ka zgjedhur atë për t'i folur popullit. Për më shumë se 40 vjet me rradhë ai foli dhe veproi.

Duke i qëndruar besnik misionit të tij për shpalljen e ndëshkimit hyjnor, ai asnjëherë s'i humbi shpresat për shpëtimin e popullit. Perëndia dënon kur e gjykon të arsyeshme, Ai do ta shpëtojë popullin e tij, në mënyrë që mbi tokë të vendoset mbretëria e tij e drejtësisë dhe lumturisë. Shpëtimi do të vijë; shenjat e tij janë dhënë tashmë nëpërmjet fëmijës së vogël që do të marrë emrin Imanuel, domethënë Perëndia me ne.

Errësira do të marrë një ditë fund, sepse një fëmijë ka lindur. Toka e Izraelit do të shndërrohet, kafshët do të jetojnë në paqe, dhe një fëmijë do t'i drejtojë ato, pa dyshim. Pjesa tjetër e vogël e popullit që i ka shpëtuar zemërimit të Perëndisë do të kthehet te Perëndia i tyre dhe do të krijojë popullin e së ardhmes. Lajmërimi i tmerrshëm i këtij ndëshkimi nxjerr më shumë në pah perspektivën e shkëlqyer të «tepricës së popullit» të cilën do ta shpëtojë fëmija mesianik, i cili do të vendosë mbi të gjithë tokën drejtësinë e Perëndisë. Ai do të rikthejë, gjithashtu, Krijimin, në bazë të shëmbëlltyrës së asaj që ekzistonte përpara korrupsionit të mëkatit.

Përmbajtja e librit

1-12 profecitë kundër Jerusalemit dhe Judës

13-23 profecitë kundër kombeve

24-35 premtimet

36-39 tregimi i aktivitetit të Isaisë gjatë sulmit të Senaheribit.

Eshatologji

Sipas librit të Isaisë historia focusohet në tri etape kryesore. :

1. Kthimi i Izraelit nga mërgimi .
2. Ardhja e parë e Krishtit (sidomos shërbimi i Shërbëtorit pësimtar – Birit të njeriut)
3. Kthimi i Krishtit.

Këto tri etapet e realizimit të planit të Perëndisë ndahen me vështirësi, sepse Isaia përdor një terminologji të ngjashme për t'i përshkruar të gjitha. Rruga e ndërtuar për të përgatitur ardhjen e Zotit vlen për të gjitha tri etape. Gjithashtu, lajmi i mirë për ardhjen e Zotit lidhet me kthimin nga mërgimi, si dhe me ardhjen dhe kthimin e Krishtit.

Përmbledhje: Këto profeci ishin përgjithësisht të mbushura me kërcënime e aluzione ndaj ngjarjeve që ndodhën nën mbretërimin e Ahazjes dhe Hizkijes.

1,27: Cioni do të shpengohet me drejtësi, kurse populli i tij kthues me drejtësi. Fjala drejtësi do të thotë të jetë në rregull (në përputhje me atë që është e drejtë), por mund të kuptohet si të vërë dikënd ose dikë në rregull = të shpëtojë. Kështu, drejtësia do të thotë rruga e Zotit të shpëtimit. Fjala mund të thuhet të mbrojë ose të korr fitore. Të gjitha këto kuptime ndodhen në DhR që duhet interpretuar sipas kuptimit në librin e Isaisë. Ky zbulim i hapi sytë Luterit.

Kapitujt 40-55 shkëputen nga konteksti historik dhe janë ngushëllues. Gjykimi u krye me shkatërrimin e Jerusalemit, dhe koha e rikthimit është afër. Një rinovim tërësor parashikohet në sajë të Personit dhe Veprës së Mesisë. Monoteizmi afirmohet doktrinalisht dhe boshllëku i perëndive të kota tregohet nga pafuqia e tyre. Urtësia dhe providenca e pafund e Perëndisë theksohen edhe më. Për herë të parë shprehet qartësisht gjithanshmëria fetare.

Në shërbim të kësaj ideje janë katër këngët e Shërbëtorit (4 pjesët lirike): 42,1-4; 49,1-6; 50, 4-9; 52,13; 53,12. Këto janë pikërisht tekstet e Shërbëtorit që vuan dhe vdekja e tij pajtuese për mëkatet e popullit, të cilat Jezusi i ka aplikuar në veten e tij dhe misionin e tij (Luka 22,19-20. 37; Marku 10,45; Mateu 12,17-21 dhe Gjoni 1,29).

Kapitujt 56-66 bëjnë fjalë për ngjarjet e fundit të kohërave dhe para së gjithash ato të mijëvjeçarit (një numër të madh të këtyre rreshtave i gjejmë edhe tek Apokalipsi 21, ku përshkruhet Jerusalemi mesanik.). Megjithatë këta kapituj theksohen nga dënimi i idhujtarisë dhe nga thirrjet për pendim drejtuar bashkëkohësve të Isaisë (sipas mënyrës së Apo-

kalipsit 21,7; 22,15), sepse idhujtaria ishte e panjohur pas kthimit nga mërgimi. Fragmentet që profetizojnë mijëvjeçarin janë: 2,1-4;11,6-9; 60,61,65,66.

Isaia profetizon duke prekur ngjarje të tilla si: mbretëria e Veriut dhe rënia e saj, mbretëria e Jugut dhe rënia e saj, mërgimi, kthimi dhe roli i Kirit (tip mesie), shërbimi i Shërbëtorit, mbretëria mesianike (mijëvjeçari).

Sfondi historik

1) Profecitë e parë u përkasin viteve që ndajnë prirjen e tij nga ardhja në fuqi e Ahazjës më 736 para lindjes së Krishtit. Atëherë Isainë e shqetësonte më së shumti korrupsioni moral se sa pasuria e Judës (kapitujt 1-5).

2) Mbreti i Damaskut, Recini, dhe mbreti i Izraelit, Pekahu, donin ta futnin Ahazjën e ri në një koalicion kundër mbretit të Asirisë, Tiglat Pilezerit III. Pas refuzimit nga ana e tij, ata e sulmuan Ahazjën dhe ky i bëri thirrje Asirisë. Isaia më kotë u mundua ta pengonte këtë politikë kaq humane. Kjo periudhë përshkruhet mjaft mirë në kapitujt 7,1-11,9, 15,26-29, 17,1-6, 28,1-4. Pas dështimit të misionit të tij, Isaia u tërhoq nga skena publike.

3) Drejtimi i Ahazjës ndaj Teglat Pilezerit III e vuri Judën nën tutelën e Asirisë dhe kështu përshpejtoi shkatërrimin e mbretërisë së Veriut.

Pas aneksimit të një pjese të territorit më 734 para lindjes së Krishtit, presioni i huaj u shtua mjaft dhe më 721 Samaria ra në duart e asirianëve. Në Jude, vendin e Ahazjës e zuri Hizkija. Ai ishte një mbret i mëshirshëm dhe plot ide. Por intrigat politike filluan të shfaqeshin përsëri dhe këtë herë kërkohet mbështetja e Egjiptit kundër Asirisë.

(Isaia 7,14): Përmbushja e dyfishtë e profecisë rreth Imanuelit: sipas disave «virgjëresha» do të jetë profeteshja me të cilën u martua Isaia pak pas dhëniës së profecisë. Në kohën kur u dha profecia (735), ajo ishte vërtet virgjëreshë. Kjo do të ketë ndodhur më 721, sepse nga kjo kohë do të jetë përmbushur profecia, falë fushatës shkretuese të Shalma-necarit V dhe të Sargonit; Damasku ra më 731 kurse Izraeli (mbretëria e veriut) më 722. Vetëm më vonë, nën Ashurbanipalin (669-626), Izraeli u risistemua. Sidoqoftë përmbushja përfundimtare realizohet në personin e Mesisë: vini re dy tiparet domethënëse të profecisë:

1. Virgjëresha do të mbetet me barrë (kur ajo është ende virgjëreshë), gjë që ishte shumë e pazakonshme dhe madje e paparë.

2. Emri i fëmijës është Imanuel (Perëndia me ne), që duhet t'i referohet

Mesisë, sepse asnjë mbret tokësor nuk mund t'i mbushë këto kërkesat.

3. Përmbushja e pjeshme, që të vërtetohen kredencialet e Isaisë, si dhe përmbushja përfundimtare.

Në këtë rresht bëhet fjalë për tri fëmijë:

1. Shear-jashuvi (do të kthehet pakica) që Isaia e mori me vete kur shkoi për të folur me Ahazin. Në të vërtetë vetëm një e dhjetë e popullsisë u kthye nga mërgimi.

2. Immanueli që u ngjiz disa 12 vjet para ngjarjeve të profetizuara.

3. *Maher-shalal-hash-bazi* (plaçkitja e shpejtë – grabitja e lehtë) që u ngjiz 3 vjet para ngjarjeve të profetizuara (kur mund të thoshte vetëm «mama ose babi!»)

Isaia, duke u qëndruar besnik parimeve të tij, preferonte më shumë t'i besohej Perëndisë sesa aleancave ushtarake. Këtij fillimi të mbretërimit të Hizkijës i kushtohen kapitujt: 14,28-32, 18, 20, 28,7-22, 29,1-14, 30,8-17. Pas shtypjes së revoltës dhe marrjes së Ashdodit nga Sargoni (kap. 20), Isaia ra në qetësi.

4. Më 705 Isaia u tërhoq në kryengritje kundër Asirisë. Më 701, Senakeribi plaçkiti Palestinën, por mbreti i Judës donte të mbronte Jerusalemin. Isaia e mbështeti atë dhe premtoi shpëtimin nëpërmjet Perëndisë. Qyteti u çlirua vërtet. Kësaj periudhe i përgjigjen kapitujt 1,4-9, 10,5-15, 27b-32, 14,24-27, si dhe pasazhet nga 28-32 për të cilat nuk u fol në periudhën paraprirëse. Për aktivitetin e Isaisë pas 700, nuk dimë asgjë. Sipas një tradite çifute ai u mundua nën sundimin e Mënasheut.

Shërbëtori i Zotit. Perëndia e ngushëllon popullin e tij në vuajtje (40-41) dhe këtij populli i është dhënë një mision që ende nuk është përfunduar (42-44). Ngjarjet historike janë në duart e Zotit, krijuesit të tokës dhe zot të të gjithë njerëzve. Ai e dërgoi Kirin, perandorin e Persisë, për të çliruar Izraelin (45-48) dhe për të shkatërruar fuqinë babilonase. Kombet janë, pra, veglat e Perëndisë për përmbushjen e planit të tij. Perënditë e popujve nuk janë veçse idhuj të prodhuar nga vetë njerëzit.

Gjatë këtyre diskutimeve, mbi të gjitha, del në pah një figurë, tiparet e së cilës nuk mund të kuptohen lehtë dhe personaliteti i të cilës është burim i hipotezeve të shumta; shërbëtori i Zotit. Ky shërbëtor ka një mision të veçantë për Izraelin dhe për kombet; ai do të flasë në emër të Zotit, ai do të jetë drita e kombeve, ai do të njohë përcmimin dhe vuajtjen, por kjo do të jetë për shkak të mëkateve të popullit. Ai do të mbajë mbi vete padrejtësinë dhe do të vdesë. Megjithatë vepra e tij do të mbrohet për shfajësimin e shumëkujt.

Ky shërbëtor quhet Jezus dhe ai ka ardhur për të shpëtuar popullin e

tij nga mëkatet. Ai është çelësi i fatit të popullit izraelit – mbreti që do të vendosë mbretërinë e tij. Por për këtë duhet që më parë të lahen mëkatet e popullit. Sipas profetit Zeharja në momentin e kthimit të Jezusit, populli do t'i afrohet kësaj fajshlyerje me një pendim të thellë (Zeharja 12,10-13). Duke pritur këtë ngjarje të lavdishme, Perëndia me mëshirën e tij, krijoi një Kishë të përbërë nga çifutët dhe paganët, e cila mbështetet në veprën fajshlyese të Jezusit, Mesisë.

Isaia është, pra, një nga profetët më të mëdhenj mesianikë. Mesia që ai lajmëron është një pasardhës i Davidit (që do të zërë fronin e Izraelit), i cili do të bëjë që në mbarë botën të sundojë paqja e drejtësia dhe do të shpërndajë njohjen e Perëndisë.

JEREMIA

Rreth një shekull pas Isaisë, më 650 para lindjes së Krishtit, nga një familje priftërore lindi Jirmja (gr. Jeremia). Familja e tij në atë kohë jetonte në rrethinat e Jerusalemit. Jeta dhe vepra e Jeremisë na bëhet e njohur, më mirë se ajo e profetëve të tjerë, nëpërmjet tregimeve biografike të shkruara në vetën e tretë dhe të cilat i gjejmë në librin e tij në këta kapituj: 19,1-20, 6, 26, 36,45, 28-29; 51,59-64; 34,8-22, 37-44. Po në këtë libër gjejmë edhe rrëfimet e Jeremisë: 11,18-12,6; 15,10-21; 17,4-18; 18,18-23; 20,7-18. Rrëfimet e tij janë një dëshmi mallëngjyese e krizave të brendshme që kaloi ai dhe janë shkruar në stilin e psalmeve vajtuese.

I thirrur që në moshë të re nga Perëndia, në vitin e trembëdhjetë të mbretërimit të Joshijës (626), ai jetoi gjatë periudhës tragjike të përgatitjes dhe më vonë shkatërrimit të mbretërisë së Judës. Reforma fetare dhe rikthimi kombëtar i Joshijës ngjallën shpresa të cilat u shuan me vdekjen e mbretit në Megido më 609, si dhe për shkak të përmbysjes së botës orientale, rënies së Ninives më 612 dhe shtrirjes së perandorisë babilonase. Vdekja e Joshijës simbolizon enigmën e suverenitetit hyjnor. Zoti ka të drejtë të devijojë nga mënyrat e tij të zakonshëm të veprimit: Mbreti i keq Menasheu arrin një moshë mjaft të shtyrë (megjithëse në fund u pendua), kurse mbreti i mirë, Joshija, vritet në lule të jetës.

Që prej 605, Nabukadnecari i imponoi Izraelit sundimin e tij, më vonë Juda u revoltua kundër nxitjes së Egjiptit që intrigoj deri në fund dhe më 597 Nabukadnecari mori Jerusalemin dhe zhvendosi një pjesë të banorëve të tij.

Më 587 u mor Jerusalemi si pasojë e kryengritjes që përfshiu ushtritë babilonase. Tempulli u dogj për herë të dytë (në të vërtetë për herë të tretë sepse e para u bë më 605 me nisjen e Danielit) dhe popullsia u

shpërngul përsëri. Jeremia i kaloi këto momente dramatike të historisë duke predikuar, kërcënuar, duke paraparë shkatërrimin, duke i paralajmëruar më kot mbretërit e paaftë që pasuan fronin e Davidit, të cilët akuzoheshin nga ushtarakët, të persekutuarit dhe të burgosurit për disfatizëm. Pas marrjes së Jerusalemit, Jeremia megjithëse jetonte në mërgim duke shpresuar në të ardhmen, vendosi të qëndronte pranë Gedaljës, i quajtur nga babilonasit guvernator. Por ky u vra dhe një pjesë e çifutëve nga frika e reprezaljeve shkoi në Egjipt. Ata morën me vete edhe Jereminë, i cili sipas të ngjarave vdiq atje.

Teologjia dhe përvoja e tij ecën gjatë gjithë kohës krahe njëra-tjetrës. Ajo që theksohet në librin e tij është rëndësia e raportit vetjak me Perëndinë. Ky raport i lejoi atij të shihte disa gjëra si: Perëndia është ai që vëzhgon dhe në skutat më të fshehta të mendjes e zemrës së njerëzve (11.-20); Perëndia është ai që i jep secilit atë që meriton (31.29-30); miqësia me Perëndinë u thye nga mëkati që rrjedh nga një zemër e keqe (4,4, 17,91, 18,12). Besëlidhja e re që Perëndia do të vendosë me Izraelin (31, 31-34) plotësimin e pjesshëm të së cilës e shohim te Kisha, është zgjidhja për këtë zemër të keqe.

Përmbajtja e librit. Librin e Jeremisë mund ta ndajmë në tri pjesë:
 1,1-25,13 përmban kërcënimet kundër Judës dhe Jerusalemit
 25,14-38, 46-52 përmban profecitë kundër kombeve
 26-35 përfshin predikimet më optimiste
 36-44 biografia e Jeremisë
 45 shtojca e shkruar nga Baruhu, sekretari i Jeremisë.

Sfondi historik: Në vitet 590 Jerusalemi ishte në gjendje dëshpërimi për shkak të ushtrive babilonase që kërcënonin përsëri kryeqytetin si dhe popullsinë e zhvendosur para disa viteve. Një shkëndijë shprese lindi te mbreti i Judës, Cidkija, tek shihte se egjiptianët dukeshin se donin të iknin nga vendi i tyre për të luftuar babilonasit dhe në të njëjtën kohë të çlironin edhe Jerusalemin.

Si të gjithë mbretërit izraelitë edhe ai kërkoi mbështetjen e një profeti për të ndërhyrë pranë Perëndisë në favor të popullit të tij. Jeremia që tashmë ishte konsultuar, shpalli me guxim se në kundërshtim me dëshirën e mbretit, së shpejti do të vinte Nabukadnecari për të shkatërruar kryeqytetin dhe ai duhet t'i nënshtrohej Perëndisë duke e pranuar këtë humbje dhe turp. Në skandalin e madh që u gjenden udhëheqësit çifut, u arrit madje të thuhet se mbreti i Babilonisë ishte shërbëtori i zgjedhur nga Zoti për të përmbushur planin e tij, dhe se të gjitha profecitë për

lumturinë, fitoren dhe shpëtimin nuk ishin veçse gënjeshtër dhe mashtrime (27-28). Në këtë kohë Jeremia u përpoq të dilte nga qyteti, por u arrestua nën akuzën se kishte dashur të kalonte në anë të armikut dhe u burgos për tradhti (37-38).

A nuk nuk anonte ai nga armiku i popullit të tij, a nuk të linte ai përshlyerjen se kishte Perëndinë në anë të tij? Dashuria, që e brente si zjarr, për popullin e tij dhe nënshtimi ndaj Perëndisë e shtyn atë të fliste (20,7-13).

Mund të themi se i tërë misioni i tij mund të shpjegohet nëpërmjet pikëllimit patetik që ndiente zemra e tij, nga natyra e saj dhe e ndjenjave më të thella. Jeremia është për popullin e tij, të cilin e do dhe për të cilin vuan. Duke u nisur nga prirja e tij, e bashkëlindur me të, dhe nga misioni që i ka ngarkuar Perëndia, ai duhet të jetë kundër popullit të tij, kundër mëkateve të mbretërve të tij, të udhëheqësve të tij, të priftërinjve të tij, të profetëve të tij dhe duhet t'u shpalli atyre ndëshkimin e Perëndisë nëpërmjet pushtimit babilonas dhe shkatërrimit të Jerusalemit.

Portreti i profetit: Jeremia ishte një djalë i ri, i ndjeshëm dhe frikacak. Ai që në fillim e mësoi se Perëndia e kishte zgjedhur atë që nga lindja për të qenë si një mur çeliku, si një qytet i fortifikuar dhe si një shtyllë hekuri kundër popullit të tij (1).

Poeti sodit bukurinë e një dege dëllinje të lulëzuar që i flet për besnikërinë e Perëndisë, po në të njëjtën kohë imazhi i kazanit që vlon e derdhet mbi vendin e tij i flet për ndëshkimin e Perëndisë.

I ndjeshëm dhe i dashur, ai merr nga Zoti urdhrin që të mos martohet sepse vendi do të zhytet në fatkeqësi, të cilat do të sjellin vdekjen e prindërve dhe fëmijëve. Pra, ai qëndroi beqar (16).

Si njeri i lutjeve dhe i besimit, Jeremia u detyrua të bërtiste kundër Tempullit dhe kultit, sepse populli lavdërohej për fenë e tij në mënyrë hipokrite dhe të gabuar (7-26).

I rrethuar nga tallësit, të gatshëm për ta akuzuar, ai dëshiron të heshtë dhe të largohet nga skena, por si mund ta shuajë ai zjarrin që i vlon në gjoks dhe që e bën të flasë! Perëndia është më i fortë se ai.

Megjithëse në burg Jeremia vazhdon të flasë, ai është në buzë të greminës dhe megjithatë nuk pushon; kërcënohet me vdekje dhe përsëri flet; përndiqet nga mbreti që lexoi dhe grisi pergamenën diktuar Baruhut, sekretari i Jeremisë, dhe nuk trembet, por fillon të diktojë një tjetër (36); i marrë me forcë në Egjipt nga një grup çifutësh, Jeremia i plakur vazhdon të profetizojë kundër idhujve dhe jobesnikëve (43-44).

Çfarë gabimi mund të bëjë një «qaraman» i cili gjatë gjithë jetës së tij

këndoi vajtime? Në të vërtetë ai është një luftëtar i pathyeshëm, që qëndron deri në fund se nëpërmjet Jeremisë, këtij mjeti të dobët, Zoti, sundimtari i popullit të tij dhe kombeve, bën të dëgjohej zëri i tij.

Jeremia është, gjithashtu, njeriu që shikon larg, më larg se çdokush; ai thotë se Perëndia nuk ndëshkon për të ndëshkuar, por për të thirrur për pendim. Do të vijë dita kur kjo perspektivë do të bëhet realitet. Populli që theu besëlidhjen e parë – si e fejuara që nuk i qëndron besnike të fejuarit – do të njohë një besëlidhje të re, e cila do të gdhendet në zemrat e njerëzve dhe do të dëgjohej në mbarë botën (31,31-34). Fisi i Davidit do të njohë mbretin e drejtësisë dhe të paqes, që do t'i falë popullit të tij shpëtimin (23,18). Në mes të mbeturinave që lëshonin tym të Jerusalemit dhe Tempullit, në mes të kolonave të burgosurve në rrugë të Babilonisë, dallohej tashmë drita e lindjes së Mesisë.

Besëlidhja e re

"Kujdes! – thotë Zoti. – Pas pak do të lidh besëlidhje të re me popullin e Izraelit dhe me popullin e Judës.³² Ajo nuk do t'i ngjajë besëlidhjes, që lidha me të parët tuaj, kur i mora për dore për t'i nxjerrë nga Egjipti. Këtë besëlidhje e shkelën, megjithëse unë si Zoti i tyre nuk i lashë pas dore.³³ Besëlidhja e re, që do të lidh me popullin e Izraelit, do të jetë krejt-tësisht ndryshe; Ligjin tim nuk do ta shkruaj mbi rrasë guri, por në zemër dhe në ndërgjegje. Unë do të jem Perëndia i tyre, dhe ata do të jenë populli im. – Fjala e Zotit! Atëherë askush nuk do të ketë nevojë ta mësojë bashkëqytetarin e tij, as t'i thotë vëllait të tij: «Njihu me Zotin!», sepse të gjithë do të më njohin, prej më të voglit gjer te më fisniku, sepse do t'ua fal mosbindjen dhe do ta harroj fajësinë e tyre. – Fjala e Zotit!" (Jer 31,31-34)

VAJTIMET

HYRJE

Jeremia gjithashtu shkroi librin e Vajtimeve. Ky libër është shkruar në stilin poetik shumë të lëmuar hebraik, prandaj duhet të jetë punuar në një fazë nga dikush i aftë në një zhanër të tillë.

Stili letrar i përdorur quhet vajtim, ose dirigjim (qina). Kjo shpjegon një nga titujt e librit, qinot (vajtimet). Një titull

alternativ është Ekha që do të thotë "Si", e cila është fjala e parë e përdorur në rreshtin e parë.

Libri është i përbërë nga p.e.s.ë drejtime të tilla për shkatërrimin e Jerusalemit nga Nebukadnetsari. Lexohet në sinagogë në ditën kur kujtohet shkatërrimi i tempullit të parë dhe të dytë. Në fakt, vendi i tij në Biblën Hebraike, në mesin e Megillot (nënseksioni i Shkrimeve), bazohet në rendin me të cilin lexohen këto rrotulla në sinagogë.

Është shkruar në poezi hebraike e cila bazohet në përdorimin e parellezimit.

1. Një përsëritje e plotë e mendimit me fjalë të tjera.
p.sh ., kënaqësia e tij është në ligjin e Zotit;
është meditimi i tij ditë e natë. (Ps 1, 2)

2. Një vazhdim i mendimit,
Ai është si një pemë e mbjellë pranë kanaleve të ujit;
jep frytet e saj në stinë. (Ps 1, 3)

3. Një ndërthurje e fjalëpërfjalës dhe asaj metaforike.
Fol dhe gjethja e saj nuk zbehet kurrë.
Kështu që edhe ai lulëzon në gjithçka që bën (Ps 1, 3).

4. E kundërta e mendimit origjinal (e zakonshme në Fjalët e urta).

Zoti ruan rrugën e të drejtëve,
por rruga e të pabesit është e dënuar (Ps 1, 6).

5. Thjesht zyrtare, mendimi vetëm vazhdon.
Tani koka ime do të ngrihet lart
mbi armikun gjithçka rreth meje (Ps 27, 6);

Katër poezitë e para janë shkruar në stilin dirigjent, i cili nuk përdor paralelizëm. Ato gjithashtu përfshijnë një rregullim akrostik (secila rresht fillon me një nga 22 shkronjat

e alfabetit hebraik), e cila shpjegon pse kapitujt 1, 2 dhe 4 kanë nga 22 vargje secili dhe kapitulli 3 ka 66 (3 x 22) vargje.

Kapitulli 3 është më i komplikuar, çdo varg fillon me të njëjtën letër!

Kapitulli 4 kthehet në paralelizëm dhe nuk përmban akrostik. Këtë herë, efekti i ngjashëm me dirigjimin prodhohet nga mbaresat në -u, -nu, -ani, -enu, -inu, -unu – të gjitha këto tingëllojnë të trishtueshme.

Përmbajtja

Vajtimi i Parë, flet për shkrimin dhe mjerimin e Jerusalemit. Qyteti (portretizuar si një grua) rrëfen në vargun 18 se dënimi i saj është i drejtë, shpresa e saj e vërtetë është që ajo duhet të shohë armiqtë e saj të vuajnë të njëjtin fat!

Të dashuruarit në vs 2 dhe 19 janë kombet tek të cilët ajo mbështetet si aleate për ta mbrojtur atë kundër Babilonasve.

Vajtimi i dytë, tema këtu është zemërimi i Zotit me njerëzit e tij. Përfundon me një lutje drejtuar Zotit.

Vajtimi i Tretë, flet për vuajtjet personale të autorit. Por në të gjitha ai sheh hirin e Zotit, përndryshe ai do të ishte shkatërruar plotësisht. Kjo krijon shpresë për të ardhmen, kështu që ai bën thirrje për pendim nga populli i Zotit dhe gjithashtu për hakmarrjen e Zotit kundër armiqtë të saj.

Vajtimi i katërt, kontraston Cionin siç ka qenë, me Cionin siç është tani. Veçanërisht mëkatet e priftërinjve dhe profetëve tregohen si shkak i katastrofës – kjo i la njerëzit pa udhëzime, si një anije pa timon. Fisnikët ishin mbështetur në Egjipt, i cili ishte i pafuqishëm për t'i shpëtuar ata.

Vajtimi i p.e.s.të, libri mbyllet me një thirrje drejtuar Zotit.

Ka një shënim mesianik në libër për aq sa vuajtjet e Izraelit paralajmërojnë ato të Mesisë (1,12 dhe kap. 3).

Libri trajton një pyetje të vështirë, pse e lejoi Zoti të ndodhte e gjithë kjo? Së pari ai lejon një mbret të devotshëm (Joshija) të vdesë në betejë dhe më pas brenda mezi 20 vjet, qyteti i shenjtë të priset dhe të ndotet. Dhe atëherë është premtimi që i është bërë Davidit (2 Sam 7), Zoti lejoi që dinastia Davidike të shuhej.

EZEKIELI

Për Ezekielin (hebr. Jehezkel) nuk dimë shumë gjëra përveç se asaj që ai ishte prift. Që në kapitullin e parë e gjejmë atë brenda një Tempulli, që të lë përshtypjen se është dhe preokupimi i tij më i madh. Ky është tempulli i tanishëm, i prishur, i fëlliqur nga ritet e papastra si dhe Tempulli i së ardhmes, arkitekturën e së cilës e përshkruan me hollësi në kapitujt 40-42 dhe në të cilën shikon kthimin e Perëndisë (43).

Duke qenë prift, ai ishte edhe një profet gjithmonë në veprim. Në kapituj 4 dhe 5 gjendemi në prani të një njeriu që i shoqëron me fjalë veprimet e tij të çuditshme. Ai ndërtoi një plan të Jerusalemit të rrethuar; ai qëndroi i shtrirë për 390 ditë rresht në anën e majtë dhe 40 ditë në anën e djathtë, i lidhur me litarë, ai hëngri ushqimin e përgatitur nga jashtëqitjet, ai rroi mjekrën dhe flokët, një të tretën e parë të flokëve e dogji, një të tretën e dytë e griu me shpatë dhe një të tretën e fundit e shpërndau në ajër. Prirja e tij kishte marrë një formë të çuditshme; vegimi i lavdisë së Perëndisë që ai mundohet të përshkruajë në kapitullin e parë na krijon një atmosferë joreale dhe të pakuptueshme.

Ne gjendemi përpara shfaqjes së krijesave të çuditshme, rrota që kanë sy, pishtarë dhe shkëndija që shoqërojnë fronin e lëvizshëm të Perëndisë. Pastaj profeti bie me fytyrë për tokë përpara këtij vegimi të pabesueshëm (rr. 28). Por shpirti i Perëndisë e çoi dhe i dha të hante pergamenën (k. 3,1-3), profeti pushtohet nga forca e Perëndisë së tij, ai nuk mund të rezistojë më, ai duhet të flasë, ai është i shqetësuar e i tronditur (3,14). Asnjë personazh tjetër i Besëlidhjes së Vjetër nuk e tregon kaq mirë fuqinë e Perëndisë kur kap dikë dhe e detyron të ecë, të flasë, të veprojë, sikurse një forcë fizike që detyron me hir ose pahir (k.8,3, shikoni gjithashtu 11,1 dhe 24; 37,1; 43,5).

Gjatë misionit të tij, Ezekielin e thirri Zoti për të kryer veprime simbolike (4-5), ai përgjason përpara çifutëve rrethimin e Jerusalemit dhe në kapitullin e 12-të përgjason nisjen e emigrantëve. Në kap. 12 ai përgjason mbretin e Babilonisë në kryqëzimin e rrugëve; në kap. 37 përgjason bashkimin e Judës dhe Izraelit. Ezekieli mbeti një shenjë e Izraelit deri në sprovat personale që i dërgoi Perëndia. Ai ishte, gjithashtu, një vegimtar, vegimet e të cilit të çonin në një botë fantastike (por të vërtetë):

1-3, vegimi i parë = koçia e Zotit (froni i tij i lëvizshëm)

8-11, vegimi i dytë = kafshët dhe idhujt në tempull (idhujtaria e fshehur)

37, vegimi i tretë = rrafshina e kockave që gjallërohen, e cila megjithë efektin simbolik na paraqet ringjalljen e Izraelit, vendi që iu ishte premtuar për të jetuar (Daniel 12,1-3; Hebrenjve 1,40).

40-48 Vegimi i Tempullit të ardhshëm i vizatuar si në skicën e arkitektit, nga i cili rrjedh edhe lumi jetëdhënës që kalon nëpër qytet (Apokalipsi 22,1-2).

Për t'u nënvizuar është fakti se Tempulli nuk parashikohet të jetë në qytet, në Jerusalemin e ri, por në veri, në territorin e veçuar për priftërinjtë. Tek Apokalipsi 21,22 na tregohet se në qytet nuk ka ndonjë tempull dhe kjo përputhet më së miri me vegimin e Ezekielit për Tempullin e mijëvjeçarit. Janë kombet e parilindura ato që ndiejnë nevojën e një Tempulli për t'iu afruar Perëndisë dhe jo banorët e qytetit të shenjtë, të cilët e shohin tashmë ditë e natë fytyrën e Perëndisë.

Në këtë libër, përveç të tjerave hasim dhe në një sër alegorish:

- dy motrat jobesnike; Ohola dhe Oholiva (23)
- mbytja e Tirit (27)
- Faraoni i paraqitur si krokodil (29)
- pema gjigande (31)
- zbritja nga ferri (32)

Ezekieli është profeti në mërgim, i cili nuk lajmëron vetëm kthimin e menjëhershëm, por edhe kthimin përfundimtar të kohëve të fundit që do të shikojë ringjalljen e kombit, kthimi i tij është teokracia që bekon mbarë tokën. Gjatë shpërnguljes së dytë babilonase më 597, Ezekieli u zu rob.

Përmbajtja e librit

Kapitujt 1-3 përbëjnë hyrjen. Në këto kapituj Zoti i jep profetit porosinë (3 vegimet).

4-24 Vërejtjet dhe kërcënimet që u bënë izraelitëve përpara rrethimit të Jerusalemit i cili u pasua nga një shpërngulje e madhe e popullsisë.

25-32 profecitë kundër kombeve. Në këta kapituj profeti shtrin mallkimin hyjnor te provokuesit e kombit jobesnik dhe bashkëpunëtorët e tyre.

33-39 periudha e pas rrethimit të fundit. Këtu profeti ngushëllon popullin duke i premtuar një të ardhme më të mirë. Po në këta kapituj Ezekieli parathotë kthimin e Izraelit në vendin e tij përpara kthimit të tij kombëtar.

40-48 Ezekieli parashikon gjendjen politike dhe fetare të komunitetit të ardhshëm që do të vendoset në vendin e tij (detajet e Tempullit). Lavdia e Zotit do të kthehet në Tempullin e rindërtuar. Shih gjithashtu

paragrafet paralele te Zeharja 12-14 dhe Apokalipsi 21-9-22,5.

Temat e librit

1) Rrënimi dhe restaurimi. Rrënimi i Jerusalemit dhe Tempullit të tij më 587 si dhe rënia në robëri e Babilonisë shënuan një plagë të dhimbshme në jetën dhe mendimin e popullit izraelit. Kjo dramë u bë dhe shtylla kryesore rreth së cilës zhvilloheshin ngjarjet e librit dhe mesazhi i Ezekielit. Çdo gjë karakterizohej nga dy ritme që përfaqësonin dy kohë, përpara dhe pas; përpara rrënimit, pas rrënimit. Në kapitujt 1-24 përmbliidhen fjalimet e mbajtur përpara 587; kapitujt 25-48 dhe kryesisht 33-48 janë shkruar pas 587 (kapitujt 25-32 janë fjalime kundër kombeve të huaja dhe data e mbajtjes së tyre nuk është shumë e saktë).

Misioni i profetit ndahet në dy pjesë: përpara rënies së Jerusalemit, ai predikon me dhunë lajmin e Perëndisë për ndëshkimin e popullit rebel që nuk pranon të pendohet dhe të kthehet te Perëndia; pas rënies, ai lajmëron me besim shpresën e kthimit për të internuarit, restaurimin e popullsisë dhe ndërtimin e Jerusalemit dhe të Tempullit, arkitekturën e së cilës ai na e përshkruan deri në detajet më të vogla, ashtu siç e ka soditur ai gjatë vegimit të tij.

Mesazhi i Ezekielit nga fillimi deri në fund përshkohet nga balancimi i së kaluarës dhe të ardhmes, i rrënimit dhe restaurimit, i së vjetrës dhe së resë, i vdekjes dhe ringjalljes. Këtu nuk kemi të bëjmë aspak me dy etapa që pasojnë njëra tjetrën, me gëzimet e hidhërimet që sjellin ato, por me një realitet të vetëm organik, i cili kërkon vdekjen e asaj që është e papastër dhe e fëlliqur, për të mundësuar rilindjen e asaj që është e shenjtë dhe e pastër.

2) Krimet e popullit: Nderi i Zotit u përdhos nga populli fajtor i cili duhet të ndëshkohet. Zoti duroi gjatë, por katastrofa është e paevitueshme (kap. 7). Pas ndëshkimit emri i Zotit do të shenjtërohet; Zoti do ta ngrrejë popullin e tij lartë në mënyrë që kombet e tjera të shohin mrekullinë e mirësisë së Zotit (kap. 36,16-36).

Drejtësia e Perëndisë u dhunua sepse populli dyshoi në Perëndinë e tij (rruga e Perëndisë nuk është e drejtë 18,25). Kapitulli i 18-të është kapitulli i keqkuptimeve. Populli e kishte deformuar fjalën e Perëndisë sepse fëmijët nuk ishin ndëshkuar asnjëherë për mëkatet e të parëve të tyre (nga ana tjetër fëmijët e kanë gjithmonë mundësinë e shkëputjes nga e kaluara nëpërmjet pendimit dhe kthimit), por për vetë mëkatet e tyre. Fëmijët trashëgojnë pasojat e mëkateve të të parëve të tyre, por ata nuk janë përgjegjës për to. Perëndia i ndëshkon fëmijët vetëm në qoftë se ata vazhdojnë të bëjnë të njëjtat mëkate si të parët e tyre. Në

kapitullin 18 Perëndia nuk bën tjetër veçse përsërit edhe një herë parimin që ishte i vlefshëm: Perëndia nuk ndërron mendje.

Tempulli i Jerusalemit ishte streha e lavdisë së Perëndisë, por njerëzit e fëlliqën këtë vend me idhujtaritë e tyre. Pra, Perëndia u largua nga Tempulli i tij dhe ia kushtoi atë shkatërrimit. Ai duhet të rrënohet (kap. 8). Pas vdekjes së Tempullit do të ndërtohet një Tempull i ri, në të cilin do të mbretërojë lavdia e Zotit (kap. 43). Që nga ky moment Izraeli do të pastrohet, kryeqyteti i tij do të jetë i shenjtë dhe prania e Perëndisë do të jetë e përjetshme, sepse vetë qyteti do të quhet JAVE SHAMA: Zoti është atje (48,35).

3) Besëlidhja e re e faljes. Me rikthimin që profetizon, Ezeieli para-shikon një besëlidhje të re që do të përqëndrohet në ripërtëritjen e brendshme: Perëndia duhet të dhurojë një dashuri të re (18,31; 11,19; 36,26). Në thelb të statutit politik dhe fetar të vendit qëndron besëlidhja e re, e cila është dhe çelësi i gjithçkaje. Paganët kanë sot të drejtën të hyjnë në këtë besëlidhje dhe të bëhen bashkëtrashgimtarë me popullin e zgjedhur (Dhiata e Vjetër).

Perëndia nuk është i lidhur me Tempullin e tij: Nëse lavdia e Zotit largohet gjatë syrgjynimit, kjo ndodh sepse ai do të shoqërojë elitën çifute që është edhe e ardhmja e kombit.

Ezeieli është, pra, profeti në mërgim i cili e inkurajon popullin në momentet më të vështira të historisë. Ai nxjerr përfundimin se Perëndia është një Perëndi që fal dhe ndëshkon me zemër të thyer, se Ai ruan mëshirën dhe faljen për breza me rradhë. Ai ndëshkon që ti të kesh një të ardhme më të mirë. Libri i Ezeielit mbyllet me perspektivën e lavdishme të mbretërisë që Perëndia do të vendosë mbi këtë tokë dhe në të cilën do të shfaqen ata që i do Ai.

Shpjegime:

Kap 1: Troni i Zotit. Më 592 Ezeieli u zhvendos në vegim në buzën e kanalit në jug të Babilonit. Atje pa një stuhi rëre të madhe që afrohej nga veriu. Veriu ishte vendlindja e perëndive babilonase (Is 14,13). Në rëre pa tronin e lëvizshëm të Perëndisë. Zoti ka përballur dhe pushtuar perënditë e babilonasve në territorin e tyre. Mbajtësit e tronit të tij u ngjajnë rojtarëve të tempullit babilonas, sepse ata janë bërë skllëverit e tij.

Kap 2: Rojtari. Ky është një fragment shpesh i keqkuptuar kur shpjegohet nga perspektiva e DhR. Njeriu i drejtë është njeriu që i përmbahet ligjit çifut, i cili është pa të metë në zbatimin e detyrat e tij

fetare. Këtu bëhet fjalë për kryerjen e detyrave fetare, e jo për shfajësimin në kuptimin e DhR. Në qoftë se njeriu bie në mëkat, nuk do të merret parasysh kryerja e tij e kaluar, por do të vritet para kohe nga babilonasit. Ky do të jetë edhe fati i profetit në qoftë se nuk e paralajmëron popullin. Ky nuk i përgjigjet rastit të besimtarit të DhR, gjendja shpirtërore e të cilit nuk mund to anulohet. Ky rast mund të zbatohet vetëm në sferën e disiplinës. Këtë e bën apostulli Pal te 1 Kor 10 – ai paralajmëron dëgjuesit e tij se po të sillen në të njëjtën mënyrë sa izraelitët e DhV, Perëndia do t'i vrasë fizikisht. Pali nuk flet për fatin e tyre të përjetshëm, por për disiplinimin e besimtarëve.

Kap 17: *Mbretëria e re davidike*: te kap. 17 lexojmë për një alegori të cedrit të Libanit (d.m.th dinastinë e Davidit) duke përfshirë paditjen drejtuar mbretit davidik të fundit, Zedekisë, i cili besonte në Egjipt e jo në Zotin (JHVH). Por asgjë nuk ishte e humbur, sepse një pinjoll nga maja e cedrit mesianik, do të rritej për të parakaluar të gjitha pemët e tjera (d.m.th. mbretëritë). Shqiponja babilonase do të largojë majën e cedrit për në mërgim, por Zoti do të shkëpuste një pinjoll tjetër (Mesinë) për ta mbjellë në lartësitë e Izraelit. Ky do të rritej në një pemë të fuqishme, nën së cilës të gjithë zogjtë (popujt gjatë mijëvjeçarit) do të gjenin strehë.

Kap 19 bën aludim për Jehoahazin (një këlysh), Jojakimin (një këlysh tjetër) dhe Zedekinë (një hardhi), i cili përgjigjej për mërgimin, sepse nuk kishte pranuar t'u dorëzohej babilonasve. Toka pa ujë i referohet mërgimit babilonas.

Kap 21: Mbreti i drejtë: Në kap. 21 na thuhet se Zoti do të hiqte kurorën e princit të keq (Zedekisë) si dhe mitrin e kryepriftit. Këto institucione do të vazdonin të rrinin në gërmadha derisa të vijë individi i emëruar nga Zoti t'i kërkonte (21,27). cf. Zan 49:10. Është kuptimplotë që edhe mbretëria edhe priftëria do t'i takonin.

Kap 23: Motrat e këqija. Flitet për motrat e këqija Oholiba dhe Ohola, të cilat përfaqësojnë Jerusalemin (d.m.th. Judën), kurse Samarinë (Izraelin). Të dyjat janë fajtorë për prostitucion, d.m.th. idhujtari, për të cilën ato do të ndëshkohen, sepse lidhja e aleancave me vendet e huaja ishte tradhti.

Kap 34. Gjyqimi i dijasporës. Në këtë kapitull bëhet aludim, mes të tjerash, për ndarjen e të mirëve nga të këqijtë ndërmjet çifutëve të shpërndarjes, pak para ngritjes së mbretërisë mijëvjeçare.

Ashtu siç bën bariu që kopeja e tij të kalojë nën kërrabën e tij, kështu do të bëjë edhe unë me ju, që të bëheni përsëri populli im, i cili jeton

sipas rregullave të besëlidhjes sime. Të gjithë ata që ishin të pabindur ndaj meje dhe u rebeluan kundër meje, do t'i përjashtoj nga populli im. Do t'i nxjerr, vërtet, nga vendet ku kishin shkuar në mërgim; por nuk do të hyjnë në tokën e Izraelit. Duhet ta kuptoni se unë jam Zoti! (Ezek 20,37-38)

Do t'i nxjerr prej vendeve dhe kombeve të huaja, do t'i mbledh dhe do t'i kthej në atdheun e tyre. Malet dhe luginat do të bëhen përsëri kullota. (Ezek 34,13)

Ndërsa ju, kopeja ime, duhet ta dini: do të kujdesem vetë për drejtësi; do t'i mbroj kafshët e dobëta kundër të fuqishmeve. Ju, desh dhe cjep, (34,17)

Por tani do t'i vij në ndihmë kopesë sime. Ato nuk duhet të jenë më në mëshirën tuaj; secila dele duhet të fitojë të drejtën e saj.»

Zoti thotë: «Mbi kopenë time do të emëroj një bari të vetëm. Ai do ta çojë në kullotë, dhe kështu do të kujdeset për të si dikur shërbëtori im, Davidi. Unë, Zoti, do të jem Perëndia i tyre, dhe njeriu që i ngjan shërbëtorit tim, Davidit, do të jetë mbreti i tyre. Këtë do ta realizoj unë, Zoti. (Ezek 34,22-24)

Kur të vijë Biri i njeriut me madhështinë e tij, dhe bashkë me të të gjithë engjëjt, atëherë do të ulet mbi fronin e tij madhështor. Para tij do të mblidhen njerëz nga të gjithë popujt dhe ai do t'i ndajë në dy grupe, si bariu që ndan delet prej cjepeve. Delet do t'i vërë në anën e djathtë, kurse cjeptë në të majtën. (Mt 25,31-32).

Kap 36 Besëlidhja e re. Kapitulli parashikon zbatimin e besëlidhjes së re.

Do t'ju nxjerr prej të gjitha kombeve, do t'ju mbledh prej të gjitha vendeve dhe do t'ju kthej në atdheun tuaj. Atëherë do t'ju spërkas me ujë të pastër dhe do të largoj prej jush mbarë ndyrësinë, e cila ngjitet pas jush për shkak të lidhjes suaj me idhujt tuaj. Do t'ju jap një zemër të re dhe një shpirt të ri. Do t'jua heq nga kraharori zemrën e ngurtë dhe do t'ju dhuroj një zemër të re të butë. Do t'ju mbush me shpirtin tim dhe do t'ju bëj njerëz që jetojnë sipas vullnetit tim, që i respektojnë urdhërimet e mia dhe i zbatojnë ato. Atëherë nuk do të dëboheni më nga vendi që i dhashë të parëve tuaj. Ju do të jeni populli im, dhe unë do të jem Perëndia juaj (Ezek 36: 24-28).

Kur Jezusi e qorton Nikodemin për paditurinë e tij rreth rilindjes shpirtërore, do të mendonte për librin e profetit Ezekiel. Çifutëve nuk u lejohej ta lexojnë këtë libër para moshës 30.

Kap 37. Ringjallja. Këtu flitet jo vetëm për rimërkëmbjen e Izraelit të bashkuar, por edhe për ringjalljen fizike.

Pastaj Zoti më tha: “Ti, o njeri, populli i Izraelit u ngjan këtyre kockave. Ata thonë: «Gjallëria jonë është zhdukur, shpresa jonë ka ikur; nuk kemi më asnjë të ardhme!» Për këtë thuaju: «Unë, Zoti, do të bëj që varret tuaja të hapen dhe do t’ju nxjerr prej tyre, o popull im; do t’ju kthej në atdhe, në Izrael. Kështu do ta kuptoni se unë jam Zoti. Do t’ju gjallëroj me frymën time, që të jetoni përsëri, dhe do t’ju kthej në vendin tuaj. Atëherë do ta pranoni se unë jam Zoti. Atë që kam thënë, do ta zbatoj unë, Zoti.»” (Ezek 37,11-14)

Megjithëse ky fragment i referohet kryesisht rilindjes kombetare, te DhR/BR citohet në lidhje me ringjalljen trupërore.

Ju siguroj se koha po afrohet — tashmë filloi — kur të vdekurit do të dëgjojnë zërin e Birit të Perëndisë, e kush e dëgjon, do të kthehet në jetë. Ati është burimi i tërë jetës dhe ai i dha Birit pushtetin për ta dhuruar jetën siç bën vetë ai. Ai e emëroi Birin gjykatës, sepse ai është Biri i njeriut. Mos u çuditni! Po vjen koha kur të gjithë ata që pushojnë në varre, do të dëgjojnë zërin e tij dhe do të dalin. Kush ka bërë mirë, do të ringjallet për të marrë jetën e përjetshme; kurse kush ka bërë keq, do të ringjallet për të marrë dënimin e tij. (Gjn 5,25-29).

Kap 38-39: Betejat e fundit

Këta të dy kapitujt flasin për pushtimin e Izraelit, por kronologisht kapitulli 39 vjen para kapitullit 38. Pushtimi i parë (kap. 39) ndodh pak para fillimit të sundimit mjëvjeçar të Mesisë, kurse pushtimi dytë ndodh në fund të atij sundimit (38 and Revelation 20,7-9). Gogu dhe Magogu fillimisht shpërndahen nga kulla e Babelit, dhe pastaj ndodhen në territorin e Turqinë të sotme. Por shumë kohë më pas ata ndodhen në Rusinë e sotme. Siç duket, Mesheku mund të identifikohet me Moskvën ose Moskovën, kurse Tuval me Tobolsk. Ata të dy në aliancë me Sirinë (mbretin e veriut te Danieli 11,36+) do të sulmojnë Izraelin.

Kap 40-48. Tempulli dhe qyteti. Në këta kapitujt hasim me një kategori të re që quhet letërsi apokaliptike, ku udhërrefuësi qiellor tregon për ndodhive që do të realizohen pavarësisht nga sjellja e njerëzve. Kapitujt flasin për një tempull të rindërtuar, për një komb të kthyer në atdhe, ku çdo fis do të banojë në territorin e vet. Qëllimi i tempullit është të jetë vend ku Perëndia i shenjtë mund të takohet me përfaqësuesit e botës së parilindur. Siç duket, izraelitët do të furnizojnë një priftëri të rilindur,

por të detyrohet të respektojë rregullimet e kultit të tempullit. Siç duket Mesia emëron një zëvendësues që përgjigjet për kultin e tempullit. Sipas skenarisë që paraqitet në librin e Ezekielit, Tempulli ndodhet jashtë qytetit të shenjtë. Qyteti është vendi ku mbretëron Mesia së bashku me Kishën e tij mbinatyrore.

Ndarja e vendit. Në kapitullin 48 të librit të Ezekielit na jepet ndarja e Vendit të Premtuar, ashtu siç do të jetë ai gjatë mbretërisë mesianike. Vendi do të ndahet në rrypina paralele që do të shtrihen nga kufiri lindor drejt detit Mesdhe. Në përputhje me kufijtë e caktuar për Tokën e Premtuar në kap. 47, fiset e Transjordanisë janë çuar në perëndim të Jordanisë. Territori i shenjtë, që është pjesë e Zotit dhe në të cilin ndodhet edhe Jerusalemi, përbëhet në veri nga shtatë fise, ndërsa në jug nga pesë fise. Kjo pjesë e rezervuar ndahet midis priftërinjëve (mes Tempullit) dhe levitëve, pjesa që mbetet ishte për qytetin dhe kullotat e tij; nga lindja deri në perëndim të kësaj pjese të shenjtë shtrihet territori i sundimitarit.

Kur flasim për kufijtë gjeografikë të vendit, tema fillon të ndërlikohet, sepse identifikimi i disa emrave është i vështirë, sidomos kufiri verior. Por sipas treguesve kufijtë duhet të jenë në përgjithësi të njëjtë me ato që ishin në kohën e Davidit dhe Solomonit dhe situata politike është analoge. Izraeli do të jetë pak a shumë i njëjtë me atë të sotshmin (përveç Sinit duke i shtuar një pjesë të Libanit të sotshëm, i cili do të shtrihet deri në Biblosin e lashtë (Bejrutin). Izraeli ka për të sunduar (ekonomiksht dhe politikisht) në të njëjtën shtrirje territoriale si ajo e kohës së Solomonit, d.m.th. nga rrëka e Egjiptit deri në Eufrat dhe nga Mesdheu deri në Transjordanin.

Duhet vënë re ndryshimi që ekziston midis Vendit në të cilin do të banojnë fiset dhe territorit në të cilin do të sundojnë ky vend. Në kapitullin 10-të të Zanafillës flitet për 10 kombe të cilat ndodheshin në Tokën e Premtuar gjatë epokës së Avrahamit, ndërsa te Besëlidhja e Ripërtërirë përmenden vetëm shtatë, të cilët shiheshin edhe si pengesë për pushtimin e Joshuas. Rabinët çifutë thonin shpesh se «gjatë periudhës së të parëve tuaj, ju (Izraeli) kishit zënë vendin e shtatë kombeve, ndërsa në periudhën e Mesisë atë të dhjetë kombeve.»

Por tri kombet që përmenden te libri i Zanafillës dhe që te Besëlidhja e Re fshihen, nuk janë gjë tjetër veçse kënasit, kënizasisit dhe kadmonasit. Pjesa më e madhe e rabinëve ishin marrë vesh për t'u identifikuar me popujt e Edomit, Moavit dhe Amonit, dhe kjo përputhet plotësisht me

një profeci të kohës mesianike. Isaia thotë: «Së bashku ata do t'i sulmojnë filistenjtë nga perëndimi dhe do t'i plaçkitin popujt që banojnë nga lindja: do t'i pushtojnë popujt e Edomit dhe të Moavit, ndërsa popujt e Amonit do t'u nënshtrohen» (11,14).

AMOSI

Amosi ishte blegtor dhe jetonte buzë shkretëtirës së Judës, një zonë kjo e ashpër dhe e thatë. Kopeja e tij përbëhej nga një lloj i veçantë delesh të vogla, por të njohura për leshin e tyre. Amosi jetonte në jug, por i duhej të shkonte shumë shpesh në veri, për të shitur leshin e deleve të tij aq të kërkuar nga të pasurit. Ka të ngjarë që edhe fjalimet e veta t'i ketë mbajtur në mes të pazarit.

Amosi jetoi në një periudhë mjaft të begatë nën mbretërimin e Jaravamit (gr. Jeroboamit). Ai dënoi padrejtësitë shoqërore të veriut, shpalli drejtësinë e Perëndisë dhe së fundi u përzu nga mbreti. Amosi nuk ishte profet profesional. Pas një misioni të shkurtër që kishte si qëllim përçarjen në shenjtëroren perandorake të Bet-El-it (7, 10) si dhe qytetin e Samarisë, e cila u bë dhe shkak për përjashtimin e tij, ai iu kthye preokupimeve të veta.

Ai predikoi gjatë viteve 783-743, periudhë kjo mjaft e lavdishme për njerëzimin, por në të cilën vihej re një ndryshim i madh midis klasave dhe kulti nuk ishte veçse një lustër fetare. Amosi thotë se dita kur do të ndërhyjë Zoti do të jetë e errët dhe jo e ndritshme, dhe kjo nuk do të jetë kështu vetëm për izraelitët, por edhe për paganët. Izraeli do të shpërngulet nga asirianët për shkak të padrejtësisë së tij. Amosi bashkë me lajmin e shpërnguljes shpall edhe atë të shpëtimit për pjesën tjetër.

Pra, edhe këtu ne gjejmë dy idetë që i hasim edhe te Joeli:

1- Dita kur do të ndërhyjë Zoti;

2- Shpëtimi i tepricës.

Në mes të shekullit të 8-të para lindjes së Krishtit, gjatë sundimit të Jaravamit II (783-743), populli jeton pa shqetësime në kohëra të qeta, jeta është e bukur për ata që kanë para. Nga jashtë nuk ndihet asnjë kërcënim, asnjë re lufte apo pushtimi. Izraeli ishte zhytur në kënaqësitë e një jete të begatë e të shthurur ku këngët e gëzimit i mbysin rënkimet e të mjerëve.

Por papritur, ashtu si era e fortë e ardhur nga larg, të gjithë njerëzit u pushtuan nga një frikë e tmerrshme; një hungërimë e largët grisi cipën e ajrit dhe lajmëroi ardhjen e luanit. Ulurima dëgjohej në intervale të

rregullta, ashtu sikurse shtrëngimi i dhimbshëm i një mengene që shtrëngohet. Luani do ta rrethojë ngadalë gjahun e tij. Pa penguar asnjë njeri e dëgjojmë atë tek lëviz nga e majta, pastaj nga e djathta, e dëgjojmë tek afrohet dhe e shohim tek hidhet për të shqyer prenë e tij.

I vogli i Izraelit, i bindur në drejtësinë e tij, i dëgjon sinjalet që profeti Amos ua dërgon shteteve fqinjë që e rrethojnë (Damaskut, Sirisë, Gazës, filistenjve, Tirit, fenikasve, Edomit, Amonit, Moavit). A është ngopur luani? Perëndia i gjykon të gjithë popujt pagan, por përse e bën ai këtë; për të ngritur lart popullin e tij? Jo, përkundërzi. Ai vepron kështu ndaj Judës për shkak të krimeve të tij, për të rënë më në fund mbi viktimën e pashqetësuar që mendonte se ishte gjithmonë i mbrojtur nga zgjedhja e tij, vepronte ndaj Izraelit për shkak të krimeve më të rënda, më skandaloze, që kërkonin një dënim më të madh se ato të të tjerëve (2,6-16).

Populli duhej të ndëshkohej për shkak të zgjedhjes që bëri, sepse me të ai dhunoi marrëveshjen që kishte bërë me Perëndinë. Posi e dhunoi populli atë? Duke e harruar ligjin dhe vullnetin e Zotit i cili i kërkonte popullit të tij që të jetonte duke u besuar sinqerisht premtimeve të tij, të jetonte me drejtësi dhe me ndershmëri përballë së ardhmes, të jetonte me shpresë dhe besim në të ardhmen. Izraeli e shkeli këtë ligj të drejtësisë; ai duhet të ndëshkohet, Perëndia i ofroi këtij populli disa mundësi, durimi i tij ishte afatgjatë, tani do të veprojë drejtësia e Perëndisë.

Kush është ky njeri që guxon të flasë kështu përpara popullit? Një blegtor. Luani filloi të ulurinte, të gjithë janë të tmerruar. Perëndia flet; Amosi duhet të profetizojë (3,8). Amosi e lë kopenë e tij dhe përshkon mbarë Izraelin për ta bërë të dëgjueshme nga të gjithë ulurimën e luanit. Amosi nuk është shumë i njohur, por të gjithë e dinë se fjalët e tij të rënda nuk tingëllojnë si ato të priftit në shenjtëroren mbretërore të Bet-Elit, të gjithë e dinë se ai u përzu nga ky vend.

Pesë vegimet e tij, që ne i njohim, mund t'i konsiderojmë si mundësi për të shprehur prirjen e tij; karkalecat (7,1-3), zjarri (1,4-6), plumbçi (7,7-9), koshi me fruta (8,1-3), prishja e shenjtërores (9,1-4). Ajo që është e rëndësishme dhe e sigurtë në vegimet e tij është përparimi i mendimit; në fillim Perëndia është i gatshëm të falë (7,3), ai mund ta ndalojë ndëshkimin (rr. 6), por pak nga pak kjo bëhet e pamundur; ai nuk mund të falë më (rr. 8), ndëshkimi po afrohet (8,2), ai ndodhet tashmë mjaft pranë (9,1-4). Megjithatë perspektiva e shpëtimit për një pakicë mbetet. Nuk ka humbur gjithçka.

HOSHEA

Amosi dhe Hoshea kanë profetizuar të dy në të njëjtën kohë në perandorinë e Veriut, pak para rënies së saj. Ata e paralajmëruan atë të pendohej përpara ndëshkimit të Perëndisë, i cili do të binte mbi shoqërinë që e kishte harruar atë. Ndërsa Amosi insistonte në drejtësinë e Perëndisë, Hoshea ngulte këmbë më shumë në dashurinë e Perëndisë, në besnikërinë e tij ndaj popullit të zgjedhur. Amosi dhe Hoshea ishin, gjithashtu, bashkëkohasit e Isaisë që profetizonte në mbretërinë e Jugut. Mbreti i mbretërisë veriore (Izraelit) në atë kohë ishte Jaravami II, i cili ishte njëkohësisht dhe një nga mbretërit më të rëndësishëm në historinë e kësaj mbretërie. Mbretëria e Veriut ishte mundur nga asirianët dhe më 721 ishte shpërngulur popullsia e saj, por nuk është e sigurt nëse Hoshea jetoi deri në këtë kohë.

Izraeli ishte pushtuar nga një periudhë e zymtë, sepse kishte filluar të ndihej kërcënimi i Asirisë, kryengritjet e brendshme kishin shpërthyer (për 15 vjet u vranë 4 mbretër), korrupsioni fetar dhe moral kishte marrë përmasa të tmerrshme. Hoshea ishte profeti që për shkak të një drame familjare e përjetoi vetë mesazhin e tij.

Hoshea ishte i pafat në familje, por në vend që të ankohej apo të ngrihte krye, ai e konsideron gjendjen e tij si vullnet të Perëndisë për kryerjen e misionit të tij. Shtëpia, gruaja dhe fëmijët e Hosheas janë një mesazh i gjallë që përforcojnë fjalimet e tij. Vetë emrat e fëmijëve kanë domethënë për popullin; njëri nga bijtë e Hosheas quhej Jizreel (2. Mbretërve 10,1-11), vajza quhej Lo-Ruhama (E Pamëshiruara), emër ky që na bën të kujtohem se Perëndia nuk njuh mëshirë për fëmijët jobesnikë, ndërsa emri Lo-Ami (Jo populli im) që iu vu birit të Hosheas na kujton se populli nuk është më i denjë për t'i takuar Perëndisë.

Amos, Hoshea dhe gruaja jobesnike janë hija i besëlidhjes midis Perëndisë dhe popullit jobesnik. I bazuar në dashurinë reciproke, kjo lidhje u thye nga mëkati i popullit. Ashtu si një grua e shturur edhe Izraeli u kthye drejt perëndive të tjera të Baalit, për të kërkuar ndere të ndryshme të cilat Perëndia, sipas atyre, nuk ua jepte. Fjala Baal do të thotë zot, pronar, posedues dhe bashkëshort, sepse Baalët mbaheshin për të zotët dhe poseduesit e tokës. Korrupsioni, idhujtaria dhe adhurimi i perëndive të tjera konsiderohen si qëndrim jobesnik i popullit ndaj Perëndisë. Dhimbja e Hosheas dhe e Perëndisë është e madhe sepse megjithë jobesnikërinë e tradhtinë ata vazhdojnë të duan. Çfarë duhet bërë?

Njeriu mund ta ndante gruan e tij dhe ta harronte burimin e vuajtjes së tij. Por ai ka tjetër synim. Me dashuri dhe durim ai e thërret atë të

kthehet, e largon nga dashnorët e saj (*baal*); i flet zemrës së saj dhe i kujton kohën e rinisë, i tregon se çfarë ka bërë për të dhe hap përpara saj derën e shpresës (2,17), ai i flet për një të ardhme të lumtur ku çdo gjë do të harrohet e falet dhe fëmijët do marrin emra të tjerë. Izraeli (Jizrael) do të quhet Jizrëel (që do të thotë «Perëndia mbjell», me shpresën e korres së ardhshme – 2,22-24), pastaj vjen Ruhama (ajo që ka mëshirë) dhe Ami (populli im) – Hoshea 2,3 dhe 25. Atëherë do të ketë gjithmonë lumturi dhe besëlidhja do të vendoset përfundimisht.

Në kapitujt 4-14 kemi fjalët e mbajtuara nga Hoshea të cilat nuk kanë një plan të qartë. Në to janë mbledhur fjalët e ndryshme të profetit të mbajtura shpesh, por të pashoqëruara nga treguesit e kohës apo vendit.

Atë që dimë mund ta përmbledhim kështu: Hoshea profetizoi në shekullin e 8-të para Kr. në mbretërinë e Izraelit. Gjendja e Izraelit nën sundimin e mbretit Jaravam II ishte e qetë, por begatia që gëzonin disa njerëz bëhej shkak për padrejtësi shoqërore, luksi i disave ngrihej mbi varfërinë e të tjerëve. Para së gjithash, kultet pagane të Baalit kishin filluar të filtronin në Izrael dhe idhujtaria me kortezhin e saj hipokrit dhe besëtytë bënë që pak nga pak të harrohej kulti i dhuruar Perëndisë.

Mbretërit ishin një shembull i keq dhe shqetësimet politike e drejtonin popullin drejt aleancave me popujt e huaj. Me guxim dhe dhimbje Hoshea i dënon të gjitha pabesnikëritë e popullit, ai flet për prostitucionet e shumta të popullit (fjala prostitucion përmendet më shumë se 20 herë në këtë libër). Prostitucioni, kremtimi i kulteve idhujtare dhe hipokrite, flijimet, festat dhe zakonet e të cilave tregojnë mungesën e adhurimit të vërtetë të Perëndisë.

Prostitucioni, gjendja shoqërore dhe morale e popullit, abuzimet, teprimet dhe padrejtësitë e të cilit shkelin ligjin e Perëndisë. Prostitucioni i një mbretërie që nuk i qëndron besnike Perëndisë. Përse Perëndia nuk i dënon tërë këto tradhti? Përse nuk i dënon ai pabesnikëritë kriminale? Madje dhe vetë kulti i ngritur për Zotin është një shkelje. Perëndia është një Perëndi xheloz (d.m.th. që nuk toleron asnjë rival), i cili kërkon që besnikët e tij t'i jepen me gjithë zemër (6,6). Ndëshkimi, pra, është i pavitueshëm.

Megjithatë Perëndia vazhdon ta dojë popullin e tij. Në zemërimin dhe ndëshkimin e tij ndihet dashuria e cila është më e fortë se zemërimi. Megjithëse Perëndia duhet ta ndëshkojë popullin e vet, ai nuk mund ta mohojë. Ashtu si burri që e do gruan e tij, ashtu si ati që do fëmijën e tij, ai flet, bën thirrje dhe shpreson.

Nganjëherë Hoshea quhet edhe profeti i besnikërisë. Sikurse *ahava* (dashuria) shënon fillimin e marrëdhënies (besëlidhjes), *hesed* (besnikëria

ndaj besëlidhjes) shënon dinamikën ose vazhdimin e marrëdhënies.

Mjerisht kjo besnikëri mungonte tek Izraeli. Ajo filloi qysh në shkretëtirën e Sinait, dhe vazhdoi kur kombi hyri në tokën e premtuar (përmenden emrat gjeografike ku u shfaq kjo sjellje e pabesë (Adma, Gilgal etj).

Hoshea nëpërmjet mesazhit të tij na shfaqet si paralajmëtar. Krahasimi i përdorur nga ai për besëlidhjen ndërmjet Izraelit dhe Perëndisë (si ai ndërmjet burrit dhe gruas) do të merret me vonë dhe do të zhvillohet më tej nga Jeremia (2-3) dhe Ezekieli (16-23).

HAGAI

Në Babiloni populli u njoh me ushtritë e robërisë dhe në saje të dëshirës së mirë të perandorit persian, Kir, atyre iu dha leja për kthim në Palestinë dhe Jerusalem. Pra, jemi në epokën e kthimit nga internimi.

Por të internuarit që ktheheshin në vendin e tyre u ndeshën me një gjendje mjaft të dhimbshme: gërmadhat, zinë e urisë, armiqësinë e vendësve (banorët që kishin qëndruar atje dhe që i shikonin me sy të keq robërit e liruar). Mund të kuptohet shumë mirë prirja e tyre në këtë situatë drejt shkurajimit dhe ecja drejt egoizmit.

Kjo gjendje e mjerueshme do të zgjasë vjet me rradhë, derisa njerëzit e Perëndisë do të shkunden nga topitja. Pikërisht këtë gjë bëri Hagai.

Me Hagain fillon periudha e fundit profetike: ajo e pasinternimit. Ndryshimi është shumë i madh. Përpara internimit parulla e profetëve ishte ndëshkimi, gjatë internimit ishte ngushëllimi, ndërsa tani restaurimi. Hagai mbërriti në një moment vendimtar gjatë formimit të judaizmit; lindjes së komunitetit të ri të Izraelit. Hagai porositi e tij të shkurtra i dha nga gushti deri në dhjetorin e vitit 520 para Krishtit. Çifutët e parë të kthyer nga Babilonia u shkurajuan shumë shpejt. Por Hagai dhe Zeharja duke i ruajtur energjitë e tyre, e shtyn guvernatorin Zerubavel dhe priftin Joshua të rifillonin ndërtimin e tempullit, i cili u bë në shtator 520 (Hagai 1,5; Ezra 5,1).

Njerëzit që u kthyen në Jerusalem filluan të ndërtonin secili shtëpinë e tij, madje nganjëherë dhe shtëpi të bukura e të rehatshme për të patur brenda mureve të shtëpisë një jetë të kënaqshme. Por ata harruan të ndërtonin shtëpinë e Perëndisë, Tempullin e Jerusalemit.

Vitet kalonin dhe shtëpia e Zotit vazhdonte të ishte një gërmadhë. Gjendemi më 520, në periudhën e perandorit Dari.

Atëherë u ngrit Hagai për të shqiptuar këto fjalë fishkëlluese: «Ju u ndeshët me sprovën të ndryshme, me disfata dhe dështime. Perëndia ju

goditi sepse ju u rehatuat nëpër shtëpitë tuaja të bukura dhe e harruat shtëpinë e Perëndisë. Pra, çohuni dhe ndërtojeni shtëpinë e tij dhe gëzimi do të kthehet te ju.»

Pra, ai pohon se shkujdesja karshi Tempullit është një provë për popullin e tij, ai e ka harruar Perëndinë, nuk e lavdëron më dhe nuk e respekton. Nuk ka shumë rëndësi nëse shtëpia do të jetë prej druri apo prej tullash, por sjellja e izraelitëve ndaj Perëndisë është ajo më shqetësuesja. Për sa kohë që Zoti lihet pas dore, për sa kohë shtëpia e tij qëndron në gërmadha po për aq kohë edhe izraelitët do të njohin vetëm hidhërim dhe turp.

Populli dhe drejtuesit e tij, Zerubaveli dhe Joshua u shkundën si të thuash nga kjo thirrje dhe nuk vonuan më për rifillimin e ndërtimit të Tempullit (1,12-15). Ndërtimi i Tempullit zgjati 4-5 vjet, dhe përfundoi rreth vitit 515 (Ezra 5,1-2; 6,13-15).

Në kapitullin 2,10-19 Hagai i shpjegon popullit shkakun e gjendjes së tyre të mjerueshme. Ne do të thoshim se mërzitja është si një sëmundje ngjitëse. Kur objektet e shenjta prekin objektet profane ato nuk u transmetojnë atyre karakterin e shenjtë, por objektet e fëlliqura, p.sh. kur prekim një kufomë atëherë fëlliqim gjithçka që prekim me dorë.

Pra, fëlliqja është më ngjitëse se shenjtëria. Me anën e këtij pohimi të çuditshëm shpjegohet varfëria e popullit. Izraeli harroi ta ngrinte Tempullin e tij. Kjo shkujdesje fajtohet është tamam si një fëlliqësi që ka prekur të gjithë jetën e popullit. Privimet e ndryshme, varfëria dhe uria shpjegohen si goditje të dërguara nga Perëndia kundër popullit që ishte fëlliqur. Por tani bekimi i Perëndisë ishte i sigurtë sepse fëlliqësia ishte zhdukur dhe Tempulli ishte rindërtuar (rr.19).

Profeti na lajmëron se Tempulli i ri do të jetë më i lavdishëm se i pari. Pavarësisht nga fasada modeste – Tempulli i ri do ta eklipsojë lavdinë e të parit – Perëndia zgjodhi Zerubavelin dhe i premtoi atij fuqi. Perëndia është besnik, do të vijë momenti kur triumfi i tij do të shpërthejë mbi të gjitha kombet dhe të gjitha pasuritë do t'i përkasin atij (Isaia 60; Apokalipsi 21,26). Atëherë do të mbretërojë paqja, pas viteve të dhimbshme të vujatjeve populli do të njohë lumturinë e premtuar dhe të profetizuar. Duke kaluar kufijtë e këtij realiteti historik, profeti lajmëron edhe ngjarjet e fundit të kohërave.

Në të vërtetë, ky ndërtim i thjeshtë i Tempullit të ri nuk është veçse një parafytyrim. Zerubaveli dhe Joshua janë paralajmëruesit e misionit të Mesisë. Pra, për këtë arsye ndërtimi i Tempullit është paraqitur si kusht i ardhjes së Zotit dhe i vendosjes së mbretërimit të tij dhe me këtë

hapet edhe epoka e shpëtimit eskatologjik. Në këtë mënyrë u kristalizua rreth shenjtërores dhe pasardhësve të Davidit shpresa mesianike të cilën Zeharja e shpreh më qartë.

MIKEJA

Mikeja (gr. Mihaja) rridhte nga fshati Moreshet (në perëndim të Hevronit) dhe ishte çifut. Ai e ushtroi misionin e tij në kohën kur në Judë mbretëronin Ahazja dhe Hizkija. Profecitë e tij i drejtoheshin si perandorisë së Veriut, ashtu edhe asaj të Jugut. Mikeja predikoi përpara krijimit dhe pas rënies së perandorisë së Veriut (marrja e Samarisë më 721) dhe deri në pushtimin e Senakeribit më 701.

Pra, mund të themi se ai ishte bashkëkohës i Hosheas dhe i Isaisë. Mihaja ishte me origjinë fshatare dhe ashtu sikurse Amosi ndiente neveri për qytetet e mëdha si dhe përdorte një fjalor të rëndë. Atij i pëlqente të përdorte vegimet e shpejta si dhe të luante me kuptimet e fjalëve. Në librin e Mikejës, i cili ndahet në katër pjesë, kërcënimet ndërthuren me premtimet.

1-3 gjyqi i ngritur kundër Izraelit

4-5 premtimet që i bëhen Cionit

6-7,7 gjyqi i ri kundër Izraelit

7,8-20 shpresa.

Zoti bën gjyqin e popullit të tij fajtor (1,2; 6,1), për shkak të gabimeve fetare dhe morale të kryera. Mikeja fshikullon të pasurit zgllabërues, kreditorët e pashpirt, tregtarët mashtrues, priftërinjtë dhe profetët lakmues, pushtetmbajtësit tiranë dhe gjykatësit e shitur. Pra, çdo gjë ishte në kundërshtim me atë që kërkonte Zoti, i cili donte që njerëzit të kujdeseshin për të drejtën, t'i tregonin njëri-tjetrit dashamirësi dhe të mos bënin asgjë pa u këshilluar më parë me Perëndinë. Rreshti 8 e kapitullit 6 përmbledh në mënyrë të shkëlqyer kërkesat shpirtërore të profetëve dhe na kujton Hoshean.

Ndëshkimi është vendosur: bota mbarë do të tundet (1,3-4), Zoti do të vijë dhe do të gjykojë popullin e tij, në rreshtat që vijnë të kapitullit të parë na lajmërohet shkatërrimi i Shomronit, i fshatrave të Moreshitit, si dhe vetë Jerusalemit i cili do të bëhet një grumbull gërmadhash.

Megjithatë profeti në vetvete ruan një shpresë, shkëndijat e së cilësi ishin hedhur nga Amosi, dhe në kapitullin 5,1-5 na lajmërohet lindja në krahinën e Efratit, e Mbretit paqësor që do të kullosë bagëtinë e Zotit.

Mikeja lajmëron gjithashtu dhe rënien e pendorisë së Veriut dhe të

Jugut. Megjithatë duke u nisur nga doktrina e pjesës (7,7) që mbetet, ai shpreson në shpresën e Mesisë.

Gjyqi i Perëndisë

Akuza (k. 1-3)

Hapja e seancës, populli është i pranishëm në gjyq; aty janë të gjithë popujt e tokës (1,2).

Mbërritja e gjyqtarit: Perëndia del nga pallati i tij, zbret në tokë dhe çdo gjë dridhet përpara tij (1, 3-4).

Të akuzuarit janë të pranishëm. Po kush janë ata? Shomroni dhe Jerusalemi. (rr. 5), dy personifikimet e perandorive të Izraelit dhe Judës, si dhe të krimeve të kryera prej tyre. Me fjalë kërcënuese dhe ironizuese, gjyqtari shpall ndëshkimin e fajtorëve (1,6-16).

Në kapitullin e dytë përmenden krimet e kryera nga fajtorët: padrejtësi shoqërore, hipokrizi fetare, profetizimi i gënjeshtres, kompromise politike etj. Bashkëfajtorët janë gjithashtu të pranishëm (k. 3), drejtuesit që shfrytëzojnë popullin, profetët që favorizojnë ata që pagajnë më shumë, priftërinjtë që kryejnë funksionet e ngarkuara për para.

Në fund të seancës së parë gjyqësore një vendim i tmerrshëm ushtoi: «Mali i Cionit do të mbetet si arë e palëruar; Jerusalemi do të bëhet grumbull gërmadhash» (3,12).

Antrakt (k. 4-5)

A duhet që ashpërsia e gjykimit të bëjë të harrojë se gjykatësi është Perëndia dhe jo një njeri i pamëshirshëm? Ashtu sikurse gjatë ndërprerjes së një seance gjyqi, kur publiku largohet nga salla e ftohtë dhe solemne e gjyqit për të dalë nën qiellin blu dhe diellin ndriçues të Zotit, kapitujt 4-5 na lajmërojnë perspektivën e vendosjes së mbretërisë së Perëndisë gjatë së cilës toka do të njohi fjalën e Zotit dhe nuk do të ketë më as luftra, as vuajtje, as të këqija, as varfëri dhe as humbje. Ai që do të gjykojë botën do të vijë nga Betlehemi (5,1, vetëm në Dhiatën e Vjetër flitet për Betlehemin si mëmëdheun e Mesisë); armiqtë e Perëndisë do të munden dhe pjesa e zgjedhur e popullit që mbetet do të jetë ngadhënjimtare dhe e mbuluar me lavdi.

Mbrojtja dhe vendimi përfundimtar (k. 6-7)

Seanca gjyqësore filloi përsëri. Publiku u ftua edhe një herë për të dëgjuar (6,1-2). Por këtë herë Perëndia del si avokat mbrojtës i popullit; gjyqtari do të poshtërohet për t'ia përmendur të akuzuarit edhe një herë të gjitha të mirat që i ka bërë në të kaluarën (6.1-5). Një portë e re

hapet, ajo e pendimit dhe faljes (6,8).

Megjithatë drejtësia duhet përmbushur dhe të shpallen sanksionet (6,9-16), sepse i akuzuari i pranon mëkatet e tij, krimet e tij, pabesitë e tij që kanë përfshirë mbarë popullin (7,1-6). Por mund të shpresohet ende për shpëtim; e vetmja rrugë drejt tij është hedhja e vështrimit nga gjykatësi, Perëndi dhe Zot (7,7-10).

Seanca gjyqësore mbyllet. Në horizonitin që hapet përpara të akuzuarit, pas ndëshkimit, vijëzohet shpresa e ngritjes dhe përtëritjes (7,11-17). Vetëm gjykatësi e meriton të mbulohet me lavdi të përhershme.

Cili Perëndi është i ngjashëm me ty, cili fal padrejtësitë, cili harron mëkatet e pjesës që mbetet dhe trashgimtarëve të tyre? Inati i tij nuk është i përhershëm, sepse ai ndjen kënaqësi kur fal. Ai do të ketë mëshirë edhe për ne (7,18-20).

CEFANJA

Cefanja (gr. Sofonia) profetizoi gjatë mbretërimit të Joshijës, 640-609. Sulmet e tij kundër modës së huaj (1,8), idhujtarive dhe perëndive boshe (1,4-5), kritikën e tij ndaj ministrave (1,8) dhe heshtja e tij në drejtim të mbretit, tregojnë se ai predikoi përpara reformës fetare dhe gjatë kohës kur Joshija ishte ende i mitur, midis 640 dhe 630; pra, përpara fillimit të aktivitetit të Jirimijës.

Juda, e ndarë nga territori i saj prej Senakeribit, jetoi nën sundimin asiran dhe sundimet e pafe të Mënashaut e Amonit, të cilët favorizuan çrregullimin fetar. Por dobësimi i Asirisë ngjalli shpresën e një përtëritje kombëtare, e cila u shoqërua nga një reformë fetare.

Libri ndahet në katër seksione të shkurtra: Dita e ndërhyrjes së Zotit 1,2-2,3 kundër kombeve (2,4-15), ndërhyrja kundër Jerusalemit (3,1-8), dhe premtimet (3,9-20).

Mesazhi i Cefanjës mund të përmbledhet në lajmërimin e Ditës së ndërhyrjes së Zotit dhe në katastrofën që do përfshijë të gjitha kombet, duke përfshirë edhe Judën. Ky i fundit dënohet për shkak të gabimeve të tij fetare dhe morale, të frymëzuara nga mendjemadhësia dhe kryengritja (3,1,11). Cefanja ka një koncept të gjerë për mëkatin, paralajmëtar i atij të Jeremisë; ai e sheh atë si një cënim personal të Perëndisë së gjallë. Ndëshkimi i kombeve është një paralajmërim (3,7), që duhet ta çojë popullin drejt bindjes dhe nënshtrimit (2,3), ndërsa shpëtimi i premtohet një pjese të nënshtruar dhe modeste 3,12-13.

Mesianizmi i Cefanjës kufizohet në këtë këndvështrim, por nëpërmjet tij na zbulohet përmbajtja shpirtërore e premtimeve.

Temat e librit : Dita e zemërimit: edhe në librat e tjerë të Biblës flitet për zemërimin e Zotit, por në asnjërën prej tyre nuk i gjejmë ato nuanca dhe tone të cilat i hasim te Cefanja. Zemërimi i Zotit ndaj popullit të tij dhe popujve të tjerë është shumë i madh, sepse popujt u zhytën në idhujtari, në adhurimin e yjeve (ushtria e qiejve 1-5), në papastërti morale e shoqërore, në sigurimin bosh, sepse nuk bëhet më fjalë për një ndëshkim të ngjashëm me shuplakën që i jepet djaloshit të pabindur apo me dënimin që i jepet fajtorit. Por bëhet fjalë për një katastrofë radikale, për një tronditje, për një shkatërrim të mbarë botës, të tokës e të qiellit (1,2-3), thua se i tërë krijimi do të përfshihet edhe një herë nga përmbytja.

Rreth vitit 625 para Krishtit, perandoria e vogël e Judës kishte dalë nga periudha e turp-it gjatë së cilës mbretërit Mënashë e Amon duke mohuar Zotin kishin arritur deri aty sa të ofronin dhe flijime njerëzore. Ishte koha kur perandoritë lëviznin kundër njëra-tjetrës duke provuar të shtypnin komshinjtë e tyre. Profeti Cefanja e ka përshkruar këtë tablo të trefishtë aq mire, saqë çdo kush dridhet përpara saj.

Por zemërimi i Zotit nuk është veçse shprehja e një dashurie të tradhtuar e të fëlliqur. Padrejtësia do të triumfojë nëse Perëndia nuk do të dënonte. Por dashuria e tij është triumfatore ndaj gjithçkaje, ndaj popullit të tij të cilit ai i dha tërë ato premtime. Do të vijë dita kur populli do të jetë i pastër, i falur dhe i shpëtuar. Strehë e tij do të jetë vetëm te Perëndia, jeta e tij do të jetë e qetë dhe e lumtur (3,12-13). Zemrat e tyre do të jenë të mbushura me gëzim (rr. 14) dhe i vetmi mbret i vërtetë do të qëndrojë në mes të Izraelit si një hero shpëtimtar (rr. 15-17).

Libri merret me një çështje të vështirë: përse Zoti lejoi të gjitha këto? Së pari ai lejon që mbreti i devotshëm të vritet në batajë, dhe brenda 20 vjetëve lejon që qyteti i shenjtë të pushtohet dhe të plaçkitet. E atëherë ka premtimi hyjnor dhënë Davidit (2 Sam 7): Perëndia lejoi që dinastia davidike të shuhet.

NAHUMI

Asiria: Asirianët i mbajtën nën sundimin e tyre të dyshimtë për më shumë se dy shekuj e gjysëm popujt e vegjël të Sirisë dhe Izraelit. Gjatë epokave më pak të mundimshme duhej paguar mbretërëve të Asirisë haraçe të mëdha dhe mjaft nga sundimtarët e Izraelit dhe Judës e dinin se çfarë do të thoshte kjo zgjedhë (Jehu, Mënahemi, Ahazi, Hizkija, Mënashëu etj.).

Në periudhat më mizore, popullit iu desh të pësonte edhe pushtimin

e ushtrive më brutale, plaçkitjen, urinë, rrethimin dhe shpërnguljen (marrja e Samarisë dhe fundi i mbretërisë së Izraelit më 722, rrethimi i Jerusalemit më 701). Kolosi asirian, kryeqyteti i të cilit ishte Ninive, i bëri të dridheshin popujt e Lindjes së Afërt dhe u përplas mbi ta si një stuhi lemerie, kërcënimi i së cilës e errësonte gjithnjë horizontin.

Megjithatë një ditë kolosi u shemb. Një koalicion perandorish, nga të cilët ai i Babilonit do të bëhej më i fuqishmi, do t'i jepte fund sundimit tiranik të Tiglat-Pilezerit, të Salmanasarit, të Sargonit dhe Senaheribit. Gjatë fushatave ushtarake shumë vjeçare, babilonasit, medasit dhe skitesit do ta shijonin pak nga pak fuqinë asiriane dhe Niniveja, qyteti i madh dhe lavdia e perandorisë, do të binte gjatë një humbje të përgjakshme. Këtë ngjarje dokumentet arkeologjike të mbajtura në shkrimin e asirianëve e përshkruajnë në mënyrë dramatike. Nahumi kishte parë po të njëjtën gjë në vegimin e tij profetik, të cilin e përshkruan si një vazhdim klishesh të marra direkt. Ashtu siç e vërteton edhe Kronika e mbretërve të Babilonisë, këto ngjarje i përkasin vitit 612 p.e.s.

Niniveja u shkatërrua! Çfarë lajmi i çuditshëm ky për popujt e vegjël që ishin nën sundimin e tij! Ç'drithërim shprese dhe gëzimi! Ç'thirrje fitoreje dhe triumfi për ata që qëndruan aq gjatë të shtypur.

Personazhi i Biblës, i cili bën që edhe ne të marrim pjesë në këtë ngazëllim, është Nahumi.

Mund të themi se Nahumi është pasardhësi i Jonës (një shekull më vonë), sepse kjo profeci përqendrohet pothuajse krejtësisht në Ninive (Asiri).

Perëndia vuri në shërbim të tij Asirinë për të zhvendosur mbretërinë e Veriut, por tani ai do të gjykojë Asirinë (kjo ndodh me marrjen e Ninives më 612 nga babilonasit). Kiaksari nga Media dhe Nabopolasari nga Babilonia e morën qytetin më 612 dhe shtatë vjet më vonë Asiria pushoi së ekzistuari si vend.

Nahumit i ishin ngulur në mendje mëkatet e Asirisë dhe i dënoi ato. Asiria përshkruhej si një luan i njohur për mizorinë dhe sadizmin e tij. Në shekullin paraardhës, kur Zoti dërgoi Jonën, u ndie një pendim kohëshkurtër kombëtar. Tani është tepër vonë. Ndëshkimi do të bjerë mbi ta. Profecia u shpall rreth viteve 663 dhe 612 para J. Krishtit.

Në vitin 663, asirianët rrënuan Tebesin në Egjipt për të cilin Nahumi bën aluzion në kap. 3 rr. 9-11. Thebesi u rindërtua më 654 dhe meqenëse për këtë nuk kemi ndonjë aluzion mendohet se profecia ka qenë e përparshme.

Libri hapet me një psalm të përgjithshëm mbi zemërimin e Zotit, por tema kryesore është shpallja e shkatërrimit të Ninives. Mënyra e

mrekullueshme e kësaj shpalljeje e bën Nahumin një poet të madh çifut.

Në profecitë e Nahumit ndjejmë Izraelin tek dridhet nga armiku i tij i betuar, populli asirian, dëgjojmë t'u këndohet shpresave që ngjall rënia e tij. Por nëpërmjet asaj që në rradhë të parë të lë përshtypjen e një nacionalizmi të rrëmbyer, shprehet ideali i drejtësisë dhe i besimit; shkatërrimi i Ninives shpreh gjykimin e Perëndisë, i cili ndëshkon armikun e planit hyjnor (1,11, 2,1), shtypësin e Izraelit (1-12-13) dhe të gjithë popujve të tjerë (3,1-7).

Libri i Nahumit duhet t'i ketë ushqyer shpresat njerëzore të Izraelit rreth 612 (data e rënies së tij), por gëzimi nuk zgjati shumë sepse rrënimi i Jerusalemit u pasua nga ai i Ninives.

Temat e librit: Nahumi është një profet i Perëndisë, dhe jo një njeri cinik që gëzohet për rrënimin e kryeqytetit më të madh, të asaj kohe, dhe për masakrën e përgjakshme të banorëve të saj. Kjo afirmon dhe faktin se është sundimi i Perëndisë ai që hakmerret ndaj armiqëve të tij e që nuk lejon që tiranët të triumfojnë përgjithmonë mbi tokë. Fundi i tyre ka për të ardhur. Nëse Perëndia është i mirë dhe i durueshëm, zemërimi i tij duhet të shpërthejë gjithashtu kundër atyre që me mendjemadhësi ngrihen deri lart e shtypin të tjerët. Këtu ne zbulojmë një të vërtetë të sigurtë për besimin tonë: fitorja i takon Perëndisë. Asnjë nuk mund t'i shpëtojë atij pa u ndëshkuar. Dhe më të fuqishmit e kësaj bote do të mposhten një ditë e populli i Perëndisë do të njohë paqen (2,1-3). Si mund ta humbim ne kurajon?

JONA

Jona është një profet që ka ekzistuar vërtet, megjithëse ka qenë mjaft i diskutueshëm. Kronologjikisht ai rradhitet midis Elishës (gr. Elizeut) dhe Amosit. Jona vinte nga Gat-Heferi, i cili gjendej në Galile disa kilometra larg Nazaretit. Sips traditës judaike ai është profeti i ri që dërgoi Elisha për të shuguruar mbret Jehuin (2. Mbret 9,1-5). Jezusi e ka parë sigurisht varrin e Jonës dhe madje dhe do të ketë medituar atje për misionin e tij. Jona është profeti i vetëm me të cilin krahasohet Jezusi. Ata ishin të dy profetët e Galilesë. Përkthimi i saktë i Gjonit 7,52 është: «Edhe ti siç duket vjen nga Galileja. Lexoje Shkrimin e shenjtë me më shumë kujdes e do të shohësh se Profeti (d.m.th. Mesia) nuk do të lindë në Galile!» Farisenjtë e dinin se Jona ishte profeti i Galilesë.

Jona, Elija dhe Elisha e kryen misionin e tyre në mesin e paganëve: Elija shkon në Sidon (1. Mbretërve 11,8)

Elisha ka të bëjë me Sirinë (2. Mbretërve 5,1)

Jona në Ninive, vend pagan.

Jona dhe Elija, që të dyve iu desh të shpallin një sër gjykimesh (1. Mbretërve 17,21; Jona 3-4). Që të dy profetët Perëndia i mbrojti nga armiqtë e tyre; Perëndia bën mrekulli. Që të dy bien në një depresion nervor dhe Perëndia i qorton të dy për cektësi mendimi (1. Mbretërve 19,18; Jona 4,11). Jonën mund ta krahasojmë edhe me Pjetrin, sepse që të dy u dërguan nga Perëndia për të çuar ungjillin te paganët.

Prapaskena historike: Jona është vërtet një personazh historik (2. Mbretërve 14,25). Jezusi nga ana e tij e ka konfirmuar vërtetësinë e tregimit. Niniveja përbëhej nga tri qytete, por më 880 dhe 701 përmëndeje vetëm Kala, meqënëse ishte edhe kryeqyteti i këtij bashkimi qytetesh.

Midis viteve 810 dhe 782, sipas analeve asirane, në atë kohë atje sundonte mbretëresha Semiramis dhe bashkë regjenti i saj Adad-Nirari. Gjithashtu në këtë periudhë vihej re një tendencë drejt monoteizmit.

Më 765 dhe 759 pati një epidemi të mëdhe kolere dhe më 763 eklips total të diellit. Këto shenja bën që qyteti të përgatitej për pendim. Libri i Jonës është kryesisht një rrëfenjë: historia e profetit të pabindur i cili në fillim donte të çlirohej nga misioni i tij dhe që i ankohej Perëndisë mbi suksesin e këtij misioni. Pothuajse të gjithë i shpëtuan mbytjes, detarët paganë, banorët bile dhe kafshët e Ninives me përjashtim të një izraeliti, të profetit Jona. Perëndia tregohet zemërgjerë ndaj profetit të tij rebel; ai tregohet i mëshirshëm madje dhe me armikun më të urryer të izraelit.

Personazhi i Jonës është tipik për disa mjedise autonomiste çifute, që ishin të mendimit se paganët ishin lindur për të shkatërruar, ndërsa Izraeli ishte populli i të besuarve të mbretërisë së Perëndisë.

Përveç kësaj, Jona mori urdhrin që të shkonte e të predikonte te paganët e Ninives. Por ai nuk e pranoi misionin e tij dhe shkoi në tjetër vend (libri i Nahumit na tregon se refuzimi i tij mund të kuptohet vetëm brenda kontekstit historik – në atë kohë Asiria ishte kombi më mizor dhe më i dyshimtë i asaj epoke). Por Perëndia e kapi Jonën dhe e detyroi të bindet. Jona ishte tashmë një njeri i rënë, trupi i tij ishte rrudhur sigurisht nga acidet gastrike të peshkut të madh – ai do të dallohej gjatë gjithë jetës për shkak të mosbindjes së tij. Së fundi, Jona iu bind Perëndisë, duke shpallur ndëshkimin e Ninives. Ky i fundit u pendua dhe Perëndia e fal; atëherë Jona, duke parë se të gjitha idetë e tij ranë poshtë, u ndie i poshtëruar dhe dëshironte të vdiste.

Temat e librit: Në këtë tregim ne gjejmë pohimin e misionit të vërtetë të popullit të Perëndisë, për të qenë drita e paganëve dhe për t'u bërë atyre thirrje për pendim dhe rilindje. Perëndia, për të treguar fuqinë dhe mëshirën e tij, provokoi shndërrimin e Ninives (duke dërguar atje profetin e tij), që ishte kryeqyteti i i perandorisë asiriane dhe çerdhe e paganizmit të egër e të fuqishëm. Mesazhi i Jonës është Ungjilli; ai theu sektarizmin e ngushtë të disa mjediseve fanatike dhe shpalli se Perëndia ua ofron mëshirën e vet të gjithë njerëzve dhe të gjitha kombeve.

OBADJA

Libri i Obadjës (gr. Abdisë) është shumë i shkurtër dhe është vetëm një profeci kundër Edomit, i cili luante rolin e bashkëpuntorit të ushtrive babilonase që kishin pushtuar Jerusalemin. Jo vetëm edomasit u gëzuan me keqdashësi për rënien e popullit të tyre vëlla, por madje edhe vranë ata që donin të shpëtonin nga babilonasit. Edomasit përfituan nga rënia e Jerusalemit për të pushtuar gjithashtu dhe Izraelin jugor.

Në vitin 586 kemi pushtimin babilonas.

Më 581 Nabukadnecari rrënoi Edomin dhe kështu e përmbushi profecinë.

Këto profeci u përgjigjen mallkimeve që filluan nga 587 dhe që i gjejmë në Psalmin 137,7, Vajtimet 4,21-22, Ezekieli 25,12; 5,1 dhe Jeremia 49,7. Kjo është një thirrje për hakmarrje dhe në të njëjtën kohë lavdëron drejtësinë e tmerrshme dhe fuqinë e Perëndisë, i cili vepron si mbrojtës i së drejtës së Izraelit.

Plani i ndërtimit të librit. Profecia zhvillohet në dy drejtime: ndëshkimi i Edomit, i shpallur në disa profeci, dhe pastaj profeti kalon në ditën e gjykimit, kur Izraeli do të hakmerret ndaj Edomit. Kjo do të thotë se profecia për të ardhmen ende nuk është përmbushur.

Temat e librit: Tonet hakmarrëse dhe urrejtja që ndeshim në librin e Ovadjës hasin këdo. Por në qoftë se ne i lidhim thëniet e tij me kuadrin historik në të cilin janë përdorur, atëherë në to do të gjejmë sigurinë që përshkon mbarë Biblën; Perëndia është i vetmi sundues i kësaj bote. Ai u bën ballë mendjemëdhenjëve dhe ngre të përçmuarit. Populli i tij u mund, u tall, u poshtërua, por triumfi i tij është i sigurtë dhe arrogant, të fortët si dhe vëllezërit e rremë do të përbuzen. Kjo siguri iu desh po-

pullit çifut për të mos rënë në dëshpërim gjatë katastrofës që ra mbi të. Perëndia nuk e kurseu popullin e tij, e goditi rëndë por njëkohësisht i premtoi edhe shpëtimin dhe kjo nuk duhej harruar.

Në prapaskenën e këtij libri të shkurtër gjejmë probleme të ndryshme, siç ishte ai i zgjedhjes së Jakovit dhe jo Esavit (Mal 1,2-4; Rom 9,6-13), atë të misionit të Izraelit dhe drejtësisë së Perëndisë, të fitores përfundimtare dhe të shpresës së popullit të zgjedhur.

JOELI

Libri i Joelit ndahet qartësisht në dy pjesë. Në pjesën e parë kemi vërshimin e karkalecave, i cili shkaktoi një liturgji zije dhe lutje. Perëndia përgjigjet duke premtuar fundin e vërshimit dhe kthimin e bollëkut (1-2). Në pjesën e dytë ndeshemi me fundin e kohërave. Kapitujt 3-4 përshkruajnë me stil apokaliptik gjykimin e kombeve dhe fitoren përfundimtare të Perëndisë dhe Izraelit. Katastrofa e shkaktuar nga karkalecat shërbeu për profetin si trampolinë, në sajë të së cilës ai arriti të kapte kuptimin e vërtetë të togfjalëshit «gjykimi i Perëndisë».

Perëndia do ta dërgojë Shpirtin e tij te njerëzit (më saktësisht te një pjesë e fëmijëve të Izraelit përpara Ngushticës së Madhe – djemtë dhe vajzat tuaja do të profetizojnë dhe pastaj do t'ua predikojnë Ungjillin si bashkëkohësve të tyre, ashtu dhe të tjerëve). Perëndia do të japë edhe shenja të tjera të jashtëzakonshme, të ndërthurura me mrekulli natyrore, si p.sh zjarrin, gjakun, diellin e errësuar, hënën me ngjyrë gjaku (rr. 2-4) nëpërmjet të cilave ai paralajmëron fundin që po afrohet. Atëherë do të vijë dita e ndeshjes së madhe; popujt do të bashkohen për betejën e fundit që do të zhvillohet në luginën e Joshafatit (që do të thotë Perëndia gjykon) dhe që do të sjellë humbjen përfundimtare të armiqve të Izraelit (4,1-17; Zeh. 14; Mt. 24,15-24; Apok. 19,11-21). Ndërsa në rreshtat e fundit (18-21) shprehet se bekimi dhe paqja do t'i jepen përgjithmonë vendit në të cilin do të qëndrojë Jerusalemi.

Interes të veçantë paraqet për ne si lexues të këtij libri pyetja që shtron shpesh Joeli mbi gjykimin e Perëndisë edhe nëpërmjet katastrofave natyrore. Perëndia drejton të gjithë botën dhe vepron ashtu siç dëshiron. Por përbri këtyre sprovave dhe paralajmërimeve, nganjëherë të tmerrshme, qëndron gjithmonë premtimi i Perëndisë; dhurata e Shpirtit të Shenjtë, bekimi i mbretërisë së tij, paqja dhe lumturia e fëmijëve të tij.

Temat e librit: Ai përqëndrohet më shumë në ditën e gjykimit të Perëndisë, doktrina e së cilës shprehet mjaft qartë. Joeli flet gjithashtu mbi pendimin (1,13-14) dhe mëshirën e Perëndisë (2,12-14). Ai insiston gjithashtu në pendimin e brendshëm. Natyrisht që dita e Perëndisë për të cilën ai aludon në analizën e fundit është Ngushtica e Madhe që do të përfundojë me kthimin shpirtëror të Izraelit, në të cilin Shpirti i Shenjtë do të luajë rolin parësor (shih Zeh. 13). Kur Pjetri citoi paragrafin e famshëm, nuk pretendonte aspak se profecia do të përmbushej përsosmërisht, por linte të nënkuptohej se i njejtë fenomen që do të ndodhte përpara Ngushticës (d.m.th. gjatë 3,5 vjetëve të parë të periudhës së fundit 7-vjeçare) do të ndodhte edhe në Ditën e Rrëshajëve.

Dita e Rrëshajëve u ndesh me përmbushjen e profecisë, sepse paranteza midis javës së 69-të dhe të 70-të të Danielit nuk ishte parashikuar në perspektivën profetike të DhV. Por ne duhet të përgatitemi për përmbushjen edhe më të rëndësishme të javës së 70-të të Danielit e cila ende nuk ka filluar.

Joeli flet për pjesën besnike që do të shpëtohet (2,32). Ai bën gjithashtu aluzione të shpeshta për Tempullin dhe liturgjinë.

Joeli është një profet mjaft i moçëm (citet pothuajse 20 herë nga profetët pasardhës) dhe është e mundshme që ta ketë ushtruar vepërimtarinë e tij në periudhën e sundimit të Jehoashit, mbretit të Judës (835-796).

HABAKUKU

Ky libër u drejtohet babilonasve. Ashtu siç e kishte konstatuar edhe Jeremia, reforma e Joshijës nuk kishte patur sukses. Banorët e Judës e kishin humbur edhe rastin e fundit për pendim. Tani Perëndia do të përdorte një popull barbar, babilonasit, për të ndëshkuar dhe zhvendosur Judën.

Kjo profeci mund të ketë ndodhur rreth viteve 600. d.m.th. nën sundimin e Jehojakimit, i cili ishte mbret ambicioz, egër dhe i shturur. Në letërsinë rabinike Jehojakimi përshkruhet si tiran i pafe, i cili kishte bërë mëkate të tmerrshme, si p.sh. incest me motrën, nusen e djalit dhe njerikën. Përveç kësaj e kishte zakon të vriste burrat, gratë e të cilëve i përdhunuan, kurse pronësinë e të cileve mori me dhunë. Gjithashtu bëri tatuazh me trupin e tij.

Libri hapet me dy ankesat e profetit të cilave Perëndia u përgjigjet me dy profeci (1,2-2,4). Pyetjes së parë (1-2-4) Perëndia i përgjigjet dhe

lajmëron se do të ndërhyjë nëpërmjet një populli të dhunshëm, i cili është instrumenti i zemërimit dhe ndëshkimit të tij. Pyetjes së dytë të Havakukut Perëndia i përgjigjet duke pohuar se të gjitha profecitë do të përmbushen, edhe në qoftë se lënë përshtypje të kundërt (2,1-3). Nga profecia e dytë dalin 5 mallkimet kundër shtypësit të padrejtë (2,5-20). Pastaj profeti në një psalmë i këndon fitores përfundimtare të Perëndisë; pavarësisht nga rrethanat i drejti do të (mbi)jetojë në saje të besimit të tij ose më saktë në saje të besnikërisë së tij ndaj Perëndisë (3,4-6).

Perëndia përdor babilonasit për të ndëshkuar Judën, por më pas ndëshkon, gjithashtu, edhe babilonasit për dhunën e tyre të padrejtë.

Temat e librit: Havakuku ishte një profet që shtronte mjaft pyetje, por edhe që dëshironte t'u jepte përgjigje pseve që kishte në kokë mbi situatën në botë ku njerëzit kënaqeshin me padrejtësinë, ku Perëndia të linte përshtypjen se nuk po bënte asgjë dhe se e keqja po triumfonte. Pra, shkurtimisht mund të themi se Havakuku guxonte t'i kërkonte llogari Perëndisë për qeverisjen e mirë të botës, se përse ai (Perëndia) i ndëshkon të këqijtë nëpërmjet më të këqijve të cilët të lënë përshtypjen e mbizotërimit të padrejtësisë? Këtu ndeshemi me problemin e së keqes të parë në prizmin e kombeve. Perëndia përgjigjet. I drejti do të triumfojë ndaj të tjerëve nëpërmjet besimit, duke i qëndruar besnik Perëndisë.

Konkluzioni: Havakuku nuk e kupton, por e pranon se ai duhet thjesht t'i besojë Perëndisë. Në rreshtat e fundit të librit, si një himn besimi, ndihet siguria dhe gëzimi për triumfin përfundimtar të Perëndisë.

ZAKARIA

Kapitujt 1-8 të këtij libri i përgjigjen vitit 520. Çifutët e dëbuar janë kthyer përsëri në Jerusalem dhe ndeshen me një gjendje mjaft të mjerueshme. Rreshtat që pasojnë ata fillistarë japin përgjigjen pyetjes së parë si vijon: «O Zot i gjithëfuqishëm, tashmë për 70 vjet bërë që Jerusalemi dhe qytetet e Judës të provonin zemërimin tënd. Kur do të kesh më në fund mëshirë për to?» (1,12). Jepet e ngjërta përgjigja si në librin e Danielit (d.m.th. jo 70 vjet, por 70 x 7 vjet).

Vendi duhet rindërtuar, riorganizuar, duhet rivendosur jeta ekonomike dhe shoqërore. Populli është i shkurajuar dhe moskokëçarës; megjithëse kanë 18 vjet që janë kthyer, Tempulli ende nuk është rindërtuar. Askush nuk merrte iniciativë për të bërë diçka deri në momentin kur dy njerëz të Perëndisë, Hagai dhe Zakaria filluan të flisnin me fjalë inkura-

juese (Ezra 5,1) por edhe të ashpra në mënyrë që njerëzit të shkundeshin nga apatia në të cilën kishin rënë. Rindërtimi i Tempullit duhet të fillonte (Hagai 1).

Hagai ishte direkt, i thjeshtë dhe i prerë në fjalët e tij, ndërsa Zakaria (hebr. Zeharja) përdorte një stil të figurshëm, shprehës madje dhe më enigmatik. Fjalët e tij krahasohen me ato të Ezekielit dhe janë të ngjashme me fjalimet e apokalipseve, si p.sh. në librin e Danielit. Vegimet e natës zënë një vend mjaft të madh në tregimet e tij, kuptimi i tyre në fillim nuk është shumë i qartë për ne. Por thelbi kryesor i mesazhit të tij është mjaft i qartë: Tempulli duhet rindërtuar, kombet armike të popullit të Perëndisë do të poshtërohen dhe së fundi do t'i nënshtrohen Mesisë. Perëndia do t'ia kthejë paqen dhe lumturinë popullit të tij dhe me këtë do të shënohet edhe fundi i shqetësimeve – çdo gjë do të jetë përsosmërisht e shenjtë, d.m.th. do t'i kushtohet tërësisht Perëndisë.

Ashtu sikurse Hagai edhe Zakaria shqetësohet për ndërtimin e Tempullit, por ai i jep më shumë rëndësi dhe vend restaurimit kombëtar, si dhe kërkesave të tij për pastërtinë dhe moralitetin.

Libri përbëhet nga dy pjesë të cilat dallohen qartë nga njëra-tjetra (1, 8 dhe 9-14). Ai është shkruar sipas një plani stilistik, megjithatë ka raste kur temat e librit të parë rimerren në të dytin, por në një formë më simbolike. Pas një hyrje të datuar tetor-nëntor 520, dy muaj pas profecisë së parë të Hagait, libri na sjell 8 vegimet e profetit (shkurt 519, 1,7, 6,8) të cilat bëjnë aluzion për pastrimin e kombit në spektrin e ministrisë së lavdishme për të ardhmen, i cili do të pasohet nga kurorëzimi simbolik i Zerubabelit (lloj Mesie që parafytyron Zotin Jezu Krishtin 6,9-14).

Në Dhiatën e Re këta kapituj të librit të Zakarisë citohen shpesh, ose të paktën bëhet aluzion në ta, p. sh: Mt 21,4-5; 27,9; 26,31; Mk 14,27; Gjn 19,37, ndërsa te Apokalipsi citimet janë edhe më të shumta. Ashtu siç e tregon edhe Apokalipsi, shumë profeci mbi ardhjen e parë të Mesisë janë vendosur përbri profecive mbi kthimin e Tij. Ky është një shembull tipik i pikëpamjes së Dhiatës së Vjetër dhe të profecisë në përgjithësi. Le të shohim dy shembuj: 9,9 dhe 9,10, si dhe 14,1-2 dhe 14,3-5; në të dy shembujt rreshti i parë ka të bëjë me ardhjen e Mesisë. kurse rreshti i dytë me kthimin e tij.

Më poshtë po japim një skemë të vogël kraha-suese:

Vegimi i parë: kalorësit 1,7-17 (shih 13,9 Apok. 6,1-9) «gjithkund mbretëron qetësia» (Zeh. 1,11). Në shkurtin e vitit 519 para Krishtit, nën sundimin e Dariut, gjithësia ishte në paqe. Kjo qetësi e shqetësonte Izraelin i cili priste tronditjen lajmëtare të kohëve të reja. Kalorësit për-

faqësojnë shpirtat e Perëndisë që patrollojnë tokën.

Vegimi i dytë: brirët dhe farkëtarët që përfaqësojnë fuqitë pagane të cilat duhen mundur për t'u vendosur Izraeli 2,1-4 (12,3-4; Dan.7,8; Apok. 13).

Vegimi i tretë: matësi që simbolizon restaurimin e qytetit 2,5-9 (Apok. 11,1; Jehez. 41,13).

Vegimi i katërt: veshja e Joshuas. Joshua është përfaqësues i popullit që duhet të pastrohet nga mëkatet për t'u rivendosur dhe për të përmbushur përkushtimin e tij të vërtetë 3,1-9 (Apok. 12,9- 13,1).

Vegimi i pestë: shandanët dhe drunjtë e ullirit përfaqësojnë prirjen e vërtetë të popullit, atë të të qenit dritë për kombet pagane 4,1-14 (Apok. 11,1-13; Zeh.14).

Vegimi i gjashtë: libri fluturues që simbolizon mëkatet e popullit dhe shlyerjen e tyre të mëvonshme 5,1-4 (13,1-6; Apok. 10,9-11).

Vegimi i shtatë: gruaja në vozë. Kombi duhet të çlirohet nga mëkatet dhe mbi të gjitha nga fëlliqësirat e mërgimit në një vend të papastër. Fëlliqësirat duhen çuar në Babiloni, sepse atje edhe janë marrë.

Vegimi i tetë: koçitë përfaqësojnë agjentët e Perëndisë që shpërndajnë të kundërshtarët e Izraelit gjykimin e Perëndisë. 6,1-8; 9,11-17 (Apok. 6,1-9).

Ndërsa kapitulli i shtatë është si një retrospektivë në të kaluarën kom-bëtare, kapitulli i tetë hap perspektivën e shpëtimit mesianik.

Pjesa e dytë është shkruar në tjetër stil, por në të gjejmë të përdoren shpesh idetë e mëparshme, veçanërisht ato që i hasim te Jeremia dhe Ezekieli. Kjo pjesë ndahet, gjithashtu, në dy seksione të cilat shoqërohen nga një titull, 9-11 dhe 12-14. Seksioni i parë është i shkruar pothuajse tërësisht në vargje, ndërsa i dyti në prozë.

Në Zak 6,9-15 sjellja e arit dhe argjendit nga Babilonia për të bërë kurorat mbretërore janë shenjë paralajmëruese e kohës kur kombet do të sjellin dhuratat e tyre në Jerusalem për nder të mbretin mesianik (Apok 21,24). Dhuratat që ia sollën dijetarët Jezusit (Mt 2,1-12) ishte gjithashtu shenjë paralajmëruese.

Kapitujt 9-11 flasin për Tokën e Re të Mesisë dhe vendosjen e Izraelit, për çlirimin e tij, kthimin e tij dhe për dy pastorë. (Jezusi është pastori i mirë i cili do të bashkojë vendin – shih: 10,2-3; 1-1; 4,14; 13,7-9). Në kapitujt 11,13; dhe 12-14 përshkruhet me nota apokaliptike tradhtia e Bariut si dhe sprovat dhe lavdia e Jerusalemit të kohërave të fundit. Jerusalemi do të jetë në qendër të sulmeve të kombeve pagane, por Perëndia do ta çlirojë dhe do t'i dhurojë atij dhe popujve të tjerë shpëtim

dhe lumturi.

Kapitujt 12-14 japin hollësi për ngjarjet që paraprijnë menjëherë kthimin e Mesisë (me përjashtim të rreshtave 14,1-2 që ka të bëjë me ngjarjet lidhur me pushtimin e Jerusalemit ë 70 pas Kr.). Kthimi shpirtëror i Izraelit ndodh kur Mesia paraqitet (pas rrëmbimit të kishës) në qiell me kishën e tij të lavdëruar.

Tetë kapitujt e parë të librit kanë për qëllim nxitja për rindërtimin e Tempullit, por gjashtë kapitujt e fundit kanë të bëjnë me ngjarjet e kohës së fundit. Në kohën e të shkruarit të librit populli i Izraelit gjendej nën sundimin medeopersik (kap 1-8), pastaj populli do të jetë nën sundimit grek (kap. 9 i 10), pastaj nën sundimin e Romës (kap. 11) dhe historia e populli do të kulminohet me rilindjen e tij (12,10-14) dhe me ngritjen e mbretërisë mesianike (kap. 12-14).

Në kap. 9 flitet për fitoret e Lekës së Madh (rr. 1-8). Rr 9-10 flasin për Mesinë (ardhjen dhe kthimin e tij) , kurse në rr. 11-17 flitet për fitoret e makabenjve.

9,9 bën aludim për hyrjen fitimtar të Jezusit në Jerusalem në të dielën e palmave, kurse në rreshtin 9,10 flitet për kthimin e tij. Është kuptimplotë që shkrimtarët e ungjijve nuk e citojnë këtë rresh 10.

Në 9,11-17 aludohet për periudhën e makabenjve; rr 13 bën akudim për ushtritë greke kundër të cilave Zoti do të luftojë (më 165). të kësaj profecie Greqia tashmë quhej kërcënim për perandorinë persike. (shih 2 M 10:29-31).

Në kap 10. flitet për bekimet e sundimit mesianik.

Në 10,10: Egjipti dhe Asiria përfaqësojnë kombet ku ishin shprërndarë çifutët.

Në kap. 11 flitet për mospranimin e Bariut të Mirë dhe për pasojat e tmerrshme: mërgim, përndjekje dhe në fund sundimi i mesisë së rremë (antikrishti).

11:1-17 aludojnë për ngjarjet lidhur me ardhjen e parë të Krishtit, që kishte për pasojë mërgimin e çifutëve.

Në rr. 10 aludohet për fundin e Izraelit si shtet i pavarur më 70 pas Kr. kurse shkelja e besëlidhjes shkaktonte që Izraeli është në mëshirë të kombeve pagane.

Në rr. 11 aludohet për tre udhëheqësit (Jonathani, Simoni dhe Elazari) që ishin në krye të kryengritjes që kanë shtypur romakët më 66-72 .

Rr. 15 përfundon me sundimin e antikrishtit, pa marrë parasysh epokën e kishës.

12,11 Vajtimi në Hadad-Rimon do të jetë korruptim i tekstit origjinal: Vajtimi për Joshijën, birin e Amonit. Pas vdekjes tragjike të Joshijës në betejë, çifutët kanë caktuar çdo vit nje ditë vajtimi. Kështu vajtimi (shenjë pendimi) që do të bëhet për Krishtin, do të jetë edhe më i madh.

Në 13,7 ka aludim për “shokun tim” dhe kjo është dëshmi e fortë për hyjninë e Krishtit .

Në kap. 14 bëhet fjalë për ngjarjet lidhur me pusahtimin e Jerusalemit më 70 pas Kr. (rr. 1-2), kur në rreshtat që vijojnë për kthimin e Mesisë.

14,4 Pasojat e termetit: lumenjtë nga Jerusalemi do të ujisin tokën e thatë. Termeti do të hapin burimet nëntokësorë dhe lumenj të rinj do të rrjedhin në Detin e vdekur dhe në Detin e Mesdheut. Kjo është në përputhje me profecinë e Ezekielit. Arava do të mushet me ujë dhe qyteti i Mesisë do të bëhet porti detar i botës.

14,5 është rresht shumë i vështirë për të përkthyer. Kjo ilustron nga përkthimi i Biblës së Jerusalemit si vojon: Lugina e Hinomit do të mbushet nga Goahu deri në Jasol; do të bllokohet siç ishte nga tërmeti në kohën e Uzijës, mbretit të Judës. S’është e qartë çfarë është qëllimi i kësaj ngjarjeje, por ka të ngjarë që bëhet fjalë për formimin e një ure që do t’i japë mundësi Mesisë të hyjë drejtpërdrejt në Jerusalemi pa zbritur në luginën e Hinomit. Në qoftë se ky përkthim është i saktë, s’ka fjalë për ikje, sepse Mesia ka arritur. Prandaj bëhet fjalë për kthimin e Mesisë, e jo për shkatërrimin e Jerusalemit më 70 pas Kr.

14,20 Gjithçka që deri tani përdorej për qëllimet e tjera, tani do të përdoret për Zotin. Ndryshimet ndërmjet pastërtisë e papastërtisë do të jenë anuluar., sepse mbarë kombi izraelit do të jetë rilindur. S’do të ketë më tregtarë, sepse s’do të ketë më as lojë të dyfishtë e as pandershmëri.

MALAKI

Periudhën gjatë së cilës Malaki (gr. Malahi) ushtroi veprimatrinë e tij mund ta përcaktojmë në bazë të përmbajtjes së librit. Malakia është pasardhës i kultit në Tempullin e rindërtuar, viti 515 para Krishtit, dhe paraardhës i ndalimit të martesave mikste gjatë kohës së Nehemjës, viti 445 – ka të ngjarë që të jetë më afër kësaj të dytës. Vrulli që Hagai dhe Zakaria i kishin dhënë komunitetit kishte rënë.

Duke u frymëzuar nga Ezekieli, Malahiu pohon se nuk duhet tallur me Perëndinë që kërkon nga populli i tij të jetë besimtar dhe i pastër. Ai

pret ardhjen e Engjëllit të Besëlidhjes, të përgatitur nga një i dërguar misterioz (3,1) dhe në të cilin Mt.11,10; Mk. 1,2 dhe Lk. 7,27 njohën Gjon pagëztorin, paraardhësin. Gjatë kësaj epoke mesianike do të vendoset rregulli moral, 3,5, dhe ai kulturor, 3,4, pika kulminante e saj do të arrihet nëpërmjet sakrificës së përkryer që Perëndia u ofron të gjitha kombeve, 1,11.

Libri përbëhet nga gjashtë pjesë të ndërtuar mbi të njëjtin model: Perëndia, ose profeti i tij, shpallin një pohim i cili diskutohet nga populli, ose nga priftërinjtë dhe zgjerohet më tej në një diskutim ku kërcënimet dhe premtimet për shpëtim qëndrojnë përkrah njëra-tjetrës. Dy temat kryesore të librit janë:

1. gabimet e bëra nga priftërinjtë dhe besimtarët ndaj kultit 1,6; 2,9; 3,6-12.

dhe

2. skandali i martesave mikste dhe ndarjeve bashkëshortore, 2,10-16. Profeti lajmëron Ditën e Gjykimit kur Zoti do t'i pastrojë anëtarët e krishterë, do t'i përpijë të këqijtë dhe do të sigurojë triumfin e të drejtëve, 3,15; 13,21.

Pyetjeve që bëjnë izraelitët, Perëndia u përgjigjet vetë duke treguar se ai nuk i thyen premtimet e dhëna sikurse pretendohet nga ata që pyesnin: a na do Zoti gjithmonë? Nëse Perëndia zgjodhi Jakovin dhe jo Esavin, do të thotë se ai e donte atë dhe dëshironte të kishte popullin e tij. Dashuria e tij për të nuk ndryshoi, por ishte populli ai që ndryshoi dhe që e bllokoi me të tëra mënyrat rrugën nëpërmjet së cilës Perëndia tregonte dashurinë e tij dhe së fundi e detyruan të tregohej i ashpër.

Libri mbyllet me shpalljen e Ditës së madhe kur Zoti do të vijë dhe do të përmbushë drejtësinë e tij; të këqijtë do të ndëshkohen, të drejtët do të lahen me diellin e drejtësisë që sjell shërim dhe shpëtim.

Tema e zemërimit hyjnor rimerret edhe nga Gjon ungjilltari, i cili për më shumë shpall bashkë me ardhjen e Mesisë, edhe zgjedhjen që është duke u bërë tashmë në gjirin e popullit izraelit, në pritje të shpëtimit përfundimtar të popullit dhe vendosjes së mbretërisë mesianike, të cilën Jezusi e përgatiti dhe në një farë mënyre e inaguroi me vdekjen e tij fajshlyese.

LETËRSIA E URTËSISË

Kohët e Davidit dhe Solomonit karakterizoheshin nga një rilindje letrare. Lloji më i rëndësishëm i kësaj periudhe quhej letërsia e urtësisë. Ndryshe nga letërsia e kombeve të tjera, urtësia në Izrael bazohej në një

marrëdhënie personale me Perëndinë. Respekti për Zotin është fillimi (d.m.th. parimi) i urtësisë. Kështu, urtësia ka gjithnjë një element moral. Ajo nuk bazohet në të menduarit filozofik, por në frytin e përvojës në kontekstin e kësaj marrëdhënie me Zotin.

Ky emërtim përfshin librat e Fjalëve të urta, disa Psalme, Koheleti; Kënga e këngëve dhe e Jobit. Çfarë saktësisht është mençuria? Një përkufizim i shkurtër rrjedh si vijon: "Dituria është aftësia për të bërë zgjedhje të devotshme në jetë". Të lashtët kishin literaturën e tyre të mençurisë, por ndërsa mençuria jo-izraelite kishte si qëllim edhe bërjen e zgjedhjeve më të mira, qëllimi ishte arritja e jetës më të mirë, ajo që mençuria biblike e frymëzuar i shtoi kësaj ishte ideja thelbësore se zgjedhjet më të mira janë ato të devotshme. "Literatura e mençurisë tenton të përqendrohet te njerëzit dhe sjellja e tyre, sa të suksesshëm janë ata në zbatimin e së vërtetës ose mësimin nga përvojat e tyre. Të mençurit (*hakamim*) ishin ata që u përqendruan të prodhonin rezultate në jetën e tyre dhe të ndihmonin të tjerët të bënin të njëjtën gjë, duke formuluar Ligjin e Zotit. Ndonjëherë një mençuri e tillë u zbatua çështjeve teknike si ndërtimi (i tendës së shenjtë – Dal 31, 3) ose lundrimi (Ezek 27, 8-9). Urtësia e Zotit do të thotë aftësi e tij në arritjen e qëllimeve të tij (si krijimi) me shpenzimin minimal të energjisë. Urtësia u kërkua gjithashtu nga njerëzit që duhej të merrnin vendime që ndikonin në mirëqenien e të tjerëve. Udhëheqësit politikë si Joshua (Lp 34, 9), Davidi (2 Sam 14,20) dhe Solomoni (1 Mbret 3, 9) përkruhen se u është dhënë mençuri (aftësi) nga Zoti, në mënyrë që sundimi i tyre të jetë efektive dhe të suksesshme. "Një mënyrë në të cilën njerëzit përsosin njohuritë e tyre dhe sjelljen pasuese është me diskutim dhe argument. Kjo lloj mençurie arrihet ndonjëherë nga ligjërimi i gjatë, qoftë në një monolog të destinuar që të tjerët të lexojnë dhe të mendojnë mirë (Koheleti) ose në një dialog midis personave të ndryshëm që kërkojnë të informojnë mendimet e njëritjetrit mbi të vërtetën dhe jetën (Job). Lloji i mençurisë që mbizotëron në librin e Fjalëve të urta quhet mençuri e urtë, ndërsa lloji që gjendet te Koheleti dhe Jobi quhet mençuri spekulative. "Stili i përdorur është poetik, i plotësuar nga të gjitha llojet e teknikave të veçanta të tilla si paralelizmat, akrostikët, aliteracionet, sekuencat numerike dhe krahasimet e panumërta si metafora dhe hiperbola, si dhe shëmbëlltyrat, alegoritë dhe gjëgjëzat. "Literatura e mençurisë nuk u gjet vetëm në Izrael, por në të gjithë Botën Antike. Ajo që e dallon atë të Izraelit është se ai thekson se mençuria vjen nga Zoti dhe se qëllimi i mençurisë është ta kënaqë Atë. Nuk është një qëllim në vetvete. "Në Izraelin e lashtë disa njerëz iu përkushtuan vetes jo vetëm për të fituar mençuri, por

edhe për të mësuar të tjerët se si ta fitojnë atë. Këta mësues të mençurisë u quajtën thjesht "njerëz të mençur", (*hakamim*) megjithëse ata përfundimisht zunë një pozitë në shoqërinë izraelite disi paralele me atë të priftit dhe profetit (Jer 18,18). Kjo klasë e veçantë burrash dhe grash të mençur u ngrit të paktën që nga fillimi i periudhës së mbretërimit në Izrael (d.m.th. rreth 1000 p.e.s.); khs. 1 Sam 14, 2) dhe funksionoi si këshilltar mësues për ata që kërkonin mençurinë e tyre. Disa u frymëzuan nga Zoti për të ndihmuar në shkrimin e pjesëve të Dhiatës së Vjetër. Vëmë re se personi i mençur shërbeu si një lloj prindi zëvendësues i personit që kërkon mençuri nga ai ose ajo. Edhe para Daljës nga Egjipti, Jozefi u bë nga Zoti një "atë" për faraonin (Zan 45, 8), dhe më vonë profeti Debora quhet "nënë" në Izrael (Gjq 5,7). Kështu shpesh në librin e Fjalëve të urta ne shohim një mësues të mençur që i drejtohet nxënësit të tij ose të saj si "fëmija im". Prindërit i dërguan fëmijët e tyre të edukohen në qëndrime dhe menyra të mençurisë nga mësues të tillë të mençurisë, dhe këta mësues u mësuan nxënësve të tyre siç do t'i bënin fëmijët e tyre.

FJALËT E URTA

Forma më e thjeshtë dhe më e lashtë e letërsisë së urtësisë është fjala e urtë (hebr: *mashal*). I tillë është në shumës, titulli i librit të quajtur Fjalët e urta ose Proverbat. Proverbi hebre është me më shumë saktësi një formulë e habitshme që tërheq vëmendjen, një fjalë e urtë popullore ose një maksimë. Pastaj proverbi (hebr. *mashal*) zhvillohet; bëhet parabolë ose alegori, fjalim dhe arsyetim. Shkurtësia e fjalës së urtë që ngulet në kujtesë, i përshtatej mësimin me gojë. Ati ose nëna ia mësojnë birit, dhe mësuesi vazhdon ta quajë «biri im» nxënësin që e edukon.

Prologu i librit i kushtohet personifikimit të urtësisë (kap. 1-9). Ky person më vonë doli si vetë Jezusi. Ekuivalenti i urtësisë në Dhiatën e Re është Fjala (*Logos*), për të cilën është fjala në prologun e ungjillit sipas Gjonit. Është kuptimplotë që Jezusi, trupëzimi i urtësisë së Perëndisë, përdorte shumë parabola dhe alegori në mësimin e tij. Sikurse urtësia i bën thirrje njerëzimit të ndjekë udhët e Perëndisë, ashtu edhe Jezusi jep të njëjtin mësim. Ajo që mëson Jezusi është udha e shpëtimit ose, më mirë, Jezusi është vetë kjo udhë e shpëtimit. Urtësia është në fund të fundit zbatimi i asaj që thotë Perëndia. Jezusi është, gjithashtu, urtësia (Logosi i Perëndisë), sepse ai është organi ekzekutiv i Trinisë.

Libri «Fjalët e urta» përfshin, jo vetëm fjalët e Solomonit, por është, gjithashtu, përmbledhje fjalësh të urta të lidhur me «të urtët» që jetonin

para Solomonit. Ata që përmenden në Bibël janë ezrahasi Etan dhe Hemani, Kalkoli dhe Darda, të bijtë e Maholit (1 Mbr 5,11). Këta katër njerëz të urtë jetonin në Egjipt kur Josefi ishte në fuqi (Zan 41). Edhe Josefi radhitej mes të urtëve (Zan 41,39). Njerëz të urtë të tjerë ishin edhe ata të Arabisë dhe të Edomit (Ovadja 8) ku banonte i urti Ijov (Ijv 1,1): vendi i Ucit ndodhej në lindje të Jordanit. Kështu, Fjalët e urta përfshijnë ajkën e urtësisë së lashtësisë.

Siç duket autori i pjesës së parë (1,7-9,18) ishte Josefi (veziri i Egjiptit – shih. Zan 41). Ai ishte i njohur për respektin e tij ndaj prindërve si dhe për kundërshtimin e gruas së pamoralshme. Kjo ndarje është plotë aluzione për këto tema. Autori i pjesës së dytë (10,1-22,16) është Solomoni.

Autorët e pjesës së tretë janë ndoshta të urtët egjiptianë, sepse përmbledhja prej 30 fjalësh të urta i përgjigjet atyre të dokumentit egjiptian (*Udhëzimet e Amenem-opetit*) të përpiluar ndoshta në kohën e Josefit. Pjesa e katërt (24,23-24, 34 – nga Solomoni) ka lidhje me kundërshtimin e përtacisë. Pjesa e pestë (25,1-29,27 – nga Solomoni) ka lidhje me mbretërim (si duhet të sundojë mbreti i urtë). Përmbledhjen e bënë oborrtarët e mbretit Hizkija. Pjesa e gjashtë (kap. 30) është vepër e Agurit, i cili, siç duket, ishte agnostik!

Pjesa e shtatë (kap. 31) është vepër e Lemuelit (shifrim për Solomonin?) që tregon për gruan ideale që i iku (shih Koh 7,26-29). Shkurt, Libri «Fjalët e urta» ishte përcaktuar kryesisht për sundimtarët, që të sundojnë me urtësi.

KËNGA E KËNGËVE

Titulli i këtij libri është në të vërtetë një sipëror hebraik për Kënga më e bukur, më madhështore. Ky libër lavdëron në mënyrë poetike, por realiste, gëzimin dhe pasionin e dashurisë njerëzore. Ndërtimi i librit u përgjigjet zakoneve të dasmës orientale të antikitetit. Gjatë shtatë ditëve bashkëshortët e rinj ishin qendra e festimit me këngë, vallëzim, poema që lavdërojnë bukurinë e bashkëshortit dhe bashkëshortes. Ata quhen shpeshherë «mbret» dhe «mbretëreshë», ulen në fronë. Miqtë dhe mikeshat ndahen në korë që këndojnë dhe vallëzojnë me duartrokite. Ardhja e bashkëshortëve bëhet me përcjellje që i ngjan përcjelljes mbretërore. Ka në të vërtetë krahasim me mbretin dhe mbretëreshën, d.m.th. me Solomonin dhe Shulamitin.

Përmbledhja e teksteve të tillë më vonë do të ketë kuptuar në mënyrë

simbolike ose alegorike, sipas perspektivës profetike që shihej në dasmë dhe në martesë një shëmbëllim të habitshëm të besëlidhjes së Perëndisë me popullin e tij, Izraelin, dhe të dashurisë që duhet ta karakterizojë. Kjo do të shpjegojë përse ky libër lexohej publikisht me rastin e Pashkëve, ku permendej çlirimi i popullit nga Perëndia, i cili e nxori nga Egjipti për të lidhë besëlidhjen e tij me të në shkretëtirë, para se ta çojë në tokën e premtuar.

KOHELETI

Autori, Salomoni, quhet *qohelet*, ose drejtues i këshillit (*qahal*), i cili, në një teokraci, shpeshherë diskutonte për çështjen e urtësisë. Ai i përmbledh këto diskutime në këtë libër. Solomoni në thelb kritikon ekstremet e shkollës së urtësisë në Izrael: gjërat gjithnjë nuk përfundojnë siç shkruhet në librin e Fjalëve të urta. Jeta është shpeshherë më e ndërlikuar: ka shumë gjëra që njeriu aspak nuk mund të kontrollojë. Për të ilustruar tesën e tij, autori përsëritet argumentet e tij në mënyrë hebraike tipike dhe me grumbull fjalësh të urta. Ka disa fjalë hebraike që autori vazhdon t'i përdorë: kotësi, absurditet (*hevel*) – kotësi mbi kotësi është sipëror hebraik që do të thotë kotësia më e madhe – jap (*natan*): Zoti na dhuron shumë për të cilat mund të gëzohemi, fati ose pjesa e ndarë me short (*jitron*) që ka të bejë me kërkimet (shpeshherë të kota) e njerëzimit, dobi (*mortar*) çfarë dobi kanë njerëzit, vdekje (*mawet*) i përball njerëzit dramatikisht me kufizimet e tyre: vdekja është ajo që e shkurajon optimizmin e rremë të njeriut, mundim (*amal*) ka të bejë me ashpërsinë e jetës, por kjo kompensohet me gëzimin (*samah*) e kënaqësive të përditshme. Autori, që i drejtohet shoqërisë që është preokupuar me sukses, arritje, prodhim dhe kontroll, paralajmëron për kotësinë dhe mërzimin e kërkimeve të tilla: gëzimi nuk arrihet me arritjet njerëzore, por me gëzimin e dhuratave të përditshme të përcaktuara nga Krijuesi.

Koheleti (predikuesi) u drejton predikimin e tij jo vetëm afetarëve, por edhe fetarëve me mentalitet laik, të cilët jetojnë sikur Perëndia aspak nuk ekziston. Ai tregon, duke iu drejtuar përvojës personale, që çdo cak dhe çdo lulëzim tokësor i mbajtur si qëllim me vete, çojnë në mërzitje, në absurditet, në zbrazëti. Autori është besimtar, i cili ishte skeptik vetëm përsa i përkiste jetës, nga e cila përjashtohej Perëndia i gjallë që vepron. Jeta ka kuptim vetëm në lidhje me Perëndinë. Predikuesi synon, gjithashtu, një fe me ndikim laik, e cila nuk merr parasysh tejkalimin dhe madhësinë e Perëndisë, dhe e cila është vetëm një sistem i mbyllur, nga i cili përjashtohet Perëndia i gjallë dhe i plotpushtetshëm.

JOBI

Libri i Jobit (hebr. Ijovit) është një nga librat më të vjetër në Bibël – ka të ngjarë se Ijovi ka jetuar në kohën e patriarkëve. Libri ka të bëjë me fshehtësinë e vuajtjeve të besimtarit. Me gjithë rregulloret e përgjithshme të librit të Proverbave, duhet vërejtur që ka përjashtime. Kjo kuptohet vetvetiu, sepse Perëndia s’është i kufizuar nga sistemi i vet. Qëllimet dhe planet e tij janë të padepërtueshme. Kjo nuk do të thotë se Perëndia është amoral – veprat e tij përputhen gjithnjë me karakterin e tij të drejtë, por ai mbetet i plotpushtetshëm në gjithësinë e tij – Perëndia mbetet perëndi dhe njeriu mbetet njerëzor. Sidoqoftë, mund të jemi të sigurtë për këtë: gjithçka bashkëpunon për të mirën e atyre që i do Perëndia. Por ka shpeshherë disa elemente të këtij plani që na shpëtojnë. Në rastin e Ijovit në fillim të librit na thuhet ajo që Ijovi nuk e dinte: Perëndia duhet të dalë i drejtë në zgjedhjen e tij të Ijovit, megjithatë djalli kërkon të provojë të kundërtën. Në fund kërkesa e Perëndisë vërtetohet, dhe Ijovi shpërblehet për besnikërinë e tij.

Që në fillim, Jobi nuk është i interesuar për teori të zgjuara, por dëshiron të ketë një intervistë me Perëndinë në mënyrë që të pastrojë emrin e tij. Miqtë e tij përpiqen të japin një përgjigje në pyetjen „pse”. Por ai zbulon se ato janë thjesht llafazanë, të cilët qëndrojnë përpara Zotit me sofistike të thjeshta dhe me sentenca bosh. Përkundër përpjekjeve të tyre të lavdërueshme për të mbrojtur Zotin nga ankesat e njerëzve, ata dëshmojnë se kanë më pak shqetësim për lavdinë e Zotit dhe më shumë për një sfilatë të mençurisë së tyre. Secili argumenton në bazë të presupozimeve të veta: përvoja fetare (Elifaz), zëri i traditës (Bildad), sens i përbashkët i shëndoshë (Zofar) dhe frymëzimi i Shpirtit (Elihu). Në fund, Zoti u thotë atyre se ata gabojnë të gjithë dhe Jobi është i shfajësuar.

Satani tregohet të jetë një qenie engjëllorë që i është dashur t’i raportojë Perëndisë, i cili e ka nën kontrollin e Tij: ai nuk mund të bëjë asgjë pa lejen e Zotit.

Ringjallja. Libri i Jobi gjithashtu përmban një referencë për ringjalljen: Jobi ishte siguruar se ashtu si një pemë do të mbin përsëri, edhe sikur të ishte prerë, kështu edhe një njeri do të jetonte përsëri (Jobi 14, 7.14). Në fakt ai dëshironte shumë mundësinë që të shikonte Shpaguesin e tij (ose avokatin) me sytë e tij edhe pasi krimbat e kishin shkatërruar trupin e tij (19, 25-27).

Historikisht, libri i Jobit është një nga librat më të vjetër të Biblës, me siguri që daton që nga koha e Abrahamit. Jobab, i cili përmendet

te Zanafilla 10:29: është ndoshta një variant i të njëjtit emër.

PSALMET

Psalmet ishin këngët fetare të Izraelit të lashtë dhe kështu liturgjia, shpeshherë në formë lutjesh, e caktuar për kultin e Tempullit. Kjo shpjegon udhëzimet e ndërlikuara për ekzekutimin e disave prej tyre nga koret e ndryshme. Përdorimi i tyre i përgjigjet: a) ceremonialit të shtetit, b) festave popullore, c) devocionit të individit (p. sh. në rastin e flijimeve të mirënjohjes, betimit, lutjes, ndërmjetësimit e të tjera).

Si këngët fetare e Izraelit, ato na paraqitin një mikrobotë të preokupimeve fetare të Izraelit të lashtë. Kështu ato shërbejnë si hyrje në botën e Dhiatës së Vjetër.

Psalmet citohen më shumë herë (rreth njëqind) në DhR se ndonjë libër tjetër i DhV. Ato përmbajnë shumë lëndë profetike që ose u plotësua në kohën e Jezusit, Mesisë së Izraelit, ose do të plotësohet në të ardhmën e afërme. Kështu dëshmojnë për karakterin e tyre të frymëzuar nga Shpirti i Perëndisë.

Mesia pasqyrohet te Psalmet si Mbreti i shuguruar (Mesia). Te Ps 110 dhe 145 flitet për Mesinë si për Perëndinë (shih zhvillimin e argumentimit tek Letra drejtuar Hebrejve). Ai pasqyrohet, gjithashtu, si Shërbëtori i Zotit. Flitet për zelinë reformuese e Mesisë (69a), flijimin e vetvetes (40, 6-8), përjetimin e izolimit (69,8), tradhtinë, urrejtjen dhe mospranimin e tij (41,9; 69,4; 35,19; 118,22), pësimin e përbuzjes (69,9), talljen (22,7; 69,21), zveshjen e tij (22,18), dhe gozhdimin në kryq (22,16). Fjalët e tij të fundit ishin një citim nga Ps 22,1 dhe 31,5. Jezusi shihet, gjithashtu te Psalmet, si njeriu që zëvendëson njerëzimin (8,4), mbreti që është njëkohësisht edhe kryepriфт (110,4), guri që hodhën tej ndërtuesit (118,22), mbi të cilin thyhet njeriu (shih edhe Isaia 8,13-15) dhe guri që dërrmon perandoritë e botës (Dn 2,34). Shih Lk 20,18.

Psalmet janë shkruar në formë poezie hebraike, sipas rregullave të poezisë orientale të lashtësisë. Kjo gjini letrare karakterizohet, jo nga rima, por nga ritmi, d.m.th. nga numri i rrokjeve të theksuara në çdo varg. Megjithëse s'është e mundshme të riprodhohet në përkthim një strukturë e tillë, mund të vihet re një tipar tjetër i poezisë hebraike, d.m.th. paralelizmi që shihet në përsëritjen e vargut si jehonë, si kontrast, sintezë, ose gradacion.

Mbishkrimet e shtypura në krye të psalmeve do të jenë meloditë, sipas këtyre duhej kënduar psalmet. Shënimet e shkruara në tekstin e psalmeve (p.sh. Sela) do të jenë udhëzimet për këndimin e psalmeve (si

allegretto, fortissimo) ose ndoshta ndryshimet e celësit.

Psalmet janë ndarë në pesë libra që u përgjigjen të pesë librave të Ligjit (Torës):

- Libri i parë Ps 1-41
- Libri i dytë Ps 42-72
- Libri i tretë Ps 73-89
- Libri i katërt Ps 90-106
- Libri i pestë Ps 107-150

Sipas traditës së çifutëve, këto pesë ndarje janë përgjigjja e Izraelit, në formë lutjesh, të pesë librave të Torës. Një shpjegim tjetër i mundshëm është se librat e Psalmave pasqyrojnë disa mbledhje që qarkullonin para se të mblidheshin në një libër i vetëm. Kjo do të shpjegonte, p.sh. pse ka dublikata psalmesh.

Disa psalme janë shkruar në formë akrostike: çdo pjesë e këtyre psalmeve fillon me një shkronjë të alfabetit hebraik. Këto janë: 9-10, 25, 34, 37, 111, 112, 119, 145. Kjo formë duhet të ketë ndihmuar adhuresin t'i mësojë përmendsh.

LETËRSIA APOKALIPTIKE

Libri i Danielit i takon gjinisë letrare apokaliptike që lind në një kohë të mediokritetit shpirtëror – në këtë rast mes të mërguarve në Babiloni – të shkaktuar nga: humbja e pavarësisë kombëtare, lëshimi i fesë tek shumica, përndjekja e atyre që mbeten besnikë ndaj Zotit. Perëndia i zbulon popullit të tij se si po realizohet plani i tij. Historia caktohet nga Perëndia, jo vetëm në përgjithësi, por edhe në hollësi; ajo që ndodh s'është rastësi, por një fazë e planit të Perëndisë që ndërtohet sipas skemës së disa periudhave.

Kjo gjini karakterizohet nga tiparet që vijojnë:

- 1) Përdorimi i vegimeve të raportuara drejtpërdrejt.
- 2) Përdorimi i simboleve si mjet zbulimi, nganjëherë të interpretuara (shih cjamin dhe dashin) dhe nganjëherë pa interpretim (shih gruan e veshur me diellin në librin e Apokalipsit kap. 12).
- 3) Parashikimi i së ardhmes së popullit të Perëndisë në lidhje me kombe të tjera, e cila arrin kulmin e saj me ardhjen e Mesisë.
- 4) Stili prozaik e jo poetik (ndryshme nga profetët e DhV).

Libri i Danielit ka për qëllim përgjigje në një pyetje të veçantë: edhe sa kohë duhet të zgjasë vuajtjet e çifutëve, popullit të zgjedhur? Libri i profetit Jeremia jepte një përgjigje të kufizuar (deri në 70 vjet: fundin e mërgimit babilonas), por libri i Danielit jep një përgjigje më të gjerë

(deri në 7 x 70 vjet: në kthimin e Mesisë për të ngritur mbretërinë e tij). Në këtë libër për herën e parë në Bibël është fjala për Birin e njeriut (emërtim mesianik), i cili i vetmi është në gjendje ta çlirojë përfundimisht popullin e tij. Përveç kësaj, shpallet qartë ringjallja e të vdekurve, e cila është zgjidhja e problemit të shpërblimit të martirëve.

Libri ndahet në dy pjesë: kapitujt 1-6 janë tregim.

1. Danieli dhe tri shoqët e tij në shërbim të Nebukadnecarit.
2. Ëndrra e Nebukadnecarit dhe shtatorja.
3. Adhurimi i shatores dhe tre shoqët në furrën e zjarrtë.
4. Marrëzia e Nebukadnecarit.
5. Gostia e Belshacarit.
6. Danieli në gropën e luanëve.

Në çdo rast, Danieli dhe shoqët e tij dalin fitimtarë nga prova, nga varet jeta (ose të paktën reputacioni i tyre), kurse paganët e falënderojnë Perëndinë që i ka shpëtuar. Këto ngjarje ndodhin në sundimet e Nebukadnecarit, princit trashëgimtar, Belshacarit, dhe pasardhësit të tij, Dariut.

Kapitujt 7-12 marren me vegimet që pa Danieli.

7. Katër egërsirat
8. Dashi dhe cjapi
9. 70 periudha prej 7 vjetësh
- 10-12. Vegimi i ngushticës së madhe dhe kohëve të fundit.

Në hollësi:

1. Katër egërsira janë: perandoria babilonase (606-539), medo-persiane (539-331), greke (331-68 (331-323 + 323-68) dhe romake (68-476). Dhjetë gishtat e këmbëve janë forma e rilindur e perandorisë romake prej 10 kombesh, e cila do të ekzistojë kur të vijë Mesia.

2. Dashi dhe cjapi (këtu jepet interpretimi) janë perandoria medo-persike (në 8,3, dy birët shënojnë natyrën dyfishtë të perandorisë), kurse cjapi perandoria greke e Aleksandrit që ndahet më vonë në katër pjesë, ndërmjet gjeneraleve të tij. Perandoria medo-persike ka tri brinjë, që përfaqësojnë Babiloninë, Lidinë dhe Egjiptin, të cilat i kishte pushtuar.

Autorin e intereson kryesisht Antioku IV (Epifan) që përndjek çifutët, pasardhësi i tij i ditëve të fundit (rr. 36-39) dhe mbreti i veriut.

3. 70 periudhat prej 7 vjetësh që përfundojnë me ardhjen e Mesisë. Ne jetojmë midis periudhës së 69 dhe asaj të 70.

4. Periudha përfundimtare e provës së madhe, ringjallja, gjyqi i fundit për çifutët dhe ngritja e mbretërisë mesianike. Kap. 11 është shpjegim me hollësi i kap. 8.

PROBLEMI I NUMRAVE TË MËDHENJ NË DHV

Në vende të ndryshme të DhV paraqiten shifra që duken tepër të mëdha. Shpeshherë presupozohet se këto shifra janë shpikur dhe bëhen shkak për të mos i besuar Biblës. Por kush do të shpikte shifra që dalin qartë si absurde? Duhet të jesh me të meta që të lejosh të shpikësh një tregim për një aksident autobusi ku vdiqën 16.000 udhëtarë!

Për shembull nga dokumentet asiriane dihet se ushtria asiriane kapërcente rallë 120.000 dhe se forca e përgjithshme të trupave të koalicionit që i përballonte asirianët në betejën e Karkarit ishte maksimalisht 70.000. Gjenerali asirian llogariti afërsisht humbjet e armikut në 14.000.

a) Korruptimi i shifrave: Ka dëshmi të mjaftueshme që tregojnë se teksti i DhV është ruajtur shumë mirë. Ka edhe dëshmi që rrjedhin nga fragmentet paralele të librat e Samuelit, Mbretërve dhe Kronikave, dhe (veçanërisht) të Ezra 2 dhe Nehemia 7, e që tregojnë se numrat transmetoheshin me shkrim me shumë vështirësi. Ka shembuj kur një zero më tepër iu shtua një numri: te 2 Samuel 10,18 lexohet «700 karrocierë», kurse te 1 Kronikat 19,18 «7.000 karrocierë». Shifra mund të humbasë: te 2 Mbretërit 24,8 mosha e Jehohahinit kur hipi në fron jepet si 18, ndërsa në 2 Kronikave 36,9 si 8 vjeçar. Një shifër e tërë mund të humbasë: te 1 Samuel 13,1 thuhet se Shauli ishte – vjeç. Tek Ezra 2 dhe Nehemia 7 shifrat shpeshherë ndryshojnë për një njësi. Ka edhe gabime të tjera në të kopjuar, shumë prej të cilave mund të shpjegohen me lehtësi.

b) Ngatërimi i fjalëve: Në tekstin e Biblës hebraike moderne, të gjithë numrat janë shkruar të plotë, por për një kohë të gjatë teksti ishte shkruar pa zanore. Mungesa e zanoreve mundëson ngatërimin e dy fjalëve që janë kyç për këtë problem: *elef* (mijë) dhe *aluf* (oficer ose prijës). Pa vokalizim (zanoret), këto dy fjalë duken identike: 'lf. *Elef* mund të shënojë «mijë», por edhe «familje» (Gjyq 6,15), ose «klan» (Zak 9,7; 12,5-6), ose ndoshta «njësi ushtarake». *Aluf* mund të shënojë «prijës fisi» (Zanafilla 36,15-43); ka të ngjarë për «oficer mbi 1.000 ushtarë». Në hebraishten moderne *segan-aluf*=nënkolonel, *aluf*=gjeneral-lejtnant, kurse *rav-aluf*=gjeneral-major.

Për shembull, në festën që shtron Davidi në Hevron te 1 Kronikat 12, siç duket, janë të pranishëm numra shumë të mëdhenj, por jo të njerëzve të zakonshëm, por të prijësve të shquar – rreth 340.800 prej tyre!! Në këtë rast duket sikur ata ishin «prijësit e mijërave» dhe «prijësit e qindrave», dhe si shkurtim fjala «mijë» përdorej për «prijës mijërash», kurse «qindra» për «prijësit e qindrave». «Mijëra» dhe «qindra» konsideroheshin si numra dhe u mblodhën. Kur këto numra deshifrohen,

kemi gjithsej vetëm 2.000 «njerëz të shquar», dhe ky rezultat na jep një kuptim më të saktë.

Kështu, duke përdorur ky parim, muri i qytetit Afek ra edhe mbi 27 oficerë e jo 27.000 ushtarë. Dhjetë prijës edomas (e jo 10.000) u hodhën poshtë nga maja e shkëmbit (2 Kro 25,12; shih edhe Ps 141,6: Kur të rrëzohen nga shkëmbinjtë sundimtarët e tyre, atëherë populli do ta pranojë se fjalët e mia janë të vërteta.

b) Statistika ushtarake: Dy gjeneralë izraelitë (Haim Herzog dhe Mordehai Gihon) shkruan një libër në 1978 me titull *Betejat e Biblës*, në të cilën ata arritën në konkluzionin se logjikisht shumica e shifrave në lidhje me madhësitë e forcave ushtarake si dhe me të vrrarët në betejë duhen ndarë më dhjetë: shumica e rasteve problematike do të shpjegonte më mirë me zbatimin e parimit të shumëzimit të shifrave origjinale me 10.

A ka ndonjë dëshmi historike për këtë? Po, ka. Misteri i Atlantidës së Platonit mund zgjidhet duke marrë parasysh të njëjtin keqkuptim të numrave. Platoni mori nga ana e priftërinjve egjiptianë atë që del si tregimi i hollësishëm për qytetërimin minoas dhe fundin e tij. Por meqenëse të gjitha shifrat ishin të shumëzuara me dhjetë, krahina nuk mund të parafytyrohej në Detin Mesdhe, kështu që e vendosi në Atlantik; kurse data u shty deri në lashtësinë më të largët! Ky faktor shumëzimi dhjetëfish gjendet edhe në shifrat e fiseve të libri i Numrave. Siç duket, ky parim ishte karakteristik për stilin epik në të cilin ishin shkruar dokumentat origjinale të historisë ushtarake në Izraelin e lashtë. Autorët e librave të Mbretërve dhe të Kronikave i riprodhojnë këto shifra pa vërejtje, sepse, siç duhet, të gjithë lexuesit e tyre ishin në dijeni me këtë parim shkrimi.

Duke përdorur metoda të tilla, shumica e problemeve të numrave mund të zgjidhet. Te 1 Mbr 20,27-30, ushtria e vogël izraelite vrau 10.000 (e jo 100.000) këmbësorë. Invadimi etiopias (nubas) kishte vetëm një 100.000 ushtarë, e jo një milion (2 Kro 14,9).

c) Regjistrimet e librit të Numërimeve. Shifrat e ushtarëve (603.550) duhen ndarë me 10 sepse duhet marrë parasysh zakoni egjiptian i shumëzimit të shifrave ushtarake me 10. Në këtë rast popullsia e Izraelit në kohën e Daljes do të ishte jo 2 miliunë, por 200.000. Mbarë popullsia e Egjiptit ishte atëherë vetëm rreth 4 miliunë. Përveç kësaj, duhet marrë parasysh që ushtria e superfuqisë, si p.sh. ajo e Asirisë, doli rrallë jashtë 120.000.

Në regjistrimin e parë në Numrat 3,43 na thuhet se kishte 22.273 meshkuj të lindur të parë nga gjithsej 600,000. Raporti i meshkujve të rritur me meshkujt e lindur së pari vjen në 27 me 1. Me fjalë të tjera,

na kërkohet të besojmë se një familje mesatare kishte 27 djem. Nëna mesatare më pas duhet të ketë pasur më shumë se 50 fëmijë (përfshirë vajzat), por nëse i ndajmë këto shifra me 10 do të marrim një shifër shumë më të mundshme.

Dy tekste në Bibël (Dal 23,29; Dt 7,6) pranojnë faktin se fillimisht kishte shumë pak izraelitë për të pushtuar Tokën e Premtuar, por dy milion izraelitë do të kishin më shumë sesa ta mbushnin tokën. Shumica e qyteteve të gërmuara në Izrael nga arkeologët përmbajnë qindra e jo mijëra njerëz. Në periudhën e gjyqtarëve, luftëtarët e fisit të Danit numëruan vetëm 600 (Jdg 18,16; Num 1,38-39).

d) Regjistrimi i Davidit: Mospajtimi në dukje midis dy grupeve të shifrave për regjistrimin e Davidit mund të sqarohet duke marrë parasysh se autori nuk na jep të gjitha hollësitë njëkohësisht, dhe kjo është tipike për stilin hebraik. Shifrat për regjistrimin ushtarak të popullsisë ishin si vijon:

Sipas 2 Samuelit 24 kishte 800.000 në Izrael + 500.000 në Judë) kurse 1 Kronikat 21,1 (1,100,000 në Izrael dhe 470,000 në Judë. Siç duhet ka mospajtim, por duhet marrë parasysh faktorët që vijnë:

I. Shifra prej 1.100.000 vlen për mbarë Izraelin, e jo vetëm për mbretërinë veriore.

II. Kjo shifër nuk përfshin 200.000 që vlen për fiset e Benjaminut dhe të Leviut të cilat, siç thuhet, nuk ishin të përfshirë në regjistrimin ushtarak. Kjo na jep një shifër të përgjithshme prej 1.300.000.

Shifra prej 500.000 në 2 Samuel 21 për Judë përbëhet nga 470.000 + 30.000 të fisit të Benjaminut, e cila, kur i shtohet shifrës prej 800.000 izraelitët prej mbretërisë veriore, na jep gjithsej gjithashtu 1.300.000.

Megjithatë kjo shifër na duket shumë e madhe dhe shtrohet pyetje nëse ajo duhet ndarë më dhjetë.

PERIUDHA NDËRDHIATORE

Dhiata e Vjetër mbaron me Azinë Perëndimore nën kontrollin e perandorisë persiane. Perandori i fundit i përmendur në Bibël është Dariu II (423-404) në librin e Nehemjës. Pikërisht në atë kohë mësonte Platoni në Greqi dhe pas pak, Aristoteli. Kur kalojmë në periudhën e Dhiatës së Re, hasim në një botë nën kontrollin e perandorisë romake. Ç'ndodhi ndërkohë? Në këtë kohë ndërmjetëse mbizotëronte perandoria greke e Lekës së Madh dhe pasardhësve të tij. Bëhen aluzione për këtë periudhë edhe në profecitë e Danielit dhe në disa libra të tjera. Mjerisht kjo periudhë është vështirë të trajtohet në një kapitull të shkurtër. Prandaj

ne duhet t'u kushtojmë vëmendje aspekteve, për të cilat interesohen autorët biblikë. Kjo do të thotë se do ta shqyrtojmë me kujdes:

- 1) Se si Perëndia e ruajti popullin e vet,
- 2) Se si i rezistonin me sukses kompromisit dhe asimilimit nga kultura greke e asaj kohe.
- 3) Se si zhvillimet, gjatë kësaj periudhe, e shpjegojnë botën, në të cilën lindi Jezusi nga Nazareti.

Nga fundi i periudhës persiane, Judën e sundonin kryepriiftërinjtë që përgjigjeshin para qeverisë persiane. Mjerisht fuqia politike kishte prirje t'i prishte. Samarianët që ishin mbetur nga mbretëria e mëparshme e Izraelit, ngritën faltoren e vet për të rivalizuar Tempullin në Jerusalem. Tempulli i tyre (i zbuluar nga arkeologët kohët e fundit) ishte ndërtuar sipas planit të originalit në Jerusalem. Në shekullin e pestë para erës sonë marrim vesh për një koloni çifute në ishullin Elefantin, në ujvarën e parë të Nilit, pranë Asvanit të sotëm. Edhe atje ishte ndërtuar një tempull për të zëvendësuar atë të Jerusalemit të përdhosur nga kulti idhujtar i mbretit Mënashë.

Më 333 Leka i Madh i mundi ushtritë persiane në Turqinë e sotme dhe kaloi me trupat e tij nëpër Siri dhe Palestinë. Sipas legjendës, kur Leka po i afrohej Jerusalem, kryepriifti çifut i doli përpara dhe e njoftoi se, sipas profecive të Danielit, ushtria greke do të dilte fitimtare. Ndoshta kjo shpjegon përse Leka i trajtoi mirë çifutët. I lejoi t'i mbanin ligjet e tyre dhe u dha shkarkim nga tatimi gjatë viteve të pushtimit. Kur ndërtoi Aleksandrinë (të cilit i vuri emrin e tij) në Egjipt më 331, ai i nxiti çifutët të vendoseshin atje dhe u dha të njëjtat privilegje si shtetasve të tij grekë. Pas vdekjes së Lekës më 323, provincën e Judës e sundonte një nga gjeneralët e tij, me emrin Antigon. Sidoqoftë, ai u hodh poshtë nga një gjeneral tjetër, me emrin Ptolemeu I, i cili pushtoi Egjiptin dhe shkoi më përpara në veri për të vënë Judën nën kontrollin e tij. Ai ishte i mirë ndaj çifutëve si edhe pasardhësi i tij Ptolemeu II, nën sundimin e të cilit në Aleksandri u përkthye Bibla nga hebraishtja në greqishte. Atë e quanin **Septuaginta** sepse thuhej që kishin qenë 70 përkthyes. Ky përkthim u bë «Bibla» e çifutëve të shpërndarjes. Leximi i këtij përkthimi në greqishte i përgatiti breznitë e mëtejshëm për të dëgjuar predikimin e të krishterëve që erdhi 300 vjet më vonë.

Rreth një shekull më vonë, një gjeneral tjetër që ishte sundimtar i Sirisë, me emrin Antiok III (i cili ia vuri emrin qytetit Antioki) më 198 e fitoi kontrollin në Palestinë. Së pari ai i lejonte çifutët të praktikonin fenë e tyre. Por, pasardhësi i tij, Antioku IV Epifan, ua ndalonte çifutëve praktikën e fesë së tyre dhe përpiqej t'i ngarkonte çifutët me qytetërimin

grek dhe me praktikën e fesë pagane greke. Kështu bëri për arsye politike sepse donte që Izraeli të kishte ideologjinë e drejtë – donte të bënte Izraelin një shtet asnjans midis vetes (në Siri) dhe romakëve që filluan ta vendosnin Egjiptin nën kontrollin e vet. Ishte revolucioni kulturor i tij (si ai i Kinisë). Marshoi në Jerusalem së bashku me ushtrinë e tij, plaçkiti Tempullin dhe vrau shumë çifutë. Ndaloj liritë fetare dhe civile, ndaloj flijimet në Tempull dhe ngriti një altar për nder të një hyjnie pagane me emrin Jupiter në vendin e altarit të mëparshëm për flitë e djegura. Ekzemplarët e Shkrimeve të shenjta u dogjën dhe çifutët u detyruan të hanin mish derri, sepse kjo ishte kundër ligjit të tyre. E bënë flinë e dosës në altar për t'i fyer çifutët. Gjithkund u shtyp feja e çifutëve. Filloi një lëvizje e rezistencës kundër pushtuesit dhe pak më vonë shpërtheu një luftë partizane nën udhëheqjen e Judës Makabe (fjala Makabe do të thotë «Çekan»). Sirianët dërguan në luftë ushtri pas ustrie – por të gjitha u mundën nga partizanët çifutë. Jëhuda Çekani rifitoi pavarësinë e Izraelit më 164 dhe në atë vit ia kushtoi Tempullin përsëri Perëndisë. Kjo ngjarje festohet sot nga çifutët në festën e Hanukës (Festa e Dritës). Më vonë Jëhuda Çekani ra në betejë, por pak më parë kishte lidhur një besëlidhje me romakët. Kjo donte të thoshte se që atëherë romakët kishin interes për këtë territor dhe kishin justifikim për ndërhyrje. Gjatë kësaj periudhe lindën disa fraksione çifute, të cilat duhej të luanin një rol të rëndësishëm në kohën e Jezusit. Farisenjtë ishin një grup fetar ekstremist (çifutësh) që refuzuan të komprometoheshin me grekët dhe me revolucionin e tyre kulturor. Ata e përkrahnin luftën çlirimtare, por vetë nuk luftonin. Nga ana tjetër, saducenjtë ishin kolaboracionistët e kohës – ishin aristokratët që komprometoheshin me armikun. Zelltarët (ose zelotët) e kohës së Jezusit ishin trashëgimtarët e vërtetë të luftëtarëve çlirimtarë, sepse ishin revolucionarët që ishin gati të përdornin dhunë dhe terror. Baraba ishte anëtar i asaj lëvizjeje. Shimoni, një nga nxënësit e Jezusit, ishte një zelltar (si fundamentalist islamik i erës sonë) i kthyer.

Pas vdekjes së Jëhudës në fushën e betejës, Jonatani, i vëllai, u bë trashëgimtar. Siç duket, ai interesohet vetëm për politikë. Kur e emëroi veten jo vetëm sundimtar por edhe kryepriфт, shumë çifutë të përshpirtshëm u tërhoqën në komunitete të izoluara në shenjë proteste kundër situatës. Kështu esenët u tërhoqën në Kumran. Në komunitetin e tyre ndoshta studionte për një kohë edhe Gjon Pagëzori kur ishte në shkretëtirë. Më vonë vdiq edhe Jonatani, dhe Shimoni i vëllai erdhi në pushtet. Shimonin e vranë, dhe Hirkani I, i biri, erdhi në pushtet. Hirkani I themeloi një dinasti me emrin hashmon, sepse Hashmoni kishte qenë

një nga emrat e Jëhudë Çekanit. Ushtria partase i mundi sirianët, e kjo u la çifutëve vend për t'u shtrirë. Nën sundimin e Hirkanit I mbretëria çifute arriti kufijtë më të largët që nga koha e Solomonit. Hirkani I i detyroi edomasit të ktheheshin në fenë çifute, duke përfshirë edhe atin e Herodit, Antipatrin, si edhe galileasit. Sundoi nga v. 134 deri në v. 104 para erës sonë. Disa kohë më vonë, shpërtheu një luftë civile ndërmjet dy pretenduesve për fronin izraelit. Romakët morën anën e Hirkanit II, një nga pretenduesit. Romakët ndërhyjnë për t'i dhënë fund luftës dhe e emëruan kryeminister Antipatrin (atin e Herodit). Gjatë edhe një periudhe traziraash, kur ushtria partase e pushtoi Izraelin, Herodi mori pozitën e njeriut të besuar të romakëve. Në këtë mënyrë në fund u bë mbret.

Koha e rezistencës makabe kundër grekëve përmendet në letrën drejtuar hebrejve në Dhiatën e Re. Në këtë letër disa njerëz lavdërohen për besimin e tyre, sepse refuzuan të hiqnin dorë gjatë revolucionit kulturor të Antiok Epifanit, me gjithë torturën dhe trajtimin e keq. Lexojmë si vijon: *Disa, të cilët refuzuan të liroheshin në kurriz të besimit të tyre, vdiqën nga torturat, që të ringjallen në një jetë më të mirë. Disa i përqeshnin dhe i fshikullonin dhe disa i futën në pranga dhe i futën në burg... Çfarë përmendjeje fituan ata me anë të besimit të tyre! Sidoqoftë nuk morën atë që Perëndia ia kishte premtuar (d.m.th. ringjalljen nga të vdekurit dhe mbretërinë mesianike), sepse Perëndia na kishte zgjedhur një plan edhe më të mirë. Qëllimi i tij ishte se vetëm së bashku me ne, do të bëhen të përsosur (d.m.th. do të ringjallehin nga të vdekurit).*'

Metodat që përdorin arkeologët biblikë për datimin e moshtrave

Gjetjet arkeologjike si p.sh. keraminën dhe gërmadhat e lashtësisë japin datime të përafërta. Po ashtu diferenca e gabimit për datimin e lëndave organike duke përdorur metodën e karbonit 14 është 10%. Përveç kësaj kjo metode (që quhet sot radiokronometri) nuk mund të përdoret për datimin e moshtrave më të vjetra se 5.700 vjet.

Atëherë ekziston metoda e termolumenishencës, e cila mund të masë vjetërsinë e sendave që u ngrohën në të kaluarën. Kur këto sende ngrohen përsëri në laborator, këto lënda rrezatojnë dritë, intensiteti i së cilës ndryshon sipas sasisë së radioaktivitetit në të cilin ekspozohen qëkur ishin ngrohur për herë të fundit. Kjo metodë përdoret gjerësisht për datimin e keramikës ose gurit të çakmakut.

Megjithatë metodat më të sakta janë datimet që jepen në dokumentet asiriane.

SFONDI HISTORIK I DHIATËS SË RE

Në këtë studim do të flasim për ngjarjet që çuan në lindjen e Jezusit. Gjithashtu, do ta shqyrtojmë sfondin politik në kohën e rritjes së tij.

Rrethanat e lindjes së Jezusit përshkruhen me hollësi në ungjillin sipas Lukës. Luka ishte mjek dhe historian që e vendosi lindjen e Jezusit në kontekstin e saj politik.

Mësojmë se Herodi i Madh ishte mbreti i Judesë kur lindi Jezusi. Kemi parë se si romakët e kishin përkrahur Herodin gjatë luftës civile ndërmjet pretenduesve të ndryshëm për fron. Në vitin 63 para erës sonë, çifutët, të nxitur nga Antipatri (ati i Herodit) iu lutën romakëve të ndërhynin për t'i dhënë fund luftës civile. Gjenerali romak, Pompeu, pushtoi Izraelin dhe zaptoi Jerusalemin. Hirkani II u emërua kryepriift dhe Antipatri (edomas që ishte në anën e romakëve) u emërua kryeminister dhe kështu sundimtar i vërtetë i Judës. Në vitin 51 Kleopatra VII u bë mbretëreshë e Egjiptit. Më 47 Herodi, biri i Antipatrit, u emërua sundimtari i Galilesë. Më 43 partasit, armiqtë e betuar të romakëve, e pushtuan Sirinë dhe romakët u tërhoqën nga kjo krahinë. Antigoni, pretenduesi makabe shfrytëzoi rastin dhe emëroi veten mbret dhe kryepriift. Herodi iku në Romë. Më 38 romakët i dëbuan partasit nga Siria dhe Palestina dhe u zhvillua një luftë ndërmjet Antigonit dhe Herodit të kthyer nga Roma. Herodi, i përkrahur nga romakët, fitoi, kurse Antigoni e ekzekutoi gjenerali romak Antoni. Herodi u emërua mbret, në të vërtetë mbret i vogël nën kontrollin e romakëve. Ai u martua me një princeshë makabe për të përforcuar pretendimet e tij mbretërore. Sidoqoftë më vonë dyshonte që farefisi i gruas së vet komplotonte ta rrëzonte. I ekzekutoi disa duke përfshirë edhe gruan e vet në vitin 29. Që atëherë Herodi duhej të përballonte dy probleme të rëndësishme:

1) Intrigat e pjesëtarëve të familjes makabe. Kjo shpjegon arsyen që Herodi dyshonte për Jezusin, pas lindjes së tij – e mbante për një pretendues makabe, i cili u shpëtoi spastrimeve të tij të mëparshme.

2) Kleopatra VII, mbretëresha e Egjiptit, donte t'ia bashkangjiste Judën mbretërisë së saj. Në vitin 31 ajo u lidh me Antonin, të cilin e mundi Oktaviani në luftimin detar tek Akciumi. Ajo së bashku me Antonin bëri vetëvrasje dhe Egjipti u bë provincë romake. Duhet përmendur shkarazi se ajo më parë i kishte lindur Herodit një fëmijë! Arsinoe, motrën e saj, e vranë në Efes me urdhrin e saj.

Herodit i hyri një programi madhështor të ndërtimit. Ndërtoi portin artificial të Cezaresë dhe në vitin 19 para erës sonë filloi rindërtimin e

Tempullit të dytë (duke dyfishuar siperfaqen e zonës së tij), i cili përfundoi vetëm pas vdekjes së Jezusit (më 64 të erës sonë). Ndërtoi edhe disa qytete të tjera për të lënë përshtypje të mirë në popull dhe u martua me disa gra të tjera. Në sferën fetare lulëzonin dy shkolla fetare rivale të shpjegimit biblik; një në Palestinë nën udhëheqjen e njëfarë Shamai dhe e dyta në Babilon ku ishte një koloni e madhe çifutësh, nën udhëheqjen e njëfarë Hileli. Njerëzit i luteshin shpesh Jezusit se me cilën nga të dy pajtohej ai. Në vitin 7 para erës sonë Herodi mbyti dy nga bijtë e tij. Siç mund të shohim, ai ishte njeri shumë mizor dhe dyshues. Sipas Tertulianit, në të njëjtin vit në Jude u krye një regjistrim nën udhëheqjen e Saturninit, i cili vazhdoi regjistrimin e filluar nën Kuirinin, legatën e Sirisë. Më shumë se 6000 farisenj refuzuan t'i betoheshin Augustit, perandorit romak. Ka të ngjarë se ky të ketë regjistrimin që përmendet në Ungjillin sipas Lukës. Ai ndodhi në vitin e lindjes së Jezusit. Në qoftë se «ylli» i përmendur në Ungjillin sipas Mateut ishte koniunksioni i planetit Jupiter (ylli mbretëror) dhe i planetit Saturn (ylli i hebrenjve) në yllësinë e Regullit (yllësia mbretërore) që ndodhi tri herë më rradhë në vitin e 7 p.e.r. dhe pastaj në vitin 5 p.e.r. (por kësaj here u shfaq edhe kometi që drejtoi astrologët deri në vendlindjen e Jezusit), atëherë kjo duhet ta përcaktojë lindjen e Jezusit më 5 p.e.r. Herodi vdiq më vitin 4 p.e.r. Astrologët ishin, siç duket, kaldeas që kishin ardhur nga ish-perandoria babilonase (ose nga Arabia ku më vonë ishin shpërngulur). Sigurisht ata kishin mësuar për Mesinë që duhej të vinte, nga çifutët që ende banonin në atë territor që nga koha e mërgimit, afër 600 vjet më parë. Pasi e gjetën foshnjen mbretërore në Bet-Lehem u nisën, dhe Perëndia i paralajmëroi prindërit e Jezusit të iknin në Egjipt. Ikën natën dhe Jezusi bashkë me prindërit e vet u bë i arratisur politik në Egjipt deri në vdekjen e Herodit. Ikën pikërisht në kohë, sepse pas disa ditësh Herodi urdhëroi që të masakronin të gjithë fëmijët nën moshën dy vjeçare në Bet-Lehem dhe në rrethinë e tij. Pas vdekjes së Herodit, Perëndia i tha Jozefit, atit ligjor të Jezusit, të kthehej në Izrael. Por kur Jozefi dëgjoi se Arkelau, biri i Herodit, u bë mbreti i Judesë, kishte ndër mend të shkonte atje. Mori në ëndërr udhëzime të mëtejshme, prandaj shkoi buzë kufijve të Judesë dhe të Samarisë, arriti në provincën e Galilesë më në veri, dhe u vendos në një qytet të quajtur Nëcaret ose Nazaret (që do të thotë Pinjoll). Mateu, në ungjillin e tij, tregon se kështu u plotësua premtimi që Mesia do të mbante titullin mesianik Pinjoll (hebr. *Necer*).

Në v. 4 para erës sonë Herodi i Madh vdiq. Augusti, perandori romak, pranoi testamentin e Herodit, por refuzoi të lejonte Arkelaun,

një nga bijtë e Herodit, të mbante titullin «mbret». Mbretëria e Herodit u nda ndër tre bijtë e tij: Arkelau u bë «sundimtari» i Judesë dhe Samarisë, Herod Antipa u bë «sundimtari» i Galilesë dhe Peresë, kurse Filipi sundimtari i provincave të ndryshme në veri (sot pjesa e Sirisë dhe Libanit). Pas vdekjes së Herodit të madh, romakët bënë inventarin e pasurisë së tij. Populli e dinte qëllimin e atij veprimi; do të mblidhnin edhe tatim, prandaj gjithkund shpërthyen kundërshtime dhe trazira. Jëhuda nga Galilea dhe një farise me emrin Cadok themeluan një lëvizje që refuzonte t'ua paguante tatimin romakëve. Disa nga ata organizuan një kryengritje të armatosur dhe romakët thirrën gjeneralin e tyre, Varin, i cili ndërhyri me ushtrinë e tij. Ai i ndoqi rebelët, 2000 nga të cilët u kapën dhe u kryqëzuan. Në vitin 6 të erës sonë, romakët e rrëzuan Arkelaun si sundimtar të Judesë si pasojë e ankesave kundër tij për shkak të sundimit të ashpër të tij dhe e dëbuan në Vjenë (në jug të Lionit të sotëm, në Francë). Judeja u bë provincë romake nën sundim të drejtpërdrejtë të guvernatorit romak (me titull prokurator), me Cezarenë si kryeqytet. Kështu Juda u bë Judeja – provincë romake. Ponce Pilati ishte guvernatori i pestë, siç do të shohim më vonë.

Kështu, pra, mund të vërehet se aludimet historike të bëra në Dhiatën e Re pajtohen me atë që dihet nga historia jofetare e kohës. Tregimi për Jezusin s'është mit, por pjesë përbërëse e historisë së Izraelit. Jigael Jadini, arkeolog i njohur izraelit, e quajti Jezusin nga Nazareti, çifuti më i madh që ka jetuar ndonjëherë. Jezusi, natyrisht, pretendoi të ishte edhe më i madh, siç do të shohim.

KATËR UNGJITË

Pjesa e parë e Dhiatës së re përmban katër ungjijtë, në të cilët ndodhet një tregim për jetën, vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit nga Nazareti. Fjala është për katër tregime të një Ungjilli ose Lajmit të mirë.

Këto regjistrime përmbajnë lëndë të ndryshme. Ka tregime të thjeshta për jetën e Jezusit, për përmbajtjen e mësimit të tij publik si dhe për përmbajtjen e mësimeve drejtuar nxënësve të tij (me një shtojcë në Letrat e apostujve). Para vdekjes së tij, Jezusi kishte premtuar se një nga detyrat e Shpirtit të shenjtë do të ishte kujtimi për gjithçka që Jezusi tha dhe bëri. Prandaj gjatë shkrimeve të tij, autorët vepronin nën frymëzimin e Shpirtit të shenjtë. Lënda është rregulluar sipas kriterëve të ndryshme: disa janë kronologjike, kurse disa tematike.

Megjithëse Jezusi dha shumë mësime në formë të lehtë për t'u mësuar përmendsh, ka shumë të ngjarë se kishte transkriptime të fjalimeve të tij

që u nxorën në qarkullim pak pas vdekjes së tij. Apostujt, kur jepnin mësim dhe predikonin ungjillin ndoshta kishin dokumente të tilla në dispozicionin e tyre për të nxjerrë hollësitë për jetën dhe mësimin e Jezusit. Gjithashtu, ka mundësi se dokumentet e tilla i lexonin me zë të lartë gjatë adhurimit publik. Më vonë apostujt i përdorën dokumentet e tilla për shkrimin e ungjijve, të cilët edhe i redaktuan disa herë. Ungjillin e parë që shkruan ishte, siç duket, Ungjilli sipas Mateut, me siguri në hebraisht dhe ndoshta në një formë të mëparshme se atë që e njohim, në vitin 41 të erës sonë. Ndoshta atëherë u shkrua projekti i parë i Ungjillit sipas Gjonit, kur Gjoni ende banonte në Jude. Ka, gjithashtu, mundësi që projekti i ungjillit sipas Markut u shkrua në vitin 43 të erës sone. Ungjilli sipas Lukës ndoshta u shkrua në vitin 58. Më vonë në vitin 96 Gjoni siç duket e bëri projektin e fundit të ungjillit të tij. Kështu mund të konstatohet se projektet e para të disa ungjijve u shkruan ndoshta vetëm 10 vjet pas vdekjes së Jezusit. Një fragment të vogël të Ungjillit sipas Markut, të gjetur në Kumran, ekspertët e datuan si të vitit 50 të erës sonë. Ka shumë të ngjarë që kur këta ungjij ishin në etapën e projektit të parë, autorët e tre ungjijve të parë huazuan lëndët nga njëritjetri, para se të redaktonin projektet e tyre të fundit. Këtë e dëshmon ngjashmëria e shumë lëndëve letrare në ungjijtë. Ka mundësi që këto dokumente origjinale ose projekte po qarkullonin aramaisht. Këtë e shpjegon stili i ngathtë greqisht, në të cilin janë shkruar – dhe jo vetëm që janë shkruar në gjuhën e thjeshtë greke, por edhe për shkak të përkthimit nga gjuha aramaike.

Ungjillin sipas Mateut e shkroi Mateu (hebr. *Matai*), tagrambledhësi, i cili ishte njëri nga apostujt. Meqenëse ishte njeri që dinte shkrim e këndim, do të ketë qenë sekretar për grupin e apostujve. Ka mundësi se mbante (me stenografi?) shënime për mësimin e Jezusit.

Ky Ungjill para së gjithash u drejtohej rrethëve çifute dhe ndoshta palestineze. Është një apologji e shkruar me qëllim që t'i kundërshtojë shpifjet çifute për personin e Jezusit. Çifutët pranonin me shumë vësh-tirësi çështjet që vijojnë:

- 1) Lindjen e mbinatyrshme të Jezusit.
- 2) Nocioni i Mesisë që vdiq në kryq (sipas tyre, ai ishte kështu nën mallkimin e Perëndisë).
- 3) Ringjallja e Jezusit

Prandaj Mateu këto çështje i trajton me hollësi. Përveç kësaj njerëzit donin të dinin:

Mëqenëse Jezusi lindi gjoja në Bet-Lehem, pse kaloi aq shumë kohë në Galile?

Si e dini se Jezusi nuk ishte fëmija i paligjshëm i Marisë?

Përsa i përket ringjalljes, a nuk ishte e vërtetë se dishepujt e vodhën trupin e tij?

Me kalimin e kohës, njerëzit donin të dinin për personazhet e dorë së dytë të tregimit. P.sh. pse Juda e tradhtoi mjeshterin e tij? Pse Pilati e dënoi me vdekje Jezusin?

Shumë vend i kushton mësimin të Jezusit, sepse çifutët interesoheshin për qëndrimin e Jezusit ndaj polemikave të ndryshme për interpretimin e ligjit çifut. Pikërisht për çështjen e interpretimit të ligjit Jezusi grindej me autoritetet çifute: ai e interpretoi ligjin në drejtimin e vet, Mesisë, kurse ata e kishin absolutizuar ligjin saqë madje e përjashtonin Mesinë nga mendimi i tyre. Ata pothuajse e kishin zëvendësuar Mesinë! Atje ndodhet lëndë unike për ungjillin e Mateut sepse para së gjithash ka të bëjë me kombin izraelit dhe me çifutët.

Jezusi paraqitet si Mesia i Izraelit: është mbreti i dinastisë së Davidit, i cili është trashëgimtari i fronit të Izraelit (kjo theksohet në gjenealogjinë në fillim të ungjillit).

Jezusi është Moisiu i dytë që sjell te populli ligjin e Perëndisë të interpretuar tani në lidhje me banimin e Shpirtit të shenjtë (dhuratës së Mesisë) në besimtar, e kjo do të bëhet e mundur në një nivel të lartë moral. Duke shpjeguar Ligjin, Jezusi, gjithashtu, korrigjon shpjegimin rabinik të rremë të ligjit nga skribët dhe farisenjtë, të cilët ligjin ia përshtatnin normave njerëzore.

Struktura e ungjillit i përgjigjet asaj të Torës (Pesëlibërshit). Ndahet në 5 pjesë lëndesh mësimore:

1. Etike: predikimi në mal (5,1-7,27) – manifesti i Moisiut më të madh; mbretëria e qiellit sjell elementin eshatologjik; të varfrit janë të përshtatshmit; toka është toka e premtuar. Kjo tregon ngjyrimin çifut te lumturitë. Interpretime të ndryshme të Ligjit nga ato të farisenjve; pajtuesit janë ndoshta ata që pajtohen me Perëndinë.

Predikimi në mal është etika: pjesa e dytë (pjesa e parë është Ligji), sepse ka të bëjë me motivacione; kritikimi i farisenjve për përshtatshmërinë e Ligjit me normat njerëzore, por edhe paralajmërim kundër antinomianizmit.

2. Misionare: Porosia misionare e 12 apostujve (10,1-42) – predikime drejtuar çifutëve tani dhe gjatë ngushticës së madhe.

3. Predikuese: Shëmbëlltyrat e mbretërisë (13,1-52). Merren parasysh aspektet e ndryshme të mbretërisë në formën e saj të ndërmjetme (fillimi, zhvillimi, dhe kulmi).

4. Kishtare: Marrëdhënet në kuadrin e mbretërisë (18,1-35). Pushteti, ndjesa, rregullimi i grindjave.

5. Eskatologjike: Kthimi i Mesisë (24,1-25,46).

Lënda mësimore është rradhitur për t'u mësuar përmendsh: p.sh.

Gjenealogjia: 14 x 14 x 14;

lumturitë: 8;

Antitezat: 6 (Mt 5,21-48) – keni dëgjuar se u ishte thënë të rabinëve të lashtë, por unë po ju them...

Ritet fetare: 3

vajtimit: 7 për mësuesit e Ligjit.

mbledhja 10 mrekujsh

predikim parabolik: 8 shëmbëlltyra për mbretërinë.

Mateu ka prirje ta largojë lëndën jothelbësore nga tregimet (ndryshme nga Pjetri tek ungjilli sipas Markut) sepse interesohet për mësimin shpirtëror.

Jezusi është Shërbëtori pësimtar, i cili vdiq për mëkatet e popullit, për të realizuar të ardhmen e tij të paracaktuar nga Perëndia.

Meqë çifutët si komb nuk e kishin pranuar Jezusin, ai themelon bashkësinë mesianike të përbërë nga çifutët dhe joçifutët, që do të trashëgonte frytin e vdekjes dhe ringjalljes së tij. Por kjo masë ishte në fuqi vetëm derisa kombi çifut do ta pranonte Mesinë. Prandaj, Jezusi jep mesim për mënyrën e jetesës në këtë komunitet ose bashkësi. Më në fund Jezusi paraqitet si Mesia që do të kthehet në fund të erës sonë për të gjykuar kombin izraelit për të vendosur se cilët do të jenë anëtarët e mbretërisë që ai do ta themelonte. Ata që nuk e pranuan atë, do të përjashtohen.

Mateu thekson (nganjëherë me anën e tipologjisë) se si jeta e Jezusit ishte plotësim i shumë profecive mesianike që u bënë në Dhiatën e Vjetër.

Këto pjesat e mësimi janë të ndara nga tregime mrekujsh. Këto mrekuilli shërbëjnë për ta identifikuar Jezusin si Mesinë e premtuar. Ai është i njëjti person që do të bëjë në shkallë më të madhe gjatë mbretërimit e mijë viteve atë që po bën tani. Përveç kësaj, mëqenëse mund të kryejë mrekuilli fizike, të dukshme, kjo do të thotë se ai ka pushtet të plotë për të kryer mrekuilli të brendshme (të padukshme) si ndjesën e mëkatëve dhe dhënien e Shpirtit të shenjtë.

Plotësimi i profecisë është një temë tjetër i këtij ungjilli. Misioni i Jezusit ishte plotësimi i Ligjit dhe Profetëve. Mateu na tregon me hollësi

se si kjo u realizua në jetën e Jezusit.

Ka edhe themën e gjykimit; te ky ungjill ka më shumë lëndë për «errësirën e jashtme, vaj dhe kërcëllimin e dhëmbëve» se te ndonjë ungjill tjetër. Jezusi shihet si Gjyqtar i Izraelit, që do të kthehet për të gjykuar kombin e tij.

Ngjyrimi çifut shihet tek temat që vijojnë:

1. Plotësimi i profecive të DhV.
2. Aludim për çëshjet e diskutimit rabinik.
3. Përdorim i shprehjes «mbretëria e qiellit» e jo «mbretëria e Zotit».
4. Ritet çifute nuk shpjegohen aspak.
5. Misioni i Jezusit i drejtohet vetëm Izraelit.
6. Merret seriozisht pushteti i udhëheqesve çifutë.
7. Kombit çifut dënohet rëndë, veçanërisht udhëheqësit.
8. Theksohet rëndësia e tepricës çifute (shenjtërit, kisha) që duhet zgjeruar për t'i përfshirë edhe joçifutët.
9. Eskatogjikisht (d.m.th. në fund të fundit) raporti i personit me Jezusin, Mbretin (Mesisë), shihet si vendimtar për hyrjen në mbretërinë e Zotit (e parafytyruar si gosti).
10. Ungjilli është lajmi i mirë për Mbretin (Mesinë). Kjo shihet si vijon:
 - a) plotësimi i idealeve të monarkisë.
 - b) Jezusi (Mesia) shihet si mbret universal.
 - c) Tundimet dhe tallja e Jezusit shihen si mospranimi i këtij pretendimi.
 - d) Ungjilli fillon me paraqitjen e Jezusit si Imanuel (Perëndia me ne) dhe mbaron me shprehjen «UNË JAM me ju përgjithmonë.»
11. Lënda eskatologjike te Mateu do të bëjë kryesisht me kombin çifut dhe shpjegohet:
 - a) sipas pikëpamjes së dikujt që banon në Izrael.
 - b) sipas pikëpamjes së profecisë së Danielit rreth 70 periudhave prej 7 vitesh.

Vendi i shkrimit: do të jetë Antiokia. Ignati, biskup i Antiokisë, e përmend i pari këtë ungjill. Sidoqoftë, pjesat e ungjillit të shkruara në aramaisht, ndoshta një listë përmbushjesh profecish ose tregimet për fëmijërinë dhe shfaqjeve të Jezusit pas ringjalljes, do të kenë qarkulluar më parë në Palestinë. Papi do të bëjë aludim për këto kur thotë: Mateu i përpiloi i pari thëniet në aramaisht dhe secili i përktheu sipas mundësisë.

Ungjillin sipas Markut e shkroi Gjon (Johan) Marku, shoku më i ri i Palit, i Barnabës dhe më vonë i Pjetrit. Prologu Antimarcionit e përmend si degëtrashë, sepse degët e tij ishte të shkurtra në raportin me pjesën tjetër të trupit. Ai quhej Johanan (me shkurtrim Gjon) kurse latinisht Mark (Marcus). Nëna e tij, Maria, ishte farefis i Barnabës (pronar tokash i pasur nga Qiproja), i cili ishte edhe pronar i një shtëpie të madhe në Jerusalem ku mblidhej kisha e parë. Maria ishte e pasur dhe fisnike. Më vonë Markun e sollën Barnaba dhe Pali në Antioki (Vap 12,25) që tek po kthehej nga një mision humanitar në Jerusalem. Më vonë Marku e përcolli Palin dhe Barnabën në udhëtimin e parë, por më vonë u sëmur dhe u kthye në Jerusalem. Barnaba, xhaxhai i tij, e mbrojti kundër Palit dhe e mori nën mbrojtjen e tij. Më vonë Pali e dërgoi Markun në misione të ndryshme dhe pastaj u bë shoqërues besnik i Palit. Vazhdimisht shoqërohej me Lukën, Pjetrin dhe Palin, udhëheqësit e kishës.

Papi (i cituar nga Eusebi) na thotë se: «Marku, i cili ishte interpretuesi i Pjetrit, shkroi me saktësi gjithçka që mbajti mend, për thëniet dhe veprat e Krishtit, por jo kronologjikisht (por tematikisht). Në të vërtetë nuk ishte dëgjues (dishepull) e as shoqërues (apostull) i Zotit, por pastaj, siç kam thënë, e shoqëroi Pjetrin, i cili adaptoi sipas mundësisë mësimin e Tij. Pasi Pjetri u martirizua në Romë, Marku e përdori lëndën për të shkruar ungjillin e tij. Ireneu na thotë se: Pas nisjes (d.m.th. vdekjes) së Pjetrit dhe Palit, Marku, dishepulli i Pjetrit, na dorëzoi me shkrim thelbin e predikimit të Pjetrit.»

Siç kemi konstatuar, ky ungjill është kryesisht tematike dhe lë jashtë shumë hollësi që ndodhen në ungjijtë e tjerë. Është shkruar në këtë formë sepse ky ungjill është para së gjithash një doracak pedagogjik i shkruar nga apostull Pjetri dhe i drejtuar nxënësve e katekizmit të krishterë. Për këtë dokumentimi pakësohet në minimum. Pas martirizimit të Pjetrit në Romë, Marku e përdori këtë lëndë për të përgatitur ungjillin që mban emrin e tij. Kjo dallohet nga një analizim i kujdesshëm i këtij ungjilli. Tregimi fillon që nga koha kur Pjetri u bë dishepull i Jezusit. Trajton kryesisht shërbimin e Jezusit në Galile, vendbanimin e Pjetrit. Mban të gjitha gjurmët e një dëshmitari. Mungojnë elementet që paraqitin Pjetrin në dritën e mirë, kurse theksohen elementet që e tregojnë atë në dritën e keqe (p.sh. mohimin e Jezusit).

Ka, gjithashtu, shumë shprehje aramaike që i hasim në tekst, dhe kjo tregon se Pjetri është autori i vërtetë. Sidoqoftë, është e qartë se ky ungjill u ishte drejtuar njerëzve që banonin jashtë Palestinës (d.m.th. në Romë). Autori me kujdes shpjegon shprehjet aramaike që i përdor si

edhe zakonet çifute (p.sh. *kurban, Golgota*). Ka edhe fjalë latine që i transkripton në greqisht (p.sh. *praetorion, flagellosas, kenturion*)

Fragmentet e mëdha të ungjillit janë të shkruara në një formë që mund të mësohet lehtë përmendsh. Këto fragmente janë shpesh të lidhura me njëri-tjetrin me anë të fjalëve hallkë (p.sh. 9,41...në emrin tim...skandal (pengesë)... zjarr...kripë).

Ky ungjill përmban fragmente të gjata rreth ndjekimit të Jezusit. Nganjëherë është me dobi të zbulojmë çfarë është tema e lëndës. P. sh. Mk 8 është një kapitull rreth verbërisë shpirtërore të dishepujve. Ngjarja në lidhje me të verbrin, siç duket, u vendos atje ku është për ta ilustruar këtë temë. Përsëri, rrethat fillimtare të kap. 9 sigurisht nuk u shprehën në atë kontekst në fillim, por u përdorën nga Marku për një qëllim tjetër.

Prandaj shpjegimi i saktë i fragmentit varet nga zbulimi i temës së tij. Shpeshherë kuadri i fragmentit zbulon kuptimin e vërtetë.

Siç duket, autori, para së gjithash, do të shpjegojë se si Jezusi është Mesia, me gjithë mospranimin e popullit çifut që e kryqëzuan. Dimë që ishte pikërisht kjo çështje që kapërthente mendjen e Pjetrit.

Pas pak ungjillin sipas Markut e vuri në qarkullim kisha e fuqishme romake dhe u pranua shumë shpejt gjithandej.

Ungjillin sipas Lukës e shkroi Luka, i cili ishte edhe autor i «Vepërave të apostujve». Luka, i cili do të ketë qenë çifut i Diasporës, lindi në Antiokinë e Sirisë, ishte me zanat mjek dhe dishepull i apostujve. Pastaj e shoqëroi Palin deri në martirizmin e tij «duke shërbyer Zotin pa pengesë, sepse nuk kishte grua e as fëmijë. Vdiq në Boetici (krahinë e Greqisë) në moshë 84 vjeç, plotë me Shpirtin e shenjtë. Kështu, pas shkrimit të dy ungjijve – atë të Mateut në Jude dhe atë të Markut në Itali – Luka e shkroi këtë ungjill në krahinën e Akaisë, nën frymëzimin e Shpirtit të shenjtë.»

Prologu antimarcionit na thotë se Luka lindi në Antiohi ku ka mundësi se shkroi ungjillin duke përdorur të njëjtat dokumenta si ato të Mateut. Ishte shoqëruar besnik i Palit dhe vizitoi Jerusalemin me raste të ndryshme ku ka mundësi se mori në intervistë ata që kishin përjetuar ngjarjet lidhur me lindjen e Jezusit. Kontributa e tij e veçantë ishte përshkrimi i gjatë i udhëtimit të fundit të Jezusit deri në Jerusalemi. Megjithatë nuk ishte vetë apostull, shoqëria e tij e vazhdueshme me Palin si dhe posedimi i dhuntisë së profecisë do ta aftësonte për shkrimin e ungjillit. Disa kanë mendimin se ai mund të identifikohet me njërin nga të dy njerëzit, të cilëve iu paraqit Jezusi në rrugën për në Emaus.

Në ungjillin e tij theksohen rrethanat e lindjes së Jezusit. Kështu bën

për të kundërshtuar trillimet e shpikura nga çifutët, për të theksuar vazhdimësinë me DhV, dhe për të kundërshtuar gnosticizmin.

Prologu i ungjillit të tij mund të interpretohen në dy mënyra të mundshme: ose Luka shkroi për hir të të krishterëve për t'i forcuar në fe duke i treguar themelet historike e fesë së tyre, ose shkroi për hir të atyre që kishin dëgjuar thashetheme për krishterimin thjest për t'i pasur gjërat të qarta. Mundësia e dytë na duket më e saktë.

Ungjilli i tij është thelbësisht një apologji (një mbrojtje e krishterimit) drejtuar joçifutëve. Qëllimi i tij ishte për t'i dhënë Teofilit dhe simpatizuesve të tjerë të vërtetën për lëvizjen e shpifur. A u dënuan të krishterët si kriminelë, dishepujt e një kriminelit që romakët e ekzekutuan? Luka tregon se Jezusin së bashku me dishepujt e tij i përligjën gjykatësit romakë. A është krishterimi i përbuzur si besëtytnie e çuditshme dhe e huaj? Luka provon se krishterimi është plotësimi i vërtetë i pritjeve fetare të Dhiatës së Vjetër që meriton tolerancën, të cilën edhe Roma ua tregonte çifutëve. Ndryshe nga feja nacionaliste e çifutëve, krishterimi është një fe ndërkombëtare, në gjendje të plotësojë nevojat shpirtërore të perandorisë romake. A u denoncuan të krishterët si revolucionarë që përmbytin botën? Luka tregon se si Jezusi i ktheu shpinën revolucionit politik, që të zbatojë një revolucion më të thellë në drejtim të ideve dhe vlerave. E, tek të krishterët ekziston dyshimi për sjelljen antishoqërore? Luka tregon se si themeluesi i lëvizjes së tyre ishte një figurë plot nder, hir dhe tërheqës, në gjendje të riprodhojë të njëjtat cilësi në jetën e dishepujve të tij si edhe t'i ngrejë në një jetë të denjë edhe të përjashtuarit e shoqërisë.

Kryetemat e ungjillit janë si vijon:

- 1) Univerzalizmi – ungjilli i drejtohet të gjithëve.
- 2) Historikësia – Luka e lidh jetën e Jezusit me profecitë e DhV dhe me Kishën e hershme. Gjithçka përshkruhet në kuadrin e historisë.
- 3) Jezusi është Zot – Ati vepron nëpërmjet Jezusit, Birit.
- 4) Rola e Shpirtit të shenjtë – sikurse Jezusi varej nga Ai në shërbimit të tij, ashtu edhe Kisha e hershme.
- 5) Ungjilli predikohet ndër të varfrit dhe të shtypurit.
- 6) Bukuria dhe dhembshuria e Jezusit, veçanërisht për njerëzit e flakur nga shoqëria, për samarianët, gratë dhe paganët.
- 7) Paralajmërimet drejtuar të pasurve dhe të fuqishmëve.
- 8) Rëndësia e lutjes drejtuar Zotit.
- 9) Ungjilli fillon dhe mbaron në Tempull, dhe përmbushet me gëzim, sepse Zoti ka mbajtur fjalën dhe u ka hapur ungjillin paganëve.

Data dhe autorësi: Në librin e Veprave të apostujve (që vjen kronologikisht pas ungjillit të Lukës) s'përmendet asnjë ngjarje pas 62 pas Kr., por ka mundësi që kjo nuk pajtohet me qëllimin e tij apologjetik. Luka do ta ketë shkruar ungjillin e tij gjatë qëndrimit të tij në Cezare në vitet 57-59 kur Pali ishte i burgosur atje. Është kuptimplotë se Luka nuk përmend as zjarrin e madhe të Romës e as ngjarjet lidhur me kryengritjen çifute (66-70) dhe shkatërrimin e Jerusalemit (70). Përse i përket lëndës që ndajnë Marku dhe Luka, ajo mund të jetë nxjerrë nga një burim i përbashkët. Shumica e ekspertëve janë i mendimit se Marku shkroi i pari ungjillin e tij, por kjo kundërshton pohimet e etërve të lashtë të kishës se ungjillin e parë e shkroi Mateu.

Problemi i regjistrimit në Lk 2,2. Teksti hebraik ka armë (toka e Izraelit). Mostshtë më e pamundur të përfshihet e gjithë perandoria Romake, por ka shumë më shumë të ngjarë që të bëhet regjistrimi i krahinës së re me qëllim taksimin në të ardhmen.

Në tekst ndoshta duhet të lexojmë Saturninus në vend të Quirinius. Ky ishte emri që Tertulliani kishte në dorëshkrimin e tij të këtij Ungjilli. Regjistrimi ndoshta ishte i kufizuar në tokën e Izraelit (teksti hebraik thotë në të vërtetë këtë). Ky regjistrim u zhvillua në 8/7 para Krishtit.

Veprat e apostujve është pjesa e dytë e historisë së Lukës. Në këtë vepër Luka na tregon se si kisha doli si fenomen botëror kryesisht joçifut nga prejardhjet e saj të një sektit çifut në Jerusalem, dhe se si Shpirti i shenjtë ishte autor i këtij fenomeni të shpëtimit univerzal të bazuar vetëm në hir. Kjo është kisha siç e synoi Perëndia: ungjilltare, e gëzuar dhe e fuqizuar nga Shpirti i shenjtë. Veprat e apostujve është apologjia dhe mbrojtja e misionit joçifute drejtuar nga Pali. Veprat është, gjithashtu, apologjia e ungjillit drejtuar qevërisë romake, e cila u jep përgjigjet pyetjeve që u paraqitën me rastin e procesit të Palit në Romë. Çfarë është krishterimi? Nëse është sekt çifut, pse kaq shumë çifutë janë kundër tij, kurse kaq shumë joçifutë anëtarë të sektit? Nëse krishterimi është çështje fetare e jo politike, pse Jezusi quhet «Mbret», kurse lëvizja e tij «mbretëri»? – pse shkakton trazira dhe çrregullim?

Bashkëkohësi i Lukës, Josef Flaviu, shkroi një apologji (mbrojtje) për hebrejtë, e cila u nda në dy libra, e dyta prej të cilave fillon kështu: «Në vëllimin e parë të kësaj vepre, Epafroditin tim më të vlerësuar, unë demonstrova antikitetin e racës sonë ... sfida gjithashtu thëniet e

Manetho, Chaeremon dhe disa të tjerë. Tani do të vazhdoj të hedhë poshtë pjesën tjetër të autorëve që na kanë sulmuar "(Jos, Ap. 2,1). Kjo është edhe një provë që Luka-Veprat ishte një apologji që synonte një audiencë skeptike romake.

Ungjillin sipas Gjonit e shkroi Gjoni apostull, pasi u shpërngul në Efes më 66 e.s, megjithëse ekziston mundësi se projektin e parë ta ketë shkruar që në Palestinë. Është e qartë se qëllimi i autorit ishte të bindurit e të pafeve: do të provojë, me anë të tetë shenjave mesianike, se Jezusi është Mesia edhe se me anë të besimit në të dhe dorëzimit të vullnetit të tij, njeriu mund të shpëtojë. Ka shumë të ngjarë që ky ungjill iu drejtua çifutëve që banonin jashtë Palestinës. Mund të tregohet se ky ungjill ka rrënjët e tij në Palestinën çifute duke marrë parasysh lidhjet e tekstit dhe të stilit me tekstet nga Kumrani. Përveç kësaj edhe struktura e ungjillit i ngjan asaj të rendit të leximeve të bërë në sinagogat e Palestinës. Shumica e mendimeve kryesore në këtë ungjill gjenden edhe në Dhiatën e Vjetër (p.sh. Fjala, Jeta, Drita, Bariu, Shpirti, Buka, Hardhia, Dashuria, Dëshmia). Jezusi paraqitet jo vetëm si plotësim i Dhiatës së Vjetër në përgjithësi; por, pikërisht si vetë Fjala, Kryemendi ose Arkitekti i krijimit të Perëndisë, si edhe Drita ose burimi i gjithë shfaqjes për Perëndinë. Në ungjillin sipas Gjonit Jezusi tregohet më drejtpërdrejt se sa në ungjijtë e tjerë si Mesia, Biri i Perëndisë, Biri i njeriut, Profeti, UNË JAM.

Përveç kësaj Ungjilli ka një qëllim apologjetik. Te 1,19-28 Gjoni kundërshton idenë se Gjon Pagëzori të ketë qenë mesia: këtë ide e kishin, siç duket, disa nga dishepujt e tij që banonin në krahinën e Efesit (Veprat 19,1-7). Gjoni kundërshton edhe ide gnostike të ndryshme. Ai thotë se askush asnjëherë nuk e ka parë Perëndinë (1,18), kurse gnostikët pohonin se mund ta shohin me anë të një përvojë ekstatike (ndonjë vegim). Te Gjoni 2,11 Gjoni thotë se Jezusi kreu mrekullinë e tij të parë në Kanë të Galilesë, kurse gnostikët pohonin se Jezusi kishte kryer mrekulli të ndryshme në kohën e fëmijërisë. Te 19,34-35 Gjoni thekson se Jezusi vdiq më të vërtetë, kurse gnostikët pohonin se Jezusi nuk vdiq në kryq, por u largua për në Indi, ku në fund vdiq me vdekje natyrore. Gnostikë të tjerë pohonin se shpirti hynor ishte larguar prej Jezusit para vdekjes së tij, dhe se individi që vdiq në kryq ishte vetëm njeri i zakonshëm (shih edhe 1 e Gjonit 5,6: *Jezusi erdhi te ne me anë të ujit të pagëzimit të tij dhe me anë të gjakut të vdekjes së tij. Ai nuk erdhi vetëm me anë të ujit, por me anë të ujit dhe me anë të gjakut njëkohësisht. Shpirti i Perëndisë dëshmon për këtë, dhe Shpirti është e vërteta*). Gjoni thekson se Jezusi ishte Perëndi-Njeriu (falë trupëzimit. shih 1 e Gj 1,1-3: Ai që quhet «Fjala», ekzistonte

qysh para krijimit, e megjithatë e dëgjuam, e pamë me sytë tanë, e shikuam dhe *e prekëm me duart tona* – Fjalën jetëprurëse. Me fjalë të tjera, Jezusi nuk ishte iluzion optik, por Perëndi i trupëzuar) i cili vdiq dhe kështu kreu shlyerjen e mëkatëve të mbarë botës (1 e Gj 2,2:).

Prandaj, të kuptojmë se ungjijtë nuk janë një falsifikim nga shekulli i dytë, por janë të rrënjësor në vendbanimin hebraik, çifut të shekullit të parë ku flitej aramaisht. Autorët ose e njihnin Jezusin personalisht ose i bazuan ungjijtë në dëshmitë e atyre që e kishin njohur. Ata s'janë një mit, por një tregim i saktë historik.

JEZUSI – NJË FIGURË HISTORIKE

Disa kritikë të shekullit XIX arritën të thoshin se Jezusi ishte një figurë mitike pa ekzistencë historike. Sidoqoftë na duket e pabesueshme se si një lëvizje aq e rëndësishme siç është krishterimi të ketë filluar spontanisht pa themelues! Fakti që kalendari ynë bazohet në lindjen e menduar të Jezusit, sigurisht na paraqit një provë të rëndësishme për ekzistencën e një individi të madh. Në kundërvënje me atë që mendojnë disa, aluzionet për Jezusin dhe nxënësit e tij që nga shekulli II nuk mungojnë dhe madje nga shekulli I. Aluzioni më i rëndësishëm buron nga historiani çifut Jozef Flavi (37-100 të erës sonë), i cili shërbente në oborin romak. Në shkurt të vitit 1972 dy profesorë izraelitë zbuluan tekstin autentik të veprës së Jozef Flavit të shkruar në gjuhën arabe në shekullin X. Në këtë tekst gjendet për Jezusin aluzioni që vijon: «Në atë kohë ishte një i urtë me emrin Jezus. Gjithë sjellja e tij ishte pa të metë dhe ishte i njohur për virtytin e tij. Shumë nga çifutët dhe nga kombet e tjera u bënë dishepujt e tij. Pilati e dënoi me vdekje me kryqëzim. Por ata që kishin qenë dishepujt e tij nuk lanë mësimin e tij. Ata treguan se si Ai iu ishte paraqitur i gjallë pas vdekjes së tij. Ndoshta ai ishte Mesia, veprat e mrekullueshme e të cilit kishin parafolur profetët.»

Një shkrimtar i shekullit II, me emrin Juli Afrikan, duke folur për errësirën që ra në tokë në kohën e kryqëzimit të Jezusit, citon nga veprat e historianit samarian Tall, i cili shkruante në Romë rreth vitit 52. Në librin e tretë të *Historisë*, ngulmon se errësirën e asaj kohe e shkaktoi eklipsi i diellit. Afrikani shton se nuk e pranon shpjegimin e Tallit.

Aluzionet e tjera jobiblike për Krishtin gjenden në shkrimet e historianit romak Tacit (55-120), Suetonit (65-125) dhe Plinit të Ri (62-114). Taciti në *Analet* (XV. 44) shkruan: «Në kohën e sundimit të Tiberit, Ponc Pilati e dënoi Krishtin me vdekje», dhe shton: «Kjo e ndaloi këtë

besëtytni për pak kohë, por ai shpërtheu rishtas». Rreth v. 120 Suetoni, në *Jetën e Klaudit*, shkruan se perandori Klaud «dëboi çifutët nga Roma, të cilët të nxitur nga Kresti, sillnin trazira» (shih Veprat e apostujve 18, 2). Këto trazira sigurisht i shkaktuan çifutët në Romë (ata ishin rreth 10.000 veta), kur predikohej mes tyre se Jezusi është Mesia (Krishti). Suetoni, gjithashtu, shkroi (në veprën e tij *Jeta e Neronit*) se të krishterët ishin «një grumbull njerëzish të dhënë pas një besëtytnie të kotë të re dhe të dëmshme». Në letrën e tij drejtuar perandorit Trajan (rreth vitit 110), Plini i Ri tregon se të krishterët «e kishin zakon të mblidheshin në një ditë të caktuar para lindjes së diellit për të recituar një himn antifonik kushtuar Krishtit që e mbanin për perëndi.» (*Letrat* 10;96). Suetoni edhe në një fragment tjetër të *Jetës së Klaudit*, përmend se si Klaudi kishte qortuar çifutët nga Aleksandria, sepse u kishin shkaktuar trazira grekëve. Gjithashtu, sipas mendjes së tij ishte të qortueshme se «disa çifutë të tjerë kishin arritur me anije në Afrikën Veriore, duke u nisur nga Siria, edhe se kishin përhapur atje mes bashkësive çifute dhe greke një murtajë universale.» Kjo gjë përkrah pohimin e përhapjes së krishterimit deri në ato krahina, dhe tregon se perandori Klaud ishte i njoftuar për krishterimin që nga viti i parë i sundimit së tij, që filloi rreth disa vjet pas vdekjes së Jezusit. Një dorëshkrim sirian në muzeun britanik mban tekstin e letrës së shkruar pas vitit 73 të erës sonë, nga një njeri që quhej Mara Bar Serapion që i përmend vdekjet e tre njerëzve, të cilët ngjarjet e mëvonshme i rehabilituan. «Çfarë fryte fituan athinasit me vrasjen e Sokratit? Ndër ta ra zi buke dhe taksirate si dënim për krimin e tyre. Çfarë përparësie fituan njerëzit e Samit që dogjën Pitagorën? Toka e tyre menjëherë u mbulua me rëre. Ç' të mirë patën çifutët pasi ekzekutuan mbretin e tyre të urtë? Pas pak mbretëria e tyre u shua. Perëndia me të drejtë u hakmor për këta tre njerëz të urtë: athinasit vdiqën nga uria; samasit u përmytën nga deti; çifutët, të rrënuar dhe të dëbuar nga toka e tyre, jetojnë të shpërndarë gjithkund... mbreti i urtë është ende i gjallë nëpërmjet mësimit që trashëgoi.» Autori i këtij fragmenti sigurisht nuk ishte i krishterë, përndryshe do të kishte thënë se Krishti jetoi tej duke u ngjallur nga të vdekurit. Prandaj, kjo është një dëshmi e rëndësishme për një fakt të njohur në atë kohë.

Sidoqoftë, tregimi më i plotë për jetën dhe mësimin e Jezusit gjendet në Dhiatën e Re. Një fragment i këtij libri që daton ndërmjet viteve 40-50 u zbulua në Kumran (Ungjilli sipas Markut 6,52-53). Edhe një fragment tjetër daton që nga viti 125 (Ungjilli sipas Gjonit 18,31-33.37). Dorëshkrimet e plota të ungjijve datohen në shekujt IV, V dhe VI. Përveç kësaj, ka afër 5.000 dorëshkrime të Dhiatës së Re që u ruajtën plotësisht

ose pjesërisht. Një krahasim me dorëshkrime të tjera të lashtësisë është kuptimplotë: libri *De Bello Gallico* nga Jul Cezari shkruar rreth vitit 50 para erës sonë, por dorëshkrimi më i vjetër i tekstit datohet vetëm në shekullin VIII të erës sonë; dorëshkrimet më të vjetra të *Analeve* nga Taciti datohen në shek. IX dhe XI të erës sonë; libri *Historia* nga Tucididi, i shkruar në shek. V para erës sonë, ka dorëshkrime që datohen vetëm në shek. IX të erës sonë! Kjo do të thotë se Dhiata e Re është vepra më e mirë e vërtetuar nga dokumentet mesdhetare të antikitetit. Dhiata e Re mban tregimin e shkruar nga dëshmitarë për jetën, vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit që thoshte për vete se është Mesia.

Kjo e vërtetë historike bazohet në:

- a) Plotësimi i profecive të Dhiatës së Vjetër,
- b) Dëshmia për mrekullitë e Jezusit si edhe për dëgjimin e zërit të drejtpërdrejtë të Perëndisë,
- c) Dëshmia për ringjalljen, të cilën jo vetëm që e parashikoi vetë Jezusi, por edhe u vë vulën të dhënave të tjera të tij.

Kuptohet vetvetiu se kërkesa të tilla nuk mund t'u shmangen lehtësisht duke pretenduar se «Krishti ishte vetëm një figurë mitike.» Duhet pranuar një nga tri mundësitë: Jezusi ishte ose i çmendur, ose mashtrues ose i vërtetë. Çifutët arritën në konkluzionin e dytë. Në një çështje me kaq rëndësi, kuptohet vetvetiu se nuk mjafton që të lejosh që të vendosin të tjerët në vendin tënd. Ti duhet të vendosësh për vete se kush ishte Jezusi.

MISIONI I JEZUSIT

Hollësitë për lindjen e Jezusit regjistrohen vetëm në Ungjillin sipas Mateut dhe në Ungjillin sipas Lukës. Është e qartë se secili ungjill përdor burime të ndryshme. Burimi i Mateut thekson më shumë anën e Jozefit, kurse burimi i Lukës flet imtësisht për përvojën e Marisë. Është e qartë se të dy burimet janë të pavarura, por pajtohen në faktin e prejardhjes së mbinatyrshme të lindjes së Jezusit.

Ka kontraste të rëndësishme ndërmjet kushteve të lindjes dhe rinisë së Jezusit dhe mënyrës së mbinatyrshme të fillimit të mbarsjes së nënës së tij. Jezusi lindi atje ku mbaheshin lopët dhe kuajt (ndoshta në një shpellë), sepse nuk kishte vend në bujtinën e mbushur plot me njerëz. U rrit në një shtëpi të thjeshtë në Nazaret (Necaret), një fshat të panjohur të Galileesë. Ati i tij, sipas Ligjit e jo sipas natyrës, Jozefi, ishte zdrukthëtar dhe murator i fshatit. Ai ishte ndoshta edhe punëdhënës. Ishte pa dyshim një figurë e nderuar në fshat. Siç duket, Jozefi vdiq kur Jezusi ishte ende

i ri, duke e lënë Jezusin si birin më të vjetër për të drejtuar punët e familjes dhe për t'i siguruar katër vëllezërit më të rinj dhe një numër të panjohur motrash. Siç duket, Jezusi e mori një arsim të zakonshëm çifut në shkollën e sinagogës së vendit. Por, në rininë e hershme doli se kishte një kuptim të mbinatyrshëm për gjërat e Perëndisë. Ai e dinte që kishte një marrëdhënie të veçantë me Perëndinë, «Atin e tij».

Rasti i daljes së Jezusit në jetën publike diku rreth vitit 28 të erës sonë, ishte misioni i Gjon Pagëzorit, një farefis jude i Jezusit, i cili ishte rritur si asket në shkretëtirën e Judesë. Gjoni i thirri njerëzit të ktheheshin te Perëndia nga mëkatet e tyre, sepse Perëndia kishte ndër mend t'i dënonte. Kjo ngjarje tërhoqi turma të mëdha tek ai, të cilat donin të pagëzoheshin si shenjë e kthimit nga mëkatet e tyre. Kur Jezusi u paraqit për pagëzim, Gjoni e njohu me anë të një shfaqjeje të mbinatyrshme të dëshmuar nga shumë njerëz se Jezusi është Mesia i premtuar. Siç duket, Jezusi u pagëzua që t'u lidhej me popullin, për të cilin do të vritej si Shërbëtori i Zotit, d.m.th. si zëvendësi i tyre hyjnor. Jezusi gjeti nxënësit e tij të parë midis dishepujve të Gjonit, me nxitimin e tij. Pas pagëzimit të Jezusit erdhi një takim vendimtar me Satanin në shkretëtirë, ku doli fitimtar.

Pas kësaj, filloi shërbimi publik i Jezusit, siç duket, në fillim në Luginën e Jordanit me theksin në pagëzim paralelisht me atë të Gjonit. Pas pak, popullariteti i Jezusit që po shtohet, tërhoqi vëmendjen e autoriteteve çifute. Përveç kësaj, Herod Antipa arrestoi Gjonin për shkak të kritikës që i bëri për martesën e tij dhe nën dyshimin e ngritjes së trazirës politike. Në këto kushte Jezusi u tërhoq në Galile, në krahinën e vet, dhe mënyra e shërbimit të tij u ndryshua në një mision shetitës dhe shërimi. Nuk dëgjojmë më se Jezusi vazhdonte të pagëzonte.

Në periudhën e parë të shërbimit të tij, njerëzit e ftuan të predikonte në sinagogat e tyre si predikues vizitor. Por, pas pak e larguan nga kjo veprimtari për shkak të predikimit të tij radikal, dhe Jezusi u gjet duke mësuar turmat përjashta. Pjesën më të madhe të kohës së tij të mësimit ua kushtonte dishepujve më të imët.

Në këtë çast kritik, meqë Herodi kishte ndër mend ta arrestonte, Jezusi u tërhoq nga Galileja, së bashku me nxënësit e tij, dhe u nis për të vetmet udhëtime të tij jashtë teritorit çifut. Jezusi shfrytëzoi rastin për t'u dhënë nxënësve të tij mësimin më të thellë, dhe për të nxjerrë nga nxënësit e tij pranimin e identitetit të tij mesianik. Ai i paralajmëroi për vdekjen pajtuese të tij që po i vinte në Jerusalem. Vendet që vizitoi Jezusi ishin Tiri dhe Sidoni (ku e shëroi bijën e gruas kenanase nga pikëllimi demoniak), Dekapoli (konfederata e dhjetë qyteteve pagane

jashtë Galilesë) dhe Cezareja e Filipit në veri të fundit në rrëzë të vargmalit Hermon. Ky qytet ishte ndërtuar përballë një faqeje shkëmbi, për të cilën Jezusi bëri aluzion pas pranimit të Pjetrit se Jezusi është Mesia. Pjetri ishte nxënësi i parë që e pranoi këtë kërkesë. Në ungjillin sipas Gjonit tregohet se Jezusi shkoi disa herë për vizitë në Jerusalem në lidhje me festat fetare. Gjoni na tregon se si njëherë Jezusi kalonte nëpër Samari dhe foli me një grua pranë pusit të Jakobit në Sukar. Me rastet e tjera kaloi përreth Samarisë duke udhëtuar pranë kufirit nëpër Pere në anën tjetër të lumit Jordan.

Jezusi, si edhe mësues të tjerë çifutë, mblodhi një grup dishepujsh. Turmat vinin e dëgjonin Jezusin me qejf dhe pastaj largoheshin; nuk ishin gati t'i zotoheshin. Vetëm dishepujt ishin pak a shumë gati të lidhnin fatin me të dhe e shoqëronin në udhëtimet e tij. Ndër këta dishepuj Jezusi zgjodhi rrethin e brendshëm (i quanin «apostuj») dhe brenda këtyre dymbëdhjetëve edhe një grup të vëçantë që përbëhej nga Pjetri, Jakobi dhe Gjoni. Gjonin e quanin «nxënës i dashur»: mund të jetë sepse ishte kushëriri i parë i Jezusit dhe kështu shok fëmijërie. Ky grup e shoqëroi Jezusin në disa raste të veçanta. Për t'u bërë dishepull, duhej t'i besohej ekskluzivisht dhe pa rezervë Jezusit që të bëhet gati për të pësuar përndjekjen dhe përjashtimin social për hir të tij. Shumica e dishepujve të tij ishte galileas. Mes grupit të brendshëm të Dymbëdhjetëve, ka shumë të ngjarë, që të gjithë përveç Judës Iskariot (njeriu nga Karioti) ishin nga Galileja. Por, në anën e karakterit dhe sfondit, ndryshonin mes tyre nga Toma pesimist gjer te Pjetri nxitës, edhe nga Mateu tagrambledhës dhe kolaboracionist që kishte bashkëpunuar me pushtuesin romak, gjer te Simoni ish-terroristi, luftëtari çlirimtar.

Autoritetet çifute ishin kundër që Jezusi e kishte zakon të shoqërohej me njerëz të dyshimtë, veçanërisht me tagrambledhësit dhe «mëkataret» (përrjashtuesit e shoqërisë së sjellshme). Jezusi edhe hante me ta, e këtë armiqtë e tij e mbanin për gjë posaçërisht skandaloze. Edhe gratë e përdala i priste mirë dhe bisedonte me to, kurse të tjerët largoheshin nga ato. Edhe samarianët, armiqtë e betuar të çifutëve, e pritnin mirë Jezusin. Jezusi mbronte veprimet e tij si pjesë të domosdosshme të shërbimit të tij, i cili iu ishte drejtuar atyre që jetonin në mjerim shpirtëror, pavarësisht nga pozita e tyre në shoqëri.

Debatet ndërmjet Jezusit dhe kryetarëve fetarë çifutë mbajnë një pjesë të madhe në tregimet e Ungjijve. Jezusi nuk kishte studiuar në institute rabinike, por mënyra e mësimit të tij si edhe grupi i dishepujve të tij bëri që njerëzit ta mbanin për rabin (mësues fetar), dhe ashtu e përshëndetnin

nganjëherë. Sidoqoftë, shpesh ndodhej i zënë në një polemikë të ashpër me skribët (mësuesit e shkrimeve çifute) dhe me farisenjtë (çifutët shumë rigorozë). Çështja qëndrore ishte jo autoriteti i Dhiatës së Vjetër, por, interpretimi i atij libri. Sipas interpretimit të Jezusit, Dhiata e Vjetër plotësohet në vetveten, d.m.th. në Mesinë, kurse sipas interpretimit të farisenjve, libri plotësohet me Ligjin e pandryshueshëm, të cilit ata i kishin shtuar shumë rregulla të tyre. Me fjalë të tjera, sipas tyre mund të fitonin shpëtimin e tyre duke dëgjuar Ligjin, prandaj pothuajse nuk kishin nevojë as për Mesinë (Shpëtimtar), as për Shpirtin e shenjtë që Ai duhej t'u jepte! Ata vendosën ndryshimet në mendim duke u bërë thirrje mësuesve të mëparshëm. Ndryshe nga ata, Jezusi u kushtonte pak vëmendje rregullave tradicionale që nuk ndodheshin në Dhiatën e Vjetër dhe asnjë autoritet nuk citonte përveç vetes. Vargu i gjashtë antitezave të predikimit në mal shpjegon se si e trajtonte radikalisht Ligjin, duke shkuar jashtë rregullit fjalë për fjalë deri në mendim prapa veprimin dhe duke i vënë parimet para udhëzimeve. Ky qëndrim radikal ndaj çështjeve fetare shkaktonte që Jezusi ishte një rrezik për institucionin e skribëve. Sipas tyre, popullariteti i mendimeve të tij, kërkonte zhdukjen e tij. Jezusi doli si Profeti dhe Moisiu i dytë që duhej të vinte për t'ia mësuar popullit ligjin e Perëndisë në dritën e ekonomisë së re të Shpirtit të shenjtë që duhej të jepte vetë Mesia. Por, kryetarët çifutë nuk e pranuan kërkesën e tij dhe më vonë e paguan çmimin për këtë qëndrim, kur romakët shkatërruan kombin e tyre duke e nxjerrë në mërgim.

Burimet e krishtera dhe të pakrishtera dëshmojnë se Jezusi ishte i njohur për bashkëkohësit e tij si çudibërës. Pjesa më e madhe e mrekullive janë raste të shërimit të mrekullueshëm, dhe kjo ishte karakteristike për shërbimin e tij. Përveç kësaj kishte shumë raste të dëbimit të djajve dhe tri rastet e kthimit përsëri në jetë të disa të vdekurve. Ndryshe nga të tjerët që i dëbonin djajtë, Jezusi nuk përdorte ritual, por vetëm u dha një urdhër. Ky aspekt i shërbimit të tij ishte vërtet një përgjigje nevojës dhe mjerimit njerëzor, por, edhe mbahej si një provë e identitetit mesianik të tij. Jezusi ishte Shërbëtori i Zotit i përshkruar në librin e profetit Isaia: ai ishte i përcaktuar të bënte, në shkallë universale, atë që e kreu në shërbimin e tij të parë – të shkatërronte sundimin e Satanit dhe të themelonte mbretërinë e Perëndisë.

JAVA E FUNDIT E SHËRBIMIT TË JEZUSIT

Vizita e fundit e Jezusit në Jerusalem u planifikua me qëllim duke ditur se kjo do të përfundonte me ballafaqim me autoritetet dhe me vdekjen e tij. Jezusi e vizitoi Jerusalemin në kohën e Pashkëve kur qyteti ishte mbushur plot me pelegrinë. Një të premte Jezusi arriti në fshatin Bet-Page, pranë Jerusalemit, ku rrinte me miqtë e tij. Të nesërmen ishte e shtunë dhe Jezusi shkoi në Bet-Anje, në rrëzë të kodrës së ullinjve, ku sigurisht shkoi në sinagogë. Pas kësaj, u ftua në shtëpinë e fariseut, Shimonit. Kur ishte në këtë shtëpi, erdhi një grua me emrin Mirjamë, e cila derdhi parfum shumë të shtrenjtë mbi këmbët e Jezusit, ndoshta me shpresë që së shpejti do të hipte në fronin mesianik në Jerusalem. Jezusi e kaloi mbrëmjen e së shtunës në Bet-Anje.

Të dielën, në mëngjes, Jezusi u ngrit në kodrën e ullinjve, nga e cila, sipas profecisë së Zëkarisë, Mesia duhej të zbriste për të hyrë në Jerusalem. Jezusi në të vërtetë bëri një hyrje mesianike në Jerusalem, duke plotësuar kështu një pjesë të profecisë. Kurse shumica e popullit e pritën me entuziazëm, farisenjtë reaguesh negativisht. Me këtë rast Jezusi parashikoi shkatërrimin e qytetit, sepse banorët e tij nuk ishin të bindur që Perëndia do ta vizitonte në personin e Mesisë. Ata refuzuan të pranonin që hyrja e Jezusit në Jerusalem ishte plotësim i profecisë së Danielit, duke mbaruar kështu periudhën e gjashtëdhjetë e nëntë prej shtatë vjetësh. Jezusi u tha se për këtë qëndrim do të duhej të priste derisa ai të kthehej në madhësi si Mesi që të plotësohej pjesa e dytë e profecisë. Nga mbrëmja Jezusi hyri në Tempull, pa rreth e rrotull dhe u nis për në Bet-Anje së bashku me nxënësit e tij.

Të hënën Jezusi u kthye dhe dëboi tregtarët nga Tempulli. Në të njëjtën ditë ndodhi ngjarja e mallkimit të fikut.

Të martën nxënësit u kthyen në Jerusalem dhe morën vesh se ishte tharë fiku. Pas kësaj, Jezusi u mor me polemikë me kryetarët çifutë. Ndodhi ngjarja e dhuratës së vejushës. Një delegacion grek erdhi te Jezusi dhe ai mbajti një fjalim për të ardhmen e botës. Juda, tradhtari, bëri kontakte me kryepriiftërinjtë dhe propozoi t'ua dorëzonte Jezusin.

Të enjten Jezusi festoi Pashkët së bashku me nxënësit e vet, megjithëse qengji kurban nuk ishte në listën e gjellëve. Qengjat ende nuk ishin therur. Therja duhej të ndodhte të premten pikërisht me rastin e kryqëzimit të Jezusit. Kjo darkë u festua në kushte të veçanta, 24 orë para Pashkëve zyrtare. Nxënësit duhej të takoheshin fshehurazi në dhomën e sipërme (që i takonte farefisit), sepse e kërkonte policia. Gjatë kësaj darke Jezusi

u shqyrtoi nxënësve se ai duhej të ishte qengji kurban i Pashkëve. Kështu ai i dha darkës një kuptim të ri duke iu referuar vetvetes. Në fillim darka e Pashkëve përkujtonte ngjarjet e Daljes, çlirimin e kombit nga robëria në Egjipt dhe formimin e tij si komb i Perëndisë. Qengji i Pashkëve i kujtonte izraelitët për fatkeqësinë e fundit kur Perëndia vrau të gjithë bijtë e parëlindur nëpër tërë Egjiptin, por i ruante ato shtëpi, në të cilat u ther një qengj, me gjakun e të cilit u lyen shtalkat e derës së shtëpisë. Çifutët hanin bukën e veçantë për të përkujtuar bukën e pjekur pa brumë kur po përgatiteshin të niseshin me nxitim nga Egjipti. Jezusi, gjatë kësaj darke, u tregoi nxënësve të vet se ai është qengji i Pashkëve që duhej të bëhej fli për të çliruar popullin e vet nga një robëri shumë më e madhe dhe nga një dënim më i madh; dënimi i Perëndisë dhe robëria e mëkatit. Nxënësit pinë verën që zakonisht jepej në darkën e Pashkëve për t'u kujtuar që ata do të mbrohen nga dënimi me anë të gjakut të derdhur për ta në kryq. Hëngrën bukën për t'u kujtuar se janë vetë përfituesit e flise që do të bëhej për hirin e tyre, sepse besuan në Jezusin. Që atëherë, ata që do të hanin të njëjtën darkë të Pashkëve do të kujtonin për çmimin, me të cilin Jezusi i çliroi ata nga dënimi dhe mëkati. Pas një darke të tillë çifutët seriozë e kishin zakon të mbeteshin pranë tryezës për të diskutuar për kuptimin e Pashkëve. Jezusi e shfrytëzoi këtë rast duke mbajtur një fjalim të gjatë për gjërat e ardhshme. Pas kësaj, dishepujt e kënduan Hallelin (Psalmet 113-118) dhe shkuan jashtë mureve të Jerusalemit, nëpër luginën e Kidronit, te kopshti i rrethuar me mur që quhej Gatshemen (Getsemane), ku Jezusi takohej shpesh me dishepujt e vet, sepse ky kopsht i takonte familjes së Markut, njëri nga dishepujt. Atje Jezusi kaloi një kohë të gjatë duke u lutur, kurse dishepujt po flinin. Ndërkohë kryepriiftërinjtë organizuan një njësi prej 1000 njerëzish, për të arrestuar Jezusin. Kjo njësi përbëhej nga 600 njerëz dhe prihej nga komandanti romak në Jerusalem së bashku me një njësi të policisë çifute të Tempullit. Priiftërinjtë dhe këshilltarët erdhën, gjithashtu, si dëshmitarë. Njësia u nis me në krye Judë, tradhtarin, i cili i ndihmoi autoritetet që të gjejnë vendin ku ndodhej Jezusi dhe dishepujt e tij në rrëpirat e kodrës së ullinjve. Jezusi refuzoi t'i shpëtonte arrestimit sepse e dinte që Perëndia po ia arrinte qëllimit të tij në ngjarjet që do të ndodhnin. Pas një përleshjeje të shkurtër kur Pjetri ia preu veshin e djathtë shërbëtorit të kryepriiftit, dishepujt ikën, duke lënë Jezusin në dorën e robëruesve të tij. Nga kjo kohë, ishte mjaft vonë, të enjten në mbrëmje.

Sipas rregullave të Ligjit, mësuesit e rremë kishin të drejtë të ketë dy marrje në pyetje paraprake para se të dëgjohej procesi i tij në Këshillin e lartë, por atë natë s'kishte shumë kohë. Jezusin e shpunë në pallatin e

kryepriiftit me emrin Hanan ku e mori në pyetje paraprake, për dishepujt dhe mësimin e tij. Jezusin e çuan pastaj në Këshillin e Lartë që përbëhej nga 71 anëtarë me në krye nipin e Hananit, njeri me emrin Jozef por me mbiemër Kajfa (Hetuesi). Ata dërguan të thërrasin dëshmitarët, por dëshmia e tyre kundërshtohej. Kështu procedura gjyqësore u ndërpre. Sipas Ligjit, Jezusi duhej atëherë të shfajësohej dhe të dënoheshin dëshmitarët e rremë. Por, me këtë rast, Kajfa doli në qendër të gjyqit dhe u përpoq të frikësonte të pandehurin, por Jezusi refuzoi t'i përgjigjej. Pastaj Kajfa hodhi asin duke e detyruar Jezusin që të betohej solemnisht të thoshte nëse ishte ai Mesia hyjnor, apo jo. Jezusi deklaroi se ishte. Pastaj, Kajfa tha se nuk ka nevojë për dëshmi tjetër dhe çështja u zgjidh me votim. Meqë Jezusi nuk e mori fjalën mbrojtja, nuk kishte të drejtën e apëlimit. Pas mbarimit të kësaj mbledhjeje, Jezusin e shpunë në oborrin e brendshëm të pallatit të kryepriiftit ku e ruanin deri në agim kur duhej të jepej vendimi gjyqësor për të në një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit të lartë në Tempull. Kur roja po ruante Jezusin, Pjetri mohoi tre herë se e njikte. Kur këndoi gjeli, duke paralajmëruar agimin, Jezusin e dërguan në Tempull për mbledhjen e fundit të Këshillit të lartë të bërë në të njëjtën sallë, nga e cila Jezusi më parë i kishte dëbuar tregtarët. Mbledhja ishte e shkurtër dhe solemne. U shpall dënimi me vdekje për Jezusin. Por, çifutët nuk kishin të drejtë ta zbatonin vendimin, sepse kombi i tyre ishte nën pushtimin romak. Prandaj Jezusin e morën në selinë e guvernatorit romak, në kështjellën Antonia pranë Tempullit. Mbarë Këshilli e çoi Jezusin në oborrin e brendshëm të kështjellës ku gjykonte Pilati. Pas një pyetjeje paraprake, Pilati e dërgoi Jezusin te Herodi, sepse Jezusi vinte nga Galileja. Por, meqë Jezusi refuzoi t'ia bëjë një çudi, Herodi e dërgoi prapa të veshur me një rrobë të bardhë mesianike. Pilati e mori përsëri në pyetje dhe doli së bashku me Jezusin në pjesën e sipërme të shkallëve të kështjellës Antonia me turmën e madhe në rrëzë. Përpiqej të tërhiqej nga dilema duke i propozuar turmës çlirimin e Jezusit. Turma, e nxitur nga priiftërinjtë, nuk pranoi dhe propozoi që të çlirohej terroristi çifut i njohur me emrin Bar-Abba. Pilati propozoi që pasi të fshikullohej Jezusi të lirohej, por, turma thirri për vdekjen e tij. Pilati u bind më në fund, dhe pas fshikullimit të Jezusit, e dorëzoi për kryqëzim, një vdekje të veçantë të rezervuar për skllëvër, rebelë dhe profetë të rremë. Siç duket, mbarimi i Jezusit erdhi, por në fakt ishte vetëm fillimi!

VDEKJA E JEZUSIT

Sipas tregimit të ungjijve, Jezusin e fshikulluan para se ta shpinin jashtë për kryqëzim. Viktima mori shumë të rrahura me fshikull (latinisht: *flagellum*) – një kamxhik i shkurtër me rripa të pajisur me sfera shumë të vogla dhe me pyka që mund t'i rjepin lëkurën njeriut.

Sipas tregimit në ungjijtë dihet se ushtarët romakë e përqeshnin Jezusin dhe e goditën në oborrin e kështjellës Antonia, dyshemeja e së cilës u gërmua dhe sot mund të shihet në Jerusalem. Pastaj e shpunë Jezusin jashtë qytetit për ta kryqëzuar. Gjoni në ungjillin e tij na tregon se ishte ora gjashtë e mëngjesit. Jezusi duhej të mbante traversën e kryqit, por edhe kjo doli se ishte tepër e rëndë për të, e kjo tregon se ishte shumë i dobësuar nga goditjet dhe fshikullimi që i kishte marrë. Ndërsa e shpinin jashtë për ta kryqëzuar, rekuizuan njëfarë njeriu me emrin Shimon nga Cireneja për të mbajtur traversën e kryqit. Ka shumë të ngjarë që një lajmëtar shkonte në krye të procesionit duke mbajtur dokumentin paditës që ta shihnin të gjithë.

Jezusin e kryqëzuan kur arritën në kodrën e Kafkës. Kjo do të thotë se ia zhveshën rrobat dhe e veshën me një leckë rreth ijës, e vunë në tokë me traversën e kryqit nën supet dhe me krahët të gozhduar nëpër kyçet e duarve në të. Pastaj traversën e ngritën dhe e lidhën me shtalkën e kryqit ende të ngritur, kështu që këmbët e viktimës, të gozhduara në shtalka ishin afër tokës. Arkeologët izraelitë para pak kohësh zbuluan skeletin e një njeriu të kryqëzuar në Jerusalem. Zbuluan se një gozhdë ishte ngulur nëpër dy kyçet e dorës, dhe se edhe një gozhdë (16 cm.) ishte ngulur nëpër dy këmbët së bashku. Pastaj tabelën e fajësimit e gozhduan në majën e kryqit.

Vdekja me anë të kryqëzimit zakonisht ishte një proces shumë i gjatë, dhe vdekja erdhi vonë, pas 36 orësh ose pas 9 ditësh: prandaj centurioni së bashku me katër ushtarë duhej të qëndronte në rojë për të penguar shpëtimin. Në mëngjes, në kohën kur Jezusi po varej në kryq, foli tri herë; njëherë iu lut Perëndisë t'i falë ushtarët romakë, sepse nuk dinin se ç'bënin; pastaj i tha njërit nga terroristët e kryqëzuar pranë tij se ai, jo në fund të botës, do të ishte me Jezusin në parajsë, por atë ditë, para perëndimit të diellit. Së treti siguroi nënën e vet, duke ia dorëzuar Gjonit që të kujdesej për të. Pas kësaj, sipas tregimit të ungjijve, gjatë tri orëve, nga mesdita deri në orën tre pasdite, kudo ra një errësirë misterioze, dhe në fund Jezusi tha: *Perëndia im, Perëndia im, përse hoqe dorë prej meje?* Pastaj tha: *Gjithçka u krye* dhe menjëherë vdiq, siç duket, me vullnetin e tij të lirë.

Por, cilat ishin shkaqet fizike të vdekjes? Me krahët e gozhduara në kryq në a përmbi nivelin e kokës, viktimi do të përkulej, e varur nga kyçet e gozhduara. Kjo do të shkaktonte spazma kraharori, të cilat do të bënin të pamundur të merrte frymë. Atëherë viktimi do të duhej të ngrihej në këmbë të kryqëzuara për të lëshuar afsh dhe për të marrë frymë si zakonisht derisa të përkulej përsëri. Më në fund, koha do të vinte kur s'ishte më në gjendje të ngrihej në këmbë, dhe do të vdiste. Për këtë, për të shpejtuar vdekjen, ushtarët romakë shpesh do t'ua thyenin këmbët të kryqëzuarve. Me këmbë të thyera, viktimi nuk mund të ngrihej më në këmbë për të marrë frymë dhe do të vdiste shpejt.

Por në rastin e Jezusit, s'kishte këmbë të thyera, në përputhje me tregimin në ungjillin sipas Gjonit, sepse ushtari romak shpori zemrën e Jezusit dhe doli gjaku së bashku me lëng të kthjellët. Një patolog zbuloi se një heshtë që shponte trupin midis brinjës së pestë dhe të gjashtë, do të depërtonte veshin e djathtë të zemrës dhe do të dilte pak gjak dhe pak lëng perikardor, një lëndë e kthjellët si ujë. Përveç kësaj, pas vdekjes plazma ndahet nga gjaku. Është kuptimplotë se në tregimin e ungjijve lexojmë që pikërisht kjo hollësi e bindi centurionin që Jezusi ishte me të vërtetë i vdekur para se t'i raportonte Pilatit. Vetëm atëherë trupi iu dorëzua Jozefit nga Ramataimi (ose Arimateja), i cili, siç thuhet, e mori, e mbështolli në savan dhe e vendosi në një varr të hapur afër në shkëmb, të cilin e kishte përgatitur për varrosjen e vet. Varri mund të shihet edhe sot.

RINGJALLJA E JEZUSIT

Jezusi ishte një njeri i çuditshëm dhe i mrekullueshëm. Për tre vjet, në tërë Palestinën po flitej për të. Të gjithë u pajtuan se ishte një figurë magnetike me fuqi të çuditshme për të shëruar. Të gjithë e dinin se me orë të tëra mund të magjepste turma të tëra kur i mësonte. Me anë të mirësisë dhe të fuqisë së tij ai kishte tërhequr shumë dishepuj nga të gjitha pozitat shoqërore. Megjithatë, për çdo njeri ai ishte enigmatik. A ishte ai Mesia, Biri i Perëndisë, apo jo?

Jezusi u varros të premtën në mbrëmje, në varrin e një pasaniku me emrin Jozef, nga Ramataimi, i cili e zbriti nga kryqi pasi roja romake kishte dëshmuar se Jezusi kishte vdekur. Zakonisht trupat e të kryqëzuarve kishin mbetur pa u varrosur. Për këtë varrimi i Jezusit tregon se Jezusi kishte përkrahjen nga rrethet me ndikim. Sidoqoftë, të dielën në mëngjes, në të gjithë ungjijtë, pohohet se varri ishte i zbrazët. Më tej flitet për njëmbëdhjetë takimet e veçanta me Jezusin e ngjallur gjatë

periudhës menjëherë pas atij mëngjesi të së dielës. Trajta shumë e ndryshme e atyre dukjeve si edhe grupet e ndryshme, për të cilat është fjala (nga individët deri në një grup prej 500 njerëzish) e bëjnë të pamundur t'i pranojmë si halucinacione. Fakti se tregimet e ndryshme për ringjalljen e Jezusit pajtohen vetëm me vështirësi (siç ndodh edhe me tregimet e varrit të zbrazët) jep të besojmë se s'ka të ngjarë që ka qenë marrëveshje e fshehur për të kryer një mashtrim të paramenduar.

Për këto arsye, të krishterët arritën në përfundimin se Jezusi u ngrit trupërisht nga varri. Trupi i tij ishte i liruar nga kufijtë e kohës dhe hapësirës: mund të kalonte nëpër dyer të mbyllura, të duket dhe të zhduket përsëri. Nga ana tjetër trupi i tij ishte, gjithashtu, krejtësisht fizik: mund të hante bukë, të ngatërrohej me rojen e natës (vreshtarin), në kopsht ose me bashkudhëtarin në rrugën për në Emaus.

Fakti i ringjalljes së Jezusit nga të vdekurit shihet më mirë duke marrë parasysh mungesat e mundësive alternative. Një mundësi është se Jezusi vetëm shtirej sikur po vdiste, e në fakt ra në një gjendje gjumi të thellë por më vonë erdhi përkohësisht në vete. Por, vdekja e tij tregohet nga të rrahurit mizor që e pësoi, nga gjashtë orë sa kaloi në kryq, nga depërtimi i barkut me anë të heshtës dhe derdhja e lëngut uxor (mundësisht e lëngut perikardor) dhe e gjakut, nga balsamimi i pjesshëm dhe mbështjellja në pelhurë varri, dhe më në fund nga vulosja e tij në varr. Kërkohet pothuajse kaq besim që të besohet që Jezusi nuk vdiq sa që të besohet që ai u ngjall nga të vdekurit.

Të tjerët mendojnë se dishepujt e vodhën trupin e Jezusit. Por, për ta kryer këtë, ata duhej të kishin mposhtur rojet romakë (s'ka shumë të ngjarë për këtë) ose t'i kishin blerë me para, gjë, gjithashtu, e pabesueshme, sepse ushtarët e dinin që do të dënoheshin me vdekje për dështim në detyrën e tyre. Fakti që pëlhurat ishin pa përzierje, pa prekje dhe se si çallma ishte ende mbëshjellë mënjanë tregon se trupi nuk u tërhoq me nxitim dhe me vjedhje. Hajdutët zakonisht nuk lënë gjithçka në rregull. Në këtë rast ata sigurisht do ta kishin larguar trupin së bashku me pëlhurat e veta. Habia dhe mosbesimi i dishepujve për ringjalljen e Jezusit tregon se ata nuk e vodhën trupin e vdekur, në qoftë se habia dhe mosbesimi i tyre nuk ishte i falsifikuar që t'i japin tregimit besë. Por, një falsifikim i tillë do të ishte i tepërt për të krishterët e parë të tillët, të cilët ishin njerëz të thjeshtë. Përveç kësaj, s'ka shumë të ngjarë se do të ishin falsifikuar tregimet, në të cilat apostujt shfaqeshin si mosbesimtarë në ringjalljen, sepse pas pak kisha filloi t'i nderonte ata.

Edhe të tjerët mendojnë se dishepujt bënë halucinacione. Por, në DhR

jepet dëshmi për shfaqjet e Jezusit në vende të ndryshme në kohë të ndryshme si edhe njerëzve të ndryshëm. Në letrën e parë drejtuar Korintasve, Pali thërret skeptikët që të pyetin dëshmitarët që janë ende të gjallë. Shfaqjet ishin të shumta dhe tepër të ndryshme për të qenë halucinacione! Përveç kësaj, dishepujt ishin psikologikisht të pa përgatitur për halucinacionet, sepse nuk pritnin se Jezusi do të ngjallej, dhe në fakt, nuk u besuan raporteve të para për kthimin e tij në jetë. Do të mjaftonte se çifutët mosbesimtarë do ta sjellin trupin e Jezusit, kur filluan të përhapeshin raportet për ringjalljen. Por kurrë nuk vepruan ashtu.

I njëjti kundërshtim vlen kundër propozimit që dishepujt erdhën në varrin e gabuar. Përse çifutët nuk e sollën trupin e vdekur nga varri i saktë? Sigurisht ata e dinin ku ishte varri i vërtetë, sepse iu lutën Pilatit që të vendosë rojen atje.

Edhe skeptikë të tjerë shpjegojnë se dishepujt modeluan tregimin për ringjalljen e Jezusit sipas mitologjisë pagane ku është fjala për vdekjen dhe ringjalljen e perëndive. Por, ndryshimet janë shumë më të mëdha se ngjashmëritë. Sfondi i miteve s'është aspak historik, jo ashtu si sfondi i tregimeve për ringjalljen në DhR. Në DhR s'ka lidhje me vdekjen vjetore dhe ringjalljen e natyrës ashtu si në mitet e pjellorisë pagane. Njerëzit e DhV pritnin me padurim ringjalljen trupore, por dënonin çdo mit të pjellorisë. Stili i thatë i ungjijve thekson kontrastin me fantazirat që ka me bollëk në mitet. Tregimet për ringjalljen duken menjëherë në kishën e parë, pa ndërprerjen e gjatë që do të kërkonte zhvillimi i mitologjisë së shtrembëruar. Deklarata e gëzuar e Palit se janë ende të gjallë shumica e njerëzve, të cilët e kishin parë njëkohësisht Jezusin e ringjallur, (prandaj mjaftonte t'i pyeste ata për hollësitë), ishte shumë guximtar në qoftë se i gjithë tregimi ishte një pasojë e zhvillimit mitologjik.

Mbetet edhe një hollësi bindëse – pozita, në të cilën u gjetën rrobat e të ringjallurit. Në çastin e të ngjallurit, trupi i Jezusit u shndërrua menjëherë, dhe ky trup, i energjizuar nga një fuqi e pakufizuar, u ngrit lart nëpër savan. Në atë çast me daljen e trupit, ajri në savan u nxor prej tij dhe savani, mbi të cilin ndodheshin 30 kilogramë mirrë e aloe të lidhur në trup me anë të rripave stofe, ra brenda duke lënë pëlhurat dhe çallmën (rizën) pikërisht në pozitën, në të cilën do të ishin në qoftë se trupi ishte ende brenda. Pikërisht kjo hollësi e bindi Gjonin se kishte ndodhur një ringjallje e vërtetë e jo se një njeri gjysmë i vdekur erdhi në vete dhe hoqi pëlhurat e tij së bashku me çallmën në pirlg. shih Gjoni 20,6-8

Përshkrimet e ringjalljes së Jezusit që ndodhen në ungjill sipas Mateut kap. 28 vërtetojnë këtë interpretim të fakteve. Në tokë ra një tërmet;

papritur ndriti një dritë nga brendia e pëlhurave në errësirën e atij mëngjesi të hershëm. Një tërmet i madh ra, dhe u largua guri i madh i vënë para varrit. Një shpërthim drite verbuese e mbushi varrin kurse ushtarët në roje ikën të tmerruar...

Diçka unike sigurisht kishte ndodhur që dishepujt çifutë e ndryshuan ditën e adhurimit të tij nga e shtuna në të dielën. Ose ata u mashtruan (atëherë do të mjaftonte që çifutët e paraqitën trupin e vdekur të Jezusit), ose e mashtruan botën. Në qoftë se është kështu, është psikologjikisht e pabesueshme se ata ishin gati të pësonin torturën edhe vdekjen për një mashtrim të njohur. Është, gjithashtu, e pabesueshme për antikitetin që falsifikuesit e një tregimi të tillë do të kishin bërë nga gratë e para dëshmitare të Mesisë së ringjallur.

Frymëzimi i DhR nuk duhet të mbahet për të vlerësuar forcën e provave për ringjalljen e Jezusit. Pengesa e vërtetë për besimin në ringjalljen është bindja se një gjë e tillë nuk mund të ndodhë. Tregimet e ungjijve tregojnë të kundërtën.

Shënim: një vërtetim i mëtejshëm i ringjalles erdhi gjoja pas pak nga një anë shumë e paparshikuar – nga savani i Turinit që mban gjurmën e një njeriu të kryqëzuar, i cili është, sipas mendjes së shumë ekspertëve, savani i vetë Jezusit. Sipas tyre, e vetmja mënyrë, në të cilën kaq shumë hollësi për viktimën do të shypeshin në savan, do të ishte damkosje më anë të rrezatimit radioaktiv të fortë, por me një kohë shumë të shkurtër. Kjo përhapje e energjisë së fortë do t'i përgjigjej atij që të krishterët quajnë «ringjallje». Në çastin e ringjalljes, trup i Jezusit do të jetë shndërruar menjëherë, dhe ky trup, i energjizuar nga një fuqi e pakufizuar, do të jetë ngritur lart nëpër savan duke u damkosur me përshtypjen e viktimës.

Kështu savani i Turinit, siç mendohet, është vetë savani, në të cilin Jezusin e mbështollën pas vdekjes së tij kur e varrosën. Sidoqoftë, kohën e fundit u botëruan përfundimet e datimit radiometrik sipas karbon 14: 1200-1300 vjet pas Krishtit! Natyrisht kjo vë në dyshim autenticitetin e savanit. Sidoqoftë, e kemi të vështirë ta kuptojmë se si një falsifikues mesjetar mund të ketë prodhuar një gjë aq të sofistikuar. Ka edhe arsye për t'i vënë në dyshim përfundimet gjoja e sigurta të datimit radioaktive. Së pari, ajo që matej nuk ishte vetë savani, por mbështjellesa e formuar nga akumulimi i pluhurit etj. Një fenomen e tillë haset shpeshherë te matimi i moshës së mumjave egjiptiane: trupi jep shpeshherë një datim më të vjetër se ai i savanit. Së dyti, ekspozim në rrezatimin e mëparshëm do të ngatërronte saktësinë e metodit të karbonit 14, i cili

bazohet në njëtrajtshmërinë e prishjes së atij elementi radioaktiv. Në këtë rast, një rrezatim i mëparshëm do të ulte shpejtësinë e prishjes radioaktive dhe kështu do t'i jepte mostrës një moshë më të re.

SHKRIMET E APOSTUJVE

Apostujt s'ishin vetëm autorët e Ungjijve, por edhe të Letrave. Këto letra ishin drejtuar ose bashkësive të krishtera (d.m.th. kishave), të cilat apostujt i kishin themeluar ose shpresonin që t'u bënin vizitë, ose drejtuar individëve, të cilëve u jepnin rëndësi. Këto letra shpeshherë u shkruan për shkak të një problemi në bashkësinë (kishën) e vendit, për të cilën përgjigjej apostulli. Në shumë raste problemi ishte një herezi që po ngrihej nga ndikimi i njëfarë filozofie që ishte e huaj për krishterimin. Nganjëherë ishte çështje për rendin kishtar ose thjesht apostulli dëshironte të përcillte me shkrim njëfarë mësimi sepse nuk mund t'i vizitonte personalisht. Letrat e apostujve, pra, përmbajnë mësimin që ishte i detyrueshëm për pranuesit sepse e shkroi njëri nga zëvendësit e Jezusit, nën frymëzimin e Shpirtit të shenjtë. Sidoqoftë, apostujt ishin një fenomen i papërsëritshëm, dhe autoriteti i tyre i papërsëritshëm nuk iu transmetua tjetërkujt pas vdekjes së tyre, por u la në shkrimet e tyre, DhR. Këto shkrime u mblodhën dhe u bënë kanonike ose normative për të gjitha çështjet e fesë ose të sjelljes, sepse apostujt ishin autorët. Që atëherë të gjitha shkrimet e tjera duhej të provoheshin nga kjo normë. Ndalohet të zbritet ose të shtohet gjë, në të gjitha këto shkrime normative (që quhen kanuni); kanoni është i mbaruar një herë e përgjithmonë.

Letrat përmbajnë mësim për personin dhe veprën e Jezusit. Ato e zhvillojnë (nën frymëzimin e Shpirtit të shenjtë) mësimin që e dha Jezusi, pasi u kthye në qiell. Ato zhvillojnë dhe mbarojnë të njëjtën shfaqje. Letrat shpesh përmbajnë një pjesë mësimore, pastaj edhe një pjesë të mësimit praktik për zbatimin në jetë. Ishin dy çështje që i mundonin të krishterët e parë që rridhnin nga sfondi pagan: sjellja pagane e padëshirueshme dhe grindja nga mosmarrëveshjet. Prandaj, nuk është çudi që të dy çështjeve u kushtohet shumë vëmendje.

Letrat përmbajnë shumë mësim për Kishën. S'ka çudi për këtë sepse ky mendim ishte shumë i ri për lexuesit, qofshin çifutë dhe joçifutë. Në Letrën drejtuar efesianëve, Pali e zhvillon mësimin për Kishën. Në letrat e tjera, veçanërisht ato që quhen letrat baritore, ka shumë mësim për rendin e Kishës si dhe për organizimin dhe zbatimin e shërbimit në Kishë. Në Letrën e parë, drejtuar bashkësisë në Korint, p.sh. ka shumë mësim për rolin e martesës së atyre që ishin në shërbim të kishës, për

sjelljen e duhur gjatë darkës së Zotit, si edhe për përdorimin e aftësive që Shpirti i shenjtë ua dha anëtarëve të kishës.

Shkrimet në fund të DhR kanë të bëjnë me përndjekje. Apostull Pjetri shkroi dy letra që përmbajnë shumë mësim praktik dhe këshilla për ata që pësonin kundërshtim dhe salvim. Letra drejtuar hebrenjve i drejtohej çifutëve të kthyer që ndodheshin në një situatë të ngjashme. Edhe Libri i Apokalipsit (ose Zbulesës) u drejtohej atyre që tashmë kishin pësuar pak përndjekje por që pritnin edhe të tjerat.

Letra e Jakobit, me gjasë, iu ishte drejtuar çifutëve të kthyer në Siri, dhe paraqitet në formë predikimi, d.m.th, një sërë këshillash morale të shkruara në një stil çifut.

Edhe disa letra u shkruan si përgjigje pyetjeve të drejtpërdrejta, të cilat i kishin dërguar kishat e themeluara nga apostulli. Problemet e mësimëve të rreme kërkonin një përgjigje mësimore, kurse problemet e sjelljes një përgjigje praktike të bazuar në Shkrimet e tjera.

Shumë përmbajtje letrash u shkruan për t'u kundërshtuar herezive. Herezitë u paraqitën ose për shkak të ideve të rreme që disa krishterë i kishin trashëguar nga sfondi i tyre pagan, ose për shkak të mësuesve heretikë që u futën tinëz në disa kisha ku mbaheshin për «të vërtetë». Herezitë e këtij lloji janë gnosticizmi dhe ligjshmëria judaizante. T'i shoshitim me radhë.

1) **Gnosticizmi** ishte një përzierje mendimesh të rrënjosura në platonizëm, zoroastrianizmin e helenizuar dhe judaizmin apostat. Ishte bashkimi i fesë me magjinë dhe me astrologjinë, të ngjashëm me ritet mistike të masonerisë së sotme ose me lëvizjen bashkëkohore Koha e Re (New Age).

Çfarë besonin gnostikët? Ata besonin se e mira dhe e keqja ekzistojnë që nga përjetësia. Të krishterët, përkundrazi, besojnë se e keqja është një pushtues i huaj në botë dhe se nuk duhet të jetë atje. Gnostikët besonin se trupi është nga natyra i keq, sepse është pasojë e krijimit nga perëndia e DhV që e vunë kundër Perëndisë së vërtetë të DhR. Të krishterët, përkundrazi, besojnë se krijimi është thelbësisht i mirë, megjithëse tani është i deformuar nga mëkati (d.m.th. nga pasojat e rebelimit të njeriut kundër Perëndisë). Gjithashtu, besojnë se s'ka kundërshtim ndërmjet Perëndisë së DhV dhe Perëndisë së DhR. Gnostikët nuk besonin në trupëzimin e Krishtit, sepse mendonin që trupi është i keq. As nuk besonin në ringjalljen, për të njëjtën arsye. Vetëm besonin në mbijetesën e shpirtit ose për bashkimin me Perëndinë (shpëtim) ose për bashkimin përsëri me trup (një lloj mallkimi). Të krishterët besojnë edhe në trupëzimin e

Krishtit edhe në ringjalljen e trupit. Gnostikët besonin se problemi kryesor i njeriut është se ka trup. Prandaj shpëtimi përbëhet nga fitimi i informatës së fshehtë (gjoja e njoftuar prej Jezusit të një grupi të zgjedhur) edhe nga shpëtimi prej trupit për t'u bashkuar me Perëndinë në një gjendje jokrijimi. Përkundrazi, në Bibël, thuhet se problemi kryesor i njeriut është ky: ai është mëkatar ose rebel kundër Perëndisë. Kjo do të thotë se ai është në një raport të padrejtë me Perëndinë për shkak të rebelimit të tij. Lajmi i mirë ose ungjilli është ky: njeriu mund të vihet në rregull me Perëndinë, të pajtohet me të me anë të flisë së Jezusit dhe me anë të besimit tek ai. Kështu njeriu mund ta trashëgojë krijimin e ri që ia përgatiti Perëndia. Përsa i përket sjelljes, kishte dy lloja gnostikësh:

1) Ata që besonin se s'ishin mëkatarë (tekstualisht: s'kishin mëkat), sepse asgjë e bërë në trup (të keq) mund të ndikojë në shpirt. Prandaj ishin të lirë ta përdorin trupin për imoralitet.

2) Grupi tjetër nuk pranuan vlerësinë e trupit, dhe merreshin me asketizmin (p.sh. me jogën). Hiqnin dorë nga martesja, sepse mendonin që gratë ishin shkaku i gjithë të këqijave duke qenë të lidhura me pjelljen, e kjo shërben vetëm për sjelljen e shpirtërave në këtë botë të keqe ku burgosen në trup.

Në letrën e parë drejtuar Korintasve, Pali kundërshton idetë gnostike të mbijetesës së shpirtit, të ekzistencës së një kategorie të veçantë të të krishterëve shumë shpirtërorë (të quajtur *pneumatikoi* – njerëzit e shpirtit) që ishin jashtë kritikës sepse kishin disa dhurata shpirtërore. Pali kundërshton edhe idenë që ajo që bëhet në trup nuk ndikon në shpirt dhe idenë se gjendja pamartësore është më e mirë se gjendja martesore. Në përgjigje të kësaj, Pali thekson ringjalljen e trupit; thekson se pjekuria shpirtërore matet me frytin e Shpirtit të shenjtë (e jo doemos me dhuratat e Shpirtit); thekson edhe idenë se njeriu është një bashkësi psikosomatike e bërë në çdo pjesë të qenies së tij sipas shëmbëllesës së Perëndisë. Pali edhe tregon martesën dhe beqarinë në perspektivën e drejtë.

Në Letrën drejtuar bashkësisë në Kolos Pali kundërshton praktikatat asketike, ligjshmërinë çifute dhe adhurimin e ndërmjetësve engjëllorë duke treguar madhësinë dhe mjaftueshmërinë e Krishtit.

Gjoni në ungjillin e tij edhe në letrën e parë të tij kundërshton idenë gnostike se nuk ndodhi trupëzimi. Në letrën e tij të parë kundërshton idenë se gjithçka që bëhet në trup nuk ndikon në shpirt që vetë mbetet i pastër. Ai i sulmoi gnostikët sepse thoshin se kurrë nuk bënë mëkat, edhe për mungesën e kujdesit për të krishterët e tjerë. Ai i ngarkon me faj duke thënë se ata nuk janë aspak të krishterë, prandaj bënë mëkatin që çon në vdekje: vazhdimisht e kundërshtuan Shpirtin e shenjtë duke

refuzuar Krishtin.

Në letrën e tij, Juda, edhe në letrën e dytë, Pjetri i dënon gnostikët moralisht të prishur sepse përpiqeshin të prishnin bashkësinë e pastër të të krishterëve. Edhe Libri i Apokalipsit i përmban paditjet për një sekt imoral gnostik si e quanin nikollaitët si edhe për një profeteshë gnostike me emrin Jezabelë.

2) **Judaizmi apostat** ishte herezia tjetër kryesore kundër së cilës luftonin Pali së bashku me të tjerët. Ajo kryesisht përbëhej nga idetë që ishin të huaja për Dhiatën e Vjetër, por megjithatë u pranuan nga judaizmi dhe kështu u bënë pjesë e traditës. Njerëzit e kësaj tradite refuzuan ta shohin DhV sipas pikëpamjes së një pritjeje të ardhjes së Mesisë edhe të derdhjes së Shpirtit të shenjtë. Njerëzit e tillë nuk kuptonin që ekonomia e DhV ishte vetëm e përkohshme, dhe si pasojë absolutizonin Ligjin. Kështu çifutët, në kohën e Jezusit, pothuajse mësonin udhën e shpëtimit me anë të veprave. Pali ua drejtoi Letrën e tij drejtuar bashkësisë në Galaci për t'i kundërshtuar njerëzit që po e mësonin këtë udhë të rreme. Në Letrën drejtuar Romakëve përsërit të njëjtin mësim por me hollësi më të imta dhe më sistematikisht. Pali thekson se të gjithë, qofshin çifutët, qofshin paganët, bënë mëkat dhe nuk ia kanë arritur planit të Perëndisë. Meqë ata të gjithë janë të dënuar me vdekje, askush nuk mund të meritojë shpëtimin. E vetmja rrugëdalje është pranimi i shpëtimit të Mesisë dhe pranimi i Shpirtit të shenjtë për ta bërë të mundur mënyrën e jetesës që i pëlqen Perëndisë. Letra drejtuar Hebrenjve, gjithashtu, thekson përparësinë e Mesisë dhe flinë e tij në planin hyjnor të shpëtimit. Në fund, autori i paralajmëron lexuesit kundër heqjes dorë nga besimi në Jezusin, Mesinë.

Letra e Jakobit siç duket, është në kundërshtim me mësimin e Palit në letrat drejtuar bashkësive në Romë dhe në Galaci. Sidoqoftë, një kontroll më i imët tregon se s'ka kundërshtim. Jakobi me të drejtë e kundërshton besimin, i cili është vetëm çështje mendore dhe nuk dëshmon për rilindjen shpirtërore me anë të veprave. Sipas mendjes së Jakobit, vepra të mira janë frytet e rilindjes e jo merituese përsa i përket shpëtimit.

Nga ky studim i shkurtër mund të shohim se si shumë të ashtu-quajtura kisha u larguan nga besimi i vërtetë dhe i përvetësuan në dogmat e tyre vetë herezitë që apostujt në DhR i dënuan! Secili mësim dhe secila praktikë duhet ta përballojë provën e Biblës, Fjalën e Perëndisë. Edhe islamizmi mund të klasifikohet si herezia e krishtere më e madhe, sepse

është një amalgamë e herezive të ndryshme, në të cilat hasi Muhameti në kohën e ndalimit të tij në Arabi, ku ishin mërguar heretikët e perandorisë bizantine. Përveç kësaj, atë e ndikonin çifutët apostatë të Arabisë, të cilët, siç duket, s'kishin mes tyre asnjë ekzemplar të Biblës për ta lexuar, por mbështeteshin në një traditë gojore të shtrembëruar të tekstit biblik. Kjo do të shpjegonte përse Kurani përmban një formë kaq të deformuar të tekstit biblik, doreshkrimet (më të vjetra) e të cilit datohen qindra vjet para shkrimit të Kuranit. Për këtë arsye islamizmi mund të quhet herezia e fundit dhe më e madhe e krishterimit.

KISHA E PARË

Dhiata e re nuk përmban vetëm katër ungjijtë, në të cilët është çështja për jetën, vdekjen, ringjalljen dhe ngritjen në qiell të Jezusit. Është, gjithashtu, libri i Veprave të apostujve, në të cilin tregohet për lindjen e Bash-kësisë së parë dhe zhvillimin e saj. Pastaj, vijnë letrat e apostujve: kryesisht ato të Palit, Gjonit, Pjetrit, Jakobit, Judës dhe të një autori të panjohur (Letra drejtuar hebrenjve). Në fund vjen libri i Apokalipsit, në të cilin bëhet fjalë për ngjarjet lidhur me ardhjen e dytë të Mesisë si dhe me themelimin e mbretërisë së tij.

Në kohën e shërbimit të Jezusit, ai vetë i kishte zgjedhur dymbëdhjetë mes dishepujve të tij. Më vonë, pas ringjalljes së tij, Jezusi i shtoi këtë numri edhe vëllezërit e tij, Jakobin dhe Judën. Më në fund i shtoi edhe Palin. Pali luajti një rol të veçantë, sepse zhvilloi teologjinë e misionit të drejtuar joçifutëve. Jezusi u dha këtyre njerëzve pushtetin e veçantë të patrashëgueshëm. Nën drejtimin e Shpirtit të shenjtë u ishte dhënë pushteti i veçantë për të themeluar kishën dhe për të rregulluar praktikën dhe organizimin e saj. Jezusi u kishte premtuar frymëzimin e veçantë të Shpirtit të shenjtë për të mbaruar shfaqjen për vete. Ky zbulim ishte i mundshëm vetëm pas ngjarjeve, për të cilat ishte fjala (d.m.th. pas vdekjes dhe ringjalljes së Jezusit). U ishte dhënë të kryejnë shenjat dhe çuditë për të përforcuar misionin e tyre hyjnor. Siç thuhet në letrën drejtuar Hebrenjve 2,3b-4: *Atëherë si do të shpëtojmë ne, në qoftë se përbuzim veprën e madhe të shpëtimit të Perëndisë? Kjo filloi kur e shpalli vetë Zoti (Jezus) dhe u vërtetua me anë të atyre që e dëgjuan. Vetë Perëndia e dha identifikimin me anë të shenjave, të veprave të bindshme, të mrekullive dhe të dhuntive prej Shpirtit të shenjtë që ua ndau sipas vullnetit të tij.*

Në Librin e veprave të apostujve tregohet për fillimin e Kishës. Filloi me ngritjen e Jezusit në qiell, 40 ditë pas ringjalljes së tij, me autorizimin për shpalljen e lajmit të mirë (ungjillit) të gjitha kombeve dhe me plo-

tësimin e premtimit për dërgimin e Shpirtit të shenjtë. Në ditën e Rrëshajëve u plotësua ky premtim dhe apostujt e morën Shpirtin e shenjtë dhe filluan të predikonin lajmin e gëzueshëm. Të parët njerëz që u kthyen nga mëkatet e tyre dhe besuan në Jezusin ishin ata që kishin dëgjuar predikimin e Pjetrit në Jerusalem. Dëgjuesit ishin jo vetëm çifutët nga Palestina por edhe nga vendet ku ishin të shpërndarë. Siç duket, këta njerëz u kthyen në vendet e veta dhe ua shpallën të tjerëve lajmin e mirë ose të paktën shkaktuan një diskutim për këtë çështje në sinagogat ku ishin anëtarë. Në Librin e Veprave të apostujve, më tej, përshkruhen daljet kryesore të ungjillit në grupe njerëzish që çifutët i mbanin për «të përjashtuar»:

- 1) Samarianët (kap.8),
- 2) Paganët (kap.10)
- 3) Dishepujt e Gjonit (kap.19).

Secili grup me radhë e mori Shpirtin e shenjtë pas pranimit të fesë në Jezusin si Mesi. Në çdo rast dukeshin të njëjtat shenja, për t'u provuar çifutëve të pranishëm se këta njerëz e morën Shpirtin e shenjtë, sikurse edhe çifutët e kishin marrë. Përforcimi i fesë ndodhi në krahina të caktuara: në Jerusalem u rrënjos feja për herë të parë. Pas martirizimit të Shtjefnit, Filipi shkoi në kryeqytetin e Samarisë (Neapolisi, Nablusi i sotëm, dikur Shehemi) ku ua predikoi samarianëve lajmin e gëzueshëm për shpëtimin me anë të Jezusit, dhe pastaj qytetëve dhe fshatrave të tjera në Samari (kap.8,5.25). Pastaj, lajmi i gëzueshëm u predikua në krahinën në lindje dhe në perëndim të Jerusalemit deri në Cezare dhe në qytetet bregdetare. Pastaj, feja u shpërnda deri në Damask. Pas pak autoritetet çifute kundërsulmuan duke dërguar Saulin në Damask me fuqi të plota për të arrestuar të krishterët, për t'i futur në burg dhe për t'i vlarë me gurë. Në kap. 9,31 shkarazi lexojmë për predikimin e ungjillit në Galile, atje ku filloi krahina e paganëve. Pastaj, ungjilli u shpërnda deri në Antioki, qytetin e tretë të perandorisë romake, ndoshta në vitin 37 të erës sone. Me këtë rast, Pali, gjer atëherë përndjekësi më i madh i kishës, ishte rrugës për në Damask për të arrestuar të krishterët, kur papritur bëri një takim vendimtar me Jezusin e ringjallur. Ky ishte shkak i kthimit të Jezusi. Që atëherë përndjekësit çifutë e ndiqnin Saulin (Palin) me radhë, sepse e mbajnë për një renegat të betuar. Pali kaloi një kohë atje ku banonin arabët (në Jordani) dhe, pastaj erdhi në Antioki ku predikonte. Dhjetë vjet më vonë, në vitin 46, Pali, pas një periudhe të mendimit dhe të studimit, u dërgua nga Shpirti i shenjtë dhe nga bashkësia në Antioki për një mision mes paganëve.

Udhëtimi i tij i parë misionar e çoi së bashku me Barnabën dhe Markun

në Qipro dhe në Turqinë e sotme lindore. Strategjia e tyre ishte së pari predikimi në sinagogat çifute. Disa çifutë dhe simpatizues paganë e pranuan ungjillin dhe u bënë embrioni i bashkësisë së mëtejshme. Kur shumica e çifutëve e refuzuan ungjillin, nganjëherë duke përdorur dhunë, drejtimi i predikimit ndryshoi te paganët. Me gjithë këto rreziqe dhe me largimin e ndihmuesit të tyre, Markut, ata arritën të themelonin bashkësi të krishtera në pesë qytete.

Ndërkohë hyrja e paganëve në Kishë shkaktoi ngritjen e pyetjeve të rëndësishme për qëndrimin e të krishterëve ndaj zakoneve dhe ligjeve çifute. Disa të krishterë çifutë me këmbëngulje thoshin se paganët e kthyer duhej të bëheshin synet dhe t'i nënshtroheshin ligjit të Moisiut për t'u pranuar në bashkësinë e krishtere, e cila gjer atëherë përbëhej vetëm nga çifutët e kthyer. Me t'u kthyer në Antioki në vitin 49, Pali, duke kuptuar se kjo lëvizje judaizante ishte një kërcënim për thelbin e ungjillit, shprehu kundërshtimin e tij të hapur. Së pari e qortoi publikisht Pjetrin, sepse ishte mënjanuar nga të kthyerit nga paganizmi me qëllim që t'i shmangej konfliktit me disa judaizantë. Së dyti, Pali, pasi dëgjoji që herezia judaizante ndikonte në bashkësitë që i kishte themeluar pak kohë më parë, u drejtoi një letër të krishterëve në Galaci, në të cilën e thekson ungjillin e shpëtimit vetëm me anë të besimit në veprën dhe personin e Jezusit, Mesisë. Këto ngjarje në Antioki shkaktuan krizën e parë në zhvillimin e krishterimit. Për t'i zgjidhur problemet e ngritura, bashkësia në Antioki i dërgoi Palin dhe Barnabën që të këshillohen me apostujt dhe të parët në Jerusalem (rreth vitit 49 të erës sonë). Këshilla e ratifikoi pikëpamjen e Palit se si të kthyerit nga paganizmi s'ishin aspak të detyruar t'i nënshtroheshin ligjit çifut të Moisiut. Me këtë rast (rreth vitit 49) për herë të parë dëgjojmë për predikimin e ungjillit mes çifutëve në Romë. Kjo shkaktoi një trazirë aq të madhe, sa që perandori Klaud i dëboi të gjithë çifutët nga Roma! Gjithashtu, me këtë rast, Jakobi, kryetari i kishës në Jerusalem, shkroi një letër që u drejtohej çifutëve të kthyer në Siri.

Në vitin 49 Pali u nis në udhëtimin e dytë misionar. Kaloi nëpër Turqinë e sotme jugore dhe më tej në Evropë ku predikoi lajmin e mirë në Greqi. Në Maqedoni u themeluan bashkësitë në Filipi, në Selanik dhe në Berejë; edhe në Akajë, ose në Greqinë jugore, në Athinë dhe në Korint. Pali kaloi dy vjet duke themeluar e përforcuar bashkësinë në Korint, e cila do t'i shkaktonte më vonë shumë andralla, siç mund të vërehet duke lexuar dy letrat drejtuar të krishterëve në Korint. Pali mbajti lidhje me bashkësitë e reja të vendosura në Maqedoni me anë të bashkëpunëtorëve të tij (p.sh. Lukës, mjeku që u bashkua me grupin në Tro-

adë) si edhe me anë të letrave (p.sh. letrave drejtuara bashkësisë në Selanik).

Më 53 Pali filloi misionin e tretë, në të cilin predikoi lajmin e mirë në Turqinë e sotme perëndimore, ku, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, themeloi bashkësinë në Efes. Përsëri vizitoi bashkësinë në Korint, dhe pastaj shkroi letrat që u drejtoheshin bashkësive të Korintit edhe të Romës. Më 58 Pali u kthye në Jerusalem për të marrë pjesë në një festë çifute. Atje, në një trazirë, romakët e arrestuan Palin: çifutët e akuzuan për dhunimin e Tempullit (ata mendonin se kishte futur disa miq paganë në oborrin e rezervuar për çifutët). Palin e futën në burg paraprak dhe më vonë e shpunë në Cezare dhe, kur apeloj në Cezarin, e çuan në Romë. Në këtë kohë perandor ishte Neroni. Nga viti 61 deri në vitin 63 ishte nën rojën ushtarake në Romë, por gjatë kësaj kohe shkroi letrat drejtuar bashkësive në Kolos, në Efes e ndoshta edhe atë që u drejtohej bashkësisë në Filip. Më 63 më në fund doli në gjyq para Neronit, por u shpall i pafajshëm.

Pas kësaj, Pali u nis në udhëtimin e katërt misionar; vizitoi Spanjën dhe krahinat e egjeut, duke përfshirë ndoshta edhe Shqipërinë e atëherëshme, ku sigurisht themeloi bashkësitë e besimtarëve. Më 65 Pali mund të ketë vizituar Efesin, Kretën dhe Maqedoninë. Gjatë kësaj periudhe shkroi letrat drejtuar Timoteut dhe Titit, zëvendësve të tij nga Maqedonia. Nga kjo kohë gjendja e çifutëve në perandorinë romake po keqësohej, sepse më 66 u bënë një sërë kryengritjesh çifute kundër Romës. Kështu filloi lufta çifute, e cila mbaroi tek në vitin 73. Më 64 digjej Roma. Kjo ngjarje shkaktoi ndryshimin e qëndrimit të autoriteteve romake ndaj të krishterëve; që atëherë klasifikoheshin si «një grup anarkistësh dhe ateistësh», i cili paraqiste një rrezik për shtetin romak. Romakët i quajtën «ateistët» sepse nuk besonin në perënditë romake! Më 67 romakët përsëri e arrestuan Palin dhe gjatë qëndrimit në burg shkroi letrën e dytë drejtuar Timoteut. Pak më vonë e ekzekutuan duke i prerë kokën.

Pali, në fund të letrës së tij, tha: *Luftën e mirë e luftova, vrapimin e kreuva, kam qenë besnik deri në fund. Tani më pret gati kurora e fitimtarit; Zoti, gjykatësi i drejtë, do të ma japë në atë Ditë; dhe jo vetëm mua, por të gjithë atyre që do të presin me padurim ardhjen e Tij.*

ZHVILLIMI I KISHËS SË PARË

Pali nuk ishte i vetmi apostull në veprim. Kishte edhe apostuj të tjerë. Megjithatë, nuk lexojmë shumë për veprat e tyre, sepse skrimet e apostull Palit kanë rëndësi më të madhe teologjik. Por edhe apostujt e tjerë e morën porosinë e Zotit për të predikuar lajmin e mirë tek të gjithë popujt. Në të vërtetë, sipas traditës kishtare, të gjithë apostujt u vranë, me përjashtim të Gjonit, i cili jetoi deri në një moshë të thyer në Efes ku edhe vdiq.

Natyrisht, Pjetri ishte në fillim figura kryesore në predikimin e parë të ungjillit, por më vonë Pali erdhi në plan të parë. Në ditët e para Pjetri ishte predikuesi kryesor, zëdhënësi para autoriteteve çifute si edhe kryetari i këshillit për disiplinën kishtare. Pjetri udhëhoqi fushën e misionit të parë të Kishës deri në Samari. Ai është, gjithashtu, i pari apostull i lidhur me misionin drejtuar paganëve. Me shtimin e rëndësisë së Palit, Pjetri e përkrahte atë. Sidoqoftë, ka vështirësi në gjurmimin e karrierës së Pjetrit pas vdekjes së Shtjefnit. Sipas veprave të apostujve, Pjetri merrej me veprimtarinë misionare në rrafshinën bregdetare të Judesë. Autoritetet çifute e futën në burg në Jerusalem, dhe pas ikjes së tij të mrekullueshme, u nis «për në një vend tjetër». Sigurisht u hodh në ilegalitet dhe shkoi në Antioki dhe ndoshta u nis pastaj për në Korint. Siç duket, Pjetri ishte i lidhur ngushtë me të krishterët në Turqinë e sotme veriore, prandaj ndoshta kishte predikuar ungjillin atje. Kjo, me radhë, do të shpjegonte pse Perëndia e drejtoi Palin të mos shkonte atje, por të rrinte në Evropë. Kjo, gjithashtu, do të tregojë se letra e Palit drejtuar galatasve, iu drejtua bashkësive në Galacinë jugore, e jo në Galacinë veriore.

Siç duket, Pjetri kaloi pak kohë edhe në Romë, të cilën e përdorte si bazë për misionet e tij në Turqinë veriore, sepse Jerusalemi përjashtohej. Nga Roma shkroi dy letrat e tij që u drejtoheshin dy bashkësive në Turqinë veriore, duke përdorur shifrën sekrete «Babilon» për «Romën». Në Romë, sipas traditës kishtare, romakët e kryqëzuan Pjetrin kokëposhtë gjatë përndjekjes së të krishterëve që shkaktoi zjarri i Romës. Sidoqoftë, s'ka dëshmi të qartë për të provuar se ai themeloi kishën në Romë, se ishte ipeshkvi i parë i Romës. Ka shumë të ngjarë se vizitat e tij në Romë ishin thjesht baritore. Ndoshta Pali iu lut Pjetrit të shkonte atje për të pajtuar të krishterët çifutë me të krishterët e kthyer nga paganizmi.

Në disa tradita është fjala për udhëtimin e Bartolomeut (Natanael Bar-Tolmait) në Armeni; në të tjerat është fjala për misionin e Markut në Egjipt (duke shërbyer për bazë Romën), për Andreun që shkoi te

sitet si edhe te shqiptarët, për Tomën ose për një nxënës të Tomës që themeloi kishën në Indi.

Kryengritja e çifutëve ose lufta çifute (66-73), e errësonte pjesën e dytë të shekullit të parë të erës sonë. Shumica e të krishterëve me prejardhje çifute ndodheshin në një gjendje shumë të vështirë. Fillimi i kësaj lufte mund të ketë shkaktuar shpërnguljen e Gjonit (së bashku me Marinë, nënën e Jezusit) deri në Efes, si edhe shpërnguljen e Filipit në Frigji. Ky sfond historik shpjegon edhe gjendjen e përshkruar në letrën drejtuar hebrenjve. Kjo letër iu ishte drejtuar çifutëve të kthyer nga judaizmi që banonin në Romë, ku ishin në një situatë të vështirë. Në periudhën, menjëherë para vitit 64, kur u bë legjislacioni i ri kundër të krishterëve, autoritetet romake filluan të mos i mbanin të krishterët më për anëtarë të një sekti çifut me të drejta të barabarta me çifutët, me tolerancën fetare. Të krishterët dolën si një organizatë e fshehtë që refuzonin të pranonin e të adhuronin perënditë romake. Papritur, të krishterët e tillë u gjendën të vetmuar dhe pa mbrojtje. Tundimi ishte shumë i fortë që të hiqnin dorë nga besimi në Jezusin, Mesinë, dhe për t'u kthyer te judaizmi ku do të kishin strehë. Autori i letrës drejtuar hebrenjve i paralajmëron lexuesit se në qoftë se veprojnë ashtu, do të humbasin. Disa vjet më vonë shpërtheu lufta çifute që mbaroi me shkatërrimin e Jerusalemit në vitin 70 dhe në vitin 135 të kombit çifut. Profecitë e Jezusit u plotësuan. Në fund të fundit fjala e Perëndisë u realizua, sepse vetëm Perëndia është në gjendje të parashikojë të ardhmën.

Në Jerusalemin, marrëdhëniet midis çifutëve dhe të krishterëve konservatorë, si Jakobi, ishin të mira (ndryshe nga helenët radikal prej shpërndarjes çifute), por, kjo mori fund me vrasjen e Jakobit në vitin 62. Pas kësaj u keqësuan marrëdhëniet. Më 85 çifutët i shtuan liturgjisë së sinagogave një mallkim kundër të krishterëve. Marrëdhëniet u keqësuan edhe më shumë kur çifutët filluan t'ua denonconin të krishterët autoriteteve romake dhe kështu shkaktuan arrestimin dhe shpesh ekzekutimin e tyre. Gjatë kryengritjes çifute të dytë, të madhe, me njëfarë Bar-Kokeba (133-135) në krye, çifutët i ndoqën të krishterët si tradhtarë, sepse refuzuan të rrëmbenin armët kundër romakëve. Një nga pasojat e kësaj lufte të dytë ishte shkëputja e plotë ndërmjet judaizmit dhe krishterimit. Mbetën vetëm disa bashkësi të vogla me prejardhje çifute, por zhvillimi historik u kishte kaluar pranë dhe më në fund formuan sektën e Ebionitëve; ata nuk pranonin as hyjninë e Mesisë dhe as pranonin Letrat e Palit. Shkëputja doli si tragjike, sepse Kisha me këtë humbi rrënjët e saj çifute. Me kalimin e kohës njerëzit hynin në kishë nga sfondi filozofik pagan (para së gjithash nga platonizmi). Njerëz të tillë kur u kthyen në krishterim,

mbajtën presupozimet dhe premisët e pikëpamjes filozofike të mëparshme. Kjo më radhë të parë ndikonte në kuptimin e tyre të krishterimit. Ky ishte vetëm fillimi i një procesi, i cili, nën ndikimin e neoplatonizmit, u bë burimi i pothuajse të gjitha herezive të mëtejshme. Me kalimin e kohës, vetëm një pakicë e të krishterëve mbetën besnikë ndaj mësimin të pastër të Dhiatës së Re.

Edhe një tipar i historisë së kishës së parë ishin përndjekjet; së pari nga çifutët pastaj nga romakët. Përndjekja romake filloi, në Romë dhe rrethinat e saj, nën sundimin e perandorit Neron (54-68). Ky vrau shumë të krishterë, duke përfshirë edhe Palin e Pjetrin. Gjithashtu, doli një urdhëresë, sipas së cilës, që atëherë, të gjithë të krishterët klasifikoheshin si «armiqtë të shtetit». Nën sundimin e Domicianit (81-96) mori hov edhe një valë përndjekjeje kundër kryetarëve të Kishës, kësaj here në Azinë e vogël (d.m.th. në Turqinë e sotme perëndimore). Apostull Gjonin e dëbuan në mërgim në Patmos, ku shkroi librin e Apokalipsit. Ka aluzion për këtë salvim në kapitujt e parë të këtij libri, ku është fjala për burgimin e në disa raste për ekzekutimin e kryetarëve të kishave. Domiciani mbahej për hyjnor dhe kështu nuk duronte të krishterët. Më 161-180 mori hov edhe një valë salvimi nën perandorin Mark Aurel, dhe përsëri më 191-211 nën Septim Severin kur u vranë shumë të krishterë.

Gjatë shekullit të dytë krishterimi u përhap edhe në lindje, jashtë kufijve të perandorisë romake, kryesisht në Osroene (Edes – mbretërinë e mbretit Abgar IX) e cila, në fund, u bë mbretëria e parë e krishtere. Ungjilli u përhap që nga Egjipti dhe Roma deri në Afrikën veriore. Atje u themeluan bashkësitë e para ku flitej latinishtja (në të tjerat flitnin greqishtja, gjuhë zyrtare të perandorisë romake). Krishterimi u përhap deri në Persi, dhe në fund, në Azinë qëndrore. Armenia u bë mbretëria e dytë e krishtere dhe Gruzia mbretëria e tretë e krishterë. Prej vitit 180, siç duket, të krishterët hasen në të gjitha provincat e perandorisë romake dhe në Mesopotami. Mendohet se në një popullsi prej rreth 50 milionësh, disa 10 përqind e tyre u bënë të krishterë, por shpërndarja e kishave s'ishte e barabartë. Dendësia më e madhe e besimtarëve ndodhej në Siri, Azinë e vogël, Egjipt, Tunisi, Algjeri, Romë, Antioki, Lyon, Armeni dhe në Etiopi.

Periudha ndërmjet viteve 250-313 karakterizohej nga përndjekjet sistematike, në shkallën e gjerë të Kishës nën perandorët Deci, Valerian dhe Diokletian. Por, me urdhëresën e Milanit (313) Licini dhe Konstantini futën politikën e lirisë fetare të barabartë për paganët dhe të krishterët. Nën perandorët Gratian dhe Teodosi (më 391) lindi ideja absurde e krishterimit shtetëror!

LETRA E PALIT DREJTUAR ROMAKËVE

Këtë letër e shkroi Pali kishës së Romës, të cilën nuk e kishte themeluar e as nuk e kishte vizituar. Siç duket, qëllimi i letrës ishte:

1. Për t'iu prezantuar kësaj kishe dhe t'i paraqesë një mbrojtje (apologji) të ungjillit që predikonte, pasi dëshiron ta përdorë Romën si trampolinë për punë të metejshme misionare në Spanjë, dhe pse dëshiron që të krishterët në Romë ta ndihmojnë financiarisht në këtë ndërmarrje.

2. Për t'i parandaluar judaizantët dhe për të kundërshtuar thashëmet se predikonte një ungjill antinomian (d.m.th. pa detyrim moral)

3. Për ta nxitur bashkimin midis çifutëve dhe joçifutëve të kthyer duke nxitur që të dyja anët të bënin lëshime ndaj njëra-tjetrës. Joçifutëve duhej t'u tregoheshin vendin: ata duhet ta kuptojnë se pa çifutët, s'do të kishte asnjë ungjill (lajm të mirë, sihariq), kurse çifutët (e kthyer) duhet ta kuptojnë se nuk kishin të drejtë t'i ngarkojnë vëllazërit e tyre joçifutë me legalizmin rabinik. Në vitin 49 të gjithë çifutët ishin dëbuar nga Roma – duke përfshirë edhe çifutët e kthyer në krishterim – kështu që kisha ishte bërë kryesisht joçifute. Vetëm më vonë, me ardhjen në fuqi të Neronit (më 54), çifutëve iu dha leje të ktheheshin në Romë.

Del qartë se letra drejtuar romakëve nuk është traktat i shkruar në zbrazëti. Madje edhe pjesët teoretike i referohen situatës së kishës në Rome. Duket qartë se Pali shqetësohej për disa zhvillime në Romë, por pasi nuk ishte themelues i kësaj kishe, u desh të jetë diplomatik në mënyrën e tij t'u drejtohej besimtarëve atje.

Data dhe vend shkrimi: Letrën e shkroi Pali mundësisht gjatë dimrit të viteve 56/57 kur banonte në shtëpinë e një besimtari në Korint. Udhëtimi misioni i tij i tretë po i afrohej fundit, dhe për tre muaj ishte myafirë te Gaji (Veprat 20,3). Ia diktoi letrën e tij Tertiut, sekretarit të tij. Në tetë kapitujt e parë, pas një përshendetjeje hyrese, Pali e shtjellon bazën doktrinale të ungjillit të tij. Teksti i tij kryesor është i *drejti* (d.m.th. i shfajësuar) *me besim do të jetojë*. Kjo shërben si tregues në mëkat dhe në vdekje që karakterizojnë botën fetare si dhe botën pagane, si dhe në ofertën e Zotit për merrjen e pafajësisë dhe jetën e përjetshme nëpërmjet Krishtit (Mesisë), e cila vulolet nga dhurata e Shpirtit të tij. Ai merret edhe me hollësi me mësimin e tij për shfajësinë (justifikimin) e besimtarit, pasi këtë mësim e kanë keqkuptuar armiqtë e tij si liri për të bërë një jetë të shthurur. Gjithashtu merret me mësimin për shenjtërim. Kapitulli i shtatë pasqyron përvojën e tij si çifut i devotshëm, në përpjekjet e tij të kota për t'i pëlqyer Zotit. Kapitulli i tetë pasqyron një të krishterë,

d.m.th. përvojën e Palit pas kthimit në fe, i cili është rilindur me anë të Shpirtit të shenjtë. Në kapitujt 9-11 Pali merret me mësimin për paracaktimin e besimtarëve për shpëtim si dhe për shpëtimin përfundimtar të kombit izraelit. Në pjesën e dytë Pali merret me zbatimin e pasojave të nënkuptuara të ungjillit në kuadër të bashkësisë së krishterë si dhe të shoqërisë pagane.

1 + 2 LETRAT DREJTUAR KORINTASVE

Pali shkroi disa letra të ndryshme drejtuar korintasve, por vetëm dy prej tyre u ruajtën. Këto letra i shpërhapën vizita personale. Kur përmbledhim të gjitha të dhëna, del tabloja që vijon:

1. Vizita e parë e Palit korintasve, që kishte si pasojë themelimin e kishës, si përçarje nga sinagoga e madhe me emrin «Ylli i detit» (Veprat 18,1-7).
2. Letra e parë (shih 1 Kor 5,9).
3. Letra e dytë, e cila është letra e parë që kemi.
4. Vizita e vështirë kur Palin e sulmuan disa anëtarë të kishës.
5. Letra e tretë, më e ashpër (shih 2 Kor 2,4; 7,8), në të cilën Pali kërkon ndeshjen e fajtorëve.
6. Letra e katërt, d.m.th. 2 Kor.
7. Vizita e tretë

Data dhe vend shkrimi: Këtë letër e shkroi Pali në Efes (shih 1 Kor 16,8) gjatë udhëtimit të tij të tretë, mundësisht rreth vitit 55. Vizita e tij e parë datohet në vitin 52 kur Gallio ishte prokonzul i Ahajës (sipas mbishkrimit të gjetur në Delfi)

Arsyeja e shkrimit:

1. Pali kishte marrë raporte nga shtëpi-kisha e Klojës rreth grindjes dhe përçarjes (1 Kor 1,11).
2. Pali kishte marrë një letër tjetër nga Stefani, Fortunati dhe Ahaiku (1 Kor 16,7) në të cilën kërkohej drejtim rreth çështjave të ndryshme si martesë, ushqim kushtuar idhujve, dhunti shpirtërore, para të mbledhura për besimtarë çifutë të varfër në Jerusalem, si dhe kërkim për kthimin e Apolos (1 Kor 7,1.25; 8,1; 12,1; 16,1.12). Përveç kësaj Pali dëgjoi se kishte probleme në lidhje me përçarje, incest, dalje në gjyq, imoralitet, gratë që profetizonin pa mbajtur vel, keqpërdorim i darkës së Zotit si dhe mospranim i ringjalljes trupërore.

Letra e parë drejtuar korintasve është letra më e gjatë baritore në DhR, e cila edhe përmban hollësitë më imta rreth ringjalljes.

Pas largimit të Palit nga Korinti, punën e tij e vazhdoi Apolo, orator i aftë me prejardhje çifute, nga Aleksandria dhe më vonë nga Efesi. Siç duket, edhe Pjetri kaloi disa kohë në Korint (1 Kor 1,12), sepse pas pak atë e ndiqnin dishepujt që parapëlqenin trajtën e krishterimit me theks çifut.

LETRA E DYTË DREJTUAR KORINTASVE

Letra ndahet në dy pjesë (1-9 dhe 10-13) Pjesa e dytë do t'i ketë shtuar më vonë, por para se Pali e dërgoi letrën përfundimtare.

Në pjesën e parë (1-9) Pali përshendes besimtarët korintas sepse kanë ndjekur urdhërimet e tij. Pali hyn në hollësi për të shpjeguar pse ka ndryshuar planet e tij të udhëtimit dhe vazhdon të shpjegojë karakterin e shërbimit të tij, duke sulmuar judaizmin rabinik. Pali gjithashtu jep hollësi të imta rreth marrjes së parasë të mbledhura për të kishterët e varfëruar në Jerusalem, të cilët ishin viktimët e zisë së bukës të vitit 46. Siç duket, në gjysmën e të shkruarit të letrës së tij, Pali mori një lajm të keq rreth andrallave që shkaktonin apostujt e rremë nga Jerusalemi. Jo vetëm që sulmuan Palin, por edhe mashtronin kishën.

Kishte dy burime kundërshtimi në kishën e Korintit. I pari ishte individ i që ishte fajtor për sjellje të shturur, dhe për të cilën Pali kishte urdhëruar kishën që ta shkishëronte derisa të vinte në vete. Megjithatë i njëjti individ mendonte se ishte privilegji i tij si aristokrat të bënte një jetë të shturur, dhe duke menduar se sulmi është mënyra më e mirë e mbrojtjes, e sulmoi personalisht Palin, siç do të kishte zakon çdo pagan.

Burimi i dytë i kundërshtimit ishte një grup njerëzish që mbaheshin për apostuj dhe kishin ardhur në Korint pas nisjes së Palit thjesht për t'i pasur gjërat të qarta rreth mesimit për shfajësimin me anë të besimit. Prandaj siç duket, këta të ashtuquajtur apostuj ishin judaizantët nga kisha e Jerusalemit që kishin pranuar idetë që qarkullonin mes korintasve për t'i ndikuar kundër Palit. Na vjen të vështirë ta kuptojmë se si kisha mund t'i kishin dëgjuar, nëse ata nuk pretendonin të ishin dërguar nga kisha e Jerusalemit. Siç duket, madje pas vendimit të këshillit të Jerusalemit (më 46), ende kishte elemente rebeluese brenda kishës së Jerusalemit të cilat Jakobi nuk arriti t'i frenonte. Pali u dha sfidë këtyre apostujve ta dëshmonin apostolatën e tyre. Pali kishte themeluar një kishë (në Korint), kurse apostujt e rreme ishin thjesht shkatërrimtarë:

ata kishin ardhur me qëllim të hapur për të *prishur* veprimtarinë e apostull Palit dhe kishin përdorur *dredhi* për t'i arritur qëllimit të tyre. Palin e kishin gjykuar sipas kritereve të botës pagane, për të cilat e dinin se do t'u pëlqenin korintasve që ende mendonin në mënyrë gjysmë pagane. Sa kishin *vuajtur* ata për shkak të ungjillit?, donte të dinte Pali. Aspak, sepse nuk e predikonin ungjillin e vërtetë për hirin e Perëndisë falë flijimit të Mesisë. Ata po predikonin një Jezus tjetër (2 Kor 11,4), i cili nuk ishte vetë Biri i Perëndisë (d.m.th. hyjnor), dhe një ungjill tjetër (shpëtimi me besim, por edhe me vepra: Gal 1,6). Nënkuptohej që me frytet e tyre do t'i njihni. Ka mundësi që këta apostuj të jenë larguar më vonë nga kisha për të formuar sektin e ebionitëve. Ebionitët e shek. II nuk bësonin më në hyninë e Krishtit dhe asnjëherë nuk e pranonin lindjen prej virgjreshës. Në këtë drejtim të çon në fund mësimi për shpëtimin me besim dhe me vepra. Në qoftë se veprat luajnë një rol në shpëtimin tonë, atëherë Jezusi nuk mund të ketë qenë mjaft i mirë për të paguar çmimin e plotë të shpëtimin tonë, prandaj do të ketë qenë më i ulët se Perëndia. Në të vërtetë veprat na mbrojnë (tregojnë se jemi me të vërtetë të shfajësuar), por nuk na shfajësojnë (tregojnë se morëm pafajësinë): vetëm një flijim i përsosur për mëkatet tona mund të jetë themel i deklaratës se jemi të shpëtuar përgjithmonë.

LETRA DREJTUAR GALATASVE

Pali, i cili po kthehej në Antioki nga udhëtimi i parë misionar, gjendet i ndërlikuar në një polemikë me judaizantët nga Jerusalemi, të cilët, siç e dimë nga Veprat 15,2, e kishin vizituar qytetin në atë kohë (shih gjithashtu Gal 2,12). Kur ndërlikohet në këtë polemikë, i vjen lajmi se mësues të ngjashëm që e ndiqnin pas, i kishin vizituar kishat e themeluara në kohën e udhëtimit të tij në Galati jugore (Veprat 13 – 14) dhe po prishnin veprimtarinë e tij. Si pasojë Pali dërgon me nxitim letrën e tij drejtuar galatasve. Disa kohë më vonë mblidhet këshilli i Jerusalemit për ta zgjidhur çështjen. Prandaj, vizita e tij në Jerusalem, për të cilin Pali aludon në letrën e tij, kishte ndodhur më parë si vizitë private për t'u këshilluar me Jakobin, Pjetrin dhe Gjonin. Kjo do të jetë vizita e tij e parë para kthimit të tij në krishterim që do të ketë ndodhur më 33 dhe që shënohet te Veprat 9,26-29. Ikja e Palit prej Damaskut duhet datuar në 35 ose 36. Prandaj letra drejtuar galatasve, e cila duhet datuar në 48 ose 49, është letra e parë e Palit.

Galacia veriore, siç duket, është vendmbërritje e pamundshëm për këtë letër, për arsye që vijojnë:

1. Me sa dimë ne, Pali nuk e vizitoi këtë krahinë – në të vërtetë ishte Pjetri ai që themeloi kishat atje (shih 1 Pj 1,1).

2. Kjo krahinë ishte jashtë rrugës së zakonshme dhe nuk ndodhej pranë komunikacioneve kryesore. Nuk ishte strategjia e Palit për t'i vizituar vende të tilla të izoluara.

3. Galacia veriore përmbante një nënkulturë kelte që nuk kishte mundësi të zgjerohej dhe kishte pak kontakt me qytetërimet e tjera. Nga anë tjetër Galacia jugore kishte komunikacione të rëndësishme dhe një popullsi të madhe çifute që ishte vendosur atje me bekimin e seleucidëve (pasardhësit e Aleksandrit të madh), dhe më vonë me atë të romakëve.

Përmbajtja: Çështja kryesore që diskutohet është ajo e ungjillit. Nuk është vetëm çështje nëse joçifutët duhet t'u përmbahen ligjit çifut me ceremonitë e tij, por nëse shpëtimi varet nga besimi ose nga besimi me vepra.

Pasi galatasit i kishin mashtuar të ashtuquajturit apostujt e kishës së Jerusalemit rreth kësaj çështjeje dhe kishin braktisur lajmin e mirë për të pranuar lajmin e keq (shpëtimi varet nga arritjet fetare), Pali duhet ta rivendosë autoritetin e tij. Judaizantët do ta kenë paditur Palin si rebel që veçohej nga kisha amtare e Jerusalemit në bazë të ndonjë vegimi që gjoja kishte pasur. Sipas tyre ishte e pamundshme që Krishti ta ketë ngarkuar drejtpërdrejt me predikimin e ungjillit, pavarësisht nga apostujt e tjerë në Jerusalem, dhe kështu nuk ishte apostull i vërtetë. Pali iu përgjigj duke pohuar se ishte me të vërtetë i dërguar drejtpërdrejt nga Krishti dhe nuk duhet të ketë ngarkuar me këtë punë nga kisha e Jerusalemit për të qenë apostull i vërtetë.

Në fakt ai i padit ata për predikimin e ngatërrimit të ungjillit, i cili nuk ishte aspak ungjill (lajmi i mirë). Jakobi do të pohonte (më vonë) në këshillin e Jerusalemit se kurrë nuk ua kishte dhënë këtë autorizim. *Pasi morëm vesh se disa prej të tanëve – por pa lejën tonë – [erdhën] u trazuan me disa fjalë dhe ua shqetësuan shpirtin* (Veprat 15,24).

Atëherë Pali vazhdon duke shpjeguar me hollësi ungjillin që predikonte. Ai përfundon duke shpjeguar mësimin e tij për shenjtërim, pasi judaizantët do ta kenë paditur për antinominianizëm, d.m.th. shfajësim do të thotë se mund të vazhdonin të mëkatonin sipas qejfit.

LETRA DREJTUAR EFESIANËVE

Sfondi: Këtë letër e shkroi Pali dhe ua drejtoi besimtarëve në Efes kur ishte i burgosur (në fakt në arrest shtëpie) në Romë, duke pritur procesin e tij (60 – 62). Në këtë kohë sigurist mendonte për kishat që kishte themeluar në Azinë e Vogël. Si apostull dhe themelues i tyre, atij i ra ndërmend përgjegjësia që kishte për to. Pas pak u hap një mundësi e papritur për t’u dërguar një letër. Një skllav me emrin Onezim ishte kthyer në krishterim nëpërmjet dëshimit të Palit, dhe Pali e kishte këshilluar të kthehej te pronari i tij i mëparshëm që banonte në Kolos. Pali u vendos të dërgonte bashkë me Onezimin jo vetëm letrën përcjellëse (drejtuar Filemonit), por gjithashtu një letër të përgjithshme drejtuar kishave që Onezimi do t’i ndeshte rrugës për në Kolos duke filluar nga Efesi, i cili ishte kryeqytet kishtar i asaj kohe. Kjo dëshmohet nga mungesa e individëve që Pali deshi t’i përsëndiste. Stili i letrës është shumë i ndërlikuar dhe letra përmban koncepte të cilat joçifutët do të kishte të vështirë t’i kuptonin: Pali, rabini tipik, është pa dyshim autori i kësaj letre.

Temat kryesore

1. Pajtimi i përgjithshëm me Perëndinë nëpërmjet flijimit të Mesisë që banon nëpërmjet Shpirtit të shenjtë tek ata që u pajtuan. Pali shoh atë që ndodhet në kishë si pjesë e qëllimit më të gjerë që Zoti ka ndërmend ta plotësojë në të ardhmen. Pali thotë se në fund Perëndia ka ndërmend t’i pajtojë me vete të gjitha nëpërmjet Mesisë. Ka dy koncepte që duhen shqaruar këtu. Pali nuk thotë se të gjithë njerëzit do të pajtohen me Perëndinë, por gjithçka, d.m.th. çdo aspekt i krijimit të Perëndisë. Perëndia do t’i nënshtrojë të gjitha Mesisë. Kjo do të thotë se ata që nuk pranojnë t’i nënshtrohen atij, do largohen nga ky krijim e ri dhe do të përfundojnë në fer (vend për hedhjen e plehrave).

Sfondi i të gjitha kësaj letre është se, si pasojë e rënies së njeriut në mëkat (d.m.th. rebelimit të tij), krijimi është huajtur nga Perëndia. Një aspekt të këtij huajtjeje është ndarje që u zhvillua midis Izraelit dhe kom-beve të tjera. Kjo simbolizohet nga muri i ndarjes në tempull midis çifu-tëve dhe joçifutëve: ndalohej që joçifutët ta kapërcenin këtë mur me rrezik për t’u dënuar me vdekje, kurse ndalohej që çifutët të hynin në një shtëpi joçifute. Por madje edhe Izrael nuk ishte pa mëkat – brenda kombit të zgjedhur kishte ndarje midis farisenjve, saducenjve dhe zelo-tëve, midis çifutëve vendas dhe çifutëve që banonin jashtë shtetit (shpërnguljës). Tani, për shkak të veprës pajtuese të Mesisë, të gjitha këto

mund të menjahohen. Pengesat e vjetra mund të hiqen dhe mund të krijohet një njerëzim i përgjithshëm i ri, që përbëhet nga çifutët dhe joçifutët: të dy mund ta adhurojnë Perëndinë së bashku si tempull (vend ku banon hyjnia) shpirtëror. Tempulli fizik me ceremonitë e tij tani fillon të humbasë përkatësinë e tij.

Besimtarët te Mesia tani korrin fitoren mbi fuqitë e errësirës që mbajnë në kthetrat e tyre botën pagane. Preokupim me këto fuqi (okultizmi, magji e zezë, mallkime etj) ishte shumë i fortë në Efes dhe, siç duket, gjetkë në Azinë e Vogel. Besimtarët i takojnë Krishtit (Mesisë) i cili, nëpërmjet ringjalljes, i ka mposhtur këto fuqitë e errësirës, pasi ishin ato që sundonin një botë të tjetësuar nga Perëndia dhe që rrinte nën pushtetin e mëkatit. Prandaj Pali i nxit besimtarët të kuptojnë atë për të cilën Zoti i ka thirrur: shpëngim i plotë i trupave të tyre me rastin e ringjalljes që do të ndodhë me kthimin e Mesisë.

Mësimi kryesor i letrës është pa dyshim ekleziologji: raporti i Krishtit me kishën e tij. Megjithatë ne duhet të ruhem nga interpretimi grek i këtij mësimi që e parafytyron Kristin si ndonjë buda kozmik që shtrihet nëpër qiell dhe kishën si korpi mistik i Krishtit në botë. Kuptimi i mësimit të Palit është si vijon: për shkak të ringjalljes dhe ngritjes në qiell të Krishtit, ai s'është më nënshtruar kufizimeve të hapësirës dhe të kohës. Nëpërmjet Shpirtit të shenjtë energjia e Perëndisë që, në kohën e Dhiatës së vjetër, përqëndrohej në tempull, tani përqëndrohet në kishë që përbëhet nga besimtarët. Kisha është tani trupi i tij në kuptimin se ai i përdor besimtarët për të zbatuar qëllimet e tij. Ky koncept përmban edhe unitetin ndërmjet Krishtit dhe kishës së tij, që bazohet në idenë e solidarësisë në kuadër të besëlidhjes. Jezusi i tha Saulit (ndryshe Palit): *Pse më përndjek mua?*, sepse i përndiqte besimtarët që i takonin Atij. Kjo është mister vetëm në kuptim se ne nuk mund ta kuptojmë plotësisht me mendjet tona njerëzore.

LETRA E PALIT DREJTUAR FILIPIANEVE

Këtë letër drejtuar filipianeve do të ketë shkruar nga Roma gjatë burgimit të Palit duke pritur procesin e tij para Neronit, i cili në fund kishte si pasojë merrjen e pafajësisë dhe lirimin e tij. Do të datohet në vitin 62.

Filipi ishte qytet i rëndësishëm në Maqedoni dhe koloni romake e themeluar për t'i strehuar legjionarët në pension. Ishte Roma në miniatyrë, një koloni romake e vërtetë. Pali e kishte ungjillizuar gjatë udhëtimit

të dytë misionar më 50 (Veprat 16,12-40). Pali e përshkoi me dy raste të mëpasshme: në vjeshtë 57 (Veprat 20.1-2) dhe në pashkë 58 (Veprat 20,3-6). Të kthyerit në fe atje gjithnjë mbanin marrëdhëni të ftohtë me të, dhe i dërgoi dhurata për veprimtarinë e tij ungjillore kur ishte në Selanik (Fil 4,16) dhe më vonë kur ishte në Korint (2 Kor 11,9). Ishte Epfroditi, delegati i tyre, ai që e kishte sjellë dhuratën e tyre te Pali në Romë, dhe të cilin filipianët e kishin dërguar për t'i bërë shoqëri gjatë burgimit të tij (d.m.th. arrestimit të shtëpisë).

Letra nuk përmban shumë lëndë mësimore: është më mirë zbraze e zemrës së Palit, këmbim pikëpamjesh, paralajmërim për t'u ruhur nga judaizantët që kërkonin të prishin veprimtarinë e Palit dhe që kishin mundësi të bënin po kështu madje edhe në Filipe.

Fragmenti kryesor mësimor është te Fil 2,6-11 ku Pali merret me trupëzimin e Krishtit, por në kuadër të nxitjes për përlulje. Mund të ketë qënë himn, madje edhe në fillim aramaikisht. Ai thotë në thelb se Jezusi hoqi dorë nga privilegjet e tij si Perëndi, por jo nga atributet e tij, sepse pranoi të ndahej nga të drejtat e tij si Perëndi. Këto të drejtat tani iu kthyen atij dhe ai është tani përveç kësaj (gjendje nuk ekzistonte para trupëzimit të tij) Perëndi-Njeriu – ndërmjetësi hyjnor i popullit të tij, kishës.

Përveç hollësive rreth trupëzimit, Pali përtërin, në fragmente të shpërndara nëpër letrën e tij, rëndësinë e kryqit (3,18), veprimtarinë e Shpirtit (1,19) si dhe kthimin e Krishtit (1,6.10; 3,20). Thekson se drejtësia (d.m.th. marrëdhëni e drejtë me Perëndinë) arritet vetëm me besimin te Mesia si flijim për mëkat, dhe jo me meritë ose me arritjet e veta.

Është para të gjithash letër praktike që thekson unitetin tonë falë ungjillit të gjithmbarshëm dhe besnikërinë personale ndaj Jezusit, Mesisë.

Në fund, Pali i fton besimtarët të gëzohen me të. Gëzimi është themelimi i letrës së Palit (haset 16 herë), me gjitha rrethanat e tij të këqija dhe përfundimin e mundshëm të procesit të tij. Nga kjo kohë Pali erdhi në konkluzionin se Krishti nuk të kthehej në të gjallën e tij.

LETRA DREJTUAR KOLOSIANËVE

Letrën drejtuar kishës në Kolos e shkroi Pali pothuajse njëkohësisht me shkrimin e atyre drejtuar Filemonit dhe efesianëve. Ajo ishte drejtuar një herezie që bënte kërdinë në Kolos – përzierje prej judaizmit legalist dhe gnosticizmit, e ngjashme me kabalën e judaizmit bashkëkohor.

Pali është në arrest shtëpie (do të jetë rreth vitit 59) bashkë me Markun, Lukën dhe Onezimin pranë vetes ndërsa dikton tri letra njëra pas tjetrës: drejtuar Filemonit, Kolosianëve dhe Efesianëve). Epafri do të jetë ai që kishte ungjillizuar qytetin Kolos si përfaqësues i Palit gjatë qëndrimit të tij në Efes, ku do të ketë drejtuar një veprimtari misionare të gjerë nëpër tërë krahinën.

Megjithëse kishën e Kolosit e kishte themeluar një grup misionarësh, Pali mendonte se përgjigjej për të dhe kështu iu përgjigj menjëherë sfidës që parashkonte ky kërcënim i ri për jetën e kishës. Ketij kërcënimit Pali i kundërshton një kristologji e fortë që mbahet Mesinë për kulmim i qëllimeve të Perëndisë, gjë që inauguron epokën e re. Me kundërshtimin e ideve gnostike, Pali përdor fjalorin e tyre të cilin e kthen kundër tyre. Për shembull fjala greke *pleroma* (plotësi) donte të thonte të gjitha ndër-mjetësit ndërmjet Perëndisë supreme dhe krijimit të tij. Kur Pali thotë se besimtarët këtë e kanë në Krishtin, gjë që do të thotë se Krishti është i vetmi ndërmjetës hyjnor ndërmjet Perëndisë dhe njerëzimit 2:9, 15). Në njëfarë kuptimi letra drejtuar efesianëve është varianti më sistematik i letrës drejtuar kolosianëve.

Pali merret gjithashtu me çështjen e ndërmjetësve engjëllorë, edhe për Izraelin (ata mbikëqyrën administrimin e Ligjit) edhe për kombet pagane ku funksionin si agjentët e Satanit, të cilët, nuk u mjaftonte t'i kujtonin paganët vazhdimisht mekatët e tyre, por edhe kërkonin të devijonin adhurim në vete dhe të siguronin se të gjithë të përfundojnë në fer. Kjo dëshmon qartë se ato fuqitë kishin kaluar të drejtat e tyre. Kolosianët nuk e kishin kuptuar se ishin të lirë nga këto fuqi akuzuese, nga ky sistem i mallkuar – nëpërmjet Mesisë ata ishin tani nën sundimin e drejtpërdrejtë të Perëndisë dhe nën kujdesin e tij. Përveç kësaj, ata ishin të caktuar për t'i zëvendësuar engejt satanikë që sundonin mbi paganët.

LETRA E PARË DREJTUAR SELANIKASVE

Këtë letër e shkroi Pali, ka të ndjarë gjatë udhëtimit të tij të dytë më 50, pasi e kishte themeluar kishën në Salonik, udhëtoi për në Korint, nga do ta ketë shkruar letrën e tij gjatë dimrit që erdhi pas, me Silën dhe Timoteun pranë tij.

Pali e vështron kohën që kishte kaluar me ta. Pastaj jep një varg udhëzimesh praktike lidhur me jetën e besimtarit, por theksi i tij kryesor është eshatologjik. Selanikasit sigurisht shqetësohehin për bashkëbesimtarët që vdiqën se mos do t'i ikte ngjarja madhështore (kthimi i Krishtit

dhe ringjallja). Pali i qetëson ata duke u treguar se kur të kthehet Krishti, do ta shoqërojnë edhe besimtarët e vdekur, kështu që edhe ata do të marrin pjesë në këtë ngjarje madhështore dhe do të ringjallen, do të bashkohen me bashkëbesimtarët e tjerë dhe do të paraqiten se bashku me Krishtin në qiell në sy të të gjithë banorëve të botës. Pasi kjo ngjarje, kur të ndodhet, do to jetë e papritur dhe pa paralajmërim, ata duhet të rrinin gjithnjë të gatshëm. Megjithatë kjo nuk do të thotë se ata duhet t'i lënë punët e tyre duke u sjellë kotë në pritje të kësaj ngjarjeje.

LETRA E DYTË DREJTUAR SELANIKASVE

Letrën e dytë drejtuar selanikasve e shkroi Pali pas pak për të korrigjuar një keqkuptim të mundshëm në lidhje me fjalët e tij të mëparshme: ai nuk do të thoshte se kjo ngjarje mund të ndodhë ndonjëherë, por se kur të ndodhë, do të ndodhë papritur. Selanikasit sigurisht shqetësohehin se Dita e Zotit ishte ardhur dhe se kishin humbur ngjarjen madhështore (rrëmbimin e kishës – kur ne do të takohemi me Krishtin). Në të vërtetë ai pohon se nuk mund të ndodhë pa u zhvilluar disa ngjarje paraprake, si për shembull paraqitja e antikrishtit (mesisë së rremë) dhe vuajtjet e mëdha (ngushtica e madhe) që do të vijnë më pas si pasojë. Selanikasit do të kenë ardhur në konkluzionin se tashmë kalonin nëpër ngushticën e madhe për shkak se ishin të përndjekur dhe për këtë arsye kthimi i Krishtit ishte i afërt.

Të dyja letrat janë padi të tmerrshme kundër çifutëve që bënë çmos për të prishur veprimarinë e Palit. Pali flet për fatin e tyre – ata po shkonin drejt një përballimi të tmerrshëm me shtetin romak, që do të përfundonte me disfatën dhe shpërnguljen e kombit. Rreshi në 1 Sel 1,10 në fund do të thotë se çifutët, duke kundërshtuar përhapjen e ungjillit, i kishin vënë vulën së ardhmës së tyre të tmerrshme. Në 2 Sel Pali vazhdon të flasë për fatin e çifutëve të kohës së fundit që do të kishin të njëjtin qëndrim: ata do të mashtrohen nga mesia e rremë dhe do të gjenin të njëjtin fat si ai: të ndarë përgjithmonë nga prania madhështore e Perëndisë. Pali nuk ka asnjë iluzion për këta çifutët që kundërshtojnë ungjillin – po shkojnë në mallkim të përjetshëm në fer.

I Paudhi (d.m.th. antikrishti – mesia e rremë çifut) do të vijë me pushtetin e Satanit dhe do të bëjë gjithfarë mrekullish, shenjash dhe çudish të rrejtshme. Ai me ngashnjime të padrejta do t' i gënjejë ata që biren për arsye se nuk e pranuash dashurinë e së vërtetës që i kishte shpëtuar. Prandaj edhe Hyji ua dërgon një fuqi që i bën të gabojnë e t' i besojnë gënjeshtres, që të dënohen të gjithë ata që nuk i besuan së vërtetës, por përqaftuan padrejtësinë. (2 Sel 2,9-12) ...Të cilët do të

ndëshkohen me dënimin e pasosur larg nga fytyra e Zotit dhe nga lavdia e madhërisë së tij (2 Sel 1,9)

LETRAT BARITORE

Letrat e Palit drejtuar Timoteut dhe Titit janë ngushtë të lidhur përsa i përket sfondit, trajtës dhe situatës historike. Siç duket, dy prej tyre u shkruan në Maqedoni, njëra drejtuar Timoteut që ishte në Efes (1 Tim,1-3), ku Pali kishte ndërmend ta takonte pas pak (3,14; 4,13), kurse tjetra drejtuar Titit të cilin e kishte lënë në Kretë (Tit 1,5). Pali ka ndërmend ta kalojë dimrin në Nikopojë (në Epir), ku Titi (i cili kishte ungjillizuar Dalmatinë me kryeqytet në Solun, pranë Splitit të kohës së sotme) duhet ta takojë (Tit 3,12). Më vonë, kur e Pali shkruan letrën e dytë drejtuar Timoteut, ai është i burgosur në Romë (1,8.16; 2,9), pasi ka kaluar nëpër Troadë (4,13) dhe Milet (4,20). Situata e tij është e rëndë (4,16) dhe ai ka përshtypje se pas pak do të vdesë (4,6-8; 18). Pali është në vetmi dhe e nxit Timoteun të vijë sa më shpejt (4,9.16.21). Del qartë se rrethanat e tij nuk u përgjigjen atyre të burgimit të parë.

Në qoftë se supozojmë se atij i dha pafajësinë pas burgimit të parë, ai duhet të ketë udhëtuar për në Spanjë sipas qëllimit të tij të mëparshëm, si dhe drejt lindjes (Fil 22). Kështu edhe 1 Tim edhe Titi përputen me datën 65 kur Pali po udhëtonte nëpër Kretë, Azinë e Vogël, Maqedoni dhe Greqi. Megjithatë 2 Tim pasqyron një burgim të ri i cili do të përfundonte me ekzekutimin e Palit më 67, pasi nga kjo kohë krishterimi ishte bërë organizatë e paligjshme.

Kështu këto letra janë drejtuar dyve prej ndihmësve të Palit kryesore, të cilët shërbenin si ndërmjetës ndërmjet kishave dhe vetvetes. Ata ishin apostolikë në kuptimin që ata e përcollën besnikërisht më tej atë që Pali u kishte besuar. Pali thekson se ata duhet të ruhen nga sinkretizmi që po zhvillohej ndërmjet judaizmit apostat dhe spekulimit grek (si kabala e sotme të çifutët) që ndikonin në shumë çifutët e shpërnguljes, të cilët edhe merrnin para duke i mësuar ide të tilla.

Te 1 Tim 1 Pali i sulmon judaizantët për teorinë e tyre të gabuar për shenjtërim: shenjtërimi nuk arrihet duke ndjekur një kod ligjor, por me fuqinë që del nga një marrëdhëni e re me Perëndinë që mundësohet nga Mesia që banon te besimtarët falë shpirtit të tij, dhe për këtë aludon fragmentet te Jeremia 31,33-34 dhe Ezekieli 11,19-20.

Në letrat baritore pasqyrohet fillimi i ndryshimit në strukturën e kishës. Me vdekjen e apostujve që më parë kishin mbikëqyer kishat e re

mbi të cilat sundonte një këshill drejtues me president (drejtor i përgjithshëm) në krye, më shumë fuqi ndodhet në duart e këtij kryetari, i cili më vonë bëhet pastor (famulltar) i kongregacionit. Vetëm më vonë u krijua pozita e ipeshkëvit (peshkopit) në kuptimin bashkëkohor të fjalës, kur një njëri i vetëm mbikëqyrte (fjala ipeshkëv ose peshkop do të thotë mbikëqyrës) jo vetëm një kongregacion të vetëm, por edhe disa kongregacione (së pari në qytet, dhe më vonë në fushë). Koha e apostujve ishte unike, e megjithatë disa kisha karizmatikë ku gjoja ushtrohet shërbimi i apostullit dhe i profetëve, dëshirojnë të kthehen në modelin apostolik të strukturës kishtare, por më kotë.

LETRA DREJTUAR FILEMONIT

Siç kemi parë, këtë letër e shkroi Pali njëkohësisht me letrat drejtuar kolosianëve dhe efesianëve, kur ishte në arrest shtëpie në Romë, kështu që letra mund të datohet përafërsisht në vitin 62. Letra na jep një vështim në personin e Palit. Në burg ai është fitues i zjarrtë i njerëzve për Krishtin me zemrën atërore për Onezimin, skllavin e ikur, të cilin e ka fituar për Krishin. Tani edhe pronarin edhe skllavin i tij i ka fituar Pali për Krishtin, kjo ndryshon marrëdhiet e tyre të dyanshme, sepse të dy janë tani vëllazër në Krishtin. Në këtë mënyrë u qiten farët që do të çonin në fundin të skllavërisë, jo me anë të një revolucioni të dhunshëm, por me anë të ndikimit të krishterë në një shoqatë të mbarë. Fillimet e kësaj zhvillimi i shohim nën regjimin e perandorit Konstantin me dekretimin e një legjislacioni të ri dhe më të butë në favor të skllavërve. Ky zhvillim e arriti kulmin e tij me zhdukjen e skllavërisë në shek. XIX, falë një rizgjimi fetar.

LETRA DREJTUAR HEBRENJVE

Megjithëse shumica e teologëve bashkëkohorë nuk e pranojnë autorësinë e Palit, dëshmia e Klementit prej Aleksandrisë (155-220) nuk mund të menjanohet lehtësisht. Ai pohon se në fillim Pali e shkroi këtë letër në hebraisht për një rreth lexuesish eksklusivisht çifut, por më pas e përktheu në greqisht të shkëlqyeshëm Luka, në dobi të një rrethi më të gjerë lexuesish. Rendi i parë i librave të DhV që mbahet te kisha ortodokse gjithashtu dëshmon për autorësinë e Palit.

Kjo letër përmban një shpjegim për mësimin e kryepriftërisë së Krishtit që ka dy aspekte. Së pari ka flijimin e vetë Krishtit që i tejkalon të gjitha flijimet e mëparshme, dhe së dyti ka shërbimin e tanishëm të tij të

ndërmjetësimit për besimtarët, i cili duhet kuptuar si ndërmjetësim pasiv (Krishti është flijim pajtues për mëkatet tona dhe ai është advokati ynë mbrojtës. Pjesa e fundit të letrës i pasqyron besimtarët si priftër që shërbejnë nën komandën e Mesisë, kryepriftit: ata kushtojnë fljime shpirtërore duke adhuruar Perëndinë dhe duke dëshmuar për të.

Këto tema zhvillohen si vijon:

a) Epërsia e Jezusit, Mesisë, mbi engjejt (1-2), pastaj mbi Moisiun (hebr. Mosheun), ndërmjetësin e besëlidhjes së mëparshme (3)

b) Epërsia e priftërisë së Mesisë (ajo e Melkizedekut) mbi atë të kryepriftit çifut (5-7) si dhe mbi priftërinë sipas rendit të Aharonit.

c) Epërsia e shenjtërores qiellore (në të cilën ka hyrë Krishti i cili na përfaqëson) mbi atë tokësore (tempullin në Jerusalem)

d) Epërsia e flijimit të njëhershëm mbi flijimet e përsëritura nën sistemin e DhV (10).

Në DhR kemi një besëlidhje më të mirë (më të efektshme) si dhe një ndërmjetës më të mirë – gjithçka na siguron një marrëdhëni të përsosur me Perëndinë (përsosuri) dhe na siguron një vend në qiell (në Jerusalem qiellor).

Letra drejtuar hebrenjve përmban gjithashtu disa fragmente për paralajmërim, të cilat siç duket mësojnë se besimtari mund ta humbasë shpëtimin e tij. Fragmenti i parë ndodhet në kap. 6,1-12. Kurse individi për të cilin është çështje siç duket është besimtar, mungesa e frytit e tradhton si besimtar vetëm me emër. Ndryshe ky fragment mund t'i referohet kombit çifut i cili nuk e ka pranuar ungjillin madje edhe pse ishte dëshmitar për shërbimin e mrekulleshëm të Mesisë midis tyre. Në fragmentin e dytë të 10,26-30, paralajmërohen çifutët përgjithësisht. Te rr. 26 shprehja «vazhdon të mëkatojë», do të thotë të vazhdojë të refuzojë ungjillin. Megjithatë në qoftë se bëhet fjalë për apostazi, ai që bën apostazi (heq dorë nga feja) kështu tregon se qysh nga fillimi s'ishte besimtar i vërtetë.

Thelbi i mesazhit të letrës është nxitje për t'u qëndruar besnik në fe e jo të heqë dorë për t'u kthyer në fushën e judaizmit. Meqë vetë Mesia (e jo ndonjë profet) ka ardhur dhe i ka plotësuar kushtimet dhe profecitë e DhV, dhe ka inauguruar një besëlidhje të re dhe më të mirë, rrëzikohet aq më shumë në rast mosbesimi. Apostazia sjell katastrofë. Në kap. 11 autori jep një listë heronjsh të fesë – listë e atyre që zinin Perëndinë për fjalë dhe vepruan, por nuk hoqën dorë, por qëndruan besnikë deri në fund, megjithëse kjo i çonin në tëhuajtje, izolim, madje edhe në vdekje.

Ndryshe nga shkrimet e tjera të Palit ku nxitja dhe sfida vijnë në fund të letrës, në letrën drejtuar hebrenjve, kjo vjen në fund të çdo seksioni. Kjo do të jetë për shkak të ngulmimit të nxitjeve të autorit.

LETRA E JAKOBIT

Këtë letër e shkroi Jakobi, vëllai i Zotit Jezus, i cili, siç duket, u bë besimtar vetëm pas ringjalljes kur Jezusi iu duk për ta emëruar apostull (1 Cor 15,7). Më pas u bë kryetar i kishës së Jerusalemit, ndoshta sepse ishte vëllai i Jezusit dhe në njëfarë kuptimi pasardhës i tij. Në vitin 62 kryepriifti Hanan urdhëroi të vritej Jakobi me gurë. Simoni, biri i Klopasit dhe i Marisë, kushërirës së nënës së Jezusit, e trashëgoi Jakobin në krye të kishës së Jerusalemit. Devotshmërinë e tij e miratonin edhe çifutët jobesimtarë dhe iu ngjit emra gjunjë deveje për shkak të lutjeve të tij të shpeshta në tempull. Letra e tij nuk është traktat sipas stilit të Palit, por një varg nxitjesh morale (siç e kishte zakon në predikimet e sinagogës) të lidhura me tema të ndryshme si dhe me lojë fjalësh. Kjo pasqyron edhe stilin e librit të Fjalëve të urta. Letrat e Pjetrit gjithashtu e ndjekin këtë model. Kjo pasqyron faktin se as Jakobi e as Pjetri nuk ishin të formuar në shkollën rabinike. Në fakt theksi teologjik i Jakobit dhe i Pjetrit si çifutë vendësë është shumë i ngjashëm: të dy linin përshtypjen se janë me arminianë dhe më katolikë se Pali, por kjo është vetëm në dukje.

Këndeje, më mirë do të kishite qenë për ta kurrë të mos e kishin njohur udhën e drejtësisë se, pasi e njohën një herë, t'ia sjellin shpinën urdhrin të shenjtë që u ishte dhënë 2 Pjet 2,21). Ky ujë — shembëllesë e pagëzimit që tani ju shpëton: ky nuk është pastrim ndyrësie të trupit, por uratë e drejtuar Hyjit (1 Pjetrit 3,21). *edhe një shembull tjetër për frazeologji hebraike që është karakteristike për këtë gjuhë! Dihet se kisha e Romës ka qenë nën ndikimin e çifutëve të kthyer, por për fat të keq besimtarët e tjerë kanë keqkuptuar shumë shprehje hebraike, të cilat i kanë interpretuar fjalë për fjalë. Kisha e Aleksandrisë kishte prirje të kundërt: nën ndikimin grek kishin prirje ta interpretojnë DhV në mënyrë alegorike.*

Edhe një karakteristikë tjetër e kësaj letre, është fakti se ajo i është drejtuar, siç duket, komunitetit çifut në përgjësi, e jo vetëm besimtarëve të krishterë. Na vjen të vështirë ta kuptojmë se si besimtarët mund të paditen për padrejtësi shoqërore aq skandaloze, madje edhe për vrasje (d.m.th. për shkakimin e vdekjes së të tjerëve).

Vepra shpënguese e Krishtit as nuk përmendet, dhe për vetë Krishtin ka vetëm dy aludime (1,1, dhe 2,1). Megjithatë, edhe pse nuk ka citime të drejtpërdrejta nga Ungjijtë, ka aludime të shumta për mësimin e Jezusit. As nuk ka aludim për shpëtimin me anë të besimit, por duhet marrë parasysh që ka të ngjarë që Jakobi ta ketë shkruar letrën e tij për të korrigjuar keqkuptimin antinomian të mësimin të Palit: mjafton të bësosh dhe mund të jetosh sipas qejfit. Jakobi thekson se besimi te Mesia

duhet të përfundojë me një jetë të ndryshuar (veprat), ndryshe nuk ka dëshmi për kthim të vërtetë në fe. Siç duket, edhe Pjetri shqetësohet për të njëjtën gjë, kur thotë si vijon: *Po edhe duresën e Zotit tonë çmojeni si rast shpëtimi, sikurse edhe Pali, vëllai ynë i dashur, ju shkroi me dije që iu dhurua. Kështu ai thotë në të gjitha Letrat, ku flet për këto gjëra. Në to ka nga diçka që merret vesh vështirë, çka të padijshmit dhe të paqëndrueshmit e shtrembërojnë, si bëjnë edhe me pjesët tjera të Shkrimit të shenjtë — në dënim të vetvetes* (2 Pjetrit 3,15-16). Pali e përdor shprehjen «i shfajësuar» me kuptimin e dhënies së pafajësisë (nga gjyqi i Perëndisë), kurse Jakovi e përdor të njëjtën shprehje me kuptimin «përligje» (veprat janë dëshmi për shfajësim, e jo shkak i shfajësimit). Ky kuptim i dytë i shprehjes përdoret shpeshherë në DhV, kryesisht te Psalmet.

LETRA E PARË E PJETRIT

Këtë letër e shkroi Pjetri në Romë pak para zjarrit të madh të Romës dhe martirizimit të tij. Disa teologë pohojnë se stili është tepër e mirë për të qenë stili i peshkarit galileas, por duhet marrë parasysh që galileasit ishin dygjuhësh. Përveç kësaj letrat e Pjetrit kanë një ngjyrosje semitike (p.sh fëmijët e mallkimit në vend të fëmijët e mallkuar – hebraishtja ka shumë pak mbiemra). Pjetri do të ketë përdorur shërbimet e Silvanit (ndryshe Silës), i cili ishte ekspert në shkrim (1 Pjetrit 5,12). S'ka dyshim se Babilon ishte parullë për Romë. Të krishterët e parë i përdornin shpeshherë parulla të tilla sepse banonin në një botë plotë me kallëzues dhe përndjekje ku sigurimi ishte me rëndësi.

Sipas traditës Pjetri është i lidhur me themelimin e kishës së Romës, por kjo traditë mund t'i referohet rithemelimit të saj më 54 pas kthimit të çifutëve nga mërgimi i përkohshëm nën regjimin e Klaudit.

Pjetri ua drejton letrën e tij besimtarëve të kishave që vetë i kishte themeluar në krahinën veriore të Turqisë se sotme. Supozohet që Pjetri kishte e shërbyer Romën si trampolinë për të ungjillizuar ato krahinat që Shpirti i shenjtë ia kishte ndaluar Palit.

Letra ka prirje të kapërcejë nga një temë në tjetrën si ajo e Jakobit dhe nganjëherë na vjen të vështirë të ndjekim argumentimin e Pjetrit. Për shembull Pjetri flet për shpirtrat e engejve rebelë në burg ku e presin me tmerr Gjyqin e Madh. (1 Pjetrit 3,18-20: shih Zan 6, 1-4 ; 2 Pjetri 2,4; Jud 6).

Në një fragment tjetër enigmatik (1 Pjetrit 4,6), Pjetri pohon se ungjilli ua predikua të vdekurve. Do të jetë aludim për Krishtin që predikonte Ungjillin tek besimtarët e Dhiatës së Vjetër në vendin e të vdekurve,

nga ku i çoi në parajsë. Askush nuk mund të shpëtohet nëse ai / ajo nuk e beson Ungjillin.

Tallësit sigurisht po thoshnin se nuk vlente të bëhet i krishterë, sepse të gjithë pa përjashtim duhet të vdesin. Çfarë përparësi atëherë kanë të krishterët? Pjetri iu përgjigjet duke shënuar se besimtarët e vdekur janë tani në parajsë, kurse të tjerët në burg, në nëntokë në pritje të Gjyqit.

Në letrën e Pjetrit theksohet tema e vuajtjes, duke marrë parasysh shkrimin e pritur të përndjekjeve në të ardhmën. Pjetri parashikon se ajo që ka filluar në Romë do të përhapet deri në Azinë e Vogël ku ndodhen kishat që kishte themeluar. Jezusi merret si shembull suprem i njeriut të pafajshëm që ka vuajtur, dhe Pjetri jep një meditim për Jezusin si Shërbëtori pësimtar. Është kuptimplotë që vuajtje e Mesisë ishte pikërisht tema që Pjetri e kishte të vështirë ta pranonte kur ishte dishepull i ri (shih Mt 16,21-23: *Qysh atëherë Jezusi filloi t'u dëftojë nxënësve të vet se i duhej të shkonte në Jerusalem, të vuante shumë prej anës së pleqve, të kryepriфтërinjve e të skribëve, se do ta vrasin e të tretën ditë do të ringjallet. Atëherë Pjetri e ndau vetmas e filloi ta qortojë: »Mos e thashtë Zoti, Zotëri! Ty s' do të ndodhë një gjë e tillë!« Jezusi u kthye e i tha Pjetrit: »Shporru meje, he djallë! Je shkandull për mua, sepse nuk i ke në mend punët e Hyjit, por punët e njerëzve!«*

LETRA E DYTË E PJETRIT

Stili i kësaj letrë to Pjetrit është i ndryshëm (por ende semitik) nga ai i letrës së tij të parë, por shkak do të jetë përdorimi i dy sekretarëve të ndryshëm. Kryetema është, gjithashtu, e ndryshme: te 1 Pjetrit autori u drejtohet besimtarëve që duhet të përballojnë një persekutim të ashpër, kurse te 2 Pjetrit problemi është ai i mësuesve gnostikë të rremë, të cilët nxitin shturje dhe mohojnë kthimin e Krishtit dhe gjykimin që duhet të pasojë.

Siç duket, këtë letër e shkroi Pjetri pas para zjarrit të madh të Romës dhe para shpërthimit të përndjekjes nga Nero në vitin 64. Del e qartë se Pjetri është autori i letrës, pasi këtë e thotë në përshëndetjen e tij. Përveç kësaj pohon se ishte i pranishëm në shndërrimin e Krishtit në një mal të lartë, dhe i referohet letrës së tij të mëparshme. Qëllimi i letrës është dyfishtë:

1. I drejtohet çështjes rreth vonesës së kthimit të Mesisë
 2. I paralajmëron lexuesit për mësuesit e rremë që janë në liri.
- Nga ana mësimore ka vështrime të rëndësishme.

Pjetri shkruan si vijon; Simon Pjetri, i cili i shërben Jezusit, Mesisë, si apostull, ua drejton këtë letër të gjithë atyre që, sipas drejtësisë f& të Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë, Jezusit, Mesisë, morën të njëjtën fe të çmuar si ne apostujt. Shprehja *sipas drejtësisë* do të thotë se në bazë të kryqit, falë të cilit njeriu i pafajshëm vdiq në vend të njerëzimit fajtor, në përputhje me drejtësinë.

Pjetri thotë se Zoti i ka thirrur të krishterët të marrin pjesë në natyrën hyjnore, çdo do të thotë jo se ata do të bëhen hyjnorë, por se do të marrin jetën e përjetshme që e ka burimin vetëm në Perëndinë (1,4).

Pjetri flet gjithashtu për frymëzimin hyjnor të Shkrimeve të shenjta (1,20). Në referimin e dytë nuk nënkuptohet se vetëm kisha ka të drejtë të interpretojë Shkrimet e shenjta, por se asnjë profeci e vërtetë e ka burimin njerëzor. Pjetri kështu thotë për t'i krahasuar Shkrimet e shenjta me pohimet e marra të mësuesve të rremë, me sa duket në lidhje me kthimin e Krishtit.

Pjetri flet gjithashtu për sigurinë e kthimit të Krishtit me gjithë vonesë të dukshme. Gjithashtu aludon për zjarrin e madh që do ta shkatërrojë qytetërimin siç e njohim ne, në kohën e kthimit të Krishtit. Kjo botë e mëkatshme duhet të pastrohet me zjarr, para se të mund ta vendosë mbretërinë e tij, d.m.th. botën e re ku do të ketë drejtësi (aludim për mijëvjeçarin). Pjetri e konsideron shndërrimin e Krishtit si paralajmërim dhe garanci për kthimin e Krishtit, pasi me rastin e shndërrimit Jezusi u duk siç do të duket me rastin e kthimit të tij. Fakti që aq shumë profeci u plotësuan me rastin e ardhjes së parë të Krishtit, na jep sigurinë plotësuese që profecitë e tjera do të plotësohen me rastin e kthimit të tij.

Pjetri flet negativisht për mësuesit e rremë, ata që njëherë e njihnin udhën e vërtetë, por më vonë u larguan nga ajo. A e kanë humbur shpëtimin e tyre apo asnjëherë nuk ishin besimtarë të vërtetë dhe vetëm më vonë u shfaqën siç ishin? Vërejtjet e Gjonit për të njëjtin grup njerëzish e përkrah siç duket mundësinë e dytë (1 Gj 2,19). *Prej nesh dolën, por nuk ishin prej të tanëve. Sepse, të kishin qenë prej të tanëve, do të kishin qëndruar me ne; por duhej të shfaqej se jo të gjithë ishin të tanët.* Madje edhe Pali tha se vetëm Zoti i i njejtë ata që janë të tije (2 Tim 2,19), aq më pak ne, e aq më pak Pjetri; vetëm mund të nxihet një gjykim të bazuar në vëzhgimet e jashtme. I njëjti parim vlen edhe për vërejtjet te Hebr 6,4-8.

LETRA E JUDËS

Autori, i cili do të ketë shkruar nga Siria, është një nga vëllezërit e Jezusit. Shumë tekste të lashta dëshmojnë për lidhjen e tij të ngushtë me këtë vend. Historian kishtar Euzebi citon nga historia e mëparshme nga Hegisipi që pohon se nipërit e Judës u çuan para perandorit Domitian dhe se ata më vonë u bënë ipeshkvi (peshkopë) nën mbretërimin e Trajanit.

Ka shumë ngjashmëri me letrën e dytë të Pjetrit, kështu që disa teologë pohojnë se njëri e kopjoi tjetrën, por një shpjegim më i mundshëm është që të dy autorët nxorën lëndë nga një burim të përbashkët – një mbledhje tekstesh (që përdornin predikues të ndryshëm) për Gjyqin dhe për kthimin e Krishtit.

Shumica e lëndës së letrës së Judës merret me sulmin e tij kundër mësuesve gnostikë të rremë që kishin depërtuar në kisha të ndyshme. Ai jep një listë prej shembujve të njerëzve që rrinë nën gjykimin e Zotit për mendjemadhësi shpirtërore dhe për shkeljen skandalozë të moralit. Juda bën aludim për dy libra jashtëkanonikë (*Ngritja e Moisiut në qiell* dhe *Libri i Henokut*), por kjo nuk do të thotë se Juda ishte dakord me gjithçka që shkruan – i njëjti parim vlen edhe për Palin që citon nga autorë paganë. Juda gjithashtu bën aludim për engjejt që ranë në mëkat, dhe kjo është mundësisht me radhë aludim për fragmente të ngjashme të Zan 6,1-5 dhe 1 Pjetrit 3,18-20.

LETRA E PARË E GJONIT

Këtë letër e shkroi apostulli Gjon. Në vînin 66 ai kishte lënë Palestinën bashkë me Marinë, nënën e Jezusit dhe ishte vendosur në Azinë e Vogël. Pas pak u emërua biskup i Efesit me përgjegjësi për shtatë kishat e përmendura në librin e Apokalipsit që ishin në dioqesën e tij. Letra e tij do të jetë drejtuar atyre shtatë kishave që kanoste herezia doketiste – një lloj gnosticizmi që mohonte trupëzimin e Krishtit. Njohja e kësaj herezie është kyç për kuptimin e kësaj letre. Doketistët besonin se meqë materia (d.m.th. bota materiale) është e keqe, s'ka mundësi që Perëndia e pastër të vihet në kontakt me materien (hebraisht «mish»), kështu që s'ka mundësi që të ketë ndodhur ndonjë trupëzim. Sipas tyre Jezusi ishte njeri i thjeshtë mbi të cilin Shpirti i Perëndisë kishte zënë vend: me rastin e pagëzimit të tij ky shpirt hyjnor ishte zbritur në të, por ishte larguar nga ai pak para kryqëzimit. Kështu individi që vdiq në kryq ishte njeri i thjeshtë. Kjo do të thotë se Jezusi ishte profet i madh (siç

besojnë edhe myslimanët), por jo Biri i Perëndisë, Mesia hyjnor. Ky mësim e sulmon thelbin e ungjillit, pasi një njeri i thjesht nuk mund të na shpëngojë. Gjoni e sulmon pikërisht këtë mësim në kap. 5, kur pohon se shërbimi i Krishtit si Shërbëtori i Zotit jo vetëm që filloi me pagëzimin e tij (*erdhi me ujë*), por u zgjerua nëpër vdekjen e tij (*erdhi edhe me gjak*), kështu që personi që u pagëzua (Mesia hyjnor) ishte i njëjti person që vdiq në kryq si fli pajtuese.

Heretiku Kerint pohonte se shpëtimi do të thoshte «lirimi nga kujdesi për jetën në këtë botë»: shpëtimi s'kishte asgjë të bënte me moralin e as me dashuri praktike për të tjerët. Kur e shpjegojmë letrën e parë në dritën e kësaj herezie, aludime që bën Gjoni bëhen më të qarta.

Në kapitullin e parë Gjoni e sulmon idenë se Jezusi ishte një iluzion optik – s'kishte trupëzim të vërtetë. Në vazhdim ai i sulmon gnostikët në lidhje me pretendimet e tyre se ishin pa mëkat, dhe që shpirti i tyre ishte i pastër nga çdo gjë që mund të bëjnë trupat e tyre.

Ka disa rreshta në kapitullin e dytë që duhen shquar sepse shpeshherë keqkuptohen. Pastrim është terminologji priftërore për ndjesën. Nëse themi (siç pohonin gnostikët): *»Kemi bashkësi me Të«, por jetojmë në errësirë, ne rrejmë dhe nuk e ushtrojmë të vërtetën. Por, nëse ne ecim në dritë, sikurse Ai është në dritë, kemi bashkësi njëri me tjetrin dhe gjaku i Jezusit, Birit të tij, na pastron nga çdo mëkat. Po nëse themi (siç pohonin gnostikët): »Ne nuk kemi mëkat«, gënjejmë vetveten dhe e vërteta nuk është në ne. Por, nëse i pranojmë mëkatet tona, Ai është besnik dhe i drejtë: do të na i falë mëkatet dhe do të na pastrojë nga çdo padrejtësi. Por, nëse themi: »Ne nuk kemi mëkatuar«, e bëjmë Atë rrenacak dhe fjala e tij nuk është në ne. (1 Gjonit 1,6-9).*

Kjo do të thotë se gjaku i Jezusit i derdhur një herë përgjithmonë na mban të pastër, d.m.th. në gjendjen e ndjesës. Gjoni këtu flet për një gjendje të përhershme që është pasoja e shfajësimit (më mirë, e marrjes së pafajësisë). Nuk ka nevojë që gjaku të derdhet përsëri ose të vihet përsëri. Kështu Gjoni flet në të vërtetë për kthimin në fe dhe rilindjen, të cilën gnostikët nuk mund ta përjetonin derisa pohonin se ishin pa mëkat dhe nuk kishin nevojë për ndjesë.

Megjithatë në kapitullin e dytë Gjoni merret me çështjen e mëkatit të kryer pas pagëzimit. Ai thotë se, pasi Jezusi është ndërmjetësi ynë hyjnor dhe avokati ynë mbrojtës, paditjet e Satanit mënjanoen. Përveç kësaj mund t'i bëjmë thirrje Krishtit për të na ndihmuar në kohën e tundimit dhe në kohën e provës së vështirë.

Shkurt, Gjoni i sulmon gnostikët për mungesën e kujdesit për bashkëbesimtarët e tjerë, dhe kjo dëshmon se ata nuk janë të rilindur. Gjithashtu

i sulmon për mohimin e trupëzimit të Krishtit, pa të cilin shpëtimi është i pamundshëm. Më pas i sulmon për antinomianizmin e tyre që aspak nuk pajtohet me krishterim të vërtetë.

LETRA E DYTË E GJONIT

Autori i kësaj letrë na paraqitet si udhëheqësi, eprori, plaku, dhe kjo na bën të mendojmë se do të jetë apostulli Gjon, i cili jetoi më gjatë se të gjithë apostujt e tjerë dhe i cili ishte ipëshkev i dioqezës së tij në Azinë e vogël. Përveç kësaj fakti që këto letrë u ruajtën në kanunin e Shkrimit dëshmon për autorësinë e tyre apostolike.

Kujt i është drejtuar nuk e dimë, por titulli Zonjës së zgjedhur na bën të mendojmë se është njëra ndër kishat (bashkësitë fetare) të dioqezës së Gjonit. Duhet të jetë shkruar rreth viteve 90-100. Në këtë letër ka aludim për gnostikët që pohonin se Shpirti i shenjtë u kishte dhënë një dijë më të thellë se ajo që kishte vetë apostulli Gjon!

LETRA E TRETË E GJONIT

Kjo letër është drejtuar Gajit, nxënësit të dashur të apostullit. Porositet mikpritja dhe Gajit i bëhet lëvdatë për këtë cilësi, frytin e Shpirtit të shenjtë. Flitet edhe për njëfarë udhëheqësi Diotref, për të cilin nuk dimë shumë. Siç duket, ky nuk e ka pranuar autoritetin apostolik të Gjonit.

I kam shkruar disa fjalë bashkësisë, por Diotrefi, që e përvetësoi padrejtësisht drejtimin e bashkësisë, nuk më kushton aspak vëmendje. Kur të vij, do ta vë para përgjegjësisë për atë që ka bërë. Ai gënjen dhe tregon gjëra të pabesueshme për ne. Por kjo nuk i mjafton! Nuk i pranon bashkëbesimtarët që janë në kalim. Kur ndokush dëshiron t'i pranojë ata, ia ndalon dhe e shkishëron!

Flitet mirë për një misionar me emër Demetër. Gjoni këshillon që Diotrefin ta zëvendojnë Gaji dhe Demetri, me kusht se kisha të jetë dakord.

Del qartë nga këto letrë që rrethanat ishin të rrezikshme: ka rrezik që letrat e Gjonit të zihen në rrugë nga policia, dhe kështu të zbulohet ku ishte fshehur apostulli. Kjo do të shpejonte pse shkruan në trajtë të koduar. Për shembull thotë: *Kam edhe shumë gjëra për të të treguar, por nuk dua t'i them me shkrim. Shpresoj se do të të shoh së shpejti dhe atëherë do të flasim personalisht dhe me hollësi për të gjitha këto.*

Përdorimi i këtij kodi na bën të mendojë se këto letrë i shkroi Gjoni pak para arrestimit dhe mërgimit të tij në ishullin Patmos.

LIBRI I APOKALIPSIT

Si zakonisht në të gjithë literaturën apokaliptike, qëllimi kryesor i librit është inkurajimi i besimtarëve që përndiqen ose të cilët janë në prag të përndjekjes. Pikërisht ky libër është ai për të cilin kishte nevojë kisha për dy shekujt e mëpasshëm kur do ta përndiqte shteti pagan romak, herë sporadikisht herë për një kohë të gjatë. Në këtë libër Babiloni identifikohet lehtësisht me Romën, kurse prostituta me kultin e perandorit gjoja hyjnor. Ky interpretimi historike nuk përjashton një plotësim të ardhshëm, për të cilin shteti totalitar i nazizmit ose komunizmit është vetëm një provë e përgjithshme. Në të vërtetë Libri i Apokalipsit fillon në perandorinë romake dhe përfundon në perandorinë romake të rikthyer, sipas profecisë të Danielit që flet për fazen e dytë të kësaj perandorie. Përveç kësaj duhet vërejtur se fjala “tokë” shpesh do të thotë, sipas kontekstit, ose toka e Izraelit ose perandoria romake.

Libri i Apokalipsit (ose i Zbulesës) është libri i fundit i Dhiatës së Re dhe për këtë edhe libri i fundit i mbarë Biblës. Prandaj, s’është çudi se në këtë libër bëhet fjala për ngjarjet e së ardhmes. Për shumicën duket një libër shumë misterioz, por çelësi i kuptimit ndodhet në Dhiatën e Vjetër, në të cilën edhe bazohet. Ka rreth 500 citate nga DhV!

Këtë libër e shkroi apostulli Gjoni, si pasojë e vegimit që pati në ishullin Patmos, ku romakët e kishin mërguar për shkak të predikimit të ungjillit. Data e shkrimit të librit është diku nga viti 96, në kohën e perandorit Domician. Domiciani ishte një nga perandorët e parë që nguli këmbë për t’u adhuruar si zot dhe perëndi sa ishte ende gjallë. Këtë kult e zbatoi veçanërisht në Azinë e vogël ku Gjoni ishte ipeshkëv në Efes. Për shkak se refuzoi të merrte pjesë në një kult të tillë, romakët e mërguan në ishullin Patmos. Ndërkohë, në stere, salvimi bënte kërdi; i vranë disa të krishterë që banonin në qytetet ku po zbatoheshin kultit i perandorit. Pergami quhet vendi i fronit të Satanit, sepse duke qenë kryeqytet i provincës romake të Azisë, ishte selia e kultit idhujtar të adhurimit të perandorit. Në këtë kohë kritike, siç duket, shtatë bashkësitë, në krahinën e Efesit, dërguan një delegacion te Gjoni për të marrë këshilla për shkak të problemeve që kishin në kishat e tyre. Letrat drejtuar shtatë kishave (kap. 2-3) formojnë përgjigjen që vetë Jezusi ua dha këtyre përfaqësuesve me anë të apostullit Gjoni. Sipas një interpretimi tjetër, engjëjt janë përfaqësuesit qiellorë të kishave, por na vjen të vështirë ta kuptojmë se si atyre mund t’u drejtohen letra.

Por, së pari, këto bashkësi duhej të kujtoheshin për Atë që është objekti i besimit të tyre; Jezusin, Mesinë e ringjallur dhe të ulur në

madhështinë qiellore, që është Zot i Kishës dhe i historisë; i vetmi që mund ta çlirojë botën nga robëria e Satanit dhe të ngrejë atje mbretërinë e Perëndisë. Kështu, kapitulli i parë i kushtohet vegimit të Jezusit, shumë i ngjashëm me atë që kishte parë Danieli. Kjo cakton lidhjen ndërmjet Personit që e kishte parë Danieli dhe Personit që e pa Gjoni. Është i njëjti Person dhe tani erdhi të plotësojë atë që kishte premtuar në librin e Danielit (10,5-6); të ndërhyjë në historinë e botës për ta dënuar botën për rebelim dhe për të ngritur mbretërinë mesianike. Biri i njeriut (Jezusi) paraqitet nën tiparet e kryepriutit të madh (me petk dhe një brez të gjerë rreth parmës shih Dal 28,4; 39,29) dhe me flokët e të Përjetshmit (Dan 7,9), me këmbët e bronzit të keruvëve që simbolizojnë gjithpranishmëri dhe lëvizshmëri (Ezekiel 1,7), dhe me zërin e lavdisë së Zotit që po kthehet (Ezekiel 43,2).

Në letrat drejtuar shtatë kishave marrim vesh se problemi kryesor në këto kisha ishte herezia gnostike që shkaktonte shthurjen e moralit si edhe komprometimin me sistemin pagan botëror. Kjo me radhë shkaktonte dobësimin e besimit dhe aftësisë për të qëndruar besnik ndaj Jezusit nën përndjekje. Edhe një fakt shqetësues që shfaqet në këto letra ishte këtu; çifutët e vendit po denonconin të krishterët. Jezusi i quan një sinagog i Satanit, sepse ata luajnë rolin e Satanit (akuzuesit pa arsye) dhe janë pa justifikim. Ata kishin bashkuar me liturgjinë e sinagogës mallkimin formal që vijon; «Që nazareasit (d. m.th. të krishterët) dhe heretikët e tjerë të fshihen nga libri i jetës.» Për këtë Jezusi iu përgjigjet: *Unë nuk do ta fshij emrin e tij nga libri i jetës. Përkundrazi, në prani të Atit dhe engjëjve të tij, do të pranoj publikisht se ata më takojnë mua.* Por, Jezusi paralajmëron disa bashkësi (kisha) se në qoftë se nuk i braktisin mëkatet e veta, janë në rrezik të heqin dorë nga besimi kur përndjekja të arrijë kulmin. Jezusi mbaron çdo letër duke i nxitur dishepujt e tij që të mbeten besnikë ndaj tij, me çdo kusht, sepse i pret shpërblim i madh.

Qëllimi i librit, pra, është para së gjithash praktik. Është nxitimi për të krishterët që të qëndrojnë besnikë ndaj Jezusit në kohën kur i përndjek shteti totalitar që kërkon nga ata gjërat që i përkasin vetëm Perëndisë. Kështu, ky libër ishte veçanërisht i përshtatshëm për të krishterët e shekujve të mëtejshëm që do të pësonin salvim në perandorinë romake. Në shekullin tonë, me kthimin e shtetit totalitar, ky libër është përsëri i përshtatshëm për të krishterët që ndodhen në një gjendje të ngjashme.

Sidoqoftë, që nga kapitulli 4, ky libër hyn në hollësi të imta për të ardhmen. Flitet për ngjarjet që i përkasin shtatë viteve të fundit të historisë botërore, menjëherë para kthimit të Mesisë, kthimit të Izraelit dhe ngritjes së mbretërisë mesianike. Kjo periudhë përshkruhet shkurt

në librin e Danielit. Në këtë libër bëhet fjalë për profecinë e shtatëdhjetë periudhave prej shtatë vjetësh që çojnë në shkatërrimin e sundimit të Satanit dhe në ngritjen e mbretërisë së Mesisë. Në librin e Apokalipsit këto ngjarje janë përshkruar me hollësi të imta. Shumica e këtyre hollësive kanë të bëjnë me kataklizma natyrore, lufta bërthamore, popullsi botërore që refuzon të kthehet nga mëkatet te Perëndia dhe shteti totalitar që përndjek pakicën e popullsisë, e cila refuzon ta adhurojë, sepse ka besnikërinë më të lartë (te Perëndia). Intensiteti i luftës shpjegohet nga fakti se pushteti i Satanit në këtë botë është aq i rrënjosur saqë më shumë vështirësi e lëshon. Libri përshkruan zemërimin e fundit të Tij, para se të mundet dhe përjashtohet nga Mesia që po vjen.

Shtatë vitet e fundit të historisë së kësaj bote, para kthimit të Mesisë, i ngjajnë një drame. Në gjysmën e librit njihemi me aktorët. Ata janë;

1) Një konfederatë prej 10 kombesh nën udhëheqjen e diktatorit me emrin Egërsira, i cili del nga deti (simbol për kombet). Ky diktator kërkon të adhurohet dhe vret ata që nuk e pranojnë. Fillimin e kësaj konfederate disa e shohin në Bashësinë Evropiane (BE), e cila përshkruhet në një vend tjetër si një formë e rilindur e perandorisë romake (të simbolizuar me kuçedër të kuqe). Babiloni simbolizon Romën, dhe si shtrirje e fjalës, sistemin botëror në kundërshtim me Perëndinë. Ky sistem është i lidhur me lavirën e madhe, e cila është simbol për kultin idhujtar shtetëror (adhurimi i perëndive romake dhe i perandorit). Kapitulli 18 tregon për shkatërrimin e kësaj perandorie dhe të sistemit të rremë.

2) Kombi i Izraelit nën udhëheqjen e Mesisë së rremë, me emrin Anti-krisht ose Profet i rremë (Egërsira e dytë). Kjo egërsirë po dilte nga toka, e toka do të thotë toka e Izraelit (hebr. *erec Jisrael*). Ky njeri lidh një marrëveshje prej 7 vjetësh me diktatorin perëndimor që garanton mbrojtjen e Izraelit si edhe lirinë e kultit fetar. Pas 3 vjetësh e gjysmë, kjo marrëveshje shkelet kur diktatori perëndimor e pushton Izraelin dhe e detyron me adhurimin e vetvetes në Tempull. Kështu kombi izraelit bie në idhujtari. Për këtë bie dënimi nga Perëndia në mbarë kombin në formën e ngushticës së madhe. Vetëm kthimi i Mesisë, në kulmin e shkatërrimit, e shpëton kombin nga shuarja e plotë nga duart e armiqve.

3) Teprica besnike e besimtarëve. Na vjen të vështirë ta mohojë faktin se kisha është e pranishme gjatë shumicës së ngjarjeve të përshkruara në librin e Apokalipsit, por rrëmbehet nga fundi. 144.000 vetat përfaqësojnë ose kishën e ngushticës së madhe, ose tepricën e Izraelit (12 x 12 x 1000): mbarë Izrael që do të kthehet te Mesija me kthimin e tij (Rom 11,25-26). Nga ana tjetër turma nga çdo kombi mund të jenë ata që kanë kaluar provën e rënde: d.m.th. brezi i fundit i kishës. Megjithatë, ka

mundësi që Gjoni *dëgjo*i numrin 144.000, por kur *shikoi*, pa kishën e ngushticës së madhe. Sidoqoftë, pretendimi që kisha nuk ka asnjë vend në ngjarjet e Apokalipsit (pas kapitullit të tretë) bazohet në një presupozim që duhet sjellë artificialisht nga jashtë.

Drama mbaron me betejën e fundit të Har-Magedonit në Izrael, në të cilën shkatërrohen plotësisht ushtritë e kombeve pagane, të cilat e rrethuan Izraelin për ta asgjësuar. Kjo ndodh kur të kthehet Mesia, i cili i mund ato. Në këtë çast, pjesa e kombit izraelit që mbetet, më në fund, e pranojnë Jezusin si Mesinë. Satanin e lidhin, kështu që nuk mund t'i mashtrojë më kombet, dhe fillon sundimi i Mesisë në shkallën botërore. Populli i Perëndia sundon së bashku me Atë dhe Izraeli e udhëheq botën në adhurimin e Perëndisë, duke mësuar kombet për udhët dhe vullnetin e Tij. Në fund të sundimit të një mijë vjetëve, lirohet Satani, i cili nxit kombet për të ngritur krye kundër Perëndisë, por mposhtet menjëherë ky rebelim i fundit. Zhduket bota e vjetër dhe paraqitet Gjyqi i Fundit. Pas kësaj, Perëndia krijon qiellin e ri dhe tokën e re, në të cilën do të banojë populli i Perëndisë.

Kjo nuk është diçka e pamundur që do të ndodhë në të ardhmen e largët. Ka shumë shenja që do të fillojnë së shpejti shtatë vitet e fundit të historisë së botës.

Struktura e librit: siç duket, renditja nuk është kronologjike, por tipikisht semitik. Gjoni e shkruan librin e tij (nën frymëzimin e Shpirtit të shenjtë) si një simfoni ku kompozitori përsërit temën kryesore por me variacione: çdo variacion i shton diçka të re kompozicionit në tërësi. Stili semitik i Apokalipsit favorizon pikëpamjen, sipas së cilës vulat, trumbetat dhe gotat plotësohen njëkohësisht si vijon:

vulat	1	2	3	4	5	6	7
trumbetat			1	2	3	4	5
gotat						1	2

Kjo do të thotë se fatkeqësitë që sjellin vulat, do të shtrihen nëpër tërë periudhën e ngushticës së madhe, ato e trumbetave nëpër pjesën e dytë, kurse ato e gotave do të koncentrohen në fund, kështu që i shtatmi në çdo seri është identik dhe çon deri te kthimi i Mesisë. Tiparet e stilit semitik janë:

1. Përmbledhje e gjerë e ngjarjeve, të cilëve shtohen hollësitë me rikujtimet e mëtejshme të së kaluarës.
2. Kronologjikisht vegimet apokaliptike lëvizin tutje-tëhu me një shpejtësi që ngatërron mendjet tona perëndimore. P.sh. hyhet në temën

e martirizmit në 6,9-11, por zgjerohet në fragmentet që vijojnë: 12,13-17; 13,7-8.15; 14,13. Në 7,9-17 paraqiten turma e madhe shenjtërisht që dalin nga ngushtica e madhe, e kjo na çon deri te fundi i Ngushticës (shih 7,15-17; 21,3-4). Kap. 11 na çon, gjithashtu, deri te fundi i Ngushticës. Vegimi i kap. 12 na kthen në lindjen e Mesisë dhe shtrihet deri te fundi i Ngushticës (rr.14). Në 13,5, 42 muajt na çojnë përsëri deri te fundi i Ngushticës. Vegimi i 144.000 vetave që qëndrojnë bashkë me Qengjin në malin e Cionit (14,1-5) mund të plotësohet vetëm pas kthimit të Mesisë mbi tokë. Në 14,17-20 arrijmë deri te beteja e Harmagedonit, dhe kjo përsëritet në 16,16. Në fund, përshkrimi i plotë i betejës vjen në 19,11-21. Në dritën e këtij stili semitik, nuk na duket se vulat, trumbetat dhe gotat vijnë njëri pas tjetrit.

Vula e gjashtë na çon te katastrofa e fundit, kur të kthehet Mesia, sepse zemërimi i Qengjit është duke goditur keqbërësit, të cilët u bëjnë thirrje shkëmbinjve për t'i mbuluar (6,12-17). Dukuritë qiellore që ndodhin nën vulën e gjashtë janë pikërisht ato, për të cilat Jezusi tha se do të ndodhin **pas** Ngushticës dhe **menjëherë para** kthimit të tij (shih Mt 24,29-30). Këtej rrjedh se vula e shtatë ka të bëjë me kthimin e Mesisë.

Përsëri, pohimet e shprehura nën trumbetën e shtatë nuk mund të plotësohet derisa të vijë Mesia pas fundit të Ngushticës (11, 15-19). Sepse, mbretëritë e botës nuk do t'i takojnë Mesisë dhe ai nuk do ta fillojë sundimin e tij mbi to derisa të vijë vetë (rr. 15). Koha e zemërimit të derdhur mbi kombet do të ndodhë në betejën e Harmagedonit (rr. 18). Gjykimi i të vdekurve dhe shpërblimi i besimtarëve do të ndodhë pas Ngushticës. Prandaj është e qartë se edhe vula e shtatë edhe trumbeta e shtatë përputhen kronologjikisht.

Të gjitha shtatë gotat grupohen në fund dhe derdhen menjëherë para se të vijë (dhe kur të vijë) Mesia. Ato janë të fundat, sepse derdhen së fundi (15,1). Konkretisht, Harmagedoni përmendet me emër nën gotën e gjashtë (16,16) dhe ikja e ishujve dhe maleve (16,20) i përgjigjet vulës së gjashtë (6,12-17).

Vula e shtatë, trumbeta e shtatë dhe gota e shtatë nuk mund të ndahen, sepse përmbajtja e tyre identitike dhe tipari përfundimtar i tyre nuk mund të plotësohen tri herë! Kështu, zemërimi i Perëndisë nuk shtrihet nëpër tërë Ngushticën. Këto fragmente në librin e Apokalipsit që përmendin derdhjen e zemërimit hyjnor, kanë të bëjnë, më saktë, me **mbarimin** e Ngushticës.

HOLLËSITË:**a) Vulat, trumbetat dhe gotat:**

Vulat, siç duket, e kanë burimin në prishjen njerëzore:

Vula 1: militarizmi. Invadimi i Evropës nga lindja (Iran).

Vulat 2: luftëra, që rrjedhin nga militarizmi

Vula 3: zi buke, që rrjedh nga luftërat

Vula 4: vdekja, pasoja e zisë së bukës dhe shkatërrimit të tjerë të luftës

Vula 5: përndjekja dhe martirizmi i besimtarëve (të brezit të fundit të kishës).

Vula 6: fenomenet qiellore që, sipas Jezusit, do ta paraprijnë menjëherë kthimin e tij (Mk 13,24-26; Mt 24,29-30; Lk 21, 25-27).

Vula 7: heshtje në qiell, bubullima, vetëtima, dhe tërmeti.

Trumbetat, siç duket, rrjedhin nga veprimtari djallëzore.

Trumbeta 1: Breshra, zjarri (ose vetëtima), dhe gjak që sjellin si përfundim djegien e tokës.

Trumbeta 2: hedhja në det e vullkanit që shpërthen (malit të ndezur), që sjell si përfundim shndërrimin në gjak të një të tretë të detit dhe vdekjen dhe shkatërrimin e një të tretë të jetës dhe anijeve në det.

Trumbeta 3: Bjerja e meteoritit, të përshkruar si yll i zjarrtë që quhet Hidhërim, në një të tretë të furnizimit me ujë në terik (lumenjtë dhe burimet), e kjo i shndërron në ujë të hidhëruar dhe helmues. Shume veta vdesin.

Trumbeta 4: errësimi i diellit, hënës dhe yjeve me një të tretë.

Trumbeta 5: hapja e humnerës së pa fund nga një yll (Satani) që kishte rrënë në tokë, që sjell si përfundim torturën e njerëzve: djajtë krahasohen me karkalecat me bisht si akrepa.

Trumbeta 6: një fatkeqësi tjetër, në të cilën kalorësit djallëzorë vrasin një të tretë të njerëzimit.

Trumbeta 7: Kthimi i mbretërive të kësaj bote në mbretërinë e Krishtit: vetëtimë, bubullimë dhe tërmet, koha e gjykimit dhe shpërblimit.

Gogat simbolizojnë fatkeqësitë që e kanë burimin në zemërimin e Zotit.

Gota 1: lunga të këqija.

Gota 2: shndërrimi i detit në gjak, që sjell si përfundim vdekjes së jetës në det (intensifikimi i trumbetës ë dytë).

Gota 3. shndërrimi i të gjithë lumenjve dhe burimeve në gjak (intensifikim i trumbetës së tretë).

Gota 4: ngrohtësia e madhe

Gota 5: errësira dhe dhimbja

Gota 6: mbledhja e hordhive nga Lindja për betejën e Har-Megidonit në Izrael. Të gjitha kombet i afrohen Izraelit për ta shkatërruar, por Krishti e shpëton Izraelin pikërisht në kohë..

Gota 7: U krye!, tërmet, bubullim dhe vetëtima, dhe shkatërrimi i futive pagane.

Lufta shpirtërore: në librin e Apokalipsit shohim se si lufta vendimtare ndodh në qiell, midis forcave të Satanit (që mundën dhe përjash-tohen) dhe forcave të Zotit. Ndryshimet në qiell shkaktojnë automatikisht ndryshimet në tokë. Qielli konsiderohet si qielli i dytë, ku ndodhen engjëjt e Satanit. Për këtë arsye duhet jo vetëm një tokë e re, por edhe një qiell i ri. Në vegimin e fundit (6,12-17) bien trupat qiellore (që simbolizojnë forcat e Satanit) dhe zhduket qielli (banesa e tyre), sepse banorët tokës ende mbeten në jetë (rr. 15). Me fjalë të tjera, ngushtica e madhe paraqitet nën tiparet e kataklizmit të fundit që do të ndodhë vetëm në fund të mbretërimit të 1000 viteve (shih 20,11).

Babiloni: Babiloni simbolizon Romën, sepse Roma e kishte zëvendësuar atë si qendër e idhujtarisë, imoralitetit dhe përndjekjeve të popullit të Zotit. Kapitulli 17 thekson fenë e rremë të Romës pagane, kurse kapitulli 18 tregtimin dhe materializmin e atij qyteti. Ka shumë aluzione për profecitë e DhV (shih Isaia 13, 14, 46-48 (veçanërisht Jeremia 50, 51 si dhe profecinë kundër Tirit (Jehez. 26-28). Ndërsa Tiri kishte qenë ndërmjetës tregtar i madh i Lindjes, Roma ishte pazari i madh për ngarkesave të tyre. Ostia, si kryeport i Romës, ishte një nga qendrat tregtare më të madhe të perandorisë. Nuk kishte asgjë mëkatore për mallrat që përbënin tregtinë luksuoze të Romës, derisa prostituta e madhe t'i përdorte ato për ta mashtruar njerëzimin me një materializëm idhujtar. Natyrisht Babiloni simbolizon, gjithashtu, shoqëria njerëzore në formën e saj të fundit.

Babilonia karakterizohet nga të këqijat morale si vrasja, çoroditja, magji, imoraliteti, dhe vjedhja, të cilat janë vetëm simptomat e idhujtarisë së njeriut, e cila përbëhet në thelb nga refuzimi i tij të pranojë gjendjen e tij si krijesë si dhe varësinë e tij nga Krijuesi.

c) **Të korrat dhe të vjelat:** të korrat simbolizon dënimin e kombeve, kurse të vjelat shkatërrimin e kombeve të mbledhura në Izrael. Të dy ngjarjet ndodhin në fund të ngushticës, njëra pas tjetrës (Joel 3,13).

d) **Dasma e qengjit:** ndodh (shih 19,5-10) pas kthimit të Krishtit në

tokë.

dh) **144.000 të vulosurit prej Izraelit** (12 x 12 x 1000). Çfarë është identiteti i tyre? Ata do të jenë ose kisha e ngushticës së madhe, ose kandidatët izraelitë për kthimin e mëvonshëm të Mesija. Ata janë të vulosur për kursim nga katastrofat e ngushticës së madhe.

e) **Mbretërimi i 1000 vjetëve**: përshkruhet me hollësi vetëm në fund të librit (21,9-22,5). Besimtarët do të banojnë, bashkë me Krishtin, në Jerusalemin e ri, i cili do të ketë zbritur në tokë (21,10). Kështu, për besimtarët, gjendja e fundit fillon tashmë në kohën e mbretërimit të 1000-vjetëve, pas ringjalljes nga të vdekurit. Ringjallja presupozon një ekzistencë tokësore, por jo e kufizuar nga dimensionet tona të kohës dhe të hapësirës. Brenda qytetit të shenjtë nuk ka më tempull, ndryshim kombësie etj, por jashtë qytetit, ku banojnë paganët, është çështje tjetër.

f) Është me rëndësi të kujtohet se disa shprehje përdoren me kuptim të kufizuar. Fjala që përkthehet si „tokë“ (hebr. *erets*) shpesh do të thotë në të vërtetë toka e Izraelit, kurse fjala që përkthehet si „botë“ (gr. *oikoumene*) shpesh do të thotë bota romake. Deti do të shënojë Detin Mesdhe, të cilin e kufizon natyrisht perandoria romake.

KOMENTARI

Kapitulli 1 1,3 *I lumi ai që i lexon edhe ata që i dëgjojnë fjalët e kësaj profecie dhe i zbatojnë ato që janë të shkruara në të.* Kjo lumturi e dyfishtë përmban një direktivë që ky libër të lexohet në mbledhjet kishtare – para së gjithash, por jo ekskluzivisht në mbledhjet e shtatë kishave – dhe që dëgjuesit t’i kushtojnë vëmendje të veçantë, dhe që përmbajtja e librit të ushtrojë një ndikim vendimtar në jetesën e tyre.

1,9 Patmos – ishull shkëmbor në arkipelagun e e Sporadeve jugore të Detit Egje ku Gjoni ishte në mërgim

1,10 *Shpirti më pushtoi dhe e gjenda veten në Ditën e Zotit,*

Kjo ndoshta do të thotë se ra në ekstazë dhe ishte hedhur përpara në Ditën e Zotit, dhe kjo do të nënkuptojë se libri ka të bëjë me Ditën e Zotit, i cili ka të bëjë kryesisht me gjykimin (3,5 vitet e fundit të 70-të të shtatëdhjetë të Danielit) dhe një kohë provash për Izraelin (krh. 1 Sel. 5,4).

1,13 *dhe në mes të shandanave dikënd si Birin e njeriut, të veshur me petk të gjatë’ dhe të ngjeshur me brez arri (diagonalisht) rreth parzmës, Ecja e tij në mes të shandanave mund të kuptohet si kontrolli i gjendjes së tyre shpirtërore, një pas një.*

Në këta rreshtat e parë të librit, Jezusi përfytyrohet në shërbimin e tij trefishtë si profet, mbret dhe prift – si ndërmjetës i zbulimit të Atit (rr. 2), si ‘sundimtar i mbretërve të tokës (rr. 5) dhe si mbajtës i rrobës së kryepriftit (rr. 23). Fraza “të veshur me petk të gjatë dhe të ngjeshur me brez arri (diagonalisht) rreth parzmës” e identifikojnë Jezusin si prift mbretëror.

1,14. *flokët i kishte të bardhë pors i leshi i bardhë, pors i bora e sytë e tij pors i flaka e zjarrit*; Kjo na kujtohet për librin e Danielit kap. 7, por atje bëhet fjalë për Të Përjetshmin (rr. 9) kurse këtu bëhet fjalë për Mesinë e ringjallur. Ky transferim i attributeve hyjnore është karakteristik për librin e Zbulesës/Apokalipsit. Me këto përfytyrime përshkruhet në DhV Perëndia, por këtu përshkruhet Mesisë, sepse ai është veta e dytë e Trinisë.

1,17 *Unë jam i Pari dhe i Sprasmi*: Titujt e Perëndisë së Izraelit (rr. 8) i mban Krishti, i cili ka marrë nga Ati «emrin që është përmbi çdo emër» (d.m.th. emrin hyjnor – Fil. 2, 9). Shih edhe: Isaia 44,6 *Kështu thotë Zoti, Mbreti i Izraelit, Shpëtimtari i tij, Perëndia i Ushtrive*: »Unë jam i pari dhe unë i sprasmi, përveç meje Hyj tjetër nuk ka!. 41: 4; ... Unë jam Zoti, i pari, po edhe me të sprasmit jam! si dhe 48,12: *Më dëgjo, Jakob, Izrael, që të kam thirrur: unë, unë jam i pari edhe unë jam i sprasmi! S'ka asnjë titull hyjnor që Ati nuk i jep Krishtit të ringjallur, e jo për herë të parë, sepse kur Jezusi u ngrit në qiell, i rimori titujt e mëparshëm (shih. Gj 17,5: O Atë, tani ma kthe këtë madhësi që kisha tek ti para krijimit të botës!)*.

1:20 *engjëjt e shtatë kishave*: Ata që kanë përgjegjësi mbi kishat. Engjëlli është një qenie që ka përgjegjësi mbi një sferë të veçantë (9,11; 14,18; 16,5). Këtu do të thotë një pastor.

Kapitulli 2

2,1 *Ai që ecën midis shtatë shandanave të artë*:

Kjo lë të kuptojë se Jezusi rregullon fitilat dhe rimbush ullirin e shandanëve që të ndritin më mirë. Me anë të këtyre mesazheve drejtuar shtatë kishave. Me fjalë të tjera Jezusi i nxit për të ndrequr sjelljen e tyre, që të dëshmojnë më mirë për të. Në të njëjtën mënyrë te Gj 14 Jezusi flet për krasitjen e hardhive.

Efesi – kryeqyteti i krahinës romake të Azisë së vogël kur herët ishte përhapur kulti hyjnore e perandorëve.

2,2 *ata që pohojnë se janë apostuj, por nuk janë* d.m.th. të dërguarit – do të jenë ata që pretendonin të jenë dërguar nga kisha memë në Jeruzalem.

2,4. *Por kam diçka kundër teje: e le dashurinë tënde të mëparshme!* Megjithë durimin e tyre të lavdërueshëm, zjarri i dashurisë së tyre të mëparshëm

– dashurinë për të gjithë bashkëbesimtarët (Ef 1,15) – ishte pakësuar dhe asgjë duke përfshirë edhe veprat e mira ose doktrina e shëndoshe – s’ mund të zëvendësojë dashurinë hyjnore (gr. *agape*), frytin e Shpirtit të shenjtë, në komunitetin e krishterë; në qoftë se nuk ka ndryshim mendjeje dhe kthim në veprat e mëparshme të dashurisë, kjo kishë i ka ditët të numëruara: shandani i saj do të hiqet.

2,6 *Por e ke këtë të mirë: urren veprat e Nikollaitëve, të cilat i urrej dhe vetë. Nikollaitët ishin gnostikë. Duket se mësimi i tyre çonte në idhujtari dhe fëlliqështi.*

2,7. *Ngadhënjyesit do t’ i jap të hajë nga pema e jetës që është në parrizin e Hyjit D.m.th. do t’ i jap jetën e përjetshme.* Prejardhja e figurës gjendet te Zan. 2, 8 f.; 3, 22. Pema e jetës së Edenit në librin e Zanafillës ishte pasqyra tokësore e pemës së jetës në Jerusalemin e ri të mbinatyrshëm. Në të vërtetë të gjitha premtimet në fund të gjitha letrave ose i referohen posedimit të jetës së përjetshme ose përmbajnë një premtim se besimtari besnik do të mbretërojë bashkë me Krishtin.

2, 6 Nikollaitët ishin një sekt gnostik i dhënë spekulimeve dhe imoralitetit. Thuhej se ndanin gratë e tyre si dhe pasuritë e tyre.

2, 9 Ata që pretendojnë se janë hebrenj dhe nuk janë. Nuk është prejardhja nga Abrahami, por besimi te Mesia dhe vepra e tij që e bën një anëtar të popullit të Zotit, një argument që Gjon Pagëzori bën gjithashtu.

2,12 Edhe pse Efesi ishte qyteti më i madh në Azinë Romake, ishte Kryeqyteti që ishte kryeqyteti administrativ.

2,13 *E di ku banon — aty ku është froni i Satanit* Froni ku rri Satani do të jetë selia e kultit të adhurimit të perandorit romak, sepse shenjtërorja e parë të kultit vendas të Romës dhe të Augustit u themelua atje më 29 para Kr. Ka aludime të tjera për këtë kult gjetiu në librin e Zbulesës.

Të krishterëve u duhej të zgjedhin o të adhurojnë Krishtin Zot ose Cezarin Zot.

2,14 *Por kam diçka pak kundër teje: janë disa te ti që e ndjekin mësimin e Balaamit, i cili e udhëzoi Balakun t’ u vinte leqe të izraelitëve për të ngrënë mishin e flijuar idhujve dhe të jepen pas fëlliqështisë.* Në fjalorin biblik kush adhuron idhujt bën fëlliqështi – kororëshkelje kundër besnikërisë ndaj Perëndisë së vërtetë. Sipas një tradite hebre Balaam e mësoi Balakun t’ i bëjë izraelitët të kalojnë në idhujtari ngashnjyer nga moavasit.

2,17. *Ngadhënjyesit do t’ i jap manën e fshehur:* Ky është një kompensim i bollshëm për heqjen nga ushqimi kushtuar idhujve. Mana e fshehtë është arketip qiellor i manës që ushqenin izraelasit në shkretëtirë. Ndër çifutët qarkullonte shumë mesim për këtë manë të fshehur në qiell, që

do të zbulohet në fund të kohës (së tanishme) dhe do t'u jepej besnikëve. (shih 2 Bar. 29,8). E quajnë bukën e engjëjve (Ps. 78,25) ose 'bukën e Perëndisë' (Jn 6,33); në dritën e mësimit për bukën e jetës te Gj Jn 6,27 +. mund ta kuptojmë manën e fshehur si një sinonim për jetën e përjetshme. Sipas një tradite hebre, Jeremia e fshehu pas shkatërrimit të tempullit arkën e besëlidhjesme çka kishte brenda, edhe manën.

...do t' i jap edhe një gur të bardhë dhe mbi gur të shkruar një emër të ri që askush nuk e njeh përveç atij që e merr. Kuptimi i kësaj figure është i paqartë, por mund të shënojë një guralec me mbishkrim (Gk. *psephos*) që shërbente si biletë hyrjeje në gostinë qiellore. Atletit në lojëra sportive që fitonte i jepej një rrasë mermeri të bardhë si shenje të fitores. Mund të nënkuptojë gjithashtu një guralecë të dhënë në fund të një gjykimi për dikë që gjendet i pafajshëm. Një emër i ri tregon për një natyrë të re.

Furnizuesit e hajmalive magjike e dinin se si me rëndësi ishte fshehja e emrit të fuqisë: fuqia e emrit të Jezusit nuk mund të apelohej nga fuqitë magjike, por është i njohur në jetën e shërbëtorëve të Tij.

2,18 Tiatira – qendër tregtar e zejtar jo e madhe në udhën Pergam – Sard

2,20 *Por kam diçka kundër teje: e duron Jezabelën — një grua që thotë për vete se është profeteshë.* Emri i saj nuk është në të vërtetë Jezabela, por ajo është ashtu e përshkruar për shkak të lehtësisë të kushteteve të dekretit apostolik ose për kompromise të mëtejshme me paganizmin (shih rr. 14) e vuri në gjendjen e pasardhësit të Jezabelës së Dhiatës së Vjetër, kulti i Baalit i cili karakterizohej nga idhujtari dhe prostitucioni ritual.

2,20 Jezabela – pseudoprofeteshë enikollaiteve.

2,24. '*të ashtuquajturat »thellësi« të Satanit:* Sikurse ekziston urtësia qiellore që shqyrton thellësitë e Perëndisë (1 Kor. 2: 10), ashtu ekziston një urtësi e rreme që premtonte të hapë thellësitë, por thellësitë e Satanit. Ka aludim për mësim gnostik.

...nuk ju vë tjetër barrë, por atë që keni: – d.m.th. përveç asaj të vënë nga këshilli apostolik i Jeruzalemit (shih Veprat 15,28).

2,28 *Dhe do t'ia jap Yllin e Dritës.* Kjo shprehje duhet kuptuar në lidhje me Zb 22, 16, ku Jezusi e quan veten Ylli i ndritshëm i mëngjesit!', aludim për yllin mbretëror që do të dalë nga Izraeli, i parashikuar nga Balaami (hebr. Bilami) te Num. 24, 17. Besimtari ngadhëjmtar, do të ndajë sundimin mbretëror të Zotit të tij ngadhëjmtar (cf. 3, 21).

Kapitulli 3

3,5 *Kështu edhe ngadhënjyesi do të mbajë petka të bardha; nuk do ta fshij emrin e tij prej librit të jetës dhe do ta dëshmoj emrin e tij para Atit tim dhe para engjëjve të tij.*

Në vitin 85, çifutët i kishin shtuar liturgjisë së tyre fragmentin që vijon: «Që nazareasit (d.m.th. të krishterët) dhe heretikët e tjerë të shkatërrohen dhe të fshihen nga Libri i jetës.» Libri i jetës është regjistri i qytetarëve të Jeruzalemit të ri mbinatyror.

Në dritën e këtij fakti mund të shqyrtohen referime të tjera (2,9; 3,5):

I di edhe fyrjet e atyre që thonë se janë çifutë, e nuk janë: janë sinagoga e Satanit!

.....NUK do ta fshij emrin e tij prej librit të jetës dhe do ta dëshmoj emrin e tij para Atit tim dhe para engjëjve të tij. Disa dekada më vonë, çifutët e Smirnës do të luanin një rol të shquar në sulmin kundër Polikarpit, epishkvit të Smirnës. Denuncimi i të krishterëve nga ana e çifutëve shënon mjerisht fillimin e antisemitizmit.

3,7 I shënjti, i vërteti. Mesisë i jepen atributet që i jepeshin Perëndisë

3,10 *Meqë e zbatove urdhrin tim për të qëndruar besnik, edhe unë do të ruaj në kohën e provës së rëndë, e cila do të lëshohet së shpejti mbi mbarë botën për t'i vënë në provë të gjithë njerëzit.* Parafjala greke e përmendur këtu është ek (të kalojë me sukses) e jo apo (të ikë nga). (khz. Apok 7,14: *Këta janë ata që kanë ardhur nga sprova e rëndë dhe e madhe*). Teksti hebraik ka: *bëjom masa* (në ditën e provës)

3,11 *Do të vij së shpejti!* Në qoftë se merret parasysh profecia te libri i Danielit te kap. 9 për 70 javët pa marrë parasysh epoka e kishës (boshllëkun midis javës së 69 dhe javës së 70), atëherë ardhja e Tij është me të vërtetë e shpejtë.

3,12. *Ngadhënjyesin do ta bëj shtyllë në tempullin e Perëndisë tim dhe prej andej ai s' do të dalë më kurrë!* Këtu ndryshon figura e shtyllës: shtylla bëhet adhuruesi në tempull, i cili, ndryshëm nga shtyllat e tempujve tokësorë që mund të lëvizin për shkak të tërmeteve të shpeshta të Filadefisë, nuk do të dalë nga fundi i saj.

Në të do ta shkruaj emrin e Perëndisë tim edhe emrin e qytetit të Perëndisë tim, të Jeruzalemit të ri, që zbret nga qielli, prej Perëndisë tim, edhe Emrin tim të ri. Ngadhënjimtari ka një emër të trefishtë: ai i Perëndisë, ai i Jeruzalemit të ri, dhe ai i Krishtit. Krhs. 2, 17; 14, 1

3,14 Laodiceja – qytet i njohur për pasuri dhe për medicinë.

Ameni – në DhV atribut që i jepet vetëm Perëndisë. Në DhR i jepet Mesisë.

Kapitulli 4 na jep një vegim për Perëndinë në qiell ku adhurohet.

4,4. 24 pleqtë janë këshilli qiellor (Dn 7,9-10). Këta janë engjejt, të cilët, të ngjashëm me 24 rradhët e priftërve and levitëve, kushtojnë adhurim qiellor (1 Kron 24,5-7; 25,1-3).

4,6 Katër gjallorët simbolizojnë katër engjejt që rregullojnë botën lëndore.

4,8. Katër gjallorët janë engjejt, të cilët identifohen me katër serafimët tek Ezek 1,18.

4,10. Etiketa e oborrit romak kërkonte prej nënmbretërve që të ulla kuroret (e jo kezat) e veta para perandorit "hyjnor" (shih Tacit *Analët* 15,29). Për të mbajtur paralelin, 24 pleqtë duhet të kenë ulur kuroret, e jo kezat e tyre. Përveç kësaj fjala hebre e origjinalit është *atar*, e cila shënon: kurorë, kezë.

4,11. "Zot dhe perëndi" janë titujt që përdorte perandori romak për vetveten.

Kapitulli 5 është në të vërtetë shërbesa e shugurimit të Mesisë, ku merr mandatin e tij – një pergamë, përmbajtja e së cilës vetëm ai është në gjendje ta zbatojë.

5,5 Luani, Pinjollit, Rrënja e Davidit janëtribute që në DhV i jepeshin Mesisë.

5,8. Shenjtorët janë ata që menjaherë përdorimin dhe pronën e Mesisë.

5,9. *Këndonin një këngë të re*: Kënga është e re në krahasim me këngën e lashtë të krijimit të rr. 4,11 (krhs. Job 38, 7). *Ti je i denjë ...* : Motivet i lindjes me të cilat përshendetën perandorët romakë përfshinin terme të tilla si: *'Ti je i denjë dhe Ai është i denjë për të trashëguar mbretërinë;* por vetëm një person është i denjë të trashëgojë sundimin botëror, dhe ai e ka fituar këtë të drejtë për shkak të bindjes së tij ndaj Atit dhe vdekjes së tij pajtuese.

5,13. Mesisë, et jo perandorit romak, i përkasin pushtet suprem dhe adhurim qiellor.

Kapitulli 6 është në të vërtetë parashikim i mbarë periudhës së ngushticës së madhe që përfundon me zjarr dhe me ardhjen e Mesisë.

Brenda këtij parashikimi duhen t'u përfshirë, pra, të gjitha seritë e mëvonshëm të plagave: të gjitha mbarojnë në ditën e Zotit, që menjëherë paraprin ardhjen e Krishtit.

6, 2. *një kalë i bardhë* Fakti se ky kalorës është i pajisur me një hark (porsi harkëtarët kalorës të ushtrisë parte) lë të kuptojë një invadim nga kufiri lindor i mbretërisë romake.

6, 13. *Yjet e qiellit ranë mbi tokë*: krhs. Mk 13, 25: Bëhet fjalë ose për një rrebesh meteoritësh ose për shembjen e autoritetit.

6, 14. *Qielli u mbështoll porsi libri kur mbështillet*: krhs Isa. 34, 4. *U shkatërrua mbarë ushtria e qiellit, u shtrrotullua porsi libër qielli shkëputen, bien të gjithë yjet e tij, siç bie gjethi i hardhisë, porsi gjethi i thatë i fikut.*

...dhe çdo mal e ishull ndërroi vend.: Bëhet fjalë për një ngatërrim kozmik, ndoshta edhe për një sprasmë ose një trazirë politike Shih edhe Jer.4: 23-26, ku bëhet fjalë për shkatërrimin e shkaktuar nga pushtuesit e huaj. Shikoj tokën: është shkretë, e zbrazët, shikoj qiellin: ka mbetur pa dritë! Shikoj malet: dhe, ja, po dridhen, shikoj kodrat: të gjitha po tunden! Këqyri përreth: s' shoh me sy njeri, shpendët e qiellit të gjithë u larguan! Këqyri: toka e pëlleshme u bë shkretëtirë, qytete të tëra grumbuj rrënojash

6,17. *sepse arriti Dita e madhe e zemërimit të tyre! Kush mund të qëndrojë përballë?» krhs. Jl 2: 11. Edhe Zoti bëri të dëgjohet zëri i tij në krye të ushtrisë së vet. Vërtet është e madhe ushtria e tij, e fortë edhe zbatuese e urdhrat të tij! Vërtet është e madhe Dita e Zotit, shumë e tmerrshme, kush mund t'i bëjë ballë? Ky zemërim është shpagim, reagimi i Tij ndaj së keqës së botës rebele. Është vepra e tij e çuditshme, kundër vullnetit të tij të parë për të shpëtuar; atje ku refuzohet oferta e tij të mëshirshme, s'ka alternativë tjetër.*

Kapitulli 7 na kthen në fillimin e kap. 6, por na flet për vulosjen e shërbëtorëve të Perëndisë para fillimit të katastrofave të përshkuara në kap. 6.

Disa do të kuptonin 144.000 (12 x 12 x 1000) dhe 'turma që askush nuk mund ta numëronte' si i njëjti grup – si kisha e përfytyruar në mënyrë simbolike. Disa të tjerë mendojnë se 144.000 përfaqësojnë Izraelin, kurse turma e madhe jo kishën (e cila, siç mendojnë, tashmë do të jetë rrëmbyer), por të shpëtuarit gjatë ngusticës së madhe. Figura citohet nga libri i Ezekielit, kur besimtarët vulosen para se të fillojë masakrimi. Ata përfaqësojnë sigurisht mbarë Izraelin (të rilindur) që do të trashëgojë tokën e premtuar. Kthimi shpirtëror i tyre ndodh më vonë, në fund të kohës së persekutimit.

Mund të konstatojmë se në librin e Zbulesës ka theks të veçantë në martirët dhe posaçërisht martirët çifutë, të cilët do të përballojnë goditje kryesore të persekutimit. Janë martirët heronjtë e librit, dhe kjo ishte me rëndësi të veçantë për kishën e hershme. Kënga e krishterë e lashtë *Te Deum*, bën aludim për ushtrinë bujare martirësh. Ringjallja e tyre (te kap. 20) nuk përjashton të krishterët e tjerë, siç e dimë nga fragmentet e tjera të Shkrimit në DhR (p.sh. 1 Kor 15).

7,14 Prova e madhe. Përndjekja e Neronit ishte është prototipi i çdo përndekje

Ka gjykime të tjera ku perandoria e egërsisë është qëlluar, por qytetarët e saj refuzojnë të pendohen.

Kapitulli 8 fillon me një interval kur mblidhen lutjet e popullit të Perëndisë për hakmarrje dhe i kushtohen Perëndisë.

8, 2 Sikurse viti i ri judaik inaugurohet me brirjen e trumbetave (Lev. 23, 24; Num. 29, 1), ashtu edhe Dita e Zotit shpallet me brirjen e trumbetave (cf. Isa. 27, 13; JI 2, 1; Mt. 24, 31; 1 Kor. 15, 52; 1 Th. 4, 16).

Ky kapitull bashkë me kapitullin 9 flasin për katastrofat e shpallura me brirjen e trumbetave që janë pasojë e këtyre lutjeve.

Kapitulli 10 përmban një interval deri në brirjen e trumbetës së shtatë, dhe kjo na çon te pika ku ishim në fund të kap. 6 (vula e shtatë) , d.m.th. deri në Ditën e Zotit, pak para kthimit të Mesisë.

Kapitulli 11 na çon te Izrael dhe pas kësaj bien trumpeta e shtatë (rr. 15-19). Na njoftohet për herë të parë për periudhën prej 3,5 vitesh, ku ka dëshmi drejtuar Izraelit dhe populli i Zotit (ata që adhurojnë në oborri i brendshëm të Tempullit) ndahet nga renegatët (oborri i jashtëm i tempullit).

11,13 Ata lavdëruan madhësitinë e Perëndisë të qiellit. Ashtu si në Josh 7:19 dhe Jer 13:16, kjo ndoshta përfshin pendimin dhe rrëfimin e mëkatit.

Kapitulli 12 vazhdon të përqendrohet te ngjarjet në Izrael. Flet për mbrojtjen e tepricës besimtare të Izraelit gjatë persekutimit të tmerrshëm i shkaktuar nga diktatori evropian dhe homologu i tij izraelas, antikrishti (mesia e rremë). Satani dëbohet nga qielli, kështu që Izraeli të bëhet kombi i rilindur, i cili do ta udhëheqë botën në adhurimin e Perëndisë së vërtetë, kombi nga i cili Mesia do të sundojë mbi mbarë botën.

12, 6. *Gruaja iku në shkretëtirë*: Megjithëse aludohet për të ardhmen (3,5 vitet), diçka e ngjashme i ndodhi kishës palestineze. Kisha iku në Jordan për t'i ikur persekutimit nga perandoria romake.

Te **kapitulli 13** na paraqiten dy egërsira – diktatori i konfederatës evropiane (që del nga deti, mjedisi pagan) dhe antikrishti, sundimtar i Izraelit, i cili e përkrah egërsirën e parë dhe e nxit Izraelin ta adhurojë si mirëbërësi i tij. Ky i fundit del nga toka, d.m.th. toka e Izraelit dhe shënon mesinë e rremë.

13,1 shënon kërkesat e një perandori të mëvonshëm për nderimet hyjnore.

13, 18. 666. Ka të ngjarë njeriu (6) që hiqet si perëndi (x 3). Alternativat e parashtruara janë si vijon: shumë përgjithshme e shkronjave greke ose hebraike (çdo shkronjë në këto gjuha kishte një vlerë numerike). Kështu 666 = Neron Cesar. Ky shifrim paraqitet te dokumenti aramaik nga sundimi i Neronit të gjetur në Wadi Murabba'at, në Jordan.

Kapitulli 14 është një interval. Duke parashikuar sundimin mijëvjeçar të Mesisë, në vegim ai qëndron në malin e shenjtë, kur do të kthehet

Krishti, kurse rreth tij qëndrojnë 144.000 të shpëtuarit nga Izraeli. Në qoftë se pranojmë këtë interpretim, atëherë rr. 3 duhet kuptuar si vijon: “Vetëm ata 144.000 të çliruar nga toka (e Izraelit) me pagimin e jetës së Mesisë mund ta mësonin këtë këngë.”

Pastaj shpallet rënia e Babilonisë – perandorisë së egërsirës.

Kapitulli përfundon me figurën e dy të korrave. Të dy të korrat simbolizojnë shkatërrimin e fuqive pagane që arritën për të shkatërruar Izraelin (shih Joel 3,13). Beteja ndodhet në tokën e Izraelit: përmasat e përshkruara (300 km) u përgjigjen kufijve jugore dhe veriore të Izraelit.

Kapitulli 15 e parashikon popullin e Zotit të sigurt në praninë e Perëndisë, pasi kanë kundërshtuar me sukses egërsirën. Pastaj përgatitet një seri e re katastrofash.

15, 8 Shentërorja është e paarritshme, sepse koha e mdërmjetësisë ka marrë fund.

Kapitulli 16 i përshkruan këto katastrofa që përfundojnë në të njëjtën pikë të katastrofave të mëparshme, kësaj here me betejën e Harmagidonit.

16, 15 Sipas Mishnës, kapiteni i rojës së tempullit në Jerusalem u binte qark rrethinave të tempullit natën, dhe në qoftë se gjente një rojtar në gjumë, i hiqej teshat që digjeshin, dhe e dëboi lakuriq. krhs. 3,18.

16, 16 Harmagedon ishte bërë simbol për disfatën e ushtrive të mëdha, p.sh e ushtrisë së Joshijës.

Thatësia e Eufratit ua hapi rrugën partëve për të pushtuar perandorinë romake.

Kapitulli 17 përshkruan prostitutën e madhe që përfaqëson kultin idhujtar të perandorit romak dhe ekvivalentin e tij të mëvonshëm.

17, 2 *me të cilën bënë fëlliqshti mbretërit e tokës*: d.m.th. mbretërit e tokës kanë lidhur traktate ekonomike dhe politike me pasoja të kobshme: ata detyrohen të adoptojnë kultin e perandorit.

dhe u dehën me verën e fëlliqshtisë së saj banuesit e dheut: krhs. 14: 8; aludim për mbizotërimin romak të botës mesdhetare.

17, 5 Ty titull ishte shkruar në ballën e saj:

Misteri shënon emrin që mban prostituta. Kjo nuk duhet kuptuar fjalë-përfjalshëm, por alegorisht: shkruhet Babilonia e madhe, por kuptohet Roma (krhs. rr. 9, 18).

nëna e lavireve dhe e të gjitha kobësive të botës: aludim për përqendrimin e idhujtarisë, besëtytnisë dhe vesës në qytetin perandorak.

17, 9-11: *Këtu kërkohet mendje e hollë. Shtatë kokët janë shtatë kodrat* (e Romës) *ku rri Gruaja* (kulti idhujtar i perandorit). Shtatë kokët janë shtatë kodrat ku rri Gruaja; janë gjithashtu edhe shtatë perandorë: ¹⁰pesë ranë

(Augusti, Tiberi, Gaj, Klaudi dhe Neroni), njëri është (Vespasiani), kurse një tjetër (Titi) *ende s'erdhi, por, kur të vijë, do të qëndrojë pak kohë* (sundoi vetëm dy vjet). *Po edhe Egërsira që ishte e nuk është, edhe ajo është i teti perandor* (Titi i mëvonshëm – egërsira e parë), është një në numrin e të shtatëve (ky është trupëzimi i të tjerëve të mëpasshëm) dhe shkon në humbje (shih Dan 9,26-27).

....*Po edhe dhjetë brirët që ti pe, janë dhjetë mbretër që ende nuk e kanë marrë mbretërinë, por do ta marrin pushtetin si mbretër vetëm për një orë bashkë me Egërsirën: Krhs Dan 9, 24-27:*

Në kohën e mërgimit të izraelitëve në Babiloni, Danieli e pyeti Perëndinë për kohën e ardhjes së Mesisë dhe për kohën e fillimit të mbretërisë së tij. Engjëlli (lajmëtari) Gabriel solli përgjigjen nga Perëndia që vijon: *Është përcaktuar për kombin tënd dhe për qytetin tënd të shenjtë (Jerusalem) 70 periudha prej 7 vitesh deri në pendimin e kombit; deri në mbarimin e rebelimit; deri në mbarimin e rendit të vjetër dhe deri në fillimin e rendit të ri, dhe deri në pastrimin e Tempullit. Dëgjo dhe kupto, që nga koha kur doli urdhri që të rindërtohet Jerusalemi (dekreti i Artakserksit në v. 444 p.e.s.) deri në ardhjen e Mesisë, janë caktuar 7 periudha prej 69 vitesh (= 476 vjet sipas llogaritjes sonë) dhe në fund të kësaj periudhe...do të zhduket Mesia dhe s'do t'i ketë pasardhës. Pas kësaj, qyteti dhe tempulli do të shkatërrohen prej udhëheqësit (gjeneralit romak me emrin Tit) që do të vijë. E deri në mbarim do të ketë shkatërrim dhe katastrofa. Ai (diktatori evropian) do ta lidhë besëlidhjen me shumicën (me renegatët izraelitë nën udhëheqjen e mesisë së rremë) për 7 vjet. E pas kalimit të gjysmës së kësaj periudhe, ai do të ndalojë vazhdimin e flijimeve (në Tempull). Në majin e Tempullit do të paraqitet shtatorja e atij që shkakton shkretim. (Daniel 9,24-26).*

Kapitulli 18 jep hollësitë rreth rënies së Babilonisë, e cila simbolizon perandorinë romake të egërsirës.

Vazhdon tema e rënies së Babilonisë, por tani paraqitet si shkatërrimi i qytetit të madh tregtar (siç ishte Tir): në kohën e Gjonit Roma ishte qendra e tregtisë botërore.

Kapitulli 19 parashikon inaugurimin e erës mesianike – e përfytyruar si gostia e Qengjit. Pastaj vijon ndërhyrja e Mesisë për të mundur fuqitë pagane dhe të rimëkëmbur Izraelin në vendin e duhur sipas qëllimeve të Perëndisë.

19,13 Veshja e zhytur në gjak nuk do të jetë gjaku i Krishtit, por gjaku i armiqve të tij që ai po asgjëson (shih Isaia 63.1-6). Rabinët thanë se Perëndia do të vishte një mantel të tillë kur ta shpëtonte Izraelin dhe të mundë armiqtë e tij. Veshja e zhytur në gjak e identifikon atë si hakmarrës të gjakut. Ne duhet të interpretojmë DR në dritën e DV.

Kapitulli 20 flet për dekretin qiellor që urdhëron rimëkëmbjen e Izraelit duke përfshirë sundimin e Mesisë me kishën e tij, megjithatë vëmendja tërhiqet mbi martirët. Përshkrimi i mijëvjeçarit lihet për më vonë në kap. 21-22, sepse vijon menjëherë përshkrimi i kryengritjes në fund të mijëvjeçarit, si dhe përshkrimi i Gjyqit të Fundit.

20, 7 Gogu e Magogu ishin fillimist fise skite, por rusët e sotëm.

Kapitulli 21 dhe pjesa e parë të kap. 22, përshkruan mijëvjeçarin ku tërhiqet vëmendja mbi Jerusalemin e ri, ku sundon Mesia me kishën e tij. Vetëm 21,1-8 përshkruan gjendjen përfundimtare pas mijëvjeçarit, ku s' do të jetë më pasosuri, vdekja ose njerëz të pa rilindur.

Kjo shihet nga fakti që Jeruzalemi i Ri zbret nga qielli në dy raste: së pari në fillim të mijëvjeçarit (21,10) dhe më pas në fillim të gjendjes përfundimtare (21,2).

21, 1 Deti për çifutët simbolizonte ndarje (e jo, sipas grekëve, mjet komunikimi): përveç kësaj deti simbolizon edhe rebelim të pareshtur. (krhs. Job 38, 8-11; Ps. 89, 9; Isa. 57, 20).

21, 8. *Por frikacakët, tradhtarët dhe të çoroditurit, vrasësit dhe të pabesët, falltarët dhe idhujtarët, si dhe të gjithë ata që largohen nga e vërteta, i pret liqeni që digjet me squfur të zjarrtë.*» Kjo është vdekja e dytë.

... Në mënyrë tipike, lista e atyre që përjashtohen nga bekimet e krijimit të ri, fillon me ata që nga frika kanë mohuar fenë përballë persekutimit.

21, 16. Qyteti që përshkruan Gjoni është një kub, i ngjashëm me shenj-tëroren e brendshëm të tempullit (1 Mbret. 6, 20) dhe me Jerusalemin qiellor në traktatën talmudike *Baba Bathra* 75b.21:24 Mbretërit e botës do të sjellin dhuratat e tyre kur ata vijnë çdo vit në Jeruzalem për të ripërtërirë besnikërinë e tyre ndaj Mesisë (shih Zak 14,16-19).

Kapitulli 22 përfundon me apelimin e fundit për të pajtohen me Perëndinë tani, para se to jetë tepër vonë, sepse, kur të vijë papritur fundi, do të jetë tepër vonë për t'u penduar (22,11): të këqijtë do të përforcohen në të keqën e tyre, kurse të drejtët në drejtësinë e tyre (krhs. Dan. 12, 10).

Fundi po afrohet në kuptimin se epoka e kishës (midis javës të 69 dhe asaj të 70 në Dan 9), nuk merret parasys.

TABELA E LIBRAVE TË DHIATËS SË VJETËR SIPAS RENDITJES SË BIBLËS HEBRAIKE

SEKSIONI I PARË me emrin **LIGJI** (hebraisht *Tora*). Fjala Tora do të thotë Mësimi themelor i fesë (izraelite). Emrat e librave janë si vijojnë:

Zanafilla
Dalja
Kodi priftëror (Levitiku)
Regjistrimet (Numrat)
Besëlidhja e ripërtërirë (Ligji i përtërirë)

SEKSIONI I DYTË me emrin **PROFETËT** (hebraisht *Nëviim*). Ky seksion mban këtë titull sepse autorët ishin profetët, d.m.th. njerëzit që shkruanin të frymëzuar nga Shpirti i shenjtë. Ky seksion është ndarë në dy pjesë:

a) Profetët e parë, librat e të cilëve janë si vijojnë:

Joshua
Gjyqtarët
Libri i parë dhe Libri i dytë i Samuelit (Samuelit)
Libri i parë dhe Libri i dytë i Mbretërve

b) Profetët e mëvonshëm. Librat janë si më poshtë:

Isaia (Isaia)
Jeremia (Jeremia)
Jëhezkel (Ezekieli)
Dymbëdhjetë Profetët librat e të cilëve janë më të shkurtër. Ata janë:
Hoshea (Ozea), Joeli, Amosi, Ovdaja (Abdia), Jona, Miha (Mikeja), Nahumi, Havakuku, Cëfanja (Sofonia), Hagai (Hagjeu), Zëharja, Malahi.

SEKSIONI I TRETË me emrin **SHKRIMET** (hebraisht: *Këtuvim*), shprehja që do të thotë Shkrimet e tjera. Ato janë:

Psalmet
Fjalët e urta
Ijovi (Jobi)
Aty ka një nënndarje të quajtur «Rrotullat»:-
Kënga e Këngëve (hebraisht: *Shir ha-Shirim*) ose Poema më bukur
Ruta
Vajtimet (hebraisht: *Ejha*)
Koheleti (Predikuesi)
Eстера
Danieli
Ezra

Nehemja
Libri i parë dhe libri i dytë i Analeve (Kronikave)

DORËSHKRIMET E DHIATËS SË VJETËR

Një fragment nga libri i Regjistrimeve (6,24-26 – bekimi priftëror) gjetur pranë Jerusalemit, i cili datohet që nga shekulli i shtatë para erës sonë.

Rrotulla e Librave të Samuelit, gjetur në Kumran, datohet që nga viti 250 para erës sonë.

Rrotulla e Librit të Isaisë, gjetur në Kumran, që u përket viteve 100-150 para erës sonë.

Papirusi i Nashit datohet që nga shekulli i dytë para erës sonë. Përmban dhjetë urdhërimet dhe kredon izraelite.

Fragmentet e disa teksteve të gjetur në depon e sinagogës (geniza) të Kajros i përket shekullit të pestë të erës sonë

Kodi i Kajros datohet që nga shekulli i nëntë i erës sonë. Pastaj vjen kodi i Alepposë, dhe kodi i Leningradit i cili datohet prej v. 1008, prej familjes së Ben Asherit.

Kodi i Reuchlinit nga familja e Ben Naftalit.

Ekzemplari më i vjetër i pesëlibërshit samarian i shek. të 13. të erës sonë.

PËRKTHIMET E DHIATËS SË VJETËR NGA ANTIKITETI

GREQISHT: Septuaginta (250-150 p.e.r.), përkthimi i Akvilit (130-140 e.r.), përkthimi i Simakut (170 e.r.); përkthimi i Teodotionit (200 e.r.); tekstet e Origenit (Heksaflat) (240-245 e.r.)

ARAMAISHT: Targumët – parafrizat e leximeve hebraike të sinagogës.

SIRISHT: pshitta (përkthim i thjeshtë, d.m.th. jo parafrzim) u kushthohet çifutëve të kthyer në Adiabene (Asirinë e mëparshme).

LATINISHT: përkthimi i Septuagintës; Vulgata e Ieronimit

KRIKKA TEKSTUALE

S'ka dyshim se ndër dorëshkrime janë vjedhur gabime ortografike. Dhe kjo nuk është vështirë të kuptohet, sepse kopistët duke kopjuar tekstet, s'kanë pasur para tyre tekstin hebraik me zanoret, dhe kanë bërë edhe gabime në shkrim, përsëritje, mungesa e përsëritjes, ndërrimi i shkronjave, bashkimi i fjalëve, ndarje të gabuar të fjalëve, kuptimi i gabuar i diktimit të fjalëve që kanë tingëllim të afërt, leximi i gabuar i shkronjave më trajtë të afërt, kapërcimi i paragrafit duke filluar ose duke mbaruar me të njëjtën fjalë si paragrafi që vijon. Autografi ishte pa zanore si tekstet e tjera hebraike. Zanoret u shtuan vetëm në Mesjetë duke përdorur traditat e mbetura mes çifutëve që nga lashtësia, por këto tradita nuk dolën 100% të sakta! Kjo do të thotë se disa herë (p.sh. ku kuptimi s'është i qartë) i duhet rikthyer tekstit nën dritën e përkthimeve më të lashta. Në këtë drejtim numrat paraqitin një problem të veçantë, sepse një ndryshim i vogël (pothuajse një pikë) mund të modifikojë numrin me faktor dhjetë. Përveç kësaj, ndryshimi i zanoreve midis bashkëtingëlloreve shpeshherë ndryshon rrënjësisht kuptimin e fjalëve!

Përveç kësaj, dihet se shkruheshin me dorë në material të vështirë siç është papirusi dhe pergamena. Por kritika e tekstit ka arritur ta rivendosë tekstin aq sa vetëm mund të dëshirohet dhe ia ka afruar autografit në mënyrën më të mundshme. Kritika tekstuale merr parasysh jo vetëm dorëshkrimet në gjuhën hebraishte (teksti masoretik dhe pesëlibërshi samaritan), por edhe ato të përkthimeve të vjetra të greqishtes, latinishtes, dhe sirishtes. Shumica e përkthimeve bashkëkohore e marrin parasysh kritikën tekstuale, por s'është kështu me përkthimet më të vjetra, dhe kjo do të thotë se këto s'janë doemos më të sakta. Nga ana tjetër, ka rrezik që kritika tekstuale të shkojë disa herë tepër larg duke u bazuar në supozime dhe jo në parime të rrepta të gjuhësisë. Në këtë punë delikate ekuilibri është i nevojshëm.

TABELA E LIBRAVE TË DHIATËS SË RE

KATËR UNGJIJT janë:

Ungjilli sipas Mateut
 Ungjilli sipas Markut
 Ungjilli sipas Lukës
 Ungjilli sipas Gjonit
 VEPRAT E APOSTUJVE

LETRAT (E APOSTUJVE)

Letrat e Palit: Letra drejtuar Romakëve, Letra e parë drejtuar Korintasve, Letra e dytë drejtuar Korintasve, Letra drejtuar Galatasve, Letra drejtuar Efesianëve, Letra drejtuar Filipianëve, Letra drejtuar Kolosianëve, Letra e parë drejtuar Selanikasve, Letra e dytë drejtuar Selanikasve, Letra e parë drejtuar Timoteut, Letra e dytë drejtuar Timoteut, Letra drejtuar Titit, Letra drejtuar Filemonit,
 Letra drejtuar Hebrenjve (d.m.th. çifutëve të kthyer),
 Letra e Jakobit
 Letrat e Pjetrit: Letra 1 e Pjetrit, Letra 2 e Pjetrit
 Letrat e Gjonit: Letra 1 e Gjonit, Letra 2 e Gjonit, Letra 3 e Gjonit
 Letra e Judës

APOKALIPSI**DORËSHKRIMET GREKE TË DHIATËS SË RE**

Fragmenti i ungjillit sipas Markut (6,52-53) dhe fragmenti nga Letra e parë e Palit drejtuar Timoteut (3,16-4,1) gjetur ndër rrotullat e Detit të Vdekur datohen që nga viti 50 i erës sonë (d.m.th. 20 vjet pas vdekjes së Krishtit)

Fragmenti i ungjillit sipas Gjonit (18,31.37) datohet që nga viti 125 i erës sonë

Kodi Vatikan: shek. i katërt
 Kodi Sinaitik: shek. i katërt
 Kodi Aleksandrin: shek. i pestë
 Kodi Efrem:
 Kodi Beza
 Kodi Klaramontan.

Dorëshkrime të Dhiatës së Re kemi sot nëpër biblioteka të botës, 5.000 copë në gjuhën greke, ndër të cilat ato më të vjetrat janë në papirus, kurse të tjerat në pergamenë.

Edhe pse nuk u ruajt autografi, përsëri me siguri mund të jemi më të

sigurtë se për çdo libër të antikitetit, sepse teksti që kemi sot, është po ai i autografit. Madje mund të pohojmë se, në krahasim me tekstet e vjetra të kohës, asnjë tekst nuk mund të matet me tekstin e DhV as përse i përket numrit të dorëshkrimeve, as përse i përket kohës që më fort i afrohet autografit.

DORËSHKRIMET HEBRAIKE TË DHIATËS SË RE

Këto do të jenë dorëshkrimet origjinale të të paktën tri librave të DhR, mbi të cilat janë themeluar përkthimet greke, por të cilat kanë mbetur në rrethe çifute. Këto janë Ungjilli sipas Mateut (dorëshkrimet e quajtura Crawford dhe Shem Tov), Letra drejtuar Hebrenjve dhe libri i Apokalipsit. Sipas Klementit të Aleksandrisë Luka ishte ai që përktheu origjinalin hebraik në greqisht, gjë që shpjegon stilin e tij grek të shkëlqyeshëm.

PËRKTHIMET E TEKSTIT GREK

LATINISHT: Vulgata e Ieronomit, por ka edhe 44 përkthime më të vjetra të njohura si *Vetus Itala*.

SIRISHT: me interes për ne janë, jo vetëm se janë shumë të vjetra, por edhe se janë të shkruara në gjuhën që ka lidhje më të ngushtë me aramaishten që fliste Jezusi. Përkthimi sirian më i njohur është Pshitta nga shekulli i pestë. Ka edhe dorëshkrime siriane më të vjetra me emrin *Syra sinaitica* dhe *Syra Cureton*.

KOPTISHT: ka disa përkthime në këtë gjuhë që e flitnin të krishterët e parë egjiptianë.

KANUNI Apostulli Gjon shkroi librat e fundit të NT dhe ndoshta e mbylli kanunin, ashtu si Ezra kishte shkruar librat e fundit të OT dhe e kishte mbyllur kanunin. Sidoqoftë Etër të caktuar të Kishës ende kishin dyshime rreth një ose dy librave dhe çështja nuk u zgjidh përfundimisht deri shumë më vonë.

367 Në Ëindje në Letrën Festale të Athanasit Lindor rendit kanonin e plotë të Dhjatës së Re (27 libra) për herë të parë

397 Në Pëndim në Këshillin Perëndimor të Kartagjenës vendos kanonin e Dhiatës së Re (27 libra)

Të dyja këto data shënojnë kohën kur u ri-konfirmua kanuni origjinal i shekullit të parë.

TABELA KRONOLOGJIKE E PERIUDHËS SË DHIATËS SE

VJETËR (VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM)

Periudha e mbizotërimit egjiptian

2091 Mbërritja e Avrahamit në Kënaan

1876 Mbërritja e Jakovit në Egjipt

1446 Dalja e Izraelit nga Egjipti

1406 Pushtimi i tokës së Kënaanit

1375-1051 Periudha e sundimit të Gjykatësve në Izrael

Pushteti suprem i Izraelit nën mbretërit David dhe Solomoni

1010-970 Sundimi i Davidit

970-931 Sundimi i Solomonit

966 Tempulli i parë

931 Ndarja ndërmjet mbretërisë veriore (Izraelit) dhe asaj jugore (Judës)

850 Shërbimi i profetit Joel në Judë, kurse shërbimi i profetëve Elija dhe Elisha në Izrael.

883 Fillimi i ekspansionizmit asirian

Periudha e mbizotërimit asirian

760 Fillimi i mbizotërimit asirian

750-700 Shërbimi i profetëve Isaia, Mihaja, Jona, Amos dhe Hoshea

721 Mërgimi i mbretërisë veriore (Izraelit) në Asiri

626 Fillimi i dinastisë babilonase

Periudha e mbizotërimit babilonas

640-600 Shërbimi i profetëve Jeremia, Cefanja, Habakuk, Nahum dhe Obadja

605 Mërgimi i parë babilonas i mbretërisë jugore (Judës). Nisja e Danielit. 70 vjetët e profecisë së Jeremisë llogariten qysh nga kjo datë (Jr 25,11)

597 Mërgimi i dytë babilonas. Nisja e profetit Ezekiel

587 Mërgimi i tretë babilonas

539 Rënia e Babilonisë

Periudha e mbizotërimit persian

538 Dekreti i perandorit persian Kir (Ezra 1,1-4). Fillimi i kthimit nga mërgimi. Fundi i periudhës së 70 vjetëve të profecisë së Jeremisë.

537 Themelimi i Tempullit të Dytë (Mbarimi më 515). Rilindja e shtetit

izraelit fetar.

520-400 Ndërtimi i Tempullit. Shërbimi i profetëve Malahi, Zakaria dhe Hagai.

458 Vizita e parë e Ezrës në Jerusalem

445 Dekreti i perandorit persian Artakserks: rindërtimi i mureve të Jerusalemit (Neh 2,1-9). Rilindja e shtetit izraelit politik. Fillimi i profecisë së Danielit për 70 periudhat prej 7 vjetësh. 483-473 Periudha e përmendur në librin e Esterës. Vizita e parë e Nehemisë në Jerusalem.

438 Vizita e dytë e Ezrës në Jerusalem.

433 Vizita e dytë e Nehemisë në Jerusalem.

Periudha e mbizotërimit grek

331-323 Izraeli në perandorinë greke të Lekës së Madh. Pas vdekjes, perandoria ndahet ndërmjet generalëve të Lekës

323 Izraeli nën mbizotërimin e perandorisë greke në Egjipt (Lagidët)

200-142 Izraeli nën mbizotërimin e perandorisë greke në Siri (Seleukidët)

166-160 Periudha e çlirimtarëve izraelit Makabe. Lufta çlirimtare kundër mbizotërimit të Seleukidëve. 166 Rikushtimi i Tempullit.

150-163 Sundimi i pasardhësve të çlirimtarëve Makabe / Johan Hirkanit, mbretëreshës Aleksandra etj.

Periudha e mbizotërimit romak

68 Fillimi i mbizotërimit romak

63 Gjenerali romak Pompe pushton Jerusalemin.

Ngritja e Antipatit, atit të Herodit

37 Romakët emërojnë Herodin e Madh

30 Vetëvrasja e Antonit dhe e Kleopatrës, mbretëreshës së Egjiptit

20 Fillimi i rindërtimit të Tempullit të Dytë (mbarimi më 64 të erës sonë).

7 Regjistrimi në Jude nën Saturnin, legatin e Sirisë (i cili vazhdon regjistrimin e Kuirinit që zgjati nga v. 12 deri në v. 6?)

5 Lindja e Jezusit

koniunksionët në tre raste e planetëve Saturn dhe Jupiter.

4 Vdekja e Herodit

TABELA KRONOLOGJIKE KRAHASUESE E LASHTËSISË

Krijimi i botës

5099 Krijimi i Adamit
 4969 Lindja e Kainit
 4924 Lindja e Shetit
 4819 Lindja e Enoshit
 4729 Lindja e Kenanit
 4659 Lindja e Mahalelit
 4594 Lindja e Jeredit
 4432 Lindja e Henokut
 4367 Lindja e Metushelahut
 4180 Lindja e Lamekut
 3998 Lindja e Noahut
 3860 Lindja e Tubal-kainit

3398 Përmbytja e madhe

3048 Vdekja e Noahut

[Sistemi i datimit të mësipërm vjen nga përkthimi grek i Dhiatës së Vjetër (Septuaginta). Sistemet e tjera llogaritin krijimin e Adamit nga 6984 deri në vitin 3616. Vetëm me ardhjen e teorisë së evolucionit kjo periudhë u ul në sferën e «prahistorisë». Njerëzit e lashtësisë, përkundraz, e merrnin seriozisht datimin e kësaj periudhe. Pse jo edhe ne?]

Të tjerët do t'i datojnë këto ngjarje si më poshtë:

2000 Nga Adami te Abrahami
 2000 Nga Abrahami tek Krishti
 2000 Nga Krishti te kthimi i Tij

Banorët e parë të rrafshinës së Mesopotamisë arrijnë nga veriu

Kulla e Babilonit – ngatërrimi i gjuhëve, pas përpjekjes së kryengritjes kundër Perëndisë.

Nimrodi – themeluesi i qyteteve të mëdha; Babilon, Uruk, Akad, Ninave. Fillimi i sistemit të parë të paganizmit të organizuar.

3000-2000 Periudha sumeriane. Themelimi i shteteve-qytet; Kish, Uruk, Akad, Lagash, Ur, Uma. Princi Lugal-Zagisi, sundimtari i Umës, i bashkon të gjitha shtetet-qytet sumeriane.

2360-2305 Sargoni (Sharrum-Kin) nga Akadi e mposht Lugal-Zagisin dhe vjen në fuqi. Dinastia e tij zgjat gjer më 2180

3000-2778 Në Egjipt, periudha tinite dhe bashkimi i provincave veriore dhe jugore, nën sundimin e Menesit. Dinastia e parë dhe dinastia e dytë

2778-2100 Perandoria e vjetër me kryeqytet në Memfis. Dinastitë nga

e treta deri në të dhjetën. Ndërtimi i piramidave në Sakarë dhe në Gize.

Që nga 2600 luftërat civile dhe rënia

2500 Qytetërimi i parë i Minosit në Kretë

2000 Fillimi i qytetërimit grek në Troadë dhe në Kretë

2500 Qytetërim i parë i njohur në Indi, në luginën e Indusit. Ky qytetërim u shkatërrua më vonë nga pushtimi i arianëve (d.m.th. një degë e horasve dhe mitanasve) që futën sistemin e kastave.

2500 Dinastia e parë (Hia) e njohur në Kinë e vendosur në luginën e lumit Huang-Ho.

2150 Pushtimi i tokës së Sumerit nga gutët – një popull malësor (kurdët e sotëm).

2166 Lindja e Avrahamit

2070 Mbreti Ur-Namu i dëbon gutët dhe themelon dinastinë e tretë në Ur.

2091 Vdekja e Terahut në Haran (në Turqinë e sotme juglindore).

Nisja e Avrahamit nga Harani.

2090 Vizita e Avrahamit në Egjipt.

2066 Lindja e Izakut

2006 Lindja e Jakovit (Jakob-Izraelit)

2000 Shteti i fuqishëm elamas në krahinën e Gjirit të Persisë. Elamasit semitik, në fund, mbizotërojnë shtetet Akad dhe Sumer. Në 1960 ata pushtojnë qytetin Ur. Më në veri, amorasit sulmojnë dhe pushtojnë tokën. Dinastitë rivale në Mari, Larsë, Ashur. Në këtë kohë shkruhen poema për Krijimin (Enuma Elish) dhe poezi për Përmbytjen (Gilgamesh). Shkruhen, gjithashtu, kodet civile të mbretërve Lipit-Ishtar dhe Isin (në 1875) dhe në 1940 kodi i mbretit Bililama nga Eshnuna.

2000 Fillimi i perandorisë së parë hitase në Anadollinë qendrore (Turqia e sotme qendrore).

1991 Në Egjipt themelohet dinastia XII nga Amenemheti I me kryeqytet në Tebes. Ekspansionizmi i fortë. Marrëdhënie të forta ndërmjet Egjiptit dhe Mesopotamisë.

1900 Josefi (një nga bijtë e Jakovit) shitet skllav.

1894-1878 Faraoni Sesostris II në fuqi në Egjipt. Josefi i shpjegon ëndrrat dhe emërohet guvernator i Egjiptit.

1878-1843 Faraoni Sesostris III – politika ekspansioniste shpie mbizotërimin egjiptian deri në Shehem, në Kënaan.

1876 Mbërritja e Jakovit në Egjipt. Fillimi i 430 vjetëve të qëndrimit të Izraelit në Egjipt deri në marrjen e pushtetit nga faraoni Amenehmet III.

1806 Vdekja e Josefit

1800 Fillimi i shtetit Mitani (nga hurrianët dhe mitanasit) i vendosur ndërmjet hitasve dhe egjiptianëve. Me kalimin e kohës ata pushtuan Sirinë, Anadollinë jugore dhe Mesopotaminë para së të munden nga asirët, më 1150. Tabelat Nuzi (kodi akadian) tregojnë ndikimin e fortë hurriane).

1748-1716 Shamshi-Adadi I, themeluesi i perandorisë së parë asiriane në Mesopotaminë e sipërme.

1728-1676 Në Babiloni, Hamurabi, mbreti i gjashtë i dinastisë amorase, dëbon elamasit dhe bashkon vendin. Qytetërim i shkëlqyeshëm. Kodi i Hamurabit. Tabelat Mari (korespondenca ndërmjet Hamurabit dhe Zimri-Limit, mbretit të fundit të Mariut). Më 1625 elamasit dhe hitasit mposhtin dinastinë e Hamurabit.

1730 Sundimi i dinastisë semit Hiksos në Egjipt. Favorizimi i izraelitëve, me të cilët janë të afërm. Kryeqytet në Avaris, afër tokës Goshen (ose Raamses) ku banonin izraelitët.

1600 Në Greqi zhvillimi i qytetërimit micen (të akasve) që mori fund më 1100.

1580-1548 Faraoni Amosis, themeluesi i dinastisë së re, dëbon hikso-sët. Ai është «mbreti i ri që nuk e njihte Josefin» (shih Dalja 1,8). Egjiptianët ngarkojnë hebrenjtë me punë të detyrueshme.

1548-1528 Faraoni Amenopnis I (Amenhotepi). Politika e gjenocidit ndaj izraelitëve (shih Dalja 1,21)

1528-1520 Faraoni Tutmosis I

1526 Lindja e Moisiut (Moisiut)

1520-1505 Faraoni Tutmosi II

1505-1483 Regjenca e Hatshepsutës (bijës së faraonit? shih Dalja 2,5)

1500 Kulmi i perandorisë Mitanni (shtet butoir midis hitasve dhe egjiptianëve).

1500 Fillimi i perandorisë babilonase që mori fund me sulmin e kasitëve më 1180.

1505-1450 Faraoni Tutmosis III. Fushata në Palestinë (Kënaan) dhe në Siri. Ndërtimi i gjerë i qyteteve-depo për qëllime ushtarake në Pitom dhe në Ramses. Kryeqyteti i tij ishte në Thebes.

1450 Shkatërrimi i qytetërimit minoan në Kretë me anë të shpërthimit vullkanik. Fillimi i shpërnguljes së pëlishtasve (filistenjve).

1450-1425 Faraoni Amenopis II. Faraoni në kohën e Daljes. Dobësimi i pushtetit; s'ishte në gjendje të bënte një fushatë ushtarake midis vitit të pestë (1445/6) dhe vitit të nëntë, sigurisht për shkak të humbjes së forcave

të tij koçish elite në Detin e Kuq.

1446/5 Dalja

1425-1408 Faraoni Tutmosis IV (biri i dytë i të atit, Amenopisit II).

1406/5 Pushtimi izraelit i Palestinës (Kënaanit) nën komandën e Joshuas

1400 Tabelat Ras-Shamra në Ugarit (dëshmi për kulturën kënanase dhe fenikase)

1375-1051 Periudha e gjykatësve në Izrael

1365-1336 Otnieli – shtypja e mesopotamasve nën Kushan-Rishataim

1319-1240 Ehudi – shtypja e moavasve (1336-1319) – Egloni

Shangari – shtypja e filistenjve

1240-1201 Dëvora – shtypja e kananasve (1260-1240)

1194-1155 Gidoni – shtypja e madianasve (1201-1194)

1200 Zhvillimi i pushtetit filiste

1154-1131 Tola

1131-1107 Jairi

1089-1083 Jiftahu – shtypja e amonasve

1083-1076 Ivcani

1076-1066 Eloni

1066-1051 Avdoni

1071-1051 Shimshoni – shtypja e filistenjve

1040 fillimi i shërbimit të Samuelit

1030-1010 Shauli

Çdo periudhë shtypjeje i përgjigjet zakonisht dobësisë së hegjemonisë egjiptiane në Palestinë.

1300 Kodi civil hitas në Hatusas afër Ankarës së sotme.

1290 Rënia e Troadës nga pushtuesit akas – grekët e vjetër.

1150 Mbarimi i qytetërimit miken pas sulmeve të dorëve. Akasit ikin dhe kolonizojnë Akadinë, Atikën dhe Jonin (në Azinë e vogël). Përparimi i dorëve në Greqi dhe në ishujt e saj. Ata futin një regjim të bazuar në qytete (*polis*) që zëvendëson idenë e fisit (*genos*) dhe zhvillojnë mitologjinë e tyre (perënditë, heronjtë etj.). Dalngadalë mbizotërojnë dy qytete greke; Sparta (me regjim ushtarak) dhe Atina (me regjim tregtar-detar).

TABELA KRONOLOGJIKE E MBRETËRVE IZRAELITË

Shauli 1030-1010
Davidi 1010-970
Solomoni 970-931

MBRETËRIT**E JUDËS**

Rëhavami (931-913)
Avija (913-911)
Asa (911-870)
Jëhoshafati (870-848)
Jëhorami (848-841)
Ahazja (841)
Atalia (841-835)
Jehoashi (835-796)
Amacja (796-781)
Uzija (781-740)
Jotami (740-736)
Ahazi (736-716)
Hizkija (716-687)
Mënasheu (687-642)
Amoni (642-640)
Joshija (640-609)
Jëhoahazi (609)
Jehojakimi (609-597)
Jehojahini (597)
Cidkija (597-587)

MËRGIMI NË BABILONI

MBRETËRIT**E IZRAELIT****Jaravami I** (931-910)

Nadavi (910-909)

Basha (909-886)

Ejla (886-885)

Zimriu (7 ditë)

Omriu (885-874)

Ahavi (874-853)

Ahazja (853-852)

Jëhorami (852-841)

Jehu (841-814)

Jëhoahazi (814-798)

Joashi (798-783)

Jaravami II (783-743)

Zëkarja (743)

Shallumi (743)

Mënahemi (743-738)

Pekahja (738-737)

Pekahu (737-732)

Hoshea (732-724)

MËRGIMI NË ASIRI**DINASTITË JASHTËBIBLIKE**

PERANDORIA ASIRIANE

883-859 Ashurnasirpal II
 858-824 Shalmanezzer III
 (853 beteja e Karkarit)
 823-811 Shamshi-Adad
 810-783 Adad-Nirari III
 782-773 Shalmaneser IV
 772-756 Ashurdan
 755-745 Ashurnirari V
 744-727 Tiglat-Pilezer III
 726-722 Shalmanezzer V
 721-705 Sargon II
 704-681 Senaheriv
 680-669 Esarhaddon
 668-630 Ashurbanipal
 629-612 Sinsharishkun
 (612 rënia e Ninaves)
 612-609 Ashuruballit
 (609 rënia e Haranit)

PERANDORIA BABILONASE

626-605 Nabopolasar
 605-562 Nabokadnecar II
 562-560 Amel-Marduk
 (Evil-merodah
 (562 rob lufte, Jehoahini, favori-
 560-556 Neriglisar
 556 Labashi-Marduk
 556-539 Nabonidi, Belshacar
 (bashkësundimtarë 549-539)
 (539 rënia e Babilonit)

PERANDORIA PERSIANE

539-530 Kir
 530-522 Kambys

522-486 Dariu
 486-465 Kserksi
 464-423 Artakserksi I
 423-404 Dariu II
 404-338 Artaksersi II
 359-338 Artaksersi III
 338-336 Arsi
 336-331 Dariu III
 331-323 Aleksandri

EGJIPTI

945-715 Dinastia XX
 945-924 Shoshenk (Shishak)
 716-664 Dinastia XXV
 716-702 Sahabako (Shabaka)
 702-690 Shebitku (Shabataka)
 690-664 Tarharka (Tirhaka)
 664-525 Dinastia XXVI
 664-656 Tanvetamani
 (Tanutamem)
 664-610 Psametik I
 610-595 Neko II
 595-589 Psametik
 589-570 Apries (Hofra)

EGJIPTI NËN GREKËT

332-323 Aleksandri i Madh
 323-285 Ptolemeu I
 285-246 Ptolemeu II
 246-221 Ptolemeu III
 221-205 Ptolemeu IV
 205-180 Ptolemeu V
 180-145 Ptolemeu VI
 145 Ptolemeu VII
 145-116 Ptolemeu VIII
 51-30 Kleopatra VII
SIRIA NËN GREKËT
 312-281 Seleuku I
 281-261 Antioku I

261-246 Antioku II
 246-226 Seleuku II
 226-223 Seleuku III
 223-187 Antioku III
 187-175 Seleuku IV
 175-164 Antioku IV Epifan
 164-161 Antioku V
 161-150 Demetri I
 150-145 Aleksandri Balas
 145-138 Demetri II
 145-142 Antioku VI
 142-138 Trifon
 138-129 Antioku VII
 129-125 Demetri II
 128-123 Aleksandri II

**Dinastia e hashmonasve në
Izrael**

142-143 Jonatani
 143-134 Simoni
 134-104 Gjon Hirkani
 104-103 Aristobuli I
 103-76 Aleksandër Janai
 76-67 Hirkani II
 67-63 Aristobuli II
 63-40 Hirkani II
 40-37 Antigoni

**TABELA KRONOLOGJIKE E
KOHËS SË DHIATËS SË RE**

Periudha e mbizotërimit romak
68 Fillimi i mbizotërimit romak
63 Gjenerali romak Pompe
 pushton Jerusalemin.

Ngritja e Antipatit, atit të
 Herodit

37 Romakët emërojnë Herodin
 e Madh

30 Vetëvrasja e Antonit dhe
 Kleopatrës, mbretëreshës së
 Egjiptit

AUGUSTI perandor (27 p.e.r –
 14 e.r.)

20 Fillimi i rindërtimit të
 Tempullit të Dytë (mbarimi në
 vitin 64 të erës sonë).

7 Regjistrimi në Jude nën
 Saturnin, legatin e Sirisë (i cili
 vazhdon regjistrimin e Kuirinit që
 zgjati 12-6?)

5 Lindja e Jezusit

Koniunksionët në tre raste të
 planetëve Saturn dhe Jupiter.

4 Vdekja e Herodit? Ndarja e
 mbretërisë së tij midis tre bijve të
 vet: Arkelaut, Herod Antipës dhe
 Filipit.

6 Rrëzimi i Arkelaut,
 sundimtarit të Judesë dhe
 Samarisë. Judeja bëhet provincë
 romake, e sunduar drejtpërdrejt
 nga Roma, me Cezarenë si
 kryeqytet.

6-15 Hanani, i biri i Shetit,
 kryepriфт

7 Lindja e Shaulit (Palit) në Tars.

TIBERI perandor (14-37)

15 Valeri Grat e ndërron

Hananin. Tre kryepriфтërinj, pastaj
 Jozefi i quajtur Kajfa (Hetuesi).

26-36 Ponc Pilati qeveritar
 romak në Jude

27 Herod Antipa, që është
 martuar me të bijën e Aretës, merr
 për grua Herodinë, gruan e vëllait
 të vet Herodit (të birit të
 Mariamnës II).

27 Fillimi i shërbimit të Gjon
 Pagëzorit

27 Vjeshtë: predikimi i Gjon
 Pagëzorit dhe fillimi i mësimin të
 Jezusit

29 Gjon Pagëzorit, burgosur në
 Makeront, i presin kokën.

33 Hyrje mesianike në
 Jerusalem. Fundi i periudhës së 69-
 të të profecisë së Danielit. Vdekja
 e Jezusit.

«Në kohën e sundimit të Tiberit,
 Ponc Pilati e dënoi me vdekje
 Krishtin» (Taciti, *Analet*).

34 ose **36** Martirizimi i Shtjefnit.
 Pak më vonë, kthimi i Palit

KALIGULA perandor (37-41)

36 Jonatani, biri i Hananit,
 emërohet kryepriфт në vend të
 Kajfës

37 Themelimi i kishës
 (bashkësisë) së Antiokisë.

KLAUDI perandor (41-54)

41 Ungjilli sipas Mateut
 aramaisht. Projekti i parë i ungjillit
 sipas Gjonit ?

43 Projekti i parë i ungjillit sipas
 Markut?

43 Pjetri në Samari dhe në

rrafshinën bregdetare

44 Agripa I urdhëron t'i pritët koka Jakobit, të vëllait të Gjonit; gjatë festës Pjetrit e fut në burg.

47 Herodi nga Kalkida emëron Hananjën kryeprift (Veprat 23,7)

Kusp Fadi qeveritar (44-46). Teuda Profeti i rremë (Veprat 5,36)

46-48 Udhëtimi i parë misionar i Palit: Antiokia, Qiproja, Antiokia e Pisidisë, Listra...Antiokia

48 Zia e bukës në Jude që ashpëron edhe më shumë viti shtunor. Helena, mbretëresha e Adiabenes, e kthyer në judaizëm, viziton Jerusalemin dhe i sjell popullsisë ndihma.

48 Pali dhe Barnaba ua sjellin besimtarëve, në Jude, ndihmën e bashkësisë së Antiokisë.

Vendimi i Këshillit të Jerusalemit: Të kthyerit nga paganizmi janë të lirë nga Ligji (Veprat 15,5; Gal 2,1)

49 Klaudi dëbon çifutët nga Roma, të cilët të nxitur për shkak të predikimit të Jezusit si Mesi, bëjnë trazira.

Letra e Jakobit?

51 Letra e parë e Palit drejtuar selanikasve.

49-51 Udhëtimi i dytë misionar i Palit: Listra, Frigjia, Galacia, Filipet, Selaniku, Athina

52-60 Antoni Feliks, qeveritar. Ai martohet me Drusilën, motrën e Agripës II, që ishte e martuar më parë me Azizin, mbretin e Emesës. (Veprat 24,24)

53-58 Udhëtimi i tretë misionar i Palit. Apoloni në Efes, pastaj në Korint.

NERONI perandor (54-68)

54-57 Pasi erdhi nëpër Galaci dhe Frigji, Pali qendron dy vjet e tre muaj në Efes. Pas 56: Letra Filipianëve. Rreth Pashkës 57: Letra e parë korintasve, pastaj një vizitë e shkurtër Korintit, 2 Kor 12,14. Kthehet në Efes dhe shkruan Letrën galatasve.

Fundi i 57: përshkon Maqedoninë, shkruan Letrën e dytë Korintasve. Dimri **57-58**: Pali në Korint (Veprat 20,3); Letra romakëve

Pashka 58: Pali në Filipe (Veprat 20,6), pastaj udhëton nëpër det për në Cezare.

Verë 58: Pali në Jerusalem

Jakobi, vëllai i Jezusit, në krye të bashkësisë judeo-kristiane.

Feliksi në Malin e Ullinjve shpërndan shoqërinë e profetit të rremë egjiptian. (Veprat 21,38). Urdhëron të vritet kryeprifti Jonatan.

Rrëshajët 58: Palin e arrestojnë në Tempull dhe e çojnë para Hananit dhe Këshillit të Lartë. Në Cezare del në gjyq para Feliksit

58-60 Pali i burgosur në Cezare

60 Palin e futin në gjyq para Festit. Pali apelon në Cezarin. Mbrohet në praninë e Agripës dhe motrës së tij Berenikës.

Vjeshtë 60: Udhëtimi i Palit për në Romë. Stuhia, dimërimi në Maltë.

61-63 Pali në Romë nën rojën ushtarake. Letrat e tij: kolosianëve, efesianëve, Filemonit, filipianëve.

Ungjilli sipas Lukës?

62 Kryepriifti, Hanania, urdhëron të vritet me gurë Jakobi, vëllai i Jezusit. Shimoni, (i biri i Klopës dhe i Marisë, kushërirs së nënës së Jezusit) trashëgon Jakobin në krye të kishës së Jerusalemit.

Agripa II e shfronon Hananinë

63 Çlirimi i Palit dhe ka mundësi të ketë shkuar për në Spanjë (Rom 15,24)

64 Letra I dhe II të Pjetrit dhe Ungjilli sipas Markut

Digjet Roma dhe fillon përndjekja e të krishterëve

Martirizmi i Pjetrit

65 Pali në Efes (I Tim 1,3), në Kretë (Tit 1,5), në Maqedoni, nga ku dërgon Letrën e tij të parë Timoteut (I Tim 1,3) dhe ndoshta edhe Letrën Titit.

66 Kryengritja e çifutëve në Aleksandri. Tiber Aleksandri vret disa mijëra kryengritës.

Në Jerusalem, Flori kryqëzon çifutë, por një kryengritje e detyron ta lëshojë qytetin. Trazira në Cezare dhe në mbarë vendin.

Cest Gali sulmon Jerusalemin, por tërhiqet me shumë humbje. Kryengritësit emërojnë qeverinë e vet.

Ikja e bujarëve të qytetit dhe sigurisht e të krishterëve që strehohen në Pelë.

67 Vespaziani me 60.000 ushtarë pushton Galilenë (zihet rob Jozefi, udhëheqësi i kryengritësve, që me vonë quhet Flav)

Letra drejtuar hebrenjve? Pali i burgosur në Romë ia dërgon Letrën e dytë Timoteut. Pak më vonë ia presin kokën.

GALBA perandor (68)

67-68 Zelotët dhe idumenjtë bëhen zotërinjtë e Jerusalemit, vrasin Hananinë dhe bujarët.

Vespaziani pushton rrafshinën bregdetare dhe luginën e Jordanit (rrënimi i Kumranit). Për shkak të vdekjes së Neronit e shtyn rrethimin

e Jerusalemit.

VESPAZIANI perandor (69-79)

69 Vespeziani pushton pjesën tjetër të Judesë. Thikëtarët qendrojnë në Jerusalem, në Herodion, në Macadë dhe në Makeront.

70 Pashkët: shumë pelegrinë në Jerusalem. Pak më vonë Titi e rrethon qytetin me katër legjione.

Fundi 70: Rrënimi i Jerusalemit

Shumë çifutë vriten në lojërat e gladiatorëve

73 Gjenerali romak F.Silva rrethon Macadën: Elazari (pasardhës i Jëhudës galileas) dhe thikëtarët e tij vrasin shoqishoqin për të mos u dorëzuar.

Rabin Gjon ben-Zakai themelon akademinë e Javnës (Jamnia) e cila merr rolin e Këshillit të Lartë.

Ndërmjet 70 dhe 80: Letra e Judës.

TITI perandor (79-81)

DOMICIANI perandor (81-96)

95 Apostulli Gjon në mërgim në Patmos. Libri i Apokalipsit

NERVA perandor (96-98)

TRAJANI perandor (98-117)

100 Në fillim të sundimit të Trajanit në Efes apostulli Gjon vdes.

110 Letra e Plinit të Ri, legatit të Bitinisë, për përndjekjen e të krishterëve.

117 Kryengritja e çifutëve në mbarë Lindjen dhe trazira në krahinat e reja.

HADRIANI perandor (117-138)

130 Hadriani në Jerusalem: vendos të rindërtohet qyteti (Aelia Capitolina) dhe Tempulli që do t'i kushtohet Jupite-rit.


132-135 Kryengritja II çifute.

Shimon Ben Koseba pushton Jerusalemin: Elazari bëhet kryepriфт. Rabin Akiva mban Ben Kosebën për Mesinë dhe Yllin nga Libri i Regjistrimeve 24:17 nga i vjen mbiemri: Ben Kosiba (i Biri i Yllit). Ky përndjek të krishterët sepse nuk duan t'i bashkangjiten kryengritjes.

Jerusalemi pushtohet. Pasi merr rreth 50 kështjella, Severi pushton Beterin ku vritet Bar Kokeba (gusht 135).

Robërit u shitën në Mamre dhe në Gazë.
 Krahuina e Judesë bëhet krahuina Siria-Palestina, kurse Jerusalemi koloni romake në të cilën çifutët nuk guxojnë të hyjnë.
161-180 Valë përndjekjeje nga Mark Aureli
191-211 Valë përndjekjeje nga Septim Severi
250-313 Përndjekjet sistematike nga perandorët Deci, Valeriani dhe Diokletiani
313 Urdhërimi i lirisë fetare nga Konstantini dhe Licini
391 Krishterimi shtetëzohet nga Graciani dhe Teodosiu.

Gjenealogjia e Jezusit



FJALOR BIBLIK ETNOGRAFIK

AKAD

Akad ishte një nga qytetet kryesore, së bashku me Babilonin dhe Erekun, që themeloi Nimrodi (Zan 10,10). Quhej edhe Agade.

Mbishkrimet tregojnë se atje lulëzoi një dinasti e hershme semitike e themeluar nga Sargoni I (rreth 2350) . Në atë kohë Akadi kontrolloi tërë territorin e Sumerit (Babiloninë jugore) dhe ushtritë e tij depërtuan deri në Siri, Elam dhe Anadollinë jugore. Falë tregtisë së madhe dhe lulëzimit që pasoi pas sundimit të Sargonit dhe pasardhësit e tij, Naram Sinit, dinastia e Akadit u bë simbolike për epokën e artë. Më vonë, kur Babilonia u bë kryeqytet, emri Akad vazhdonte të përdorej për të shënuar mbarë Babiloninë veriore deri në epokën e mëvonshme persike në regjistrimet e Asirisë dhe Babilonisë.

Gjuha akade përdoret për të shënuar gjuhët semitike të Asirisë dhe Babilonisë, kurse dialekti i dinastisë akadiane quhet akadian i vjetër.

Kronologjia e sundimtarëve akadianë

Sundimtar	Kronologji emesme para Kr.
Sargoni	2334–2279
Rimushi	2278–2270
Manishtushu	2269–2255
Naram-Sini	2254–2218
Shar-Kali-Sharri	2217–2193
Ndërsundim	2192–2190
Dudu	2189–2169
Shu-turul	2168–2154

AMARNA

Amarna ishte sinonimik me Akhetaten, kryeqytetin egjiptian të faraonit Amenofis IV (Akhenaten) dhe pasardhësve të tij (rreth 1375-60).

Amarna është enjohur për letrat e Amarnës – letërkëmbim ndërmjet vasalëve kananas dhe zotërinjve të tyre egjiptianë. Në këtë letërkëmbim zbulohen intrigat ndërmjet sheteve qytetërore dhe hitasve. Gjithashtu bëhet fjalë për popullin që quhet Hapiru që disa ekspertë identifikojnë me hebrejtë, dhe që i sulmojnë këto qytete. Por ky identifikim varet nga datimi i këtyre letrave. Letrat e Tell El Amarnës (korespondencë mes vasalëve kananas dhe zotërinjve të tyre egjiptianë) siç duket, pajtohen me kohën e Pushimit të Palestinës nga ana e izraelitëve në 1400. Ky datim pajtohet gjithashtu me dëshmitë arkeologjike dhe shpjegimet biblike. Në këto letra lutet shumë për ndihmë (posaçërisht për harkëtarët), sepse po i sulmonte një popull me emrin *hapiru* (d.m.th. hebrejtë). Qytetet e për-mendura në këtë korrespondencë janë pikë-riht ato qytete, të cilat Joshua i pushtoi vetëm më vonë. Joshua, në njerën nga këto letra, është për-mendur edhe me emër. Në një letër tjetër marrim vesh se një nga mbretë--tërit vasalë që mbretë--ronte në qytetin e Shehemit u bë tradhtar dhe tokën e tij e vuri në dis-pozicion të hebrejve. Është kuptimplotë që ceremonia e ripërtëritjes së besë-li-dhjes në fund të librit të Joshuas ndodhi pikërisht në këtë krahinë, afër Shehemit, midis dy kodrave të Evalit dhe Gerizimit. Atje ende qëndron edhe përmen-dorja e ngritur nga Joshua.

AMORASIT

Një popull kananas (Zan 10,16) shpeshherë i shënuar ndërmjet hitasve dhe perizasve, në kundërshtim me izraelitët (Dal 33,2) . Amorasit ishin të shpërndarë nëpër malësinë në të dy anët e Jordanit. Abrahami kishte lidhur besëlidhje me

amorasit e Hevronit, dhe me ndihmën e tyre, shpartalloi katër mbretërit që kishin sulmuar qytetet e rrafshinës së Detit të vdekur, duke përfshirë edhe qytetin amoras Hazazon-tamar (Zan 14,5-7). Emri amoras përdorej gjithashtu si term i përgjithshëm për banorët e Kenaanit (Zan 48,22; Josh 24,15). Profeti Ezekiel përshkruan mire këtë popullsi të përzier të Kenaanit kur thotë se Jerusalemi është pasardhës i amorasit dhe hitasit (Ezk 16,3.45).

Gjatë gjysmës së dytë të mijëvjeçarit të tretë mbishkrimet sumeriane dhe akadiane aludojnë për amorasit (sum. *mar-u* kurse akadisht. *amurru*) si popull i shkretëtirës ata nuk enjhnin jetën qytetare si p.sh, drithë, shtëpi, qytete, dhe qeveri. Qendra e tyre ishte Pasari Jebel Bishri në veri të Palmyrës në Siri. Rreth vitit 2000 ky popull, i cili ishte infiltruar gjatë shekujve, depërtoi me forcë në Babiloni. Ata përgjigjeshin pjesërisht për shembjen e dinastisë së tretë të fuqishme të Urit dhe morën sundimin mbi disa qytete (p.sh.Larsa) Atëherë një dinasti amorase u themelua në Babilon, dhe mbreti i saj më i fuqishëm, Hamurapi, pushtoi dy shtetet amorase të Ashurit dhe Marit ne 1750.

Invadimet e popujve të tjerë si kasisët, hurianët në Mesopotami, kurse izraelitët në Palestinë dhe aramasit në Siri, i dobësuan amorasit si fuqi nga viti 1000. Emri i tyre mbijetoi si shënim për Siri-Palestinë gjersa i pasuan hatti, dhe ishte gjithashtu shënim për „perëndim”.

Në kohën e pushtimit izraelit të Palestinës, mbretërit amoras (Sihoni nga Heshboni dhe Ogu nga Bashani) sunduan mbi shumicën e Transjordanit (Josh 12,1-6). Fitorja mbi këta të dy mbretër ishte hapi i parë i pushtimit të tokës së premtuar. dhe quhej ngjarja më e rëndësishme në historinë e Izraelit (Am 2,9; Ps 135,11 i 136,19). Fiset Gad, Ruven dhe gjysma e Manasheut e pushtuan këtë territor (Num 32,33), i cili më vonë formoi një nga 12 krahina që përkrahnin oborrin e Solomonit (1 Mbr 4,19). Burrat e Ait quhen amorasit (Josh 7,7), dhe Jerusalemi, Hevroni, Jarmuti, Lakishi dhe Egloni ishin principata amorase, të cilat e pushtoi Joshua (Josh 10,1-27). Amorasit veriorë ndihmuan mbretin e Hacorit (Josh 11,1-14). Nami i tyre i keq mbeti, dhe

furnizoi një krahasim me idhujtarinë e Ahavit dhe Manasheut (1 Mbr 21,26; 2 Mbr 21,11, khs Zan 15,16).

ARAMASIT

Kombësi semitike midis Sirisë dhe Euftratit e përmendur në letrat e Amarnës dhe në një mbishkrim të Tiglat-Pilezerit. Në Dhiatën e vjetër kjo krahinë midis Euftratit dhe Tigrisit quhet Aram Naharaim: toka e dy lumenjve (Zan 24,10). Atje gjendej Harani, atdheu i Abrahamit. Jakobi është i lidhur me këtë krahinë (Br 26,5). Në kohën e Davidit dhe Solomonit ekzistonin shtetet aramase Samal në Sirinë veriore, Cova midis antilibanit dhe shkretëtirës arabe/siriane, kurse në luginën e lumit të Leontit Bet-Rehov (2 Sam 10,6), Maakar, Geshuri dhe Damasku. Asirianët i dhanë fund pavarësisë së këtyre shteteve më 732, edhe perandorisë së Damaskut. Aramasit ushtronin një ndikim të madh në Asiri. Gjuha e tyre (aramaisht) u bë gjuha e tregtisë dhe më vonë gjuha botërore. Ndërkohë fisi aramas i kaldenjve u shpërngul në deltën e Euftratit dhe Tigrisit dhe zgjeroi edhe më ndikimin e tij. Perandoria ra nën ndikimin e aramasve dhe aramasit hipën në fuqi pas dinastisë së re babilonase.

Në epokën e gjyqtarëve Izraeli ra nën sundimin aramas për 8 vjet, kur Otnieli mundi forcat nën komandën e Kushan-Rushataimit, mbretit të Padan Aramit. Në burimet biblike të mëvonshme flitet për mbretërit Shaul, David dhe Solomon (shek, XI – X), të cilët luftuan kundër mbretërive të shteteve të vëgjel aramase në jug të kufirit verior si p.sh: Aram-Cova në luginën Beqaa, Aram Bet-Rehov dhe Aram-Maaka pranë malit Hermon, Geshur në Hauran, dhe Aram-Damask. Raportin e një mbreti aramas e gjetën arkeologët në Izraelin verior, në stelën e Tel Danit, e cila dallohet për shkak se është aludim jashtëbiblik i parë për dinastinë e Davidit.

Mbretërit e Izraelit luftuan në një seri fushatash kundër mbretërisë së Damaskut, kur sundonte dinastia e Ben-Hadit. Propheti Elisha ishte i ndërlikuar në këto ngjarje. Njëherë mbreti

izraelit, Ahavi, drejtoi një koalicion prej sirianesh, izraelitësh dhe popujsh të tjerë kundër Asirisë në betejën e Karkarit më 893, kur aleatët arritën të ndalonin përparimin e përkohshëm të Asirisë drejt jugut.,

ASIRIA

Pjesa e teritorit të dy lumenjve, qytetet kryesore të krahinës qendrore, Asur, Arbilu, Dur-Sharukin, Kelah dhe Ninive. Nga fillimi i historisë deri në shek. VII sunduan pandërprerë mbi Ashurin 116 mbretër. Tashmë në kthimin e II. mijëvjeçarit asirianët themeluan ngulime tregtare në Anadolinë. Asirianët u bënë ndërmjetësit e kulturës sumeriane dhe babilonase të trashëguar. Ngritja e parë politike asiriane ndodhi falë usurpatorit Shamshi-Adad I (1750-1717). Ky pushtoi shtetin qytetëror Mari, themeloi një perandori që lidhi Eufратin dhe Tigrisin dhe zgjerohej jashtë këtij teritori. Por kërkimi për t'u zgjeruar edhe më, frenohej nga Hamurapi nga Babiloni, nga shteti mitanas dhe nga hitasit. Klima e papëlqeshme dhe grindjet formojnë frymën luftëtare të asirianëve. Udhëheqësit e tyre formojnë një ushtri të disiplinuar dhe të fuqishme. Që nga shek. XIII Asiria zgjerohet në të gjitha anët. Tukulti-Ninurta (1242-1206) pushton Babilonin, depërton gjer në Detin mesdhe dhe liqenin e Vanit. Fazën e dytë të zgjerimit e drejton Adad Nirari II (909-889). Fushatat bëhen edhe më të pamëshirshme dhe mizore, robërit e luftës keqtrajtohen, njerëzit e vendeve të pushtuara deportohen. Salmanassari III (858-824) sulmon i pari Izraelin. Mbreti izraelit Jehu i jap haraç. Mbreti judeas Ahazja e thërret Tiglat Pilezerin III (745-727) në ndihmë kundër Sirisë dhe Izraelit (khs 2 Mbr 15,19; 16,7-19; Iz 7).

Biri i tij, Shalmanasari V (727-722) rrethon kryeqytetin e Samarisë. Sargoni II (722-705) e pushton qytetin (2 Mbr 17,6). Pastaj, nën sundimin e Hizkijës, Sanheribi (705-681) rrethon Jerusalemin. Fushatën e tij kundër Palestinës ky e përshruan në mbishkrime të ndryshme të gjetura, kurse rrethimin e Lakishit në

mbishkrimet të gjetura në pallatin e tij. Nën sundimin e Asarhadonit (681-669) dhe atij të Ashurbanipalit (668-626) perandoria asiriane shtrihej nga Gjiri Persik dhe nga malet Zagros gjer në Egjipt, nga malet e Armenisë gjer në shkretëtirën arabe. Ashurbanipali përkrah artin dhe shkencën, në residencën e tij themelon një bibliotekë me 10.000 pllakat argjili duke përfshirë veprat më të rëndësishme të letërsisë babilonase: p.sh. eposi i Gilgameshit, eposi i Enuna Elishit. Nën sundimin e Nabupolasarit të Babilonit dhe mbretit medas Kiaksarës pushtohen Assur (614) dhe Ninive (612). Perandoria asiriane merr fund (Nah 3) dhe perandoria e re babilonase hipen në fuqi.

PERANDORËT ASIRIANË

883-859 Ashurnasirpal II
 858-824 Shalmanezar III
 (853 beteja e Karkarit)
 823-811 Shamshi-Adad
 810-783 Adad-Nirari III
 782-773 Shalmaneser IV
 772-756 Ashurdan
 755-745 Ashurnirari V
 744-727 Tiglat-Pilezer III
 726-722 Shalmanezar V
 721-705 Sargon II
 704-681 Senaheriv
 680-669 Esarhaddon
 668-630 Ashurbanipal
 629-612 Sinsharishkun
 (612 rënia e Ninaves)
 612-609 Ashuruballit
 (609 rënia e Haranit)

BABILONIA

Rrafshulët në rrjedhën e poshtme të lumenjve Eufat dhe Tigris, i cili ua detyron pjellorinë vërshimeve të herëpashershme të këtyre lumenjve si dhe sistemit të kanaleve. Qytetet më të rëndësishme janë si vijon: Akad, Sipar, Babilon, Kish, Borsipa, Nipur, Isin. Lagash, Uruk, Larsa, Ur dhe Eridu. Në mesin e mijëvjeçarit të katërt mërgojnë sumerianët. Kryevendi i perandorisë së tyre më të madhe është më parë Uruk. Pastaj ndërrohet selia e perandorisë midis Kishit, Umës (Uruk) dhe Urit. Dokumentet më të lashtë përmbajnë lëndë rreth tregtisë, dhe më vonë listat e mbretërve dhe analet shtetërore.

Sargoni I i Akadit (2350) futi hegemoninë e parë semitike në Babiloni dhe themelon perandorinë e parë në histori. Perandoria e pasardhësve të tij shkatërrohet 160 vjet më vonë prej gutasve (kurdëve të sotëm). Perandorinë e dytë e themelon Urnamu (2070-1960). Në Ur, kryeqytetin e tij, ndërtohet përsëri tempulli për nder të perëndishës së hënës Nana. Në shek. XIX depërtojnë në perandori amorasit (semitët perëndimorë) të cilët përvetësojnë perandorinë në Larsa dhe Ashur, dhe themelojnë dinastinë e parë babilonase. Sundimtari më i njohur i asaj dinastie është Hamurapi (1728-1626). Ky pushton mbarë Babiloninë, nënshton shtetin qytetëror Mari, dhe anekson Asirinë në perandorinë e tij. Megjithatë pasardhësit e tij nuk mund ta mbajnë mbarë territorin e perandorisë, dhe më 1530 perandoria bien në duart e hitasve. Nga lindja depërtojnë kasantët që vijnë në pushtet. Sundimi i tyre merr fund në 1150. Babilonia humb hegemoninë dhe kulmin e kulturës së saj të lartë. Pika qendrore e pushtetit zhvendoset në Asiri. Shekujt e mëpasshëm sjellin ndryshime të shkaktuara nga depërtimi i aramasve. Pas vdekjes së mbretit asirian Ashurbanipal, depërtojnë kaldenjtë nga jugu. Nabupolasari pushton Babiloninë dhe më 625 emërohet mbret, Babilonia merr përsëri pushtetin dhe emërohet perandoria e re babilonase ose perandori e kaldenjve. Perandoria përjeton kohën e shkëlqeshme nën

sundimin e Nebukadnecarit (605-562). Perandoria e tij shtrihet nga Gjiri persik gjer në Detin e Vdekur. Nebukadnecari pushton Jerusalemin më 597 dhe 586 dhe deporton shtresën e lartë të popullsisë në mërgim. Mbreti i fundit babilonas është Nabonidi (556-539). Në kohën e tij të sundimit në qytetin e oazës Tema, Belshacari është bashkëmbret në Babiloni. Më 539 Kir e pushton perandorinë dhe Babilonia bëhet provincë persiane (shih Dan 5).

PERANDORITË BABILONASË

626-605 Nabopolasar

605-562 Nabokadnecar II

562-560 Amel-Marduk (Evil-merodah)

(562 robi i luftës, mbreti Jehoa-hi-n, favorizo-het nga ky)

560-556 Neriglisar

556 Labashi-Marduk

556-539 Nabonidi, Bel-sha-cari

(bashkësundimtarë 549-539)

(539 rënia e Babilonise)

EBLA

Ebla ishte ndër mbretëritë më të hershme në Siri. Sot gërmadhat e saj ndodhen afro 55 km në jug-perëndim të Alepos në Siri. Ebla ishte qendër e rëndësishme në mijëvjeçarit të tretë dhe në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të dytë. Zbulimet arkeologjike provojnë se Levanti ishte qendër e qytetërimit të lashtë dhe të centralizuar, i barabartë me Egjiptin dhe me Mesopotaminë.

Duke filluar nga një koloni e vogël në erën e bronzit të hershëm (rreth. 3500), Ebla u zhvillua në një perandori tregtare dhe më vonë në një fuqi ekspansioniste që imponoi hegjemoninë e saj mbi shumicën e Sirisë perëndimore dhe lindore. Gjuha e saj, eblaite, quhet sot gjuha më e hershme semitike pas gjuhës akadiane. Eblën e shkatërruan gjatë shek. XXIII, por pastaj e

ndërtuan dhe përmendohet në analet e dinastisë së tretë të Urit. Ebla e dytë ishte vazhdim i së tretës dhe e sundoi një dinasti e re, në fund të mijëvjeçarit të tretë, dhe kjo hapi udhën për ngulimin e fiseve amorase për të formuar Eblën e tretë. Perandoria e tretë lulëzoi gjithashtu si qendër tregtare; ajo u bë vasal i një aleati të Jamhadit (Alepos së sotëm) deri në pushtimin e fundit nga mbreti hitas Mursili I rreth. 1600.

Ebla mbante lulëzimin e saj me anë të rrjete tregtare të madhe. Sendet u gjetën në gërmadhat e pallateve nga vendet e largëta si Sumer, Qipro, Egjipt si dhe Afganistan. Organizata politike e Eblës ndryshonte nga ajo e Sumerit. Gratë gëzonin një gjendje shoqërore të lartë dhe mbretëresha kishte ndikim të madh tek shteti dhe tek sfera religjioze. Në gërmimet e qytetit u gjetën rreth 20.000 pllaka me shkrim kuneiform që datohen nga rreth 2350.

EDOM

Edom është emri i vendit dhe i popullit të vendosur fillimisht në Transjordan midis Amonit në veri, Detit të Vdekur dhe Aravës në perëndim dhe shkretëtirës arabe në jug dhe në lindje. Kufiri i Edomit me atë të Amonit ishte lumi (në fakt një rrëkë) Zered. Kryeqyteti ishte Bocra. Edomasit ishin të njohur për urtësinë e tyre (shih librin e Jobit). Për shkak të tokës së tyre të lërueshme të kufizuar, ata u detyruan të bëjnë një komb tregtar: ata mund të kontrollonin udhat tregtare si për. sh. rrugën e mbretërve. Edomi përmendet në Bibël si dhe nga faraoni Seti I nga rr. 1215, si në analet e fushatës së Raamses III. (rr. 1186–1155). Edomasit identifikoheshin me një popull semitik që arriti në krahinën e Edomit në shek. XIV Pas një periudhe rënie. Edomi e pushtuan babilonasit. Pas kësaj disfatë ata emigruan në krahinën jugore të Judës, ku vendi i tyre i ri quhej Idumeja, kurse banorët idumasit. Herodi ishte idumas.

Meqenëse edomasit kishin pushtet për të penguar hyrjen në Detin e kuq, izraelitët kishin shpesh përleshje me ta (1 Mbr 11,14). Nën sundimin e Davidit Edomi ishte shtet vasal, por pas vdekjes së Solomonit, edomasit morën përsëri pavarësi (1 Mbr 11,25) për shkak të minierëve të tyre të bakrit, dhe kjo ishte humbje e madhe për izraelitët. Nën sundimin e mbretit judeas Amacja, Edomi u bë përsëri shtet vasal, por kjo mori fund kur Izraelin e pushtuan babilonasit.

EGIPT

Egjipti ka nga historitë më të gjata në botë. Egjipti i lashtë quhej djepi i qytetërimit duke marrë parasysh zhvillimin e parë të shkimit, bujqësisë, urbanizmit, religjionit të organizuar dhe qeverisë së centralizuar. Ndërtesa madhështore si piramidat e Gizës me sfinksin e madh, si dhe gërmadhat e Memfisit, Thebesit, Karnakut e pasqyrojnë këtë trashëgim kulturor dhe mbeten sot e kësaj dite fokusi i studimit arkeologjik dhe interesit botëror.

Një mbretëri të bashkuar e themeloi më 3150 mbreti Menes, dhe kjo shkaktoi një seri dinastish që sunduan mbi Egjiptin gjatë tri mijëvjeçarëve të mëpasshëm. Kultura egjiptiane lulëzoi gjatë kësaj periudhe të gjatë dhe mbeti dallueshëm në fene, artin, gjuhën dhe zakont e saj. Dinastitë e para dhe të dyta të Egjiptit të bashkuar përgatitën tiparet dalluese të periudhës së mbretërisë së vjetër, *afro.* 2700–2200 p.K., kur u ndërtuan shumë piramida, posaçërisht piramida e Djoserit (dinastia e tretë) dhe piramidat e Gizës (dinastia e katërt).

Periudha e parë ndërmjetëse shënoi fillimin e kohës së trazirave politike gjatë rreth 150 viteve. Vërshime më të forta të Nilit dhe stabilizimin e qeverisë kthyen perseri lulëzim për vendin në mbretërinë e mesme më 2040 p.K., dhe kjo arriti kulmin gjatë mbretërimit të faraonit Amenemhat III. Një periudhe e dytë e përçarjes shënoi arritjen e dinastisë së parë të huaj në Egjipt, ajo

e hiksosve semitikë. Pushtuesit hiksosë pushtuan një pjesë të madhe të Egjiptit të Ulët rreth 1650 dhe themeluan kryeqytetin e tyre në Avaris. Ata i debuan një ushtri nga Egjipti i Lartë nën drejtimin e faraonit Ahmose I, i cili themeloi dinastinë e XVIII. dhe zhvendosi kryeqytetin nga Memfisi në Thebes.

Mbretëria e re filloi me themelimin e dinastisë së XVIII. (1550–1070) dhe kjo shënoi ngritjen e Egjiptit si fuqi ndërkombetare që u zgjerua deri në Tombos në Nubi, duke përfshirë edhe krahinat e Levantit në lindje. Kjo periudhë është e njohur për disa nga faraonët më të famshëm, duke përfshirë edhe Hatshepsut, Thutmose III, Akhenaten bashkë me gruan e tij Nefertiti, Tutankhamun dhe Ramesses II. Më vonë vendin e pushtuan libianët, nubasit dhe asirianët, por egjiptasit vendës në fund i dëbuan ata dhe rimorën kontroll mbi vendin e tyre. Ramesses II zgjeroi hegjemoninë egjiptiane gjer në Siri dhe kështu ra ndesh me hitasit. Pas betejës së Kadeshit, të dy palët nënshkruan traktatin e paqes ne 1258.

Më 525 p.e.s, persianët, me Kambisin II në krye, filluan pushtimin e Egjiptit, që ra në duart e persianëve me betejën e Pelusiumit kur faraoni Psaltik III u zu rob lufte. Pastaj Kambisi përvetësoi titullin e faraonit, megjithëse sundoi nga kryeqyteti persian në Shushan. Persianët sunduan mbi Egjiptin për disa shekuj, kur më në fund Aleksandri i Madh i pushtoi. Pas vdekjes së tij Egjiptin e sundoi një nga gjeneralët e tij, i cili themeloi dinastinë e ptolemaidëve. Aleksandria u bë kryeqyteti i ri. Sundimtarja i fundit i kësaj dinastie ishte Kleopatra e cila bëri vetëvrasje me dashnorin e saj romak, Antonin. Pastaj Egjipti u bë provincë romake.

Egjipti dhe hebrejtë

2166 Lindja e Abrahamit

2090 Vizita e Abrahamit në Egjipt.

2066 Lindja e Jichakut (Izakut)

2006 Lindja e Jaakovit (Jakob-Izraelit)

1991 Në Egjipt themelohet dinastia XII nga Amenemheti I me kryeqytet në Thebes. Ekspansionizmi i fortë. Marrë-dhë-nie të forta ndërmjet Egjiptit dhe Meso-potamisë.

1900 Josefi (një nga bijtë e Jakobit) shitet skllav.

1897–1878 Faraoni Sesostris II në fuqi në Egjipt. Josefi i shpje-gon ëndrrat dhe emërohet guvernator i Egjiptit.

1878–1860 Faraoni Sesostris III – politika ekspansioniste shpie mbizotërimin egjiptian deri në Shehem, në Kënaan.

1876 Mbërritja e Jaakovit në Egjipt. Fillimi i 430 vjetëve të qëndrimit të Izraelit në Egjipt deri në marrjen e pushtetit nga faraoni Amenehmet III.

1806 Vdekja e Jozefit

1800 Fillimi i shtetit Mitani (nga hurrianët dhe mitanasit) i vendosur ndërmjet hitasve dhe egjiptianëve. Me kalimin e kohës ata pushtuan Sirinë, Anado-llinë jugore dhe Meso-potaminë para së të munden nga asirët, në

1730 Sundimi i dinastisë semit Hiksos në Egjipt. Favo-rizimi i izraelitëve me të cilët janë të afërm. Kryeqytet në Avaris, afër tokës Goshen (ose Raamses) ku bano-nin izraelitët.

1550–1525 Faraoni Ahmose I, themeluesi i dinastisë së re, dëbon hiksosët. Ai do të jetë «mbreti i ri që nuk e njihnte Jozefin» (shih Dalja 1,8). Egjiptianët ngarkojnë hebrenjtë me punë të detyrueshme.

1541–1520 Faraoni Amenhotepi I. Politika e gjenocidit ndaj izraelitëve (shih Dalja 1,21)

1520–1492 Faraoni Thutmose I

1526 Lindja e Moisiut (Mosheut)

1520-1505 Faraoni Thutmose II

1505-1483 Regjenca e Hatshepsutës (bijës së faraonit? shih Dalja 2,5)

1500 Kulmi i perandorisë Mitanni (shtet tampon midis hitasve dhe egjiptianëve).

1458–1425 Faraoni Thutmose III. Fushata në Palestinë (Kë--naan) dhe në Siri. Ndërtimi i gjerë i qyteteve-depo për

qëllime ushtarake në Pitom dhe në Ramses. Kryeqy-te-ti i tij ishte në Thebes.

1425–1400 Faraoni Amenhotep II. Faraoni në kohën e Dal-jes. Dobësimi i push-tetit; s'ishte në gjendje të bënte një fushatë ushtarake midis vitit të pestë (1445/6) dhe vitit të nëntë, sigurisht për shkak të humbjes së forcave të tij elite në Detin e Kuq.

1446/5 Dalja e izraelitëve

EGJIPTI – faraonët e kohës biblike

Dinastia XI

2117–2069 Intef II

2069-2060 Intef III

2060–2010 Mentuhotep

Dinastia XII

1991–1962 Amenemhat

1971–1926 Sesostris I

1929–1895 Amenemhat II

1897–1878 Sesostris II

1878–1860 Sesostris III

Dinastia XVIII

1550–1525 Ahmose I

1541–1520 [Amenhotep I](#)

1520–1492 Thutmose I

1492–1479 Thutmose II

1479–1458 Hatshepsut

1458–1425 Thutmose III

1425–1400 Amenhotep II

1400–1390 Thutmose IV

1390–1352 Amenhotep III

1352–1334 Akhenaten

1320–1292 Horemheb

1279-1213 Raamses II

Dinastia XIX

1213-1203 Merenptah

1203–1200 Amenmesse

1203–1197 Seti II

1197–1191 Merenptah Siptah

Dinastia XX

1001–992 Amenemope

992–986 Smendes II

986–967 Siamun

967–943 Psusenes II

Dinastia XXII

943–922 Shoshenq I (Shi-shak)

922–887 Osorkon I

887–885 Shoshenq II

Dinastia XXV

716-702 Sahabako (Sha-ba-ka)

702-690 Shebitku (Sha-ba-taka)

690-664 Tarharka (Tir-haka)

Dinastia XXVI

672–664 Neko I

664-610 Psametik I

610-595 Neko II

595-589 Psametik II

589-570 Apries (Hofra)

EGJIPTI NËN GREKËT

332-323 Aleksandri i Madh

323-285 Ptolemeu 1

285-246 Ptolemeu II

246-221 Ptolemeu III

221-205 Ptolemeu IV

205-180 Ptolemeu V

180-145 Ptolemeu VI

145 Ptolemeu VII

145-116 Ptolemeu VIII

51-30 Kleopatra VII

ELAM

Vend në lindje të Babilonisë dhe qytetërim i parë i Persisë me kryeqytet në Shushan, megjithëse gjuha e Elamit është më e lashtë se ajo e Persisë. Elami nuk mund të dalë në krye me Sumerin dhe Akadin. Që nga shek. XIII kishte përlëshje me Asirinë dhe Babiloninë, dhe kufiri midis tyre ndryshoi vazhdimisht. Qysh nga 700 Elami lufton si aleat i Babilonisë kundër Asirisë, por më 650 u detyrua t'i nënshtrohet Asirisë. Rënia e kryeqytetit fillon me pushtimin e arabëve.

FENIKIA

Rrip bregdetar pranë Detit Mesdhe, në perëndim dhe në jug perëndim të Libanit. Lumenj dhe përrenj të shumtë presin copa-copa krahinën dhe vështirëson lidhjet ndërmjet qyteteve. Libani është ndarë vertikalisht në dysh nga lugina Beqaa: hyrja jugore e luginës quhet hyrja e Hamatit. Lugina ndodhet mes dy malësive: malet e Libanit dhe malet e Antilibanit. Rruga e natyrshme lidhore është deti. Prandaj historia e Fenikisë është histori e shteteve qytetërore (Biblos, Sidon, Tir, Ugarit). Fenikia kishte një perandori detar që përbëhej nga koloni mesdhetare si. p.sh. Kartagjena, Sardenja, Tarshishi (në Spanjë), dhe ndoshta një koloni edhe në Amerikë. Kulmi i perandorisë ishte 1200–800. Ata quajtën vendin e tyre Kenan, kurse banorët kenanasit. Fenikasit shpikën një alfabet të ri që në fund adoptuan grekët dhe pastaj romakët..

Fenikasit ishin tregtarët më të famshëm të kohës së tyre. Fillimisht ata bënë tregti kryesisht me grekët duke tregtuar me dru (cedrat), sklevër, xham dhe lëndë ngjyrëse të purpurtë në formë pluhuri. Gjithashtu eksportuan dru (cedrat) në Egjipt dhe në Izrael. Importuan kallaj nga Kornuali (në Angli) dhe bakër nga Qiproja dhe shkrinë të dy për të prodhuar bronz. Gjithashtu eksportuan sendet luksuoze në Izrael në këmbim me dridhë dhe ulje ulliri. Për të forcuar këtë marrëveshje tregtare, Ahabi u

martua me princeshën fenikase Itobaal ndryshe Jezabel, dhe kjo solli idhujtari në Izrael. Zoti reagoi duke dërguar profetin e tij, Eljahun, për të përballuar këtë krizë.

Porti më i rëndësishëm fenikas ishte Tir që kishte pasuri të madhe. Mbreti i tij u bë një tip satani për shkak të mendjemadhësisë së tij.

FILISTENJTË

Filistenjtë (ose pëlishtasit, të cilët i kishin vënë emrin e tyre tokës së Palestinës) në fillim i takonin qytetërimin grek të përqëndruar në Kretë. Kur ky qytetërim u shka-tërrua në 1470 nga një shpërthim vullkanik shumë i madh, shumica e ba-no-rëve u sh-përngulën në jug, së pari u zm-brap-sën në Egjipt dhe pastaj në breg-detin e Pa-leshtinës. Atje u shpërngulën dhe themeluan një qytetërim që përbëhej nga pesë shtete qytetërore me emrat: Ashdod, Ashkelon, Gaza, Gat dhe Ek-ron. Shumë kohë më parë filistenjtë kishin pasur marrë-dhë-nie tregtare me Palestinën gjatë viteve 1900-1700.

Kohët e fundit arkeologët kanë gjetur një varrezë filiste. Në gropat ata kanë gjetur skeletë të varrosur me sendet e tyre personale, dhe kjo dëshmon për një kulturë të sofistikuar.

FRIGJIA

Në lashtësi Frigjia ishte një mbretëri në krahinën qendrore të Anadollisë.

Gjatë epokës heroike të mitologjisë greke, disa mbretër legjendarë ishin banorët e Frigjisë: Gordias, nyjën e të cilit e preu Aleksandri i Madh, Midasi, që ktheu në ar gjithçka që preku, kurse Mygdoni që bënte luftë me amazonët. Sipas *Eniadt* të Homerit, frigjasit ishin aleatë të ngushtë me trojanët dhe morën pjesë në luftën trojanase kundër akaiasit. Fuqia frigjase arriti kulmin e saj në shek. XIX nën sundimin e mbretit Midas, i cili dominonte shumicën e Anadollisë perëndimore dhe qendrore,

dhe rivalizonte asirianët dhe Uruartu. Megjithatë ky Midas i mëvonshëm ishte mbreti i fundit i Frigjisë së pavarur, para se kryeqytetin e tij e pushtuan kimeriasit më 695. Atëherë Frigjia u bë vasal i Lidisë, pastaj i Persisë, Aleksandrit të madh, Pergamonit, Romës dhe në fund Bizantit.

GIHON

Gihoni i lashtë quhet sot lumi Araks i cili rrjedh nëpër Turqi, Armeni, Azerbajjan dhe Iran. Araksi është ndër lumenjtë më të gjatë të Kaukazit. (1.072 km)

GREQIA

Greqia e Lashtë është qytetërimi që i përket periudhës së historisë greke që zgjat nga periudha arsilike e shek. XIII deri në atë të VI para Kr. dhe deri në vitin 212 para Kr. pas pushtimit nga Roma pas Betejës së Korintit.

Në qendër të kësaj periudhe është Greqia Klasike, që lulëzoi gjatë shekujve të pestë dhe të katërt para Kr., fillimisht nën sundimin e suksesshëm athinas pas kërcënimit ushtarak prej pushtimeve perse.

Epoka e Artë athinase mbaron me disfatën nën duart e Spartës në Luftën e Peloponezit në vitin 142 para Kr..

Kultura greke klasike kishte një ndikim të fuqishëm te Perandoria Romake, që mbajti një variant të saj në shumë pjesë të rajonit mesdhetar dhe Evropë të Mesme, për arsyen e së cilës Greqia Klasike konsiderohet si kultura themelore që mundësoi themelimin e qytetërimit perëndimor.

Nga shek. VI disa qytete kishin dalë si zotërues në politikën greke: Athinai, Sparta, Korinti dhe [Thebesi](#). Secili prej tyre kishte vënë krahinat rrethuese dhe qytetet më të vogla nën kontrollin e

tij, kurse Athinai dhe Korinti ishin bërë fuqi detare të mëdha dhe tregtare.

Shtimi i shpejtë i popullsisë në shek. VIII dhe VII kishte si pasojë emigrimin e shumë grekëve për të formuar koloni në Italinë jugore, Siçilinë dhe Azinë e vogël. Këto koloni greke nuk ishin nën kontrollin e qyteteve themelore, megjithatë shpesh mbanin lidhje tregtare dhe fetare me to.

Proçesi i emigrimit kushtëzoi gjithashtu një seri konfliktesh ndërmjet qyteteve greke të Siçilisë dhe Kartagjenës. Këto konflikte zgjatën nga 600 deri në 265, kur Roma (fuqia e re dominuese) hyri në aleancë me mamertinët për t'u mbrojtur kundër armiqësive të tiranit të Sirakusit, Hiero II, dhe pastaj kundër kartagjenve. Në këtë mënyrë Roma u bë fuqi e re dominuese kundër fuqisë së shpëlarë të qyteteve greke të Sicilisë dhe hegjemonisë kartagjene në këtë sferë. Një vit më pas shpërtheu Lufta Punike e Parë.

Gjendja e dobësuar e zonës qendrore të Greqisë koinçidoi me ngritjen e Maqedonisë, e drejtuar nga Filip I. Brenda 20 vjetëve Filip kishte bashkuar mbretërinë e tij, e kishte zgjeruar në veri dhe në perëndim me çmimin e fiseve ilire, e pastaj kishte pushtuar Thesalinë dhe Trakinë. Suksesi i tij ua detyroi reformave të ushtrisë.

Aleksandri, biri dhe pasardhës i Filipit, e vazhdoi luftën. Ky e mundi Darijën III të Persisë dhe shkatërroi plotësisht perandorinë persiane, duke e aneksuar me Greqinë.

Betejat më të njohura të luftërave greko-persiane përfshijnë edhe Marathon, Thermopylae, Salamis, dhe Plataea. Me kalimin e kohës të gjitha krahinat e Greqisë ishin çliruar nga ndikimi persian.

Kur Aleksandri vdiq më 323, fuqia dhe ndikimi i Greqisë ishin në kulm. Megjithatë pavarësinë e shteteve greke e zëvendësoi zhvillimi i kulturës greke.

Gadishulli grek ra nën sundimin romak gjatë pushtimit të Greqisë pas betejës së Korintit. Maqedonia u bë provincë romake, kurse Greqia jugore ra nën sundimin e prefektit

maqedonas. Ishujt egje iu shtuan këtij territori në 133. Athenai dhe qytete të tjera greke ngritën krye me 88, por gadishullin e shtypi gjenerali romak Sulla. Luftërat civile shkretuan vendin edhe më, derisa Augusti e organizoi gadishullin si provinca e Akaisë më 27 para Kr.

Greqia u bë provinca kyç e perandorisë romake, kurse kultura romake ishte bërë prej kohësh greko-romake. Gjuha greke u bë *lingua franca* në Lindje dhe në Itali, dhe shumë intelektualë grekë si p.sh Galeni, punuan në Romë.

HITASIT

Hitasit ishin popull i lashtë i Anadollisë që themeloi një perandori të përqëndruar në Hatusa në Anadollinë qendrore rreth 1600. Perandoria arriti kulmin e saj rreth 1550 nën sundimin e mbretit Suppiluliuma I, kur ajo rrethoi një sipërfaqe që përfshinte shumicën e Azisë së vogël si dhe Levantin verior dhe Mesopotaminë e Lartë. Pas rreth 1180, perandoria mori fund dhe u nda në shtetet-qytetërore hitase, disa nga ata përjetuan gjer në shek. VIII.

Gjuha hitase ishte dega anadollase më e lashtë e gjuhëve indo-evropeane

Në kulmin e saj perandoria hitase ishte fuqi e madhe krahas perandorive egjiptiane ose asiriane. Për të vulosur një traktat paqeje me Egjiptin, faraoni Raamses II u martua me një princeshë hitase më 1274. Luftëtarët hitasë ishin të njohur për koçitë e tyre të luftës si dhe për kuajt e tyre.

HURIANËT

Hurrianët ishin një popull i epokës së bronzit në Lindjen e afërt. Ata banonin në Anadollinë dhe në Mesopotaminë veriore. Kryeqyteti i tyre ishte Urkesh. Kombi më i madh hurian ishte mbretëria shumëetnike e Mitanisë, ku mitanasit formonin një shtresë të lartë që dominonte hurrianët. Popullsia e perandorisë

hitase përbëhej nga një popullsi e madhe hurrianësh, dhe hurrianët ndikuan tek mitologjia hitase. Nga epoka e bronzit të hershme hurrianët u asimiluan me popujt e tjerë me përjashtim të Urartut. Disa ekspertë mendojnë se gjuhët hurriane dhe urartase janë të afërta me gjuhët e Kaukazit verior, kurse armenasët janë një përzierje hurrianesh dhe urartasesh.

Nga shek. XXI gjer në shek. XVIII, Asiria kontrollonte kolonitë në Anadollin, dhe hurrianët adoptuan shkrimin kuneiform akadian. Tektetet në gjuhën hurriane u gjetën në Hatusa. Letra më e gjatë e letrave të Amarnës janë shkruar në gjuhën hurriane: bëhet fjalë për një letër që shkroi mbreti Tushratta i Mitanisë drejtuar faraonit [Amenhotep III](#). Emrat hurrianë u gjetën në krahinën e Kurkikut. Hurrianët ishin të njohur për kuajt e tyre.

KASITËT

Atdheu i parë i kasitëve nuk është shumë i njohur, por siç duket, ishin malet e Zagrosit në provincën e Lurestanit në Iran. Ata kontrollonin Babilonin pas rënies së perandorisë babilonase të lashtë. Për shkak të ngatërimit gjuhësor të shkrimtarëve greke ky popull njihet gabimisht nganjëherë si Kush (shih librin e Zanafillës). Ata quheshin në lashtësi Kaššu, Kassi, Kasi ose Kashi.

Ata hipën në fuqi në Babilonin pas plaçkitjes hitase më 1595 dhe themeluan një dinasti të bazuar në Dur-Kurigalzu. Kasitët ishin anëtarët e aristokrisisë luftëtare. Dinastia e tyre zgjati 500 vjet. Disa nga udhëheqësit kasitë mbanin emra indo-europianë, kështu ka të ngjarë se ata ishin një elitë sundimtare e ngjashme me mitanasit që sundonin mbi hurrianët në Azinë e vogël.

KUSH > NUBIA

KAPADOKIA

Kapadokia është krahinë historike në Anadollinë qendrore. Sipas Herodotit në kohën e kryengritjes tone (499 p.e.s.) kapadokianët sundonin mbi një krahinë që shtrihej nga malësia e Taurit gjer në Detin e Zi. Kapadokia kufizohej në jug nga malet Taur që e ndanin nga Kiliki, në lindje nga Eufрати i sipërm, në veri nga Ponti, kurse në perëndim nga Likaonia dhe Galacia lindore.

Sipas Herodotit kapadokianët quheshin Meshek.

Mbretëria e Kapadokisë ende ekzistonte në kohën e Strabos (rr. 64 para Kr. – rr. 24 pas Kr.) si shtet i pavarur me kryeqytet në Kajseri (ndryshe Mazaka).

Kapadokianët, të përkrahur nga romakët kundër Mitridatit VI të Pontit, emëroi një sundimtar vendas Ariobarzanes, në 93; por në të njëjtin vit luftëtarët armenasë nën komandën e Tigranit hynë në Kapadoki, shfronoi mbretin dhe kurorën Gordios si mbreti i ri vasal, kështu krijuan një shtet tampon flala tampon nuk ekziston në shqip kundër romakëve që po afroheshin. Por pas disfatës së mbretërve armenasë, romakët emëruan Ariobarzanes mbret në 63 para Kr..

KILIKIA

Në lashtësi Kilikia ishte krahina bregdetare jugore e Anadollisë. Ajo egzistonte si entitet politik qysh nga koha e hitasve dhe pastaj u bë pjesë e mbretërisë armenase.

Kilikia ndahej në Kilikia Trachea (malore) dhe Kilikia Pedias (asirianisht Kue, Kilikia e rrafshët). Në lashtësi ky territor ishte mbuluar me pyje që furnizonin Fenikinë dhe Egjiptin me dru. Kilikia nuk ka qytete të mëdha.

Kilikia njihet si Kizzuwatna në epokën e hershme hitase. Në mbishkrimet asiriane banorët e Kilikisë hasen si *Hilikku*, dhe në gjysmën e hershme të mijëvjeçarit Kilikia ishte një nga katër fuqitë kryesore të Azisë perëndimore. Qytetet kryesore ishin:

Tarzu (Tars), Ingira (Anchiale), Danuna-Adana, Pahri (ndoshta Mopsuestia), Kundu (Kyinda, pastaj Anazarbus) dhe Karatepe.

Mbreti i parë i Kilikisë së lirë quhej, Išputahšu, biri i Pariyawatrit. Në një dokument tjetër shënohet një traktat ndërmjet mbretit Išputahšu dhe Telipinut, mbretit hitas. Mbreti i fundit i Kilikisë Sunassura II u detyrua të bëhej vasal i hitasve.

Në shek. VIII krahina u bashkua nën sundimin e mbretit Mukšuš, i cili quhej themeluesi i Mopsuestisë, megjithëse kryeqyteti ishte Adana. Tipari shumëkulturësh i Mopsuestisë pasqyrohet në një mbishkrim të shkruar në gjuhën luviane dhe në gjuhën fenikase

Në shek. IX Kilikia u bë pjesë e Asirisë dhe mbeti kështu deri në fund të shek. VII.

KIMERIANËT

Kimerianët janë popull i lashtë, i përmendur për herën e parë në dokumentet asiriane të shek. VIII para.Kr..

Prejardhjen e kanë në stepat e Pontit. Ata do të kenë sulmuar shtetin Urartu më 714. Forcat asiriane nën komandën e Sargonit II i mundën më 705, kur ata u kthyen drejt Anadollisë, ku pushtuan Sardin, kryeqytetin e Lidisë më 696/5. Pak pas ata i mundi më 619 Alyates i Lidisë. Pastaj ata do të jenë shpërngulur në Kapadoki.

Ka mundësi që dega e tyre veriore të jetë lidhur me emrat Gomer, Krim si dhe keltët. Ata do të jenë kaluar nëpër stepat e Azisë, por nën presion nga skitët, ata do të kenë depërtuar në Evropë, ku do të kenë themeluar kulturën kelte.

LUFTËRAT E HEBRENJVE

Lufta e parë judease (66–73 pas Kr.), ishte e para nga tri kryengritje kundër romakëve. Lufta e dytë ishte lufta e Kitosit (115–117) që ndodhi kryesisht në diasporë, kurse lufta e tretë ishte ajo e Bar Kohbës (132–136).

Kryengritja e madhe filloi më 66 për shkak të gjendjes së tensionuar ndërmjet romakëve dhe çifutëve. Kriza u rrit për shkak të protestave kundër taksave dhe për shkak të sulmeve kundër qeveritarëve romakë. Guvernatori romak Gessi Flor kundërshtoi duke plaçkitur Tempullin me pretendim se të hollat i takonin perandorit romak. Të nesërmen ky arrestoi shumë figura të shquara. Ky incident shkaktoi një revoltë të madhe r dhe më pas garnizonin romak e pushtuan kryengritësit dhe mbreti Agripa II bashkë me nëpunësit romakë u larguan nga Jeruzalemi. Kur u pa se kryengritja doli jashtë kontrollit Cesti Gal, legati i Sirisë, sollti ushtrinë romakë të Sirisë (me Legjion XII Fulminata) për të rikthyer rregullin dhe për të shtypur revoltën. Megjithë sukseset e para, duke përfshirë edhe pushtimin e Jafës, legjioni sirian ra në pritë dhe kryengritësit masakruan 6000 ushtarë romakë. Josef Flavi u emërua komandant i Galilesë kurse Elazar ben Hananiya komandant i Edomit. Muret e Jerusalemit u përforcuan, kurse ekstremistët u dëbuan.

Romakët reagues duke emëruar Vespazian të birin, Titin në komandën e dytë si gjeneral që u përgjigjej për shtypjen e kryengritjes. Atij u dhënë katër legjione. Vespaziani filloi fushatën e tij duke pushtuar qytetet e Galilesë, duke përfshirë edhe Jotbatën ku Jozef Flavi (Josef ben Matitjahu) u dorëzua. Llogaritet që rreth 100.000 çifutë ose u masakruan ose u shitën si skllëvër. Pas disfatës në Galile zelotët ikën për në Jerusalem. Brenda qytetit shpërtheu një përleshje ndërmjet fraksioneve të ndryshme si p.sh saducenjtë kundër zelotëve. Pas një reshtjeje kohëshkurtër Vespaziani u tërhoq në Romë, ku u emërua perandor i ri, dhe Titi u emërua kryekomandant më 69. Titi filloi rrethimin e Jerusalemit dhe më 70 e pushtoi qytetin. Titi u largua për në Romë dhe la legjionin X *Fretensis* për të pushtuar kalatë judease që mbetën. Kështjella e fundit që ra ishte Macada. Llogaritet që një milion judeas jane masakruar mërguar ose u shitën skllëvër.

Kryengritja e Bar Kohbës ndodhi rreth 132–136 pas Kr., dhe filloi për shkak të gjendjes së tensionuar në Jude. Simon bar

Kohba, udhëheqësi i kryengritjes, quhej nga të gjithë mesia që duhej të rikthenteer pavarësi kombetare. Të krishterët që nuk e pranonin Bar Kohbën si mesi u persekutuan egërsisht. Fillimisht ai pati sukses, por dy vjet më vonë perandori romak Hadriani mblodhi një forcë të madhe për të pushtuar vendin (një e treta e mbarë ushtrisë romake!).

Ushtria romake përbëhej nga gjashtë legjione nën komandën e gjeneralit Sekst Juli Sever. Bar Kohba bëri një luftë guerilje dhe ndërtoi gjithkund një sistem tunelesh të ngjashme me tunelet e Viet-Kongut në Vjetnam. Më në fund romakët e shtypën kryengritjen më 136. Sipas historianit romak Cassius Dio, 580,000 judeasit vdiqën në këtë luftë të tretë, dhe mbarë Izraeli u shpopullua në një shkallë të paparë deri atëherë. Disa u vranë, disa vdiqën nga uria, kurse të tjerët u shitën skllëvër. Humbjet romake ishin aq të madha sa që dy legjione u detyruan të çmobilizoheshin. Qendra e popullit u zhvendos në Galile, Bet Shan dhe Golan. Kalaja e fundit që ra ishte Betar, ku Bar Kohba bëri vetëvrasje. Judeasve u ndalohej të hynin në Jerusalem që u bë qytet pagan. Udhëheqësit fetarë e kryengritjes u vranë hapur në amfiteatrin e Cezaresë pas torturave të tmerrshme.

LIDIA

Lydia ishte një mbretëri e epokës së hekurit në Azinë e vogël perëndimore. Në shkallën e saj më të gjere mbretëria e Lidisë përfshinte mbarë Anadollinë perëndimore. Më vonë ajo u bë provincë e perandorisë persiane me Sard si kryeqytet.

Guvernatori i parë i saj quhej Tabali, i emëruar nga Kiri i madh.

Edhe më vonë Lidia u bë provincë romake. Në shek. VII u stampuan monedhat e para. Herodoti mendoi se etruskët ishin me prejardhje lidiane. Gjuha lidiane ishte e afërt me gjuhën hitase. Në kohët biblike Lidia ishte i njohur për arkëtarët.

Lidinë e sunduan tri dinasti:

Atyadët (1300) – Heraklidët (Tylonidët) (deri në 687 para .K)

Sipas Herodotit herklidët sunduan nëpër 22 gjenerata (1185 p.e.s., për 505 vjet). Alyattes ishte mbret i Lidisë më 776. Biri i tij, Kresi (560-546), ishte i njohur për pasuritë e tij shumë të mëdha. Mbretin e fundit e vrau Gygesi i cili trashëgoi fronin. Disa mendojnë se Gygesi ishte Gogu i Biblës, Më 546 Kresin e mundën persianët nën komandën e Kirit dhe perandoria lidiane mori fund.

MARI

Mari ishte qytet i lashtë në Siri. Mari lulëzoi si qendër tregtare dhe shtet qytetëror mes 2900 dhe 1759. Meqenëse ndodhej në rrugën e tregtisë, funksionte si ndërmjetës midis Sumerit dhe Levantit në perëndim. Kjo rrugë tregtare lidhi qytetin Mari, Afganistanin dhe me Kretën në Mesdhe. Rivali i tij tregtar ishte Ebla.

Arkeologët zbuluan pllakat e Mariut (rreth 3 000) që japin informatë rreth emrave gjeografikë, tekstet administrative, ekonomike dhe juridike. Ato datohen në 1800 – 1750.

MIDIAN

Midiani ishte një lidhje fisesh të afërta të shpërndara që endeshin nëpër një sipërfaqje që zgjerohej nga një krahinë në jug të Detit të Vdekur deri në shkretëtirën e Sinait. Ata adhuronin perënditë Baal dhe Ashtorot në disa shenjtore të shpërndara si p.sh. Kadesh. Shenjtërore të gjetura në Timna, i ngjajnë Tendës së shenjtë të izraelitëve.

Sipas Biblës Midian ishte pasardhës i Abrahamit dhe Keturah (Zan 25,1-2). Ata ishin të afërm me kenitët.

MITANNI

Mitanni ishte një shtet me gjuhë huriane në Sirinë veriore dhe në Anadollinë juglindore që kishte pavarësi nëpër periudhën 1500–1300 para K. Mitanni hipën në fuqi pas shkatërrimit hitas të Babilonisë amorase, kur një seri mbretërisht asianë të dobët krijuan një zbrazëti politike në Mesopotami. Popullsinë huriane e dominonte një shtresë mitanase aristokratike. Kjo shtresë kishte lidhje të ngushtë me arianët e Indisë, sepse kishin të njëjtat hyjni si p.sh. Mitra, Varuna, Indra, dhe Nasatya (Ashvins). Mitanni ishte shtet tampon kyç ndërmjet asirianëve dhe Egjiptit, i cili ishte rivali i tyre kryesor.

MOAB

Moabi është emri historik i nje parcele toke malësore në Transjordan. Toka shtrihet gjatë bregdetit lindor të Detit të vdekur. Ekzistenca e mbretërisë së Moabit konstatohet nga gërmime të shumta arkeologjike kryesisht stela e mbretit moavas Meshu, që përshkruan fitoren moavase mbi birin e mbretit izraelit Omri. Kryeqyteti moavas ishte Dibon. Sipas Biblës Moavi ishte shpesh në konflikt me të afërmit izraelitë në perëndim.

Me dyndjen e amorasve, moavasit u detyruan të tërhiqeshin në krahinën në jug të lumit (rrëkës) Arnon. Këta amoras ishin nën sundimin e mbretit Og.

Ogun e mundën izraelitët kur i afroreshin tokës së premtuar. Më vonë, sipas Librit të gjyqtarëve Ehad ben Gera vrau mbretin moavas dhe drejtoi një ushtri izraelite kundër moavasve. Në anën tjetër, në Librin e Rutës flitet për marrëdhëniet miqësore ndërmjet Moavit dhe Betlehemit. Më vonë Davidi ua besoi prindërit e tij mbrojtjes së moavasve kur e përndiqte mbreti Saul. (1 Sam 22:3,4). Territorin e lashtë të Moavit e pushtojnë tani beduinët.

NUBIA

Nubia është një krahinë që ndodhet gjatë Nilit ku sot gjendet Sudani verior dhe Egjipti jugor. Nubia është me rëndësi për Egjiptin sepse ishte hyrja për tregti me Afrikën. Ishte p. sh. burim i njohur për arin. Njëherë kishte një dinasti nubase në Egjipt (shih Tirhaka te 2 Mbr 19,9). Më 701 princin trashëgimtar Tirhaka (20 vjeçar) e kishte dërguar i vëllai mbreti Shebitku në një mision të dështuar për të pushtuar Judën.

Emri Nubia e ka prejardhjen nga populli nomad që quhej Noba që u shpërngul në këtë territor pas shembjes së mbretërisë së Meroes. Në lashtësi ky popull quhej Kush.

NUZI

Nuzi ishte qytet i lashtë i Mesopotamisë në jugperëndim nga Kirkuku pranë Tigrisit. Qyteti Gasur u themelua në kohën e perandorisë akadiane nga fundi i mijëvjeçarit të tretë. Në mesin e mijëvjeçarit të dytë hurianët e pushtuan dhe e riemëruan Nuzi. Pas pushtimit të perandorisë huriane të Mitanit nga hitasit, Nuzi ra në duart e Asirisë.

Nuzi është e njohur për pllakat (rreth 5000) që gjetën arkeologët. Në këto pllaka bëhet fjalë për tregti, marrëdhiet me punëtorët, dhe çështjet juridike. Këto pllaka vërtetojnë zakonet biblike si vijon:

1. Çiftet pa fëmijë mund të adoptojnë si trashëgimtar një nga shërbëtorët. Te Zan 15 Abrahami adoptoi shërbëtorin e tij Eliezer si trashëgimtar. Kështu Jishmaeli iu lind Abrahamit nëpër Hagarën me iniciativën e gruas së tij Sara.
2. Shërbëtorja dhe biri i saj nuk duhen larguar pas lindjes së birit të vërtetë (khs Zan 21,9-14).
3. Tupkitilla i Nuzit ka blerë trashëgimin e tij për tre dhen (khs 25,29-34).

4. Bekimi gojor i atit që po vdiste vlente para ligjit (khs Zan 27,48).

PERSIA

Fisi kryesor i Iranit që banonte fillimisht ndërmjet Detit Kaspik dhe Gjirit Persik, pas fitores së tij mbi medasit (552) dhe me pushtimin e Babilonisë (539) Kiri i madh (558-528) themelon perandorinë botërore të persianëve. Në 538 ky u jep lejë judeasave të kthehen në atdhe pas mërgimit (Ezra 1,1-11). Darije I Longiman, organizatori kryesor i perandorisë (522-486) lehtëson rindërtimin e Tempullit që shugurohet më 515 (Ezra 6,6-16, Në librin e Esterës është shkruar ajo që i ndodhi një kolonie çifutësh midis viteve 483 dhe 473 para Kr.: se si Perëndia i shpëtoi ata nga një intrigë vrasëse. Atë kohë Kserksi I ishte perandori persian. Libri i Esterës fillon me një gosti të madhe të bërë në Shushan. Tani dihet se ky banket ishte i lidhur me përgatitjet për fushatën ushta-rake kundër Greqisë. Më 480 flota e tij pësoi një disfatë të rëndë nga ana e grekëve dhe pas pak u mund edhe ushtria e tij. Kserksi u kthye në Persi shumë i trishtuar. Në këtë rast përpiquej të ngushëllohej me këna-qësitë e pallatit dhe e kërkoi mbretëreshën ndërmjet vajzave të bukura të perandorisë së tij. Ai zgjodhi Esterën dhe u martua me të. Perandoria pastaj shembet pas disfatës së Dariut III kundër Aleksandrit të Madh), pas betejës së Isosit më 333.

Pas vdekjes së Aleksandrit Irani ra në sundimin e perandorisë greke seleukide. Më mesin e shek. II para Kr. perandoria parte u ngrit në fuqi, e cila u bë rivalja i perandorisë romake, dhe kjo shkaktoi luftërat romano-parte.

PERANDORIA PERSIANE

539-530 Kir

530-522 Kambys

522-486 Dariu

486-465 Kserksi
 464-423 Artakserksi I
 423-404 Dariu II
 404-338 Artakserksi II
 359-338 Artakserksi III
 338-336 Arsi
 336-331 Dariu III
 331-323 Aleksandri

PISHON

= Kura

Lumi Kura e ka burimin në Turqi, rrjedh nëpër Turqi drejt Gruzisë, pastaj në Azerbajxhan, ku lumi Araks derdhet në të dhe hyn në Detin Kaspik. Gjatësia e lumit është 1,515 km..

PONT

Ponti është shënim grek për një krahinë në bregdetin jugor të Detit të Zi Quhej më vonë Trebizond me kryeqytet në Sinop që u themelua në 731. Ponti quhet nganjëherë atdheu i amazonëve.

Mbretëria e Pontit arriti kulmin e vet nën sundimin e Mitridatit VI. Nën sundimin e tij territori i Pontit përfshinte edhe Kapadokinë pontike dhe një pjesë prej Amenise. Në të vërtetë Mitridati ishte aleat i mbretit armenas Tigran. Romakët i pushtuan të dy mbretërit dhe Ponti u bë provincë romake.

QYTETËRIMI MINOAS NË KRETË

Qytetërimi minoas ishte qytetërim egje i epokës së bronzit që lindi në ishullin e Kretës dhe në ishujt egje të tjerë, që lulëzoi ndërmjet 3650 dhe 1400. Ky qytetërim i takon epokës së historisë greke që paraprinte qytetërimin miken dhe asaj të Greqisë së lashtë.

Kreta ishte e njohur për kultin e demit. Religjionin e kontrollonin gratë që ishin priftëresha.

Në periudhën minoene u zhvilluan kontakte ndërmjet Kretës, Detit Egje dhe Detit Mesdhe. Si tregtarë dhe artistë ndikimi i tyre arrinte Egjiptin, Qipron (burim i bakrit), Kenaanin dhe Anadollinë. Megjithatë ky qytetërim mori fund për shkak të shpërthimit vullkanik në ishullin Santorini (Thera) rreth 1525-1500.

ROMA

Roma e lashtë ishte një qytetërim italik që filloi në gadishullin taljan në shek. VIII. Ajo ishte para se gjithash një perandori mesdhetare, e cila u zgjerua për t'u bërë parandoria më e fuqishme dhe më e madhe e lashtësisë me afro 50 - 90 milionë banorë.

Brenda afro 12 shekujsh qytetërimi u zhvillua nga monarkia, pastaj në formën e saj republikane dhe në fund në një autarki. Me anë të pushtimit dhe aneksimit ajo u bë dominuese në Evropën jugore dhe perëndimore.

Shoqëria romake e lashtë ka kontribuar në qeveri moderne, drejtësi, politikën, inxhinierinë, artin, literaturën, luftë, fenë, gjuhë dhe shoqatë. Roma zhvilloi një ushtri profesionale. Ajo arriti suksese të mëdha në sferën e arkitekturës, me ndërtimin e ujësjellësave, rrugëve, pallateve dhe monumenteve.

Gjatë historisë së saj, Roma ishte përfshirë në dy seri luftërash me rëndësi: kundër Kartagjenës (luftërat punike 264-146 para Kr.) dhe kundër partëve (58-63 dhe 161-166 para Kr.), nga të cilat ajo doli fitimtare. Në jug sundimi romak shtrihej gjer në Arabi, kurse në veri deri në Angli.

Fundi i Perandorisë Romake erdhi në [476](#), kur perandori i fundit i saj, Romul August, u hoq dhe nuk u zëvendësua. Në Lindje, perandoria përjetoj formën e perandorisë bizantine që mori fund me pushtimin turk të kryeqytetit më 1453.

Gjuha latine flitej vetëm në Afrikën jugore Spanjë, dhe vetëm ndër aristokratë Romës deri në shek.III. pas Kr. Gjithandej flitej greqisht.

PERANDORËT ROMAKË

14-37 Tiber
 37-41 Kaligula
 41-45 Klaudi
 54-68 Neron
 69-79 Vespazian
 79-81 Tit
 81-96 Domician
 96-98 Nerva
 98-117 Trajan
 117-138 Hadrian
 138-161 Antononin Pi
 161-180 Mark Aureli
 180-192 Komod
 191-211 Septim Sever
 235-238 Maksim Traks
 238-244 Gordian III.
 244-249 Filip Arabski
 249-251 Decie
 253-260 Valerian
 260-260 Gali
 268-270 Klaudi Goti
 270-275 Aurelian
 275-276 Tacit
 276-282 Prob

RIORGANIZIMI I PERANDORISË:

TETRARHIA (284-310)

285-305 Dioklecian + Maksimian

305-311

Tetrarhija (dorëheqja e Dioklecianit dhe Maksimianit)

Maksenci + Maksimin I. Daja
 Galeri (u. 311) + Konstanci I Klor (u. 306)
 312-337 Konstantin + Licini- (u. 325)
 337 Konstans I. (u. 350). + Konstantin II. (u. 340) +
 Konstanci II.
 350 Konstanci II.
 361-63 Julian
 364 Jovian
 365 Valentinian I. (vdiq 375) + Valent (378)
 378 Teodozi- I + Gracian (vdiq 383) + Valentinian II.
 383-88 Uzurpimi i Magnit Maksim
 383-95 Teodozi I.
 425-54 Valentinian III.
 475-76 Romul August
 476 Fundi i parandorisë romake perëndimore

SKITËT

Skitët ishin një grup i madh nomadësh iranianë dhe evroaziatikë që banonin në stepat evroaziatike nga shek. IX deri në shek. I. Gjuha e tyre i takon degës lindore të gjuhës iraniane. Skitët klasikë e lashtësisë banonin gjatë Detit të Zi. Grupe të tjera banonin në Azinë qëndrore ku quheshin *Iskuzai*, *Askuzai*, ose *Saka*. Skitët themeluan një rrjet të madh tregtar që lidhte Greqinë, Persinë, Indinë dhe Kinën.

Në shek. VII skitët kaluan Kaukazin dhe shpeshherë bënë inkursione bashkë me kimerianët në Lindjen e Mesme, dhe në fund luajtë rolin kryesor në shkatërrimin e Asirisë më 612 para Kr.

Skitët mbanin trupa kuajsh, bagëtish dhe dhensh, dhe banonin në tenda, luftonin me arkë mbi kalë. Ata zhvilluan një kulturë të pasur që karakterizohej me sende metalesh të ndritshme, varret e pasura (kurganët) dhe një stil artistik të sofistikuar.

SUMER

Sumeri do të jetë qytetërimi i parë në Mesopotami jugore. Qytetet e tij (Eridu, Kish, Lagash, Nipur, Ur dhe Uruk) ndodheshin pranë lumit Euftrat. Qytetërimi sumerian lulëzonte në mijëvjeçarin e tretë. Tekstet me të vjetra datohen nga 3100, Ka paralele të qarta ndërmjet literaturës sumeriane dhe lëndës biblike në librin e Zanafillës 1-11. Me kalimin e kohës, gjuha sumeriane (e cila është unike) vdiq, por përjetoi vetëm si gjuhë sakrale. Para se Abrahami të largohej nga Sumeri, amorasit kishin pushtuar vendin.

UGARIT

Ugariti ishte port i lashtë në një rrip toke në Sirinë veriore, 11 km në veri të Latakisë. Ugarit kishte lidhje të ngushtë me perandorinë hitase, i dërgoi haraç Egjiptit, dhe bënte tregti me Qipron (ndryshe Alashia), Egje, Sirinë dhe hitasit. Kulmin i tij e ariti më 1450-1200 para Kr.

Mbreti i fundit i Ugaritit ishte Ammurapi (rreth 1215 - 1180), i cili ishte bashkëkohës me mbretin hitas Suppiluliuma II. Në një letër drejtuar sundimtarit të Qiprosë Amurapi thekson se ka një krizë, sepse njerëzit e detit (d.m.th. filistenjtë) janë gati të pushtojnë mbretërinë e tij, dhe ai është pa mbrojtje ushtarake. Një pllakë kuneiforme tregon se Ugariti u shkatërrua pas vdekjes së faraonit egjiptian Merneptah (në 1203).

Tabletat e Ugaritit tregojnë paralele të ngushta me praktikatat kananase, dhe gjuha e Ugaritit është shumë afër hebraishtes.

URARTU

Urartu ishte një mbretëri prej epokës së hekurit që ndodhej në malet e Armenisë me qendër pranë liqenit Van.

Mbretëria u ngrit në fuqi në mes të shek. IX, por e pushtuan medasit në fillim të shek. VI. Trashëgimtarët e mbretërisë ishin

armenasit dhe mbetëritë e tyre të mëpasshme. Asirianët gjithashtu e kishin sulmuar Urartun herë pas here nga perandorët si vijon: Tukulti-Ninurta I (rr 1240), Tiglat-Pileser I (rr. 1100 p.e.s), Ashur-bel-kala (c. 1070), Adad-nirari II (rr. 900), Tukulti-Ninurta II (rr. 890), dhe Ashurnasirpal II (883–859).

Urartu arriti kulmin e tij nën sundimin e Argishtit (rr. 785 – 760 p.e.s.), dhe u bë ndër mbretëritë më të fuqishme të Lindjes së Afërt, dhe, pasi që kishte bërë të dështojë sulmi i Shalmaneserit IV, mbreti Argishti themeloi një kryeqytet të ri pranë liqenit Van.

Tiglath Pileser III i Asirisë e pushtoi Urartun në vitin e parë të sundimit të tij (745 p.e.s.). Pas fitores asirianët gjetën shumë kuaj dhe kalorës që përdorën për të tërhequr koçitë e tyre të luftës.